Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVII nr. 85 / 2008

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVII nr. 85 - 2008

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë: ***Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha

Korrektor: Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

Shtyp: *Koha* - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVII nr. 85 / 2008

Prishtinë
2008

EDITORIAL

Qemajl Morina

SHOQËRIA E HIXHRETIT DHE NE

Fillimi i vitit 2008 gregorian në të katër anët e botës u shënua me manifestime dhe ceremoni prej më të ndryshmëve, vetëm dhjetë ditë më vonë pasoi viti i ri hixhri 1429, i cili kaloi në heshtje, pa farë pompoziteti edhe në ato vende ku koha llogaritet sipas kalendarit hixhri. Pa farë manifestimesh, pa farë akademish për domethënien e një epoke të re të Islamit. Andaj, një popull që nuk e di rëndësinë e të kaluarës së tij, ai nuk është i denjë të ketë një të ardhme më të mirë. Ky është realiteti ynë si ymet islam dhe si botë islame.

Më 10 janar, është dita e parë e muajit Muharrem 1429, vitit të ri të myslimanëve, sipas kalendarit hixhri. Myslimanët kanë kalendarin e tyre hënor, i cili bazohet në rrotullimet e hënës. Kalendari mysliman ka 12 muaj, por me vetëm 354 ditë, do të thotë se është më i shkurt se kalendari diellor apo gregorian për 11 ditë. Për këtë shkak viti i ri i myslimanëve, por edhe festat islame, siç janë dy bajramet, brenda një viti lëvizin për 11 ditë, për këtë ato bien në stinë të ndryshme të vitit. Sa për ilustrim po përmendim se në vitin 2008 kemi tre vjet të kalendarit hixhri 1428, 1429 dhe 1430.

Kalendari islam, i njohur si kalendari hixhri, është i lidhur me shpërnguljen e profetit Muhamed prej Mekes në Medine, e cila ka ndodhur në vitin 622. Edhe pse dihet se shpërngulja nuk ka ndodhur në fillim të muajit Muharrem, por dy muaj më vonë, megjithatë, kur është bërë institucionalizimi i kalendarit islam, në kohën e sundimit të halifit të dytë të myslimanëve Omerit r.a., fillimi i muajit Muharrem është marrë si datë nismëtare e epokës islame. Meqenëse, kalendari islamik është i asociuar me hixhretin, viti i ri shfrytëzohet për ta përkujtuar hixhretin si njërën prej ngjarjeve më të mëdha në historinë islame dhe si nismë e ndërtimit të shtetit islam.

Profeti i Islamit, Muhamedi a.s. kishte kaluar mbi dhjetë vjet të plota në vendlindjen e tij në Mekke, duke u përpjekur t'i bindë bashkëqytetarët e tij të Mekes të besojnë në fenë Islame, principet e së cilës ishin diametralisht të kundërta me besimin politeist, që ata besonin në atë kohë. Por, ato përpjekje nuk patën sukses. Numri i atyre që kishin besuar fesë së re që ai predikonte ishte shumë i vogël. Në ndërkohë, paria e Mekes, e cila kishte frikë se nëse rritet numri i atyre, që do ta pasojnë profetin Muhamed, mund të rrezikohen interesat e tyre jo vetëm në aspektin e besimit, por edhe interesat e tyre ekonomike dhe privilegjet, që ata gëzonin si shtresa më e lartë e shoqërisë. Në veçanti, kur dihet se aty gjendej tempulli i shenjtë, Qabeja e cila edhe para Islamit vizitohej nga arabët e tërë Gadishullit Arabik, si dhe qendër me rëndësi tregtare, nga e cila përfitonin klasa sunduese. Andaj, ata filluan t'i sulmojnë, abuzojnë dhe t'i torturojnë ata pak njerëz, që kishin pasuar fenë, të cilën po predikonte profeti Muhamed. Për t'iu shmangur këtyre maltretimeve, të cilat ishin shumë të vrazhda dhe në pamundësi t'i marrë nën mbrojtje, ai i këshilloi ata të emigrojnë në Abisininë e atëhershme e në Etiopinë e sotme, sepse "aty sundon një mbret i krishterë, i cili është i drejtë dhe do t'u marrë nën mbrojtje", u kishte thënë profeti Muhamed, pasuesve të vet.

Emigrim i dytë i myslimanëve të parë ishte brenda në Gadishullin Arabik, në qytetin Jethrib. Kjo kishte ndodhur pas kontakteve të para që kishte pasur Pejgamberi a.s. me disa përfaqësues të fisit Evs dhe

Hazrexh të Jethribit, gjatë vizitës së tyre në Qabe. Numri i myslimanëve të shpërngulur në Jethrib ishte 70.

Në fillim të vitit 622, profeti Muhamed do të informohet se paria e Mekes po organizonin një komplot për likuidimin e tij. Ky ishte momenti i fundit, që ai në shoqërinë e shokut të tij besnik, Ebu Bekrit të shpërngulet prej Mekes në qytetin Jethrib, i cili pas shpërnguljes së tij do të quhet me emrin "el-Medinetu el-Munavvaratu" (Qyteti i shndritshëm).

Shpërngulja e profetit Muhamed prej Mekes në Medine, nuk është një shpërngulje e thjeshtë prej një qyteti në një qytet tjetër, apo prej një vendi në një vend tjetër, por ajo ishte një kthesë e madhe në historinë islame. Për profetin Muhamed dhe myslimanët ishte një mënyrë e re e jetës. Andaj, si e tillë meriton që me të, të fillojë edhe epoka e re e Islamit. Tani e tutje, principet organizative të shoqërisë së re nuk do bëheshin në baza të lidhjeve farefisnore, por në baza më të gjëra të humanitetit njerëzor. Njerëzit, që kishin shoqëruar profetin Muhamed në hixhretin (shpërnguljen) e tij quheshim "muhaxhirun" (muhaxher), të shpërngulur - emigrantë, kurse banorët e Medinës, të cilët kishin strehuar muhaxhirët quheshin "ensarë" (ndihmëtarë).

Profeti Muhamed, në ndërtimin e një shoqërie të re, në kuadër të shtetit të ri u përqendrua në tre principe themelore: E para: në formimin e njeriut të ri, sepse ai është bërthama e shoqërisë. Andaj, me tërë potencialin e vet u angazhua në sendërtimin e marrëdhënieve mes njeriut dhe Zotit, pastaj në mes myslimanit dhe vëllait të tij mysliman dhe më në fund në marrëdhëniet e tij me të tjerët, prej jo myslimanëve.

Për të sendërtuar marrëdhëniet e njeriut me Zotin, punën e parë që bëri ishte ndërtimi i xhamisë, që ajo të jetë qendër adhurimi, edukimi dhe formimi për të gjithë myslimanët. Sepse, nëpërmes mësimeve të Allahut bëhej forcimi i lidhjes mes myslimanit dhe Krijuesit të tij, i cili manifestohej gjatë faljeve të pesë kohëve të namazit.

Qëllimi i xhamisë ishte pastrimi i shpirtrave dhe edukimi i tyre, për atë edhe ndërtimi i saj ishte shumë i thjeshtë. Për dallim nga realiteti ynë i tashëm, kur ne ndërtojmë xhami të bukura, gjigante me shu-

më zbukurime dhe arkitekturë moderne, ku investohen miliona euro apo dollarë, mirëpo ne po dështojmë në edukimin e shpirtrave sipas vlerave të larta islame. Këtu shihet dallimi mes përmbajtjes së brendshme dhe formës së jashtme!

Prej bazave themelore dhe prioriteteve në sendërtimin e shoqërisë së hixhretit, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm, në fuqinë dhe mbështetjen e shoqërisë së atëhershme ishte lidhja e fuqishme që ekzistonte mes myslimanit me vëllain e tij mysliman, tërësisht e bazuar në besimin e ri. Shembujt e këtillë janë të shumtë dhe të njohur në librat e historisë islame në vëllazërimin mes muhaxhirëve dhe ensarëve.

Dashuria për hir të Allahut, është mëshirë që depërton në shpirtrat e njerëzve dhe e forcon shoqërinë. Aty nuk ka vend për egoizëm në kolektivitet. Aty tretet lidhja në baza familjare, farefisnore dhe klanore, e cila ekzistonte para Islamit. Me anë të respektit, sakrificës e dashurisë, ensarët dhe muhaxhirët dhanë shembujt më të mirë në vëllazërimin dhe përkrahjen e ndërsjellë. Shembulli më konkret ishte ai në mes Sad ibni Rebia - nga ensarët dhe Abdurrahman bin Avf nga muhaxhirët. Tregimet janë të njohura dhe të shumta në këtë aspekt.

Dashuria dhe vëllazërimi i shoqërisë paraqet një vullnet të fuqishëm për shoqërinë, e cila është në gjendje të ballafaqohet me sfidat më të mëdha. Ky ishte synimi, të cilin dëshironte ta realizonte Pejgamberi a.s., sepse nëpërmes strategjisë afatgjate donte t'i përgatiste besimtarët e vet për një mision të madh dhe rol të rëndësishëm, si dhe për misione të vështira në të ardhmen, të cilat nuk mund të bartin vetëm njerëzit me moral të lartë dhe besim të fortë në Allahun e madhërishëm. Këtë ata e realizuan me sukses të plotë.

Shtrohet pyetja a ekzistojnë këto lidhje të dashurisë ndaj Allahut, por edhe lidhjet familjare dhe ndaj të afërmve tanë, por edhe obligimi më i vogël ndaj fqinjit?! Fqinji vdes, i afërmi sëmuret dhe askush nuk di për këtë! Pastaj ne pyesim ku është mëshira e Zotit?! Është çuar dhe atë e ka zëvendësuar ndërprerja, sepse ligji i Zotit nuk ndryshon. A nuk thotë Allahu për të afërmit se kush i mban lidhjet me ta do ta mëshirojë atë dhe kush i ndërpret do ta ndërpresë atë. Kjo pra ka të bëjë me më të afërmit tanë. Çka mund të themi për dashurinë dhe

vëllazërimin?! Andaj, nuk duhet ta qortojmë askënd tjetër përveç vetveten... Shembujt e ndërprerjes së lidhjeve familjare dhe të egoizmit në shoqëritë tona janë të panumërta.

Na mbetet principi i fundit i shoqërisë së hixhretit dhe shtetit islam e ai ka të bëjë me marrëdhëniet e myslimanit me jo myslimanin, apo ajo që sot quhet me tjetrin.

Prej akteve të para që bëri Pejgamberi a.s., kur vendosi bazat e shoqërisë së hixhretit dhe shtetit islam, ishte principi i pranimit të tjetrit prej jo myslimanëve, që në atë kohë ishin çifutët e Medinës dhe të krishterët e Nexhranit, në kuadër të tolerancës dhe pranimit të një realiteti ekzistues. Për t'i rregulluar këto marrëdhënie në mënyrë institucionale, ai hartoi Kartën e Medinës, e cila mund të krahasohet me kushtetutat e shteteve bashkëkohore. Në të, profeti Muhamed vendosi principin themelor të Kur'anit se nuk ka imponim në fe. Karta e Medinës përmbante disa principe, prej të cilave më të rëndësishme ishin:

Uniteti i popullit pa farë dallimi në baza fetare. Të gjithë pa dallim janë të barabartë në të drejta, përgjegjësi dhe privilegje. Kjo është ajo që quhet shtetësi, të cilën politikanët përpiqen ta realizojnë sot në shtetet e tyre. Aty thirrej për unitet për t'u ballafaquar me mizorinë, korrupsionin dhe armiqtë e jashtëm. Sigurohej e drejta e plotë e praktikumit të lirisë së fesë për jomyslimanët si dhe mbrohej pasuria dhe dinjiteti i tyre. Kërkohej prej jomyslimanëve që të kontribuonin në buxhetin e shtetit sikur myslimanët dhe të bashkëpunonin me ta në mënjanimin e ndonjë rreziku, që mund t'i kanosej shtetit nga ndonjë armik i jashtëm.

Ky ishte qëndrimi i Islamit dhe i akteve të tij të shkruara prej fillimit të paraqitjes së tij dhe formimit të shtetit islam. Çifutët e fisit beni Kurejdha nuk iu përmban akteve të Vesikes së Medines, ata iu bashkëngjiten armiqve dhe për atë edhe pësuan.

Për fat të keq, sot gjërat qëndrojnë ndryshe. Në vend të aleancës së qytetërimeve dhe bashkëpunimit mes tyre, flitet dhe shkruhet për konfliktin dhe luftën mes tyre. Kjo betejë sikur nuk ka të ndalur, dëmet janë tejet të mëdha dhe ato mund të jenë marramendëse, nëse lejojmë që kryeneçët të na udhëheqin e ne që i kuptojmë gjërat të heshtim dhe

të bëhemi sikur kjo nuk ka të bëjë me ne. Ne duhet të proklamojmë madhështinë e Islamit me vepra të mira, moral të lartë e jo me veprime, me të cilat Islami jo vetëm se nuk ka të bëjë asgjë, por ai në mënyrën më të ashpër i dënon ato. Në mes kryeneçësisë së tjetrit dhe madhështisë së Islamit, qëndron sekreti në vazhdimësinë e konfliktit civilizues gjatë historisë deri në ditët tona. Për fat të keq, në mes të disfatës së myslimanit në personalitetin e vet, humbjes së identitetit të vet, besimit të tij në tjetrin dhe injorimit të kaluarës së tij, fshihen dobësitë dhe humbja e jonë.

Këto ishin principet më kryesore të shoqërisë së hixhretit dhe shtetit të parë islam, i cili kontribuoi në përparimin e civilizimit botëror, i cili habiti filozofët dhe politikanët e të gjitha kohëve. Kjo na obligon të gjithë neve, që ai të jetë projekt civilizues i ymetit, për të cilin duhet të punojmë të gjithë ne, që ta rikthejmë në jetë.

Prej mësimeve të hixhretit nga të cilat mund të mësojnë myslimanët në kohën tonë, janë, se hixhreti nuk ishte një shpërngulje e thjeshtë prej një vendi në një vend, ashtu siç po veprojmë ne me shpërnguljet tona nënçmuese prej jugut në veri, për kushte më të mira jetësore të kësaj bote. Hixhreti ishte shpërngulje morale prej një gjendje në një gjendje tjetër. Thirrja islame u bart prej një vendi në një vend tjetër, prej një gjendje në një gjendje tjetër, prej pozitës së dobët në një pozitë të fuqishme dhe prej pakicës në shumicë, prej përçarjes në unitet, prej ngurtësisë në lëvizje. Për këtë edhe pati sukses.

Qemajl Morina

THE ISLAMIC NEW YEAR

(Summary)

The beginning of 2008, according to the Gregorian calendar, was marked by numerous manifestations. On the other hand, the Islamic New Year (1429) was ignored. A people, which does not recognize the importance of its past, does not deserve a better future. This is our current reality, as an Islamic Umma.

January 10 was the first day of the month of Muharram 1429 (Al-Hijra). Muslims use the Islamic calendar, which has 12 lunar months. The lunar year is approximately 354 days long. Since the Islamic lunar calendar is 11 to 12 days shorter than the solar year, Muslim holidays migrate throughout the seasons.

كمال مورينا

مجتمع الهجرة و نحن

(خلاصة البحث)

لقد تم الاحتفال بمناسبة راس العام الميلادي الجديد الفان و ثمانية بمراسيم مختلفة في جميع انحاء المعمورة قبل عشرة ايام من بداية العام الهجرى الف و أربعمائة و تسعة عشرين و الذي مر بهدوء حتى في تلك البلاد الاسلامية التي تعمل حسب التقويم الهجرى. و ذلك بدون احتفالات و بدون ندوات عن معانى الهجرة و الدروس المستفادة منها. عليه فان الامة التي لا تهتم بماضيها هي ليست جديرة بان تكون لها مستقبل أفضل. هذا و اقعنا كامة مسلمة و كعالم اسلامى.

في العاشر من يناير كان أول يوم من شهر محرم 1429 راس السنة الهجرية المسلمون يعتمدون على التوقيت القمرى و الذي يعتمد على تحركات الهلال. السنة القمرية لها 12 شهرا و لكن عدد الايام لا يتجازو 354 يوما و هذا يعنى بان السنة القمرية أقل من السنة الشمسية بأحد عشر يوما و لذلك نرى بان الاعياد الاسلامية تقع في فصول مختلفة على سبيل المثال نرى بان في السنة الشمسية 2008 تقع ثلاث سنوات هجرية 1428 و 1429 و 1430.

AKAID

Orhan Bislimaj

BESËTYTNIA DHE RREZIKU I SAJ NË BESIMIN ISLAM

Hyrje

Fakti që myslimani i ka të ravijëzuara dhe të qarta dimensionet e besimit islam, në Kur'an dhe Hadith, i ndalohet të përvetësojë çdo formë tjetër besimi që nuk u referohet bazave të Fesë. Platforma e besimit Islam, e ka marrë formën e vet të prerë me përfundimin e shpalljes së Kur'anit. Ajo nuk pranon kurrfarë shtimi, as pakësimi, as evoluimi e as devijimi. Këtë platformë të besimit, e cila përbën thelbin e besimit dhe nuk është shumë e gjatë, ngase përmblidhet në formë të aksiomave dhe formulave, është e nevojshme që ta dijë secili besimtar, në mënyrë që mendësia e besimit, të mbrohet nga çdo devijim, i cili e kërcënon në mënyrë serioze ekzistencën e imanit. Në këtë aspekt, pa dyshim se prej dukurive shumë të rrezikshme, është besëtytnia, e cila konsiderohet kontradiktë e imanit. Në mënyrë që ta kuptojmë më shtruar rrezikun e besëtytnisë, këtë studim do ta parashtrojmë në dy pjesë:

1. **Besëtytnia**, ku do të diskutohet rreth terminologjisë së saj, njohjes me të, historikut të çështjes, llojeve të besëtytnisë dhe shkaqeve që çojnë në të; dhe

2. **Besimi islam përjashton kategorikisht çdo besëtytni**, ku do të diskutohet rreth sovranitetit të besimit islam, duke qartësuar aspektet e besimit, në të cilat, besëtytnia vjen në kontradiktë me imanin, si dhe do të shpjegohet se, përse besëtytnia është akt i frikshëm dhe i rrezikshëm për myslimanin!?

I. BESËTYTNIA

1.1. Domethënia gjuhësore dhe terminologjike e fjalës 'besëtytni'

Në kuptimin gjuhësor, fjala **besëtytni** (lat. bestia - bishë, kafshë) do të thotë paragjykim i gabuar, sipas të cilit disa ngjarje e dukuri merren si shenja të fshehta që parathonë të ardhmen ose që sjellin të mirën e të keqen, besim i kotë"[1]. Besëtytnitë nuk mbështeten në arsyen e shëndoshë të njeriut, në shkencë, në fe a në teologji.[2]

Në gjuhën arabe për fjalën besëtytni ekzistojnë disa shprehje. Si fjalë më e përgjithshme dhe adekuate është '**el-hurafetu**' - الخرافة, që do të thotë: *bisedë (ngjarje) e kotë tërësisht* (الحديث الباطل مطلقا)[3], përkatësisht '*bisedë e rremë për zbulimin e dëshirave të mira'* (الحديث المستملح المكذوب)[4]

Po ashtu, besëtytnisë i thonë edhe '**el-huza'bilu'**- الخزعبل, që do të thotë e '*pavërtetë'* (الباطل), ndërsa në kuptimin praktik 'el-huza'biletu'- الخزعبيلة konsiston '*bisedën që është atraksion për tallje / qeshje'* (الأضحوكة)[5], një indikacion ky se besëtytnia është objekt talljeje dhe asgjë nuk ka të bëjë me të vërtetën.

---

[1] Mikel Ndreca, "*Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*", botoi Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 87.

[2] Halit Muharremi, "*Fjalor i Teologjisë*" Tiranë, Geer, 2006. fq. 41.

[3] "*El-Munxhidu fil-lugati vel-a'lam*", boton 'darul meshrik' Bejrut - Libon, 1986. fq. 175

[4] Ibrahim Mustafa, Ahmed Hasen Ez-Zejjat, Hamid Abdul Kadir, Muhamed Alijun-Nexhar, "*El-Mu'xhemu'l Vesit*", pjesa e parë dhe e dytë, Darud-da'veti, 1989/1410, Stamboll, Turqi, fq. 229. Fjala 'el-hurafetu', po ashtu e ka kuptimin edhe të mbledhjes së pemëve në vjeshtë (ما يجتني من الفواكه في الخريف). Shih: Po aty, fq. 229.

[5] "*El-Mu'xhemu'l Vesit*", op.cit. fq. 232.

Më tej, besëtytnia identifikohet edhe me fjalën ‘**et-tijeretu’**- ألطيرة, që nënkupton “*parandjenjën për keq*” apo “*pesimizmin*”[6]. Pejgamberi a.s. në shumë hadithe të tij e përmend këtë shprehje dhe e krahason me fallin, magjinë, etj., duke i llogaritur si ‘besëtytni’ që pronarin e tyre e nxjerrin nga ymmeti i Muhamedit a.s.

Ndërsa në kuptimin terminologjik të fjalës, ‘besëtytnia’ si term akaidi, identifikon *bindjen e kotë besimore, e cila nuk ka kurrfarë mbështetje në bazat e Fesë (në Kur’an dhe Hadith) dhe, si e tillë konsiderohet devijim dhe kontradiktë e imanit, sepse e kundërshton esencialisht konceptin e monoteizmit, mbi të cilin ngrihet doktrina islame*.

1.2. Njohje me besëtytninë

Besëtytnia si një çështje që i përket sferës së bindjes të njeriut, përkatësisht besueshmërisë së tij, përgjithësisht shënon tërësinë e veprimeve apo bindjeve të caktuara, që në përmbajtjen e tyre kanë karakter irracional dhe qesharak, sepse nuk përkojnë me perceptimin racional si një formë që dikton besimi i vërtetë.

Në fjalorin e terminologjisë fetare, besëtytni-a (gr. deisidaimonia; lat. superstitio) do të thotë: besim i kotë, i zbrazët, i pamend dhe marrëzor, i cili, si i tillë nuk ka asnjë bazë apo mbështetje në arsyen e shëndoshë të njeriut, në logjikë, shkencë, teologjinë e fenë e njëmendtë; besim ky që paraqet tërësinë e përfytyrimeve të ndryshme të gabuara për gjoja fuqinë mbinatyrore dhe për veprimin gjoja magjepsës të gjësendeve, simboleve, veprimeve e sjelljeve të gjësendeve, fenomeneve dhe njerëzve (p.sh., nallça “shpëtimtare” në ballë të automjeteve, rruazat e kaltra në dorë të fëmijëve, të cilat këta i shpëtojnë nga “syri i keq”, pastaj maskota në ndeshjet sportive, të cilat sjellin fat, fitore, hedhja e ujit pas atij që shkon në provime, etj.)[7].

[6] Kjo fjalë me këtë kuptim përdoret edhe në shumë vende në Kur’an. (shih:En-Neml:47; Jasin:18-19, etj).

[7] Akad. Ekrem Murtezai, *“FJALOR i terminologjisë fetare”* boton Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, Prishtinë, 2007, fq. 68.

Në këtë rrafsh, karakteri i tyre, fund e krye është nënçmues, sepse ndërlidhet me besueshmëri të paarsyeshme, duke i dhënë gjësendeve atribute hyjnore se gjoja ato mund të ndikojnë në veprimtarinë dhe shëndetin e personave besëtytë. “Shikuar nga aspekti logjik e filozofik, besëtytnitë janë vendosje e lidhjeve shkakore ndërmjet atyre gjësendeve, dukurive apo njerëzve, të cilat zaten nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ose janë të lidhura në mënyrë të rastësishme (p.sh., rënia e meteorit dhe vdekja e ndonjë njeriut; skuqja e hënës dhe gjakderdhja; lufta pastaj paraqitja e tymtarit dhe ngjarja e padëshirueshme etj.)”[8]

Prandaj, themi se manifestimi i besëtytnive është tepër naiv dhe primitiv, sepse t’i jepet gjësendeve atribute mbinatyrore me rol efektiv në jetën e njeriut, pa shfaqur ndonjë lidhje shkakore të arsyeshme dhe të ndikueshme ndërmjet tyre, kjo nuk ka domethënie tjetër, pos hyjnizim i gjësendeve apo i krijesave, të cilat nuk mund të bëjnë asgjë absolutisht për veten e tyre e lëre më për të tjerët.

Ndërsa, në aspektin fetar, besëtytnitë legjitimisht konsiderohen si devijim në doktrinën e fesë Islame, sepse lënë ndikime negative dhe esenciale në organikën e besimit islam, ndërsa ndikime çoroditëse në mendësinë besimore të besimtarit.

1.3. Historiku i çështjes

Besëtytnia si manifestim naiv i besueshmërisë së njeriut, ka një shtrirje të lashtë në histori. Madje mund të themi se ajo zë fill, që në celulat e para të shoqërisë njerëzore. Në argumentet tradicionale të fesë Islame, kemi dëshmi të mjaftueshme se besëtytnitë si kontradiktë e besimit të drejtë kanë një histori tejet të gjatë. Fakti se, Allahu i Madhëruar ka dëshmuar se, secili popull ka pasur pejgamberë apo të dërguar, të cilët i kanë thirrur shoqëritë që të largohen nga besimet e devijuara, të kota dhe besëtytnitë dhe t’i kthehen besimit të drejtë[9],

[8] Akad. Ekrem Murtezai “*FJALOR*…” op.cit. fq. 68.

[9] Allahu xh.sh. në Kur’an thotë: ***“…Çdo popull pati udhëzues** (pejgamber).” (Kur’ani, Er-Rra’d:7).*

është argument se shoqëria njerëzore prej themelimit të saj është shoqëruar me devijim dhe besëtytni. Allahu i Madhëruar thotë:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولاً أَنِ اُعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ

"Ne çdo populli i kemi dërguar nga një pejgamber. Të gjithë ata thoshin: Adhuroni vetëm Allahun, e shmanguni idhujve" *(Kur'ani, En-Nahl:36)*[10]**.**

Fjala '**tagut'** (طاغوت) në konceptin e përgjithshëm përfshin '*çdo gjë tjetër që adhurohet përpos Allahut, prej xhinnëve, njerëzve dhe idhujve*" (كل ما عُبِدَ من دون الله، من الجن و الإنس والأصنام). Gjithashtu fjala '*tagut*' nënkupton "*çdo njërin që ka devijuar nga rruga e drejtë dhe i largon (të tjerët) nga rruga e hajrit, sikurse janë shejtani, fallxhori, magjistari* etj.

(كل رأس في ضلال يصرف عن طريق الخير، و شيطان و الكاهن و الساحر)[11]. Pra, fjala '*tagut*', në realitet është sinonim për çdo besëtytni apo adhurim të kotë.

Në Kur'an, në shumë vende lexojmë historinë e pejgamberëve dhe thirrjet e tyre drejtuar popujve te të cilët janë dërguar. Përkujtojmë Nuhin a.s. dhe popullin e tij mosbesimtar, pastaj pejgamberin Salih a.s., të cilit populli i tij i pati thënë: ***"Ne parandiejmë fatkeqësi me ty dhe me ata që janë me ty"*** *(Kur'ani, En-Neml:47),* ndërsa '*parandjenja*' (ألطيرة) është besëtytni e qartë. Së këndejmi përkujtojmë luftën e Ibrahimit a.s. me idhujt, që në thelb përbënin një besueshmëri boshe apo besëtytni. Sfidën e tij me babanë e vet Azeri, që ishte mjeshtër i idhujve, ndërsa adhurimi i idhujve, nuk është tjetër pos një besëtytni e kulluar. Pastaj kujtojmë rezistencën e pejgamberëve të tjerë, Jakubit a.s. e djalit të tij Jusufit a.s.. Po kështu kujtojmë Musain a.s. e vëllanë e tij Harunin a.s. me sfidën e 'viçit', të cilin e pati bërë nga ari një person me emrin Samirij, të cilin e adhuronin. Pastaj, kujtojmë edhe të

[10] Përkthimi i ajeteve me adaptime eventuale, është marrë nga: *KUR'ANI, përkthimi me komentim në gjuhën shqipe*, përktheu dhe komentoi H.Sherif Ahmeti, 1413 h / 1992 m, Prishtinë, botim i Medinës.

[11] *"El- Mu'xhemu'l Vesit"*, op.cit. fq.558-559.

gjithë pejgamberët e tjerë, për të ardhur te pejgamberi i fundit Muhamedi a.s..

Kur Muhamedi a.s. erdhi në Mekkën e atëhershme me shpalljen e fundit Kur'anin famëlartë, shoqërinë mekkase e gjeti të kapluar në politeizëm, besëtytni, mosbesim dhe dukuri të tjera negative. Arabët ishin aq paragjykues sa çdokush tjetër para ardhjes së Kur'anit. Ata nuk ndërmerrnin asnjë udhëtim apo vendim tjetër të rëndësishëm, pa iu referuar besëtytnive të llojllojshme dhe idhujve te të cilët kërkonin ndihmë dhe mbarësi. Le të kujtojmë vetëm çlirimin e Mekkës, ku Pejgamberi a.s. i largoi nga Qabeja mbi 350 idhuj që ishin shndërruar në kult adhurimi. (shih: Kur'ani, El-Isra:81).

Pra, për gjatë gjithë historisë, besëtytnia ka pasur manifestim. Më e njohur, thuajse te të gjithë popujt pa dallim, të parët e të mbramët, ka qenë besëtytnia në parashikimin e së ardhmes dhe të fshehtës nëpërmjet yjeve dhe lëvizjeve të trupave qiellor, e njohur si **astrologji.**[12]

Është konkludim i arsyeshëm se besëtytnia, rrënjët i ka në primitivizëm. Qoftë në primitivizmin që ndërlidhet me kohën, ku shoqëritë në të kaluarën ruanin dhe trashëgonin me fanatizëm besëtytnitë, qoftë me primitivizmin që ndërlidhet me mendësinë, ku njerëzit vazhdimisht shpikin (sajojnë) besëtytni të cilat nuk kanë ekzistuar më parë, sikurse janë besimi në vende të 'shenjta' apo individë, me të cilët ndërlidhet ndonjë ngjarje e kohës.

Fatkeqësisht edhe në mjediset e myslimanëve janë importuar besime të kota dhe besëtytni. Ndonëse koha e Pejgamberit a.s. dhe gjenerata e artë e sahabëve i bëri një shkëputje të vërtetë transmetimit të besëtytnisë nga mendësia e periudhës së injorancës, megjithatë, shoqëria islame nuk do të mundë ta ruajë imunitetin e vet nga infeksioni i saj. Veçanërisht, do të bëhet e pashmangshme kur feja Islame do të shtrihet në vendet e Persisë, Bizantit, Indisë, Egjiptit etj., vende këto që nga historiografia botërore shquhen për kultura dhe besime me bazë mitologjike. Myslimanët e rinj nga këto vende, sigurisht se jo të

[12] **Astrologji** (gr. dituri për yjet) dituri e rreme, që përpiqet të parashikojë ngjarjet dhe fatin e njerëzve, duke vëzhguar vendosjen e trupave qiellorë. (shih: Mikel Ndreca, "*Fjalor fjalësh …*" op.cit. fq. 61)

gjithë, kanë marrë me vete edhe elemente prej 'besimit' të vjetër. Kur kësaj ia shtojmë edhe atë se ka pasur njerëz të feve të tjera, që kanë kaluar në fenë islame duke synuar rrënimin e fesë nëpërmjet interpretimit të gabuar të doktrinës.

Një gjendje e këtillë, kur më pak e kur më shumë e ka shoqëruar ecjen e Islamit nëpër shekuj (kohë). Nëse gjendjen e shikojmë në kohën tonë, kur komunikimi me shoqëri të ndryshme të besimeve dhe kombësive të ndryshme, është bërë pjesë normale e jetës bashkëkohore, gjegjësisht një model i pashmangshëm i globalizmit (modernizmit), atëherë besëtytnia me shumë lehtësi edhe importohet, po edhe eksportohet nga njëri vend në tjetrin. Në rastin konkret, besëtytnia te ne (myslimanët) ka ardhur nga dy rrugë:

- Ose na është importuar dhe na importohet pahetueshëm nga kulturat tjera, duke vazhduar të ruhet si një 'trashëgimi e gabuar' që transmetohet prej gjeneratës në gjeneratë,
- Ose, fenomenin e besëtytnisë, feja islame ka mundur ta gjejë të pranishme në shoqëritë, të cilat kanë pranuar konvertimin në Islam, sikurse kjo ka ndodhur me shoqërinë idhujtare të Mekkës, pas ardhjes së Pejgamberit a.s. apo edhe me të gjitha shoqëritë tjera, ku Islami i ka hasur për herë të parë, pa e përjashtuar nga kjo edhe vendin tonë dhe hapësirat ballkanike.

Pa marrë parasysh se si, sot, në gjithë globin, fatkeqësisht edhe në mesin e myslimanëve, besëtytnitë nuk kanë të ndalur, ku më pak e ku më shumë. Janë hapur qendra të ndryshme astrologjike, në të cilat paragjykohet fshehtësi të ndodhive të së ardhmes, duke manipuluar me të ardhmen. Pastaj, këto informata boshe emetohen nga botues të ndryshëm nëpër edicione televizive, në faqe të gazetave ditore e atyre periodike.

1.4. Llojet e besëtytnisë

Besëtytnitë janë të shumta dhe të ndryshme. Pothuajse, secili vend i ka besëtytnitë e veta. Disa prej tyre kanë karakter më gjithëpërfshirës dhe rajonal e disa të tjera janë më të kufizuara dhe lokale. Numri i tyre është aq i madh sa që është e pamundur të përfshihen në këtë punim të gjitha, apo edhe të shpjegohen të gjitha. Mirëpo, tërësia e besëtytnive mund të përmblidhet në tri kategori, nga të cilat edhe do të sjellim shembuj: besëtytnitë që lidhen me ndonjë subjekt; besëtytnitë që lidhen me ogurët (shenjat) dhe gjësendet, dhe besëtytnitë që lidhen me vendet e caktuara.

a) Besëtytnitë që lidhen me ndonjë subjekt

Në këtë kategori hyjnë të gjitha besëtytnitë që ndërlidhen me ndonjë qenie të gjallë, pa marrë parasysh se është njeri, kafshë, shpend apo diçka tjetër. Prej besëtytnive më të shquara të këtij lloji janë:

Magjia (gr. mrekulli, çudi), e cila konsiston tërësinë e veprimeve që bëhen me lëvizje, me sende, me shkrime ose me fjalë, të cilat gjoja kanë fuqi të ndikojnë mbi njerëzit e mbi dukuritë e natyrës dhe të bëjnë çudira. Pra, aftësia e jashtëzakonshme që ka dikush për ta bërë për vete.[13] Njerëzit, duke mos e njohur irracionalitetin e magjisë, besojnë se magjistari ka veti mbinatyrore, dhe mund të bëjë mrekulli, gjë që e madhërojnë atë e jo Allahun. Po kështu veprohet edhe me talismanet[14] e ndryshme, hajmalitë[15] apo amuletet.

---

[13] Mikel Ndreca, "*Fjalor fjalësh …"*op.cit. fq. 443.

[14] **Talismani:** nënkupton një objekt apo gjësend i përbërë prej drurit, metalit lëkurës, tekstilit, letrës etj. në të cilin janë shkruar fjalë e fjali nga "shkrimi i shenjtë" ose janë vizatuar simbole të shenjta të ndonjë feje, për ç'arsye besohet se bartësin e tij e mbron nga të ligat e ndryshme, siç janë sëmundjet, mësyshi nga syri i keq, dëmtimet, rreziqet që i kanosen njeriut gjatë jetës, dhe të njëjtit i sjell lumturi etj. (Shih: Akad. Ekrem Murtezai "*FJALOR…*" op.cit. fq. 589).

[15] Duhet thënë edhe këtë, se një pjesë e dijetarëve e lejojnë përdorimin e hajmalive, nëse ato përmbajnë lutje nga Kur'ani dhe Sunneti, në origjinal, me një shkrim të lexueshëm dhe të qartë, dhe duke pasur bindjen se hajmalitë si objekt, nuk sjellin efekt, por atë e sjell Allahu i Madhëruar. Sa i përket hajmalive që kanë vetëm shenja dhe shkrim të palexueshëm dhe përmbajtje të tjera, ato ndalohen me mendim unanim të dijetarëve. (shih: Jusuf Kardavi, "*Hallalli dhe harami në Islam"*, Shkup, 1998. fq. 242; shih: http://www.zeriislam.com/hutbe-fetva/fetva_Buti/Pyetje-dhe-pergjigje-VII.html).

Falli - parashikim i rremë dhe i pathemeltë i së ardhmes së dikujt, i ngjarjeve që do të ndodhin etj. Duke përdor letrat e bixhozit ose duke shikuar filxhanin e kafesë, vijat e pëllëmbës së dorës etj.[16] Falli është ndër besëtytnitë më të përhapura si në të kaluarën si në të tashmen. Arabët para Kur'anit, fatin e tyre e kërkonin nëpërmes shigjetave, në të cilën në njërën anë shkruante "*Zoti më urdhëroi*" në anën tjetër "*Zoti më ndaloi*", kurse ana e tretë ishte e pashkruar. Kur dëshironin të niseshin në rrugë ose të martoheshin, shkonin te shtëpia e idhujve, ku ishin shigjetat, dhe prej tyre e kërkonin fatin e tyre. Në qoftë se ishte shigjetë urdhëruese, niseshin, nëse ishte ndaluese, abstenonin, ndërsa nëse dilte ajo e pashkruara, atëherë e përsëritnin derisa të dilte e shkruara *urdhëruese* ose *ndaluese*. Kjo mënyrë e kërkimit të fatit i ngjan asaj që kërkon shoqëria jonë nëpërmjet rërës, guaskave, hapjes së faqeve, letrave, galave dhe qitjes fall nga filxhani. Të gjitha këto forma janë haram në Islam.[17]

Astrologët - janë ata, që me dituri të rreme, përpiqen t'i parashikojnë ngjarjet dhe fatin e njerëzve, duke vëzhguar vendosjen e trupave qiellorë.[18] Po ashtu, edhe përdorimi i astrologjisë për parashikimin e fatit, është prej besëtytnive të lashta. Këtu bën pjesë edhe **horoskopi**, si parathënie e fatit të njerëzve duke u bazuar në pozitën e yjeve.

b) Besëtytnitë që lidhen me ogurët (shenjat) dhe gjësendet

Besëtytnia në "shenja" është mjaft e përhapur. Në kohën parakur'anore, njohja e shenjave të mira apo të këqija përmes lëvizjeve të zogjve apo kafshëve njihej me emrin '**tijareh**', nga folja '**tare**' e cila do të thotë '*fluturon*'. P.sh., nëse një njeri niset për një rrugë dhe një zog fluturon mbi të dhe del në anën e majtë të tij, ai do ta konsiderojë atë si shenjë se po i afrohet një fat i keq, andaj sillet përreth dhe kthehet në shtëpi.[19] Ngjashëm me këtë, në trevat tona është bindja se nëse

[16] Mikel Ndreca, *"Fjalor fjalësh …"* op.cit. fq. fq.221.
[17] Jusuf Kardavi, *"Hallali ..."*, op cit. fq. 237-238.
[18] Mikel Ndreca, *"Fjalor fjalësh …"* op.cit. fq. 61.
[19] Abu Ameenah Bilal Philips, *"Bazat e tevhidit (monoteizmi islam)"* Prishtinë pa vit botimi, fq. 83.

bukla apo miu apo macja e zezë parakalojnë në rrugën para ndokujt gjatë udhëtimit, ky udhëtim mund të ketë ndonjë të keqe.

Prerja e thonjve- edhe kjo besëtytni është bërë praktike dhe ka një shtrirje të gjerë në popullatën myslimane. Sipas kësaj, meshkujt nuk duhet t'i presin thonjtë edhe të dorës edhe të këmbës përnjëherë, sepse sipas besimit në këtë rit u merret goja kur të dalin në gjyq.[20] Po kështu është edhe me rrobat e grisura, nëse ato i qepen mashkullit, përderisa i mban veshur.

Me rastin e vdekjes, gratë që marrin pjesë në të, mantelet apo xharret siç ishin të njohura në kohët e hershme i linin të varura jashtë shtëpisë në një litar, të cilin e vendos familja e të vdekurit. Kjo bëhet me qëllim që më në këtë shtëpi të mos vijë vdekja dhe mantelat të mos vishen për këtë qëllim. Po kështu, bijat dhe mikeshat që kanë marrë pjesë në vdekjen e caktuar, kurrsesi nuk kthejnë t'i shohin të afërmit e vet, duke mos dashur që vdekja të shkojë tek ata.[21]

Patkoi apo nallçeja e kalit, të cilën e përdorin shumë njerëz qoftë nëpër vetura apo nëpër dyert e shtëpive. Në Greqinë antike kuajt trajtoheshin si shtazë të shenjta. Një patkua mbi derë të shtëpisë, pjesa e prapme e të cilit vendosej në drejtim vertikal, mendohej se sjell fat, në të kundërtën, kur patkoi kthehej nga pjesa e hapur teposhtë njerëzit besonin se fatit i ka ardhur fundi.[22]

Rruazat e kaltra. Po ashtu, është shumë i përhapur besimi se ngjyra e kaltër sjell fat dhe na mbron nga ndikimet negative psikike dhe shpirtrat e ligë. Të veshësh veshje me ngjyrë të kaltër në ditën e parë të martesës është besuar se bashkëshortëve të ardhshëm në jetën e përbashkët bashkëshortore do t'iu sjellë fat, harmoni dhe lumturi. Një besim i tillë, është tejet i përhapur edhe në kohën e sotme dhe ka të bëjë me bartjen e zinxhirit apo qafores me guralecë të kaltër rreth

[20] Ali Vezaj, Punim Diplome, *Sihri, (magjia) xhinët dhe besëtytnia*, Prishtinë, 1998. fq.50.
[21] Ali Vezaj, *"Sihri..."* op.cit. fq. 50.
[22] Philips, *"Bazat e tevhidit …"* op.cit. fq. 80.

qafe, se ato na ruajnë nga gripi, ftohjet dhe inflamacionet e ndryshme.[23]

Mund të themi se, besëtytnitë në shenja kanë shtrirje të gjerë dhe janë të shumta. Të tilla janë edhe '**trokitja në dru'**, **'kripa e derdhur' 'thyerja e pasqyrës' 'Numri 13'** etj.[24]

c) Besëtytnitë që lidhen me vendet e caktuara

Ky lloj i besëtytnisë, zakonisht ndërlidhet me varret, në të cilat janë varrosur njerëz të ashtuquajtur 'të mbërrimë' apo me ndonjë vend tjetër që ndërlidhet me ndonjë ngjarje që ka lënë gjurmë në histori. P.sh., një prej këtyre besëtytnive është 'S**hëngjergji**', i cili festohet më 5 dhe 6 maj dhe është besëtytni e vërtetë. "Besohet se nëse kontaktohet me tokën vjen plleshmëria, kështu që vajzat rrokullisen nëpër livadhe për të pasur fat në martesë, kurse nuset për të pasur fëmijë. Atë ditë bëhen pastrimet rituale dhe spërkaten skutat e shtëpive dhe objektet e saj."[25] Në rajonin e Prizrenit, kjo festë festohet në atë formë, ku më 5 maj, njerëzit tubohen në varrezat e vjetra të qytetit, që njihen me emrin "Karabash"; aty gjendet edhe një 'tyrbe' rreth së cilës bëhet nderim, hedhin të holla, bëjnë nezër, presin qengja etj., të gjitha këto duke besuar se mbrojnë nga e keqja dhe çojnë në fat dhe mbarësi.[26]

Zakonisht, varret apo thënë ndryshe 'tyrbet' janë ato që kanë marrë identitet për 'vende të shenjta'. Këto besëtytni janë të përhapura në mbarë botën, ku më pak e ku më shumë.

[23] Adnan Abrashi "*Mistika e ngjyrave*" marrë prej http://www.syri3.com/mistika%20e%20ngjyrave.html
[24] Shih: Philips, "*Bazat e tevhidit …*" op.cit. fq. 90-92.
[25] Basri Iljazi, *Shkaqet e prapambeturisë së muslimanëve*, Tetovë, 1999. fq. 70-71.
[26] shih: Ali Vezaj, "*Sihri...*" op.cit. fq. 49.

1.5. Shkaqet që çojnë në besëtytni

Shkaqet e besëtytnisë janë të ndryshme dhe sillen nga vendi në vend. Por si shkaqe të përgjithshme, kryesisht janë katër sosh:

a) Mungesa e njohurive ndaj besimit islam. Mungesa e dijës fetare, është pikërisht elementi që favorizon shfaqjen e besëtytnive. Kjo, sepse njeriu është instinktivisht qenie në nevojë për prehje besimore. Besimi në të mbinatyrshmen (Allahun), tashmë është vërtetuar botërisht, nga shumë anë, se është diçka që buron në vetë individin. Nëse kjo nevojë e natyrshme, te besimtari nuk përmbushet mjaftueshëm me iman, ajo medoemos do të absorbojë forma tjera të besimit, që si të tilla janë të paverifikuara, besëtytni, mitologji dhe kontradiktore me konceptin e monoteizmit islam. Në këtë aspekt, besëtytnia është një dukuri që ndërfutet në mendësinë e besimtarit, ndoshta pa u hetuar, si pasojë e mospajisjes së tij me njohuri të mjaftueshme rreth imanit.

b) Ndjekja e dëshirave dhe e tekave personale. Ndjekja e pasioneve sipas domethënies parimore, nënkupton që veprimet dhe bindjet t'i referohen korrigjimit të dëshirave të lira personale, e jo mësimeve të Kur'anit dhe Sunnetit të Muhamedit a.s. apo të fesë Islame si tërësi. Kur'ani na njofton se të gjithë popujt para kur'anor, kanë devijuar thellë, atëherë kur subjektet fetare i kanë vendosur nën korrigjimin e diapazonit të arsyes dhe dëshirave, përkatësisht duke i dhënë mendjes dhe dëshirave kompetencë për diçka që nuk u lejohet.

Për këtë arsye, njerëzve që gjykojnë sipas dëshirave dhe pikëpamjeve personale në subjektet fetare u është thënë: të dhënët pas dëshirave (ehlul ehva). Njerëz të tillë, përgjithësisht u japin rol gjykues kulturës, pikëpamjeve dhe prirjeve të marrë jashtë mjediseve islame dhe pastaj nga ky kënd i shohin argumentet juridike (të sheriatit). Dhe për këtë shkak - ashtu si edhe në filozofi - parashtrojnë pikëpamje të ndryshme nga njëri-tjetri si dhe të veçanta nga "rruga e drejtë" (sirati mustekim).[27] Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: ***"E nëse ata nuk të***

[27] Prof. Dr. Bekir Topaloğlu, "*Hyrje në Kelam*", Prishtinë 2002, fq. 163.

përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakt prej Allahut, ndjek epshin e vet?...” *(Kur’ani, El-Kasas:50).*

c) Fanatizmi në argumente. Fanatizmi është një dukuri tepër e rrezikshme, sepse është predispozitë për njëanshmëri në gjykime. Njeriu fanatik, shumë vështirë mund ta pranojë (vlerësojë) fuqinë e argumenteve dhe kështu ndjekjen e të vërtetës. Allahu në Kur’an thotë: *”**E kur u thuhet atyre** (idhujtarëve): **Pranoni atë që Allahu e shpalli! Ata thonë: Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë** (ata do t’i pasonin)” (Kur’ani, El-Bekare:170)*

Në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe ndjekësit e tarikateve si dhe adhuruesit e varreve, të cilët, nëse dikush i fton që të ndjekin rrugën e saktë, fillojnë e argumentohen duke thënë se rruga që ndjekin ata është rruga që kanë ndjekur baballarët dhe gjyshërit e tyre.[28]

d) Imitimi i jomyslimanëve. Ky është njëri prej shkaqeve kryesore të besëtytnisë te myslimanët. Sepse, sikurse dihet doktrina e fesë islame nuk pranon kurrfarë besëtytnie. Të gjitha besëtytnitë që ekzistojnë apo që mund të ekzistojnë te myslimanët janë pasojë e imitimit të feve tjera dhe kulturave të tjera. Transmeton Ebu Vakid El-Lejthij se:

أَنَّ رَسُولَ اللَّه صَلَّى اللَّهُ عَلَيْه وَسَلَّمَ لَمَّا خَرَجَ إِلَى حُنَيْنٍ مَرَّ بِشَجَرَةٍ لِلْمُشْرِكِينَ يُقَالُ لَهَا ذَاتُ أَنْوَاطٍ يُعَلِّقُونَ عَلَيْهَا أَسْلِحَتَهُمْ فَقَالُوا يَا رَسُولَ اللَّه اجْعَلْ لَنَا ذَاتَ أَنْوَاطٍ كَمَا لَهُمْ ذَاتُ أَنْوَاطٍ فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْه وَسَلَّمَ سُبْحَانَ اللَّه هَذَا كَمَا قَالَ قَوْمُ مُوسَى اجْعَلْ لَنَا إِلَهًا كَمَا لَهُمْ آلِهَةٌ وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِه لَتَرْكَبُنَّ سُنَّةَ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ

[28] Dr. Saleh El-Fevzani *“Tevhidi”* Tiranë, 2000, fq. 149.

*“Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s., ishte nisur për të shkuar në Hunejn[29] me disa shokë, gjatë rrugës kaluan pranë një lisi të politeistëve që quhej ‘dhatu envatin’. Politeistët e kishin zakon t’i varnin armët e tyre në të (kinse që t’u sjellë fat). Disa nga sahabët (shokët e Pejgamberit a.s., të cilët sapo kishin pranuar fenë Islame) thanë: O i Dërguari i Allahut, bëna edhe neve një “dhatu envat”, sikurse e kanë ata (idhujtarët): Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj: ’Subhanall-llah’ – madhëruar qoftë Allahu. Ky veprim i juaji është mu si ai që populli i Musait a.s. i ka thënë atij: **’bëre një zot për ne si zotërat e tyre’[30].** Pasha atë që e ka shpirtin tim në dorë, të gjithë ju do të ndiqni rrugën e atyre para juve.*[31]

II. BESIMI ISLAM PËRJASHTON KATEGORIKISHT ÇDO BESËTYTNI

Deri këtu, përgjithësisht ofruam një njohje parimore karakterizuese me besëtytninë, tani do të shohim se si qëndron çështja e saj në besimin islam. Për të ditur se në cilin aspekt besëtytnia e kundërshton besimin islam, së pari duhet ta kuptojmë vetë konceptin e besimit.

Boshti, mbi të cilin ngrihet doktrina e besimit islam është **tevhidi** - deklarimi i Njëshmërisë së Allahut të Madhëruar me fjalët ‘*la ilahe illall-Llah’* - Nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) përpos Allahut.

2.1. Tevhidi - deklarimi i njëshmërisë së Allahut

Tevhidi, si akti i parë dhe i përhershëm i myslimanit, identifikon pikën kulmore, nën parametrat e së cilës përfshihet gjithçka për fenë

[29] “Hunejn” - emër i njërës prej betejave më të mëdha të Pejgamberit a.s. kundër pabesimtarëve, e cila u zhvillua në vitin e 10 - të hixhretit.

[30] Allahu në Kur’an thotë: ***”Beni Israilët** (ata që i kishin besuar Musait a.s.) **i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë:O Musa, na e bën edhe ne një zot** (statujë) **si zotët që i kanë ata** (ai popull)**”. Ai (Musai) tha:’ju jeni popull që nuk dini’”** (Kur’ani, El-A’raf:138).*

[31] “Sunenut-Termidhij”, Kitabu:El-futunu an Resulilahi, Babu: ma xhae leterkebun-ne sunenu men kane kablukum, hadithi nr.2106. (citim sipas: CD-së)

dhe rreth fesë. Ky nocion, në esencën e vet konsiston tri gjëra thelbësore:

- *Mohimin e çdo hyjnie përveç Allahut të Lartësuar;*
- *Vërtetimin e Hyjnisë së mirëfilltë të Allahut xh.sh. jashtë çdo rivaliteti;* dhe
- *Pangjashmërinë e Allahut me asgjë prej krijesave të Tij dhe e kundërta.*

Dijetarët, për ta njohur unikalizmin gjithëpërfshirës të tevhidit, si nocion që përshkon çdo akt fetar, atë e kanë ndarë në tri aspekte (sfera)[32]:

a) "**Tevhidu'r-Rububijjeh**" (**توحيد الربوبية**) - të besuarit e Njëshmërisë së Allahut në aspektin se, vetëm Ai është Krijues dhe Sundues i çdo gjëje. Tevhidur-rrububije, konsiderohet prej kategorive të para të tevhidit, sepse ngërthen në vete të besuarit në ekzistencën e Qenies së Allahut për Krijues, Sundues dhe furnizues të çdo gjëje. Këtë aspekt të tevhidit, parimisht e beson çdo krijesë instinktivisht (shih: Kur'ani**,** Ali Imran: 83). Në Kur'an tregohet se sikur të pyeteshin idhujtarët se, kush është krijues i tokës dhe i qiejve, ata do të thoshin 'Allahu', sikurse thotë Allahu i Madhëruar: *"**Po nëse ti i pyet: Kush i krijoi ata, me siguri do të thonë: Allahu**!..."(Kur'ani, Ez-Zuhruf:87); pastaj: **"Thuaj:kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka, kush e ka në dorë të dëgjuarit e të parit** (tuaj), **kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe e nxjerr të vdekurin nga i gjalli, kush rregullon çdo çështje? Ata do të thonë: Allahu…"** (Kur'ani, Junus:31).*

b) "**Tevhidu'l-Uluhijjeh**" (**توحيد الألوهية**) - Të besuarit e Njëshmërisë së Allahut të Madhëruar në aspektin se, vetëm Ai duhet të adhurohet dhe askush tjetër. Ky lloj i tevhidit, e obligon të besuarit se:

- Vetëm Allahu është Një dhe i Vetëm;

[32] Duhet ta qartësojmë se këto tri lloje të tevhidit, janë pjesët që përbëjnë një tërësi të vetme, e ajo është feja Islame apo imani. Ato janë të lidhura ndërmjet veti në mënyrë të pandashme. Ndërsa, qëllimi i kësaj ndarje, është vetëm profilizimi i aspekteve për njohjen më të mirëfilltë të spektrit të dokrtrinës Islame. Nëse njëri prej tyre mohohet, është mohim i vetë Imanit si tërësi dhe konsiderohet dalje nga feja Islame.

- Vetëm Allahu është meritor për t'u adhuruar dhe askush tjetër pos Tij;
- Vetëm Atij i takojnë të gjitha adhurimet; dhe
- Vetëm prej Tij kërkohet ndihmë, e nga askush tjetër.

Bazuar në këtë, besimtari adhuron (i bënë ibadet) vetëm Allahun dhe askënd tjetër, pastaj vetëm Atë e do me të vërtetë, frikësohet vetëm prej Tij, shpreson vetëm prej Tij, duanë (lutjen) ia drejton vetëm Atij, mbështetet vetëm në Të, vetëm ndaj Tij shpreh përvuajtjen, përulësinë, pendesën dhe të gjitha llojet e tjera të ibadetit.[33] Pikërisht kjo kategori e tevhidit, është ajo që njerëzit i bënë të dallojnë njëri nga tjetri, përkatësish të dallohen besimtarët e vërtetë nga jobesimtarët.

c) "**Tevhidu'l-esmai ve's-sifati**" (**توحيد الأسماء و الصفات**) - të besuarit e Njëshmërisë së Allahut të Madhëruar në aspektin se, vetëm Atij i takojnë emrat dhe cilësitë e përsosura.[34] Allahu i Madhëruar posedon emrat dhe cilësitë e Tij të përkryera dhe jashtë çdo krahasimi me cilësitë e krijesave. Cilësitë e Tij ndahen në të Qenies (ألذاتية), sikurse janë: **el-vuxhud** (Allahu ekzisto), **el-kidem** (është i përhershëm pa fillim), **el-beka** (i gjithmonshëm pa fund), **el-vahdanijjeh** (është një i vetëm), **el-muhalefetu li'l-havadithi** (është i pangjashëm me krijesat), **el-kijamu bin-nefsi** (ekziston nga vetvetiu), **el-ilm** (është i gjithëdijshëm), **el-kudretu** (është i gjithëfuqishëm), **el-iradetu** (ka vullnet të pavarur), **es-sem'u** (dëgjon çdo gjë), **el-besaru** (shikon çdo gjë), **el-hajat** (jeton), **el-kelam** (posedon të folurit), **et-tekvin** (krijon nga asgjëja), dhe të veprës (ألفعلية), sikurse janë: **et-tahliku** (të krijuarit), **et-terziku** (të furnizuarit), **el-inshau** (të bërit), **el-ibdau' (**të shpikurit**), es-sun'u (**të formësuarit) dhe cilësi të tjera të Qenies dhe të Veprës të përmendura në Kur'an dhe hadithe të Muhamedit a.s., të cilat, myslimani obligohet t'i besojë.

[33] Dr. Muhamed Naim Jasin "*Besimi, bazat, esenca, negacioni*" boton Furkan ISM, Shkup, 1998, fq. 15.

[34] Ibnu Ebil Izz, El-Hanefijj, "*Sherhu'l akidetit-tahavije"*, vërtetimin shkencor dhe recenzimin e kanë bërë grup dijetarësh, botimi i nëntë 1408h \ 1988m, El-mektebetu'l Islamijj, Bejrut, fq. 78.

Në këtë aspekt, duke i besuar cilësitë e Allahut të Madhëruar, mbyllet rreptësisht çdo portë e besëtytnive, sepse nëse i kërkojmë ndihmë dikujt tjetër përpos Allahut, sikurse është të drejtuarit varreve, kjo do të thotë se atij që i drejtohemi po i japim cilësinë e gjithëfuqishmërisë, dëgjimit, gjithëdijës dhe cilësi të tjera që i kërkon akti i kërkesës dhe përgjigjes ndaj saj, ndërsa është fare e qartë se ata janë të pafuqishëm për të dëgjuar kërkesën apo kthyer ndonjë gjë (përgjigje), ngase vetëm Allahu është i gjithëfuqishëm dhe krijon çdo gjë. Prandaj, atyre nuk duhet drejtuar, por Atij që është i Gjallë, që nuk vdes.

2.2. Argumentet për ndalimin e besëtytnisë

a) Argumentet nga Kur'ani

Argumentet (tradicionale) nga Kur'ani dhe Hadithi na mësojnë se imani dhe besëtytnia janë dy gjëra të kundërta. Njëra tjetrën e luftojnë. Edhe imani edhe besëtytnia në të njëjtën kohë nuk mund të bashkohen te një besimtar. Kur mungon prezenca e imanit, shfaqet besëtytnia. Derisa imani shprehjen e vet e lidh për besimin në Allahun Një, Krijues të çdo gjëje, besëtytnia objektivin e vet e adreson në të krijuarën. Anashkalimi i direktivave që burojnë nga imani dhe përvetësimi i bindjeve të tjera, duke i dhënë gjësendeve prerogativën që i takon Krijuesit Absolut, apo duke besuar në ta, apo duke iu lutur atyre, apriori shpie në rrugët që çojnë ose në politeizëm (besim në shumë zota) ose në ateizëm (mosbesim). Kjo është edhe domethënia e ajetit të Kur'anit famëlartë:

وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلاَّ وَهُم مُشْرِكُونَ

"Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, vetëm se duke i shoqëruar *(zota të tjerë)". (Kur'ani, Jusuf:106).* Pra, e besojnë Allahun, por këtë besim e shoqërojnë edhe me besëtytni të tjera, rival besimit në Allahun. Po ashtu në një ajet tjetër Allahu urdhëron qartë:

وَلاَ تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لاَ يَنْفَعُكَ وَلاَ يَضُرُّكَ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذًا مِنَ الظَّالِمِينَ

"Dhe mos lut tjetër kë pos Allahut, ndonjë *(idhull)* ***që nuk të sjell as dobi as dëm, e nëse bën atë, dije se i ke bërë padrejtë vetvetes"*** *(Kur'ani, Junus:106).*

Thënia e Allahut ***'mos lut tjetërkënd pos Allahut'*** është gjithëpërfshirëse, dhe e kufizon çdo mundësi tjetër që njeriu t'i drejtohet dikujt tjetër apo të hyjnizojë diçka tjetër.

Kur u paraqit Pejgamberi a.s. në shoqërinë e atëhershme ekzistonin disa njerëz që njiheshin me emrin '*kehhan'* ose '*arr-rrafin'* (fallxhorë e astrolog), të cilët pretendonin se i njihnin ngjarjet e të kaluarës dhe të ardhmes nëpërmjet kontakteve me xhinët ose me krijesat të ngjashme me to, dhe për këtë shkak Pejgamberi a.s. u shpalli luftë gënjeshtarëve të tillë, të cilët nuk mbështeteshin në dituri të vërtetë, në rrugë të drejtë dhe në librin ndriçues, dhe ua lexoi ajetin që ia shpalli Allahu xh.sh.[35]:

"Thuaj: "Askush veç Allahut as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtën, as nuk e di se kur ringjallen" *(Kurani: En-Neml: 65).*

Domethënë, të fshehtën nuk e di askush, as engjëjt, as exhinët e as njerëzit, sepse Allahu i Madhëruar e ka dëshmuar këtë dhe e ka vërtetuar. Hutimi i disa njerëzve se gjoja xhinnët e dinë të fshehtën dhe të ardhmen është vetëm iluzion dhe mashtrim. Xhinnët, në raste të caktuara, mund ta dinë vetëm atë që ndodhë dhe atë që planifikon njeriu për ta bërë në të ardhmen dhe jo atë që do të ndodhë. Pra, duhet bërë dallim ndërmjet:

- **planifikimit** për të ardhmen, dhe
- **njohjes së ndodhive** të së ardhmes.

Njëra dhe tjetra kanë dallim esencial. Le ta marrim një shembull: Unë planifikoj, që pas një jave ta blej një shtëpi, por këtë plan e mbaj sekret dhe nuk mund ta dijë askush pos Allahut të Madhëruar. Fallxhorët, këtë planifikim timin mund ta dinë nëpërmjet xhinnit tim (el-karinu[36]), i cili i dëgjon planet e mia dhe ia transmeton në moment

[35] Jusuf Kardavi, *"Hallalli dhe harami në Islam"*, Shkup, 1998. fq. 236.

[36] El-Karinu - përcjellës: është shejtani që e shoqëron secilin njeri. Pejgamberi a.s. me një rast i pati thënë Aishes r.a. *"A të erdhi shejtani yt"? "A thua, vallë, a edhe unë kam shejtan"?- pyeti ajo. (P.a.s) Tha: "S'është askush prej jush pa shejtanin e vet"…"* (sipas:

fallxhorit, sepse xhinnët e kanë atë mundësi që në largësi të madhe të transmetojnë informacione shumë shpejt. Mirëpo xhinni e din vetëm planifikimin e jo ngjarjen e të ardhmes, sepse ngjarjet e të ardhmes ekskluzivisht janë në fuqinë e Allahut, përfshirë këtu gjithçka që ekziston pa bërë përjashtim edhe vetë ekzistencën e xhinnëve, sepse Ai i ka krijuar xhinnët, Ai i ka krijuar njerëzit dhe gjithçka tjetër. Si mund ta kontrollojë xhinni të ardhmen, kur ai nuk e ka në dorën e vet as jetën e vet?! Nëse unë them, se pas një jave do të shkojë në Qabe, dhe kjo ndodhë kështu, nuk do të thotë se unë e di të ardhmen. Absolutisht jo. Por, vetëm planifikimi im ka rastisë të përputhet me atë që është shkruar në caktimin e Allahut për të ndodhur. Prandaj, fallxhorët, nëpërmjet xhinnëve mund t'i dinë, po them kushtimisht, planifikimet për të ardhmen e jo ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen, sepse ato janë e drejtë ekskluzive e caktimit të Allahut.

Nga këtu, kuptojmë se ekzistojnë dy lloj të fshehtash:

1.**E fshehta relative** (ألغيب النسبي), dhe

2.**E fshehta absolute** (ألغيب المطلق)

E fshehtë relative është ajo e fshehtë, të cilën pos Allahut mund ta dinë edhe dikush prej njerëzve, ndërsa e fshehtë absolute është diçka që vetëm Allahu xh.sh. e di, kurse njerëzit nuk mund ta dinë dhe nuk mund të depërtojnë me njohuritë e tyre të kufizuara ta zbulojnë atë fshehtësi.[37] Për këtë arsye dhe është i porositur myslimani që për planifikimet e tij në të ardhmen, të thotë **inshallah** - nëse do Allahu do ta bëj[38], e assesi të mos thotë se 'këtë punë dhe atë punë, do ta bëj'. Ndaj, fallxhorët pandehin apo hamenden dhe nuk mund të ndryshojnë asgjë prej asaj që është vendosur për të ndodhur. Allahu i Madhëruar i drejtohet Muhamedit a.s. që tu thotë të gjithë njerëzve dhe veçantë atyre që i mashtrojnë njerëzit duke i manipuluar me njohjen e të ardhmes:

Emin Behrami, "*Perkthimi dhe komentimi i* domethënies së *El-Istiadhesë, el-besmelesë dhe i suretu'l fatihasë në gjuhën shqipe*", botimi i dytë, Prishtinë 2000, fq.23).

[37] Sabri Bajgora *"Pesë të fshehtat hyjnore"*, në "Takvimi" - 1998, boton: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë, fq. 5

[38] Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: ***"Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: Unë do ta bëj këtë nesër! Vetëm*** *(nëse i shton)****: në dashtë Allahu…"*** *(Kur'ani, El-Kehf:23-24).*

"Thuaj: "Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi as ndonjë dëm, pos çka do Allahu. Sikur ta dija të fshehtën, do t'i shtoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë" *(Kurani, El-A'raf: 188).*

Po ashtu, një ajet tjetër, ku Allahu i Madhëruar tregon rreth vdekjes së Sylejmanit a.s., mohon drejtpërdrejt mundësinë që xhinnët ta njohin të ardhmen. Allahu i kishte nënshtruar xhinnët e Sylejmanit a.s., dhe i kishte detyruar ta dëgjonin atë, duke i kërcënuar me dënim të rëndë. Sulejmani a.s., këtë mundësi e kishte shfrytëzuar për të mirë të njerëzimit dhe i kishte ngarkuar me punë të rënda. Mirëpo, kur vdiq Sulejmani a.s., xhinnët ende vazhdonin në atë trend. Sikur ta dinin të fshehtën ata do të dinin edhe për vdekjen e Sulejmanit a.s. dhe do të braktisnin kryerjen e punëve të rënda. Prandaj Allahu thotë: ***"...Sikur ta dinin të fshehtën, nuk do të vazhdonin të qëndronin nën mundin e rëndë"*** *(Kur'ani, Sebe'e:14).*

Pra, falli dhe pretendimi për njohjen e të ardhmes janë një mashtrim i vërtetë dhe "konsiderohen prej shirkut, sepse janë punë të shejtanit, ndërsa është fare e qartë se xhinnët për t'u vënë në shërbim të magjistarit kërkojnë prej tij kryerjen e gjynaheve të ndryshme, midis të cilave edhe forma të ndryshme shirku."[39]

b) Argumentet nga Hadithi

Me të vërtetë ekzistojnë shumë hadithe që i bëjnë denoncim fallxhorëve dhe besëtytnive në përgjithësi. Ndonëse, hadithet e Pejgamberit a.s. nuk flasin veç e veç për secilën prej besëtytnive që i kemi përmendur dhe për shumë të tjera që ekzistojnë e që nuk i kemi përmendur, pasi që porta e tyre mbetet e hapur, megjithatë, thëniet e Resulullahit s.a.v.s. vendosin kriteret që vlejnë për të gjitha llojet dhe kategoritë pa dallim. Sepse, besëtytnitë, në parim, janë të gjitha njësoj: besim i kotë, ndërsa vetëm manifestimi i tyre ndryshon. Si ai që shkon te fallxhori, e i beson atij që po e thotë, si ai që kërkon bereqe-

[39] Shih: El-Fevzani "*Tevhidi*" op.cit. fq. 50-51

tin prej varrit apo nallçes (patkoi), si ai që u beson idhujve apo idoleve, janë njësoj - besim i kotë. Le të transmetojmë disa prej tyre:

Transmetohet se një delegacion ka shkuar te Pejgamberi a.s. me paragjykimin se ai u takon atyre që e njohin të fshehtën, dhe kështu fshehën diçka në dorë dhe e pyetën për të, e ai u përgjigj me sinqeritet:[40]

إِنِّي لَسْتُ بِكَاهِنٍ وَ إِنَّ الكَاهِنَ وَ الكَهَانَةَ و الكُهَّان فِي النَّارِ

"Unë nuk jam parashikues; parashikuesi, parashikimi dhe fallxhorët do të hyjnë në zjarr!"[41].

Kur njerëzit pranuan Fenë Islame gjatë kohës së Pejgamberit a.s. ata shpesh kanë bartur me vete besimin në nuska të njohura kolektivisht në gjuhën arabe si 'temaim' (lexo: temimeh). Lidhur me këtë ka shumë hadithe të Pejgamberit a.s. me të cilat ai e ka ndaluar rreptësisht atë shprehi të myslimanëve.[42]

Transmeton Imran bin Husajn r.a. se

أَخْبَرَنِي عِمْرَانُ بْنُ حُصَيْنٍ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَبْصَرَ عَلَى عَضُدِ رَجُلٍ حَلْقَةً أُرَاهُ قَالَ مِنْ صُفْرٍ فَقَالَ وَيْحَكَ مَا هَذِهِ قَالَ مِنْ الْوَاهِنَةِ قَالَ أَمَا إِنَّهَا لاَ تَزِيدُكَ إِلاَّ وَهْنًا انْبِذْهَا عَنْكَ فَإِنَّكَ لَوْ مِتَّ وَهِيَ عَلَيْكَ مَا أَفْلَحْتَ أَبَدًا

"Pejgamberi a.s. i kishte parë një byzylyk bakri në llërë të dorës së një njeriu, e i kishte thënë: Mjer ti! ç'është ky? Njeriu (i tha):kjo është që t'më mbrojë nga dobësia! Pejgamberi a.s. i tha: Sa i përket asaj, ajo vetëm ta shton dobësinë, prandaj gjuaje atë, nëse vdes me të në llërë, kurrë nuk do të shpëtosh".[43]

[40] Jusuf Kardavi, *"Hallalli..."*, op.cit. Shkup, 1998. fq. 236.
[41] Cituar sipas: Jusuf Kardavi, *"Hallalli..."*, op.cit. fq. 236.
[42] Philips, *"Bazat e tevhidit …"* op.cit. fq. 75.
[43] Musnedi i Imam Ahmedit, Kitabu: evvelu musnedil basrijjin, Babu:hadithu Imran bin Husajn, hadithi nr. 19149 (citim prej CD-së).

مَنْ عَقَدَ عُقْدَةً ثُمَّ نَفَثَ فِيهَا فَقَدْ سَحَرَ وَمَنْ سَحَرَ فَقَدْ أَشْرَكَ

"Ai që lidh nyja e pastaj fryn në to (nyja), bën magji, e ai që bën maxhi, bën shirk"[44]

مَنْ أَتَى كَاهِنًا أَوْ عَرَّافًا فَصَدَّقَهُ بِمَا يَقُولُ
فَقَدْ كَفَرَ بِمَا أُنْزِلَ عَلَى مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

"Kush shkon te fallxhori ose te paralajmëruesi dhe i beson në atë që e thotë, bën kufër në atë që i është shpallur Muhamedit a.s."[45] .

Pejgamberi a.s. të thotë::

لاَ طِيَرَةَ وَخَيْرُهَا الْفَأْلُ قَالُوا وَمَا الْفَأْلُ قَالَ الْكَلِمَةُ الصَّالِحَةُ يَسْمَعُهَا أَحَدُكُمْ

Nuk ka tijareh - pesimizëm, por më e mira të mirës është el-fe'lu. I është thënë: "O i Dërguari i Allahut, po çka është el-fe'lu? Tha: fjala e mirë (shpresëdhënëse) që mund ta dëgjojë secili nga ju" [46]

Është me rëndësi të theksojmë se, besimi Islam nuk i vë në shënjestër vetëm atë që merret me fall, magji apo parashikim, por edhe atë që shkon tek ai dhe u beson fjalëve të tij. Po edhe nëse nuk i beson, sërish nuk lejohet, sepse ndikon në inkurajimin e tyre. Pejgamberi a.s. thotë:

لَيْسَ مِنَّا مَنْ تَطَيَّرَ أَوْ تُطُيِّرَ لَهُ أَوْ (تَكَهَّنَ أَوْ) تُكُهِّنَ لَهُ أَوْ سَحَرَ أَوْ سُحِرَ لَهُ

"Nuk është prej nesh ai që parandien ose që kërkon t'i parandihet diçka,(ai që qet fall) ose që kërkon t'i qitet fall dhe ai që bën magji ose kërkon t'i bëhet magji!"[47]

[44] Suneni i Nesaiut, kitabu: tahrimud-demi, babu: el-hukmu fis-sihreti, nr.4011 (citim prej CD-së).
[45] Musnedi i Imam Ahmedit, Kitabu:bakije musnedu'l-muketh-thirine, babu:bakijel musnedus-sabik, hadithi nr.9171 (citim prej CD-së).
[46] Sahihul Buhari, Kitabut-tib-bi, Babu:Et-tijeretu, hadithi nr. 5313 (citim prej CD-së). Me fjalën 'shpresëdhënëse', është për qëllim, nëse dikush pyet për një send që i ka humbur, atij duhet thënë do ta gjesh inshallah, apo të sëmurit duhet thënë do të shërohesh inshallah, e kështu me radhë. Pra, përmbajtje pozitive e assesi negative.
[47] Transmetim i Bezzarit me sened të mirë. (cituar sipas: Jusuf Kardavi, *"Hallalli..."*, op.cit. fq. 244)

c) Argumentet racionale

Parimi i parë i besimit Islam ishte që në mendjet e myslimanëve të krijohet bindja se kjo gjithësi e madhe ku jetojnë të gjitha krijesat e Allahut, nuk është kaotike dhe se nuk zhvillohet jashtë ligjeve të caktuar, si dhe asgjë nuk lëvizë sipas dëshirave të krijesave, sepse sikur të ndodhte një gjë e tillë a thua çfarë mund të ndodhte kur shumica e tyre janë kontradiktore[48] (shih:Kurani:El-Mu'minun:71). Kjo gjithësi është me ligje të caktuar, të pandryshueshme e konstante të cilat në asnjë mënyrë nuk ndryshojnë. (shih: Kurani, Fatir: 43).

Më lart, kur kemi folur te nëntitulli "njohje me besëtytninë" thamë se shikuar nga aspekti logjik e filozofik, besëtytnitë janë vendosje e lidhjeve shkakore ndërmjet atyre gjësendeve, dukurive apo njerëzve, të cilat zaten nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ose janë të lidhura në mënyrë të rastësishme.[49]

Racionalisht, manifestimi i besëtytnive është tepër naiv dhe primitiv, sepse ndërlidhet me besueshmëri të paarsyeshme. T'u jepen gjësendeve atribute mbinatyrore dhe se gjoja ato mund të ndikojnë në jetën e njeriut, pa shfaqur ndonjë lidhje shkakore të arsyeshme, kjo nuk ka domethënie tjetër, pos hyjnizim i gjësendeve apo i krijesave, të cilat nuk mund të bëjnë asgjë absolutisht për vetveten e tyre e lëre ma për të tjerët.

Besimi është besim i drejtë dhe nuk është besëtytni, sepse korrespondon plotësisht me shkakun dhe pasojën. Sa i përket shkakut, ai induktohet nga ekzistenca e Krijuesit, ndërsa sa i përket pasojës ajo induktohet nga paaftësia e njeriut si qenie në varshmëri. Si mund ta kuptojmë këtë? Njeriu është qenie e nevojshme në ekzistencë dhe ndien nevojë për ekzistencën e vet në çdo moment. Ai pa ajër nuk mund të jetojë, ndërsa ajri është krijim i Allahut. Pastaj, të gjitha nevojat e tij plotësohen në kuadër të kësaj gjithësie. Prej qiellit, Allahu e lëshon shiun, ndërsa prej tokës na jep frutat. Të gjitha këto të mira i ka krijuar Allahu dhe njeriu nuk e ka asnjë meritë në krijimin e tyre. Nga

[48] Jusuf Kardavi, "*Hallalli...*",op.cit. fq. 235.
[49] Akad. Ekrem Murtezai "*FJALOR*…" op.cit. fq. 68.

këtu, njeriu duke e pa këtë pafuqi të tij, p.sh. vetëm për një moment sikur të mos ekzistojë ajri, ai nuk mund të mbijetojë, ai detyrimisht (kupto: instinktivisht) ndien nevojë për t'iu drejtuar një fuqie mbinatyrore. Kjo mbështetje e tij është besimi që i adresohet Allahut të Madhëruar, Krijuesit të Gjithësisë. Kjo është natyrshmëria e njeriut, ku shkaku është vetë Allahu, ndërsa pasoja është domosdoshmëria e besimit në Të. Ndërsa besëtytnia është marrëzia e njeriut, sepse është ikje nga kjo gjendje natyrore e tij. Për të tillët Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: ***"... se kur do ta shohin dënimin*** *(në botën tjetër),* ***do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm Allahut*** *(e jo idhujve)* ***dhe se Allahu është ndëshkues i rreptë".*** *(Kur'ani, El-Bekare:165.*

2.3. Domethënia akaidologjike e çështjes

Pasi u qartësua, tevhidi dhe llojet e tij, pastaj edhe argumentet që ndalojnë besëtytninë, na mbetet ta tërheqim paralelen akaidologjike, e cila vërteton se besëtytnia është akt i frikshëm, ngase e kërcënon në mënyrë serioze ekzistencën e tevhidit. Kur i kuptojmë mirë kornizat e tevhidit në të gjitha llojet e tij, e kemi shumë lehtë ta kuptojmë se përse besëtytnia është kontradiktë e besimit islam. Nëse besojmë në 'tevhidin rububijjeh', kuptojmë se askush nuk mund të bëjë asgjë përpos Allahut. Nëse besojmë në 'tevhidin uluhijjeh', kuptojmë se askujt nuk duhet drejtuar për çdo nevojë dhe për adhurim përpos Allahut. Nëse besojmë në 'tevhidul esmai ves-sifati', kuptojmë se askush nuk është i përsosur dhe nuk ka kapacitete për t'i përgjigjur nevojave tona përpos Allahut.

Nisur nga këtu, gjithçka që i atribuojmë prej vetive të këtilla dikujt tjetër, pra veti hyjnore, kemi rënë në kontradiktë me besimin islam. Ndërsa është fare e qartë se besëtytnia është atribuim vetive hyjnore krijesave dhe kështu është adhurim ndaj tyre.

Njeriu në historinë e vet, parimisht mund të themi se nuk ka çaluar shumë nga 'mosbesimi' si një akt i mohimit kategorik të ekzistencës së Allahut, sepse në përgjithësi e ka besuar ekzistencën e Tij (shih: Kur'ani, Ez-Zuhruf:87; Junus:31). Por, ai është përshkuar më së shu-

mti nga ndjenja e (mos)veçimit të Allahut për zot të Vetëm në adhurim, me bindjen se vetëm Atij duhet t'i takojë çdo formë e adhurimit. Kjo e fundit, ka qenë kërkesë e secilit pejgamberë për çdo shoqëri njerëzore: ***"... Të gjithë ata thoshin:Adhuroni vetëm Allahun, e shmanguni idhujve"*** *(Kur'ani, En-Nahl:36).*

Në këtë konstelacion, themi se besëtytnia, parimisht nuk është diçka që e mohon drejtpërdrejt Allahun (kufër), por themi se besëtytnia është ajo që besimtarin besëtyt e shpie në një dukuri tjetër tepër të rrezikshme, e që është **'politeizmi - idhujtaria'** apo siç njihet në terminologjinë fetare **'shirku'** - të adhuruarit dikë tjetër krahas Allahut.

Ndonëse, 'besimtari' besëtyt, e beson Allahun e që kushtimisht mund të llogarisim për një fije shprese në çështjen e tij, në anën tjetër është fatale vendimi se, megjithëkëtë, Allahu i Madhëruar nuk i ka llogaritur për besimtarë ata që e kanë besuar Allahun për Krijues, por që krahas adhurimit ndaj Tij, kanë adhuruar edhe idhuj (idole) të tjerë, apo që adhurimin ndaj tij e kanë përzier me besëtytni dhe mitologji. Në Kur'an, lexojmë se sikur idhujtarët të pyeteshin se kush i krijoi qiejt dhe tokën ata gjithsesi do të thoshin "Allahu" (shih:Kur'ani; Ez-Zuhruf:87); pastaj sikur të pyeteshin se kush i furnizon me begati, gjithsesi do të thoshin "Allahu" (shih:Kur'ani, Junus:31). Domethënë, ata kanë pasur 'besim' në Allahun. Mirëpo, krahas Tij kanë adhuruar edhe 'fuqi mbinatyrore' të tjera, përfshirë nga llojet e gjësendeve që vetë i kanë gdhendur apo kultet e personaliteteve të vdekura, të cilët i kanë konsideruar për ndërmjetësues te Zoti i Vërtetë. (shih: Kur'ani, Ez-Zumer:3; Junus:18). Këtë besueshmëri të tyre Allahu i Madhëruar e ka quajtur **shirk** - politeizëm.

Po ashtu, Allahu ka dëshmuar se janë ateistë (jobesimtar), ata të cilët e morën për zot, Isain (Mesihin) birin e Merjemes (shih:Kur'ani, El-Maide:72). Po kështu ka dëshmuar edhe për ata që thanë se ***"Allahu është i treti i treve"*** (shih:Kur'ani, El-Maide:73).

Prandaj nëse e shikojmë me kujdes përmbajtjen e besëtytnisë dhe manifestimin e saj, padyshim do të vërtetojmë se ajo inkorporon drejtpërdrejt elemente të shirkut - politeizmit, në të tri kategoritë e tevhidit.

a) Shirku në 'rububijjeh'. Shirku në këtë kategori shfaqet në forma të ndryshme. Në mesin e ca njerëzve myslimanë, shirku i rububijjes është i manifestuar në besimin e tyre se shpirtrat e të shenjtëve dhe njerëzit e tjerë të drejtë mund të ndikojnë në çështjet e kësaj bote, madje edhe pas vdekjes së tyre. Shpirtrat e tyre, besohet se mund t'i plotësojnë nevojat e ndonjërit, t'i largojnë fatkeqësitë dhe t'i ndihmojnë çdonjërit që iu lutet atyre. Andaj, adhuruesit e varreve ia atribuojnë shpirtrave njerëzor aftësinë hyjnore, me të cilën shkaktohen ngjarjet në këtë botë, të cilat në të vërtetë vetëm Allahu mund ti shkaktojë.[50] Besëtyti, në rastin konkret, duke përvetësuar këtë formë të besueshmërisë, i bën injorim të drejtpërdrejtë Allahut të Madhëruar duke ia atribuuar edhe dikujt tjetër krahas Allahut, sovranitetin e Krijuesit, Sunduesit, Furnizuesit, Ndihmuesit, etj.

b) Shirku në 'uluhijjeh'. Në këtë kategori të 'shirkut' bëjnë pjesë të gjitha veprimet me karakter të besueshmërisë dhe adhurimit, të cilat i drejtohen dikujt tjetër, e jo Zotit, apo në të njëjtën kohë i drejtohen edhe Zotit të Madhëruar, po edhe dikujt tjetër në cilësi të ndërmjetësuesit. Besimi në besëtytni, përgjithësisht e ka këtë manifestim, ku lutjet i adresohen 'ndërmjetësuesve' (përfshirë subjektet, shenjat, vendet e shenjta, etj.) kështu duke i dhënë atribute hyjnore. Lidhja e besimit në besëtytni, do të thotë që të shprehet përulja (nënshtrimi) ndaj atij të cilit i drejtohet. Ndërsa shprehja e përuljes në konceptin e adhurimit dikujt tjetër përpos Allahut, është shirk ndaj Allahut, i Cili është i Vetëm që meriton t'i nënshtrohemi e askujt tjetër. Allahu në Kur'an thotë:

وَلاَ تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لاَ يَنْفَعُكَ وَلاَ يَضُرُّكَ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذًا مِنَ الظَّالِمِينَ

"Dhe mos lut tjetër kë pos Allahut, ndonjë *(idhull)* ***që nuk të sjell as dobi as dëm, e nëse bën atë, dije se i ke bërë padrejtë vetvetes"*** *(Kur'ani, Junus:106).* Po ashtu thotë:

[50] Philips, "*Bazat e tevhidit …*" op.cit. fq. 43-44.

***"E nga njerëzit ka asi që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan** (i madhërojnë) **ata, sikur** (që besimtarët e vërtetë e duan) **Allahun, …"** (Kur'ani, El-Bekare:165).*

Prandaj, rëndësia e veçimit të Allahut në të gjitha lutjet dhe adhurimet, ka qenë motoja e të gjithë pejgamberëve. Këtij parimi, në Kur'an dhe në Hadithe të Pejgamberit a.s. i është kushtuar kujdes i veçantë, ndoshta pse shumica e shoqërive kanë qenë të përfshira në këtë kategori të shirkut.

c) Shirku në 'el-esmau ve's-sifat'. Shirku në këtë kategori, përfshinë bindjet besëtyte, duke i dhënë krijesave atributet e Krijuesit, dhe e kundërta, duke i dhënë Krijuesit atributet e krijesave. Besimi në besëtytni, nuk do mend se është një manifestim ideal dhe real i atribuimit të cilësive të Allahut, krijesave. P. Sh. Thënia e njerëzve se 'natyra krijon' apo se 'natyra e ka krijuar njeriun dhe çdo gjë tjetër' është diçka e këtillë, sepse natyra është vetë krijesë dhe nuk mund të krijojë asgjë. Por, Allahu është Krijues. Pastaj, sikurse janë thëniet se 'materia' është e pa fillim dhe e pafund. Po ashtu lutja ndaj të vdekurve, apo të gjallëve në kuptim të përulësisë, është e këtillë. Më tej, shkuarja te fallxhiu dhe besimi në fjalët e tij mbi fshehtësitë e ndodhive të së ardhmes, është shirk, sepse njohës i të ardhmes është vetëm Allahu Fuqiplotë.

2.4. Dispozita ndaj besimtarit besëtyt

Besimtari i cili manifeston besueshmëri në besëtytni, çështja e tij i nënshtrohet dy dispozitave:

- Dispozita e kësaj bote (دنيوي), e cila nënkupton procedurën ku besëtyti duhet të përballet për besëtytninë të cilën e aplikon dhe duhet t'i tërhiqet vërejtja se ajo konsiderohet devijim nga rruga e vërtetë. Nëse ai nuk heq dorë nga ajo formë e besueshmërisë, atëherë pason qëndrimi në varësi me intensitetin e kotësisë apo rrezikut të besëtytnisë. Sepse, dihet se disa prej besëtytnive janë **shirk i pastër** (politeizëm), sikurse është *lutja ndaj të vdekurve dhe sjellja rreth 'tyrbeve'*, qoftë duke iu drejtuar atyre si ndërmjetësues, në atë mënyrë siç veprojnë katolikët, të cilët u rrëfehen priftërinjve për mëkatet e bëra..., ku priftërinjtë veprojnë si ndërmjetësues mes njerëzve dhe Zotit, qoftë duke iu lutur atyre drejtpërsëdrejti për falje të mëkateve[51], e disa të tjera janë në intensitet më të zbehtë, sikurse është bartja e një rruaze të kaltër në byzylyk apo rreth qafe për ta larguar 'mësyshin', duke mos i besuar për fuqi mbinatyrore, por vetëm për ta devijuar shikimin dashakeqë të njerëzve.[52]

  Nëse nuk hiqet dorë nga ato që janë besëtytni të kategorisë së rëndë (shirk), atëherë vjen në shprehje akuza për devijim nga rruga e drejtë, përkatësisht për apostazi - dalje nga Feja Islame (مرتد). E kjo domethënë se ai privohet nga të drejtat islame, pasi paraprakisht të plotësohen kushtet sheriatike për këtë dhe të evitohen pengesat, sikurse është ofrimi i mundësisë që ai të kthehet sërish në Fenë Islame (duke përfshirë procedurat adekuate për këtë), pastaj sqarimi i atyre çështjeve (bazore) me argumente në të cilat ka rënë në apostazi si shkak i besëtytnisë…etj. Nëse pendohet nga qëndrimet e tij, kthehet në shoqërinë islame me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Në të kundërtën ekzekutohet[53]. E nëse kjo nuk mund të realizohet (zakonisht në vende ku sheriati nuk ka aplikim), atëherë atij as nuk i jepet selam e as nuk i kthehet; nuk ka mbrojtje për jetën e tij dhe pasurinë e tij; nuk mund të martohet me grua myslimane; apo nëse është i martuar shkurorëzohet; nëse vdes në këtë gjendje nuk i lahet xhenazja; nuk i falet namazi i xhenazes; nuk varroset në varrezat e myslimanëve; nuk zbatohen parimet e trash-

[51] Interpretim nga: Philips, "*Bazat e tevhidit …"* op.cit. fq. 219-220.

[52] Transmetohet se halifi i tretë pas Pejgamberit a.s., Osmani r.a. kur shihte ndonjë fëmijë të bukur thonte:"*Nxijani vrimën e mjekrës së tij, që mos ta godet mësyshi*" (Ahmed Ez-Zehrani, Abdul Mexhid Ez-Zahim, "*Shërimi i të sëmurëve me Kur'an dhe Sunnet*" pa vend dhe vit botimi, fq.48).

[53] Pejgamberi a.s. ka thënë: مَنْ بَدَّلَ دِينَهُ فَاقْتُلُوه "*Kush dezerton nga Feja Islame, mbyteni*" Ahmed bin Alij bin Haxher El-Askalanij, "*Fet'hu'l bari sherhu Sahihi'l Buhari*" Mektebetu'd-dari's-selam, botimi i parë 1421 h/2000 m, Rijad, '*Kitabu istitabetil murted-dine vel muanidine'*, kapitulli 2, hadithi nr.6922.

ëgimisë ndërmjet tij dhe të afërmeve dhe dispozita të tjera[54]. E sa i përket besëtytnive të kategorisë më të lehtë, më së paku që mund të thuhet është se ato konsiderohen prej mëkateve që meritojnë ndëshkimin e Allahut të Madhëruar.

- Dispozita e botës tjetër (أخروي), e cila është varësi e qëndrimit të besimtarit në këtë botë. Allahu ka dëshmuar se **politeistët** (ku potencialisht mund të bëjnë pjesë edhe besëtytët hijerëndë) dhe **mosbesimtarët** do të jenë përgjithmonë në xhehennem (shih: Kur'ani, El-Maide:72-73), ndërsa mëkatarët nga besimtarët janë në dëshirën e Allahut, nëse do i falë dhe i shpie në xhennet me mëshirën e Tij, e nëse do i dënon me drejtësinë e Tij aq sa është pesha e mëkatit të tyre në këtë botë. Çështja e tyre është në mëshirën e Allahut të Madhëruar. (shih:Kur'ani: El-Bekare:284).

Përfundim

Nga sa u tha më lart, besëtytnia është dukuri shumë e rrezikshme në kontekst të devijimit, ndërsa shumë e frikshme në kontekst të pasojave. Tashmë e kuptuam se, manifestimi i besëtytnisë, parimisht ka elemente të politeizmit apo idhujtarisë.

Fatkeqësisht, edhe në hapësirat tona mbarëkombëtare, pra, në mesin e myslimanëve, ka besëtytni të natyrave dhe llojeve të ndryshme. Shumica e tyre me bazë të krishterë e një pjesë tjetër me bazë pagane. Është imperativ besimor - imanor, që në mënyrë të prerë të distancohet çdo mysliman nga të gjitha format e besëtytnive dhe shfaqjet irracionale të besueshmërisë. E kemi besimin Islam, i vetmi i drejtë, i cili na përmbush çdo nevojë tonën në të gjitha rrafshet dhe nuk lë asnjë hapësirë. Nuk kemi nevojë të marrim 'ndërmjetësues' për te Allahu, e as të shpresojmë diç të mirë te ato gjësende apo çfarëdo qoftë tjetër, që nuk mund të bëjnë asgjë (as të mirë e as të keqe) për veten e tyre. Për gjithçka që ndiejmë nevojë në jetën tonë, duhet t'i drejtohemi Allahut

[54] Alaud-din Ebi Bekr bin Mes'ud El-Kasanij El-Hanefij "*Bedaiu's-sanai'i*", darul fikri, botimi i parë, 1996/1417, Bejrut-Liban, vëll. IV, fq. 198-206.

Allahu i Madhëruar, i drejtohet Pejgamberit a.s. duke i thënë:

"E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua." *(Kur'ani, El-Bekare:186).* Në këtë ajet, duket mjaft qartë se, Allahu e ka kushtëzuar udhëzimin e drejt, me lutjen drejtpërdrejt Atij dhe me të besuarit në Të. Po ashtu, në kaptinën 'El-Fatiha', të cilën e këndojmë në çdo rekatë të secilit namaz i drejtohemi Allahut: ***"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë"*** *(Kur'ani, El-Fatiha:4).*

Le ta përfundojmë këtë diskutim me një thënie të Pejgamberit a.s., kur me një rast iu pati drejtuar Abdullah Ibni Abbasit r.a., duke i thënë:

يَا غُلاَمُ إِنِّي أُعَلِّمُكَ كَلِمَاتٍ احْفَظْ اللَّهَ يَحْفَظْكَ احْفَظْ اللَّهَ تَجِدْهُ تُجَاهَكَ إِذَا سَأَلْتَ فَاسْأَلْ اللَّهَ وَإِذَا اسْتَعَنْتَ فَاسْتَعِنْ بِاللَّهِ وَاعْلَمْ أَنَّ الأُمَّةَ لَوْ اجْتَمَعَتْ عَلَى أَنْ يَنْفَعُوكَ بِشَيْءٍ لَمْ يَنْفَعُوكَ إِلاَّ بِشَيْءٍ قَدْ كَتَبَهُ اللَّهُ لَكَ وَلَوْ اجْتَمَعُوا عَلَى أَنْ يَضُرُّوكَ بِشَيْءٍ لَمْ يَضُرُّوكَ إِلاَّ بِشَيْءٍ قَدْ كَتَبَهُ اللَّهُ عَلَيْكَ رُفِعَتْ الأَقْلاَمُ وَجَفَّتْ الصُّحُفُ

"O djalosh, ja do t'i mësoj disa fjalë: Ruaju (mëkateve të) Allahut, Ai të ruan ty. Ruaju Allahut, Atë do ta gjesh në anën tënde. Kur kërkon diçka, kërko vetëm prej Allahut. Kur kërkon ndihmë, kërko vetëm prej Tij. Dije se sikur i gjithë populli të bashkohej për të të bërë ndonjë të mirë (dobi), nuk do të mund të bënte asgjë, përveç se një gjë që ta ka shkruar (caktuar) Allahu. Dhe sikur të bashkohej i gjithë populli për të të bërë ndonjë të keqe, nuk do të mund të bënin asgjë veç asaj që ta ka shkruar (caktuar) Allahu. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletushkat"[55]

[55] Transmeton Termidhiu i cili ka thënë se hadithti është "hasenun sahihun", "*Sunenu't-Termidhij*", Kitabus-sifetil Kijameti, Babu: minhu, nr. 2440 (prej CD-së)

Orhan Bislimaj

SUPERSTITION AND ITS THREAT TO ISLAM

(Summary)

The fact that the dimensions of Islam have been outlined to Muslims in the Qur'an denies them the possibility to adopt any other form of belief, which does not refer to the foundations of religion. The platform of Islam gained its distinct form upon the revelation of the Qur'an. Nothing can be added to it. This platform must be taught to all the believers, in order to prevent them from straying. With respect to this, there is no doubt that one of the most dangerous phenomena is that of superstition. In order to analyze this phenomenon we have divided this paper in two:

In the first part we will discuss the meaning of the word superstition, the kinds of superstition and the reasons that lead to it.

In the second part we will discuss the dangers this phenomenon poses to believers.

أرحان بسليماى

الخرافة و خطرها على الاسلام

(خلاصة البحث)

مدخل:

بما أن المسلم لديه خطوط و اضحة عن اطار العقيدة الاسلامية موضحة في القرآن الكريم و الحديث فانه لا يسمح له الاعتماد على اية عقيدة ليست لها مرجعيةعلى أساس الدين الاسلامى. العقيدة الاسلامية اتخذت اطارها الصحيح و الواضع مع انتهاء نزول القرآن الكريم و بناء عليه فانها لا تقبل اية زيادة أو نقصان أو تطوير أو انحراف عن مسارها الصحيح. هذا الاطار العقائدى و الذي يحتوى على جوهر العقيدة و التي يجب أن بعرفها كل مسلم و ذلك حتى يتم حفاظ الايمان عن كل انحراف و الذي يهدد وجود الايمان. و في هذا الاطار من الظواهر الخطيرة هي الخرافة و التي تعتبر اضدادا للايمان و حتى نفهم بصورة أكثر خطورة الخرافة قمنا بتقسيم هذه الدراسة إلى قسمين.

STUDIME

Prim. Dr. Ali Iljazi

KUR'ANI FAMËMADH DHE "ATEIZMI SHKENCOR"

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik urdhëron e thotë:

"Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton askush".[1]

Pra, dituria është burimi i urtësisë.

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin famëmadh na thërret në meditim, na nxit në hulumtime shkencore në mënyrë që nëpërmjet shkencës të arrijmë deri te njohja e ekzistencës së Zotit, dhe ajo që ndodh përreth nesh është rezultat i urtësisë dhe dëshirës së Tij.

Ai është Zoti absolut i fuqisë së pafund. Të shërbyerit e njeriut me shkencë nuk është çrregullim i rendit Hyjnor. Pasuria dhe fuqia e njeriut të sotëm rrjedhin nga dituria të cilën ia jep shkenca. Sipas mësimit islam shkenca është imperativ për besimtarin dhe begati e vërtetë e Zotit. Fjalët e para të drejtuara Muhammedit a.s. nëpërmes Shpalljes kanë qenë:

***"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi** (çdo gjë).*
***Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur** (në mitrën e nënës).*
Lexo! Se Zoti yt është më bujari!

[1] El Bekare, 269.

Ai që e mësoi** (njeriun) **të shkruajë me pendë.
Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte".[2]

Çdo send që posedon gjallëri (këtu bën pjesë edhe njeriu), me jetën e tij dhe punën e tij shkakton ndryshime, e këto ndodhin siç na mëson islami sipas përcaktimit të Zotit. Këtu është në pyetje diç tjetër: forma morale e qëndrimit tonë.

Feja na mëson dhe tërheq vërejtjen që shkencën ta shfrytëzojmë në të mirë, e jo në të keqe, duke kërkuar nga ne që të jemi falënderues ndaj Zotit. Islami kërkon nga ne që çdo mirësi që posedojmë të jetë në shërbim të njerëzve dhe kjo të jetë nga dashuria ndaj Zotit, pa asnjë llogari njerëzore, por duke pritur vetëm shpërblimin nga Ai.

Edhe diç tjetër: islami tërheq vërejtjen që të mos bëhemi kryelartë. Kur'ani kërcënon kryelartët:

"Nuk ka dyshim se ata që përgënjeshtruan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet derisa të përbirojë deveja nëpër vrimën e gjilpërës. Ja, kështu i shpërblejmë kriminelët".[3]

"Çdo gënjeshtar e shumë mëkatar është i shkatërruar.

Që i dëgjon ajetet e All-llahut, të cilat lexohen, e pastaj vazhdon prapë si mendjemadh, sikur nuk i ka dëgjuar ato. Atë lajmëroje për një vuajtje të dhembshme".[4]

***"Këtë** (dënim) **e keni për shkak se gëzoheshit pa të drejtë në Dunja** (duke bërë mëkate etj.) **dhe për shkak se** krenoheshi (me mendjemadhësi)".*[5]

"Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, e ti i përgënjeshtrove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besuan.

E ata që bënë gënjeshtër ndaj All-llahut, do t'i shohësh në ditën e kijametit, fytyrat e tyre të nxira. A nuk është në xhehennem vendi i arrogantëve?"[6]

[2] El Alak, 1-5.
[3] El A'rafë, 40.
[4] El Xhathije, 7-8.
[5] Gafir, 75.

Por, mu njeriu bashkëkohor u bë kryelartë. Kjo nuk është shkas i asaj që e mëson shkenca, por ajo që i ofron shkenca. Ai krenohet: "Këtë e kam arritur me diturinë time. E gjeta rrugën dhe mënyrën që të arrij te kjo".

Këtë na përkujton Kur'ani fisnik në rastin e Karunit:

"Ai** (Karuni) **tha: "Më është dhënë vetëm në saje të dijes sime...!"[7]

Njeriu shpjegon, që ka filluar nga asgjëja si prodhim i natyrës, por që evolucioni ia mundësoi që gjithnjë e më shumë të lirohet nga kontrolli i saj.

Shpallja e përmirëson, e këshillon që Zoti është Ai, i Cili e ngriti njeriun, por njeriu për këtë nuk qan kokën fare, ai është i liruar nga modestia dhe falënderimi religjioz. Dhe kështu i trimëruar me sukseset e tanishme në shkencë dhe teknikë, mahnitet me mundësitë e mëdha të cilat në shikim të parë ia ofron e nesërmja. Ai nuk druan të thotë që kur t'i njohë edhe fshehtësitë e panjohura të jetës, më në fund do të bëhet "zot i vetes" dhe zot i vetë natyrës, e jo rob i saj.

Perspektiva është impresive.

Do të humbasë uria dhe sëmundjet në Tokë. Organet e dëmtuara do të zëvendësohen me ndërmarrje kirurgjike me organe të shëndosha apo plastike.

Jeta e njeriut do të zgjatet. Është e njohur që zhvillimin e njeriut e rregullojnë disa gjëndra me tajim të brendshëm. Njohja e fshehtësisë së funksionimit të tyre dhe të kodit gjenetik, gjegjësisht njohuria çfarë ndikon në funksionimin e tyre të rregullt ose të parregullt, do të thotë mundësia e njeriut dhe në këtë ai shpreson që sipas dëshirës së tij të krijoi gjeni ose idiot në sferën intelektuale, ndërsa xhuxhë ose div në imazhin fizik. Njohuria e thellë mbi gjenet dhe terapia rekombinante e ADN-së do të ndikojë në karakteristikat trashëguese. Në epruvetë do të kultivohen embrionet njerëzore me cilësi të përcaktuara më parë, psikike, fizike dhe intelektuale, e që krijon vizionin e revolucionit biologjik të tërësishëm të llojit njerëzor.

[6] Ez Zumer, 59-60.
[7] El Kasas, 78.

Hulumtimet më të reja lidhur me të menduarit dhe transmetimin e përvojës në pasardhës si karakteristika trashëguese (e që deri më tani kanë qenë të njohur si instikt) ka sjellë deri te kuptimi se deponimi i diturisë është e përmbledhur në një formë në strukturën kimike të molekulave të quajtura ARN dhe ADN. Kjo hap hipotezën teorike në mundësinë e injektimit të diturisë artificiale, thënë në mënyrë abetareske, me injeksione e jo me shkollim të mundimshëm shumëvjeçar.

Njeriu pranon se tani sapo ka hapur derën e botës së re fantastike të mundësive njerëzore.

Por, sa i përket teknikës, këtu njeriu është në hov të plotë. Në prag është e ashtuquajtur epoka post-industriale e begative materiale kur puna e lodhshme njerëzore do të zëvendësohet me punën e makinave automatike të udhëhequra me trurët elektronikë. Pastaj mundësitë e paparapara të komunikimeve. Zbuloi energjinë atomike dhe shërbehet me të, në prag janë njohuritë e reja për proceset e reja subatomike, mbi antithërrmijat, mbi antimaterien, të cilat ia hapin burimet e mëdha energjisë, në të ashtuquajturën anihilim të materies, që do t'ia lehtësojë rrugën deri te planetët tjerë, duke i mundësuar mbijetesën në ato, si dhe rrugën kah yjet tjera dhe kozmosi.

Duke gjykuar sipas sukseseve të deritanishme e gjithë kjo nuk është fantazi por mundësi reale.

Mirëpo, kur, çfarë dhe sa do të realizojë nga dëshirat dhe ambiciet e tij, varet nga dëshira e Zotit. Të gjitha sukseset dhe mossukseset janë sipas përcaktimit të Zotit. Këtë mesazh ia përcjell Shpallja.

Feja na mëson në modesti. Modestia nuk është mungesë e dëshirave, ambicieve dhe punës, falënderim, falënderim i dërguar në vend të vërtetë, falënderim ndaj Zotit në rezultatet e arritura. Feja i tërheq vërejtjen njeriut që dëshirat të mos humbasin në lakmi, zili, padrejtësi dhe tirani.

Edhe shkenca e mëson në modesti. Në çdo hap ajo tregon në kufizimin e diturisë dhe fuqisë sonë dhe në varshmërinë tonë në fuqinë jashtë perceptimeve tona. Çdo ditë na zbulon se vlera jonë është gjithnjë më e vogël sesa kemi menduar.

Përderisa qielli deri dje ka qenë menjëherë mbi kokën tonë, tani na zbulohet se është i gjerë me miliarda vjet drite. Sa më tepër e njohim atomin ose qelizën kuptojmë se janë shumë më të komplikuar sesa kemi menduar.

Makrokozmosi dhe mikrokozmosi na zbulohen me ligjet e tyre të çuditshme dhe zhvillime të cilat impresionojnë intelektin njerëzor.

Edhe pse dituria njerëzore, fuqia dhe pasuria rriten vazhdimisht, kjo ka vetëm vlerë relative.

Për këtë nuk duhet kuptuar fjalë për fjalë, fjalët që dëgjohen që për njeriun paraqitet ardhmëri e mundësive të pakufizuara. Sa do që të jenë të mëdha, prapëseprapë janë të kufizuara dhe si të tilla do të mbesin.

Kur dëgjohet për të gjitha shfaqjet fantastike të ardhmërisë njerëzore, habit që ende nuk dëgjohet edhe mendimi që njeriu do të ngadhënjejë pleqërinë dhe vdekjen. Ende nuk është e qartë për të çfarë do të thotë vdekja, apo si shkaktohet pleqëria.

Mirëpo, edhe fenomeni i fitores ndaj sëmundjeve ka vetëm vlerë statistikore. Sëmundja nuk është e lidhur vetëm me fenomenin e varfërisë dhe skamjes. Edhe standardi i lartë njerëzor i ka sëmundjet e tij. Siç e dimë nga përvoja, disa sëmundje zhduken, të tjerat paraqiten në mënyrë të pashpjeguar, prandaj njeriu pyet a është reale të pritet kohë pa këto fatkeqësi.

Thjesht na vihet konkludimi filozofik nga ky fakt që secila kohë i ka problemet e veta, peripecitë, vuajtjet dhe shkaktarët e vdekjes, e kështu do të jetë edhe më tutje si antitezë e sukseseve dhe dëshirave njerëzore. Është e çuditshme që njeriu faktin e ndryshimeve dhe shkatërrimit permanent të asaj që është nuk e ka shpallë princip në natyrë. Por, për besimtarin është i mjaftueshëm shpjegimi kuranor që çdo gjë është e ekspozuar ndryshimeve dhe shkatërrimit, përveç Qenies Hyjnore, e cila është e përhershme:

"Çdo gjë që është në të *(në tokë)* ***është zhdukur.***

E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i madhëruar e i nderuar!"[8]

[8] Er Rahman, 26-27.

Të kultivosh embrionin në epruvetë nuk është njësoj si të krijosh embrionin. Të mbledhësh elemente të caktuara në proporcion të caktuar nuk është vështirë, por si nga kjo të krijohet jetë, qelizën e cila rritet dhe shumohet?

Shkencëtarët të vetëdijshëm për arritjet e diturisë dhe mundësive të tyre, janë shumë më modest sesa janë mendimet laike.

Por zhvillimi tekniko – teknologjik sikur nuk njeh kufizime. P.sh., robotët që përgjigjen në pyetje – veprimet e tyre janë të bazuar në imitimin e sistemit nervor të njeriut. Nuk ka pengesë teorike që të konstruktohen robotët që do të tregojnë emocionet, që të "gëzohen" ose "të hidhërohen" – e që do të jetë imitim i pastër dhe programim nga ana e njeriut.

E tërë kjo lë përshtypje të thellë, ndërsa ne, jemi tek në fillim të epokës elektronike! Por, çfarë do të ndodhë nesër? Përparimi i tanishëm teknik ka kaluar fantazinë njerëzore. Kanë filluar të qarkullojnë mendime; mos ndoshta robotët e së nesërmes, të cilët do të sjellin konkludime logjike, do të kundërvihen pushtetit dhe eksploatimit njerëzor?

Mirëpo, ekziston një përgjigje e thjeshtë dhe bindëse: robotët, sado që të jenë të përsosur, asnjëherë nuk do t'i arrijnë njerëzit, dhe nuk mund të bëjnë atë që e bëjnë njerëzit, ngase nuk kanë vetëdije dhe dëshirë. Literatura fantastike u jep robotëve të tyre vetëdije, por të gjithëve na është e qartë se vetëdijen ata nuk do ta kenë kurrë. Ndoshta do të ishte e tepërt të përmendim papërgjegjësinë morale të këtyre makinave sikur mos të duhej të theksonim që njeriu gjithmonë do të jetë moralisht përgjegjës për pasojat e veprimeve të tija.

Intelekti njerëzor, vazhdimisht mundohet me çështjet e arsyeshmërisë të ekzistencës njerëzore. Nëse vdekja është fjala e fundit e natyrës, ligjeve dhe fuqive të saj, atëherë jeta për vetë njeriun është e pakuptimtë. Jeta për vetë jetesën është mashtrim i rëndomtë.

Në jetën e përditshme hasim fjalët vulgare: "Lejo të jetosh këtu", njeriu mundohet të jetë i ndershëm ndaj vetes, dëshiron të arsyetojë ekzistencën e tij personale. Mendimi ateist pohon atë që është, gje-

ndjet dhe proceset, shkaqet e tyre prekëse dhe pasojat e dukshme, dhe këto i ofron si shpjegime, dhe këtë e shpjegon si arsyetim.

Mu në këtë është gabimi i mendimit ateist, që duke u munduar të shpjegojë njeriun, karakterin dhe zhvillimet e tij në natyrë kërkon edhe arsyetimin e ekzistimit të tij. Faktin e ekzistimit të tendencave biologjike, epsheve dhe dëshirave mundohet t'i kuptojë si një gjë që në vete është e mjaftueshme. Për këtë mund të ndodhë që mendjes njerëzore ateiste t'i duket se është e vetëkuptuar që llojet më në fund shkatërrohen dhe definitivisht zhduken, ndërsa lloji i tyre "homo sapiens", shkon gjithnjë përpara si një rrjedhë e pa kthyeshme.

Por, feja mëson që edhe për popuj ekziston vdekja. Ne e dimë nga historia që shumë popuj kanë qenë dhe kanë ekzistuar. Ne nga retrospektiva vendosim kushtet si kanë mundur të shpëtojnë nga shkatërrimi, por Kur'ani na përmirëson:

"Çdo popull** (që përgënjeshtroi pejgamberët) **ka afatin e vet, e kur t'u vijë afati tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë".[9]

Kur'ani vendos kushtet e tij dhe ato janë të natyrës morale. Në tregimin e Jonusit thotë:

"Përse nuk pati vendbanim që të ketë besuar e besimi i tij të ketë ndihmuar** (në shpëtim), **pos popullit të Junusit, që pasi që besoi, Ne larguam prej tyre dënimin shëmtues në jetën e kësaj bote dhe i lejuam të jetojnë deri në një afat të caktuar".[10]

Rruga deri te zotërimi mund të tregohet edhe si rrugë deri te shkatërrimi. Shkenca e njeh këtë dhe e quan si "çrregullim i baraspeshës biologjike në natyrë". Me zhdukjen e luanëve në disa savane të Afrikës, shumë shpejt ato rajone u kthyen në shkretëtirë. Bimëngrënësit aq shumë u shumuan sa shkatërruan tërë vegjetacionin.

Përvojat e këqija në Australi me një lloj kaktusi, i cili në mënyrë krejt naive ishte mbjellë në një oborr si bimë zbukuruese, duke u përvjedhur mbuloi një të tretën e kullosave të këtij kontinenti duke u bërë

[9] El A'rafë, 34.
[10] Junus, 98.

problem nacional, e shtynë njeriun të ketë kujdes për pasojat negative të veprimit të tij. Kështu në të gjitha anët që tani ngrihet alarmi për shkak të ndotjes së ujit dhe ajrit, nxehjes globale, mënyrës joracionale të eksploatimit të xeheroreve, për shkak të shumimit tej mase të llojit njerëzor, me ç'rast njeriu kërcënon vetveten, për shkak të zbulimit të helmeve në organizmin e njeriut, nga pesticidet.

Fuqia e njeriut shpesh po tregohet si shpatë me dy tehe.

Feja mëson që tërë kjo botë materiale, kështu si është, do të përjetojë ndryshim të papritur, katastrofa me përmasa kozmike. Kjo do të thotë edhe fundin e kësaj bote:

"Erdhi** (është afruar) **caktimi i All-llahut** (kijameti), **pra mos kërkoni ngutjen** (ardhjen para kohës) **e tij!...."[11]

Në tërë Kur'anin thuhet për këtë si moment i cili veç është i përcaktuar e për të cilin di vetëm Zoti.

Ateisti nuk mendon për këtë, ai në ardhmëri shikon sikur zhvillimi i tanishëm në kozmos do të shkojë nesër pa pengesa me temp të njëjtë. Por, shkenca nuk e trimëron këtë mendim ateist. Ajo tregon në shumë procese të mundshme të cilat paraqesin shkatërrim për llojin njerëzor. Përmbytjet, thatësinë, goditjet termike dhe acari i madh, çrregullimet tektonike, epidemitë, sarsi, aidsi, virusi i shpezëve dhe katastrofat e ngjashme që sulmojnë njeriun, e gjithë kjo për besimtarin ka formën e saj morale, andaj nga këto nxjerr përfundim moral.

Një ateisti kjo nuk i shkon fare ndërmend. Zbulimet e fundit na kanë befasuar që të ashtuquajturat, njollat në diell kanë ndikim të madh në jetën psikike të njeriut.

Ose sikur Dielli të rrisë për 1% nxehtësinë e tij, çdo gjë do të digjej në Tokë, ndërsa nëse do të zvogëlonte për 1% çdo gjë do të ngrihej.

Ndërsa Dielli rrezaton me intensitet të njëjtë dhe mu kjo mundëson jetën në Tokë.

Ateisti përafërsisht kështu do të përgjigjej: "Nuk shoh shkas përse do të duhet të ndodhë diç jashtë asaj që ndodh zakonisht".

Nga aspekti i fesë, mu kjo është tragjedia e ateistit.

[11] En Nahl, 1.

Ai nuk sheh Zotin, andaj mendon që bota në vete mjafton.

Feja e ka mësimin e vet dhe ofron shkaqet e saj. Shkenca po ashtu. Feja jep fjalën e fundit, ndërsa shkenca starton nga rastet e veçanta dhe me sintezën e tyre mundohet të fitojë fjalën përfundimtare.

Shkenca ende ka shumë gjëra të pazbuluara, por qëndrimet e fesë dhe shkencës ofrohen, thënë më saktë qëndrimet shkencore gjithnjë e më shumë përputhen me qëndrimet e fesë.

Por, gjithsesi rreziku është afër. Në kozmosin gjigant çdo moment shkatërrohen sisteme të tëra diellore të ngjashme me tonin. Këto janë "supernova", yje si i quan shkenca.

Çfarë do të ndodhë nëse Dielli ynë për një moment bëhet "supernova", që eksplodon? Çartë se ky do të ishte fundi i njeriut në Tokë, dhe fundi i lavdërimit të tij. E ky është rrezik real, nuk është e pabesueshme, po kjo mund të ndodhë dhe sipas disa llogaritjeve gjatë dhjetëmijë vjetëve.

Por, çfarë nëse kjo ndodh nesër? Kush mund ta dijë? Por, edhe sikur mund ta dinim, kush do të mund ta ndalte kataklizmin?

Ka prej njerëzve që rezonojnë kështu: lloji njerëzor do të emigrojë në kozmos, do të shkojë në sisteme të tjera yjore, më të reja se sistemi ynë diellor, duke vazhduar jetën atje. Ky rezonim të bën për të qeshur, dhe përkujton në sjelljen e djalit të Nuhut a.s., i cili refuzoi të hipte në anijen e babait, duke menduar që do të shpëtojë nga përmbytja duke ikur në majën e bjeshkës; siç e përshkruan Kur'ani fisnik:

"...Nuhu e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: "O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me mohuesit!"

Ai** (djali) **tha: "Unë do të ngjitem në një kodër që do të më mbrojë nga uji** (vërshimi)!" **Tha: "Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të All-llahut, pos atë që Ai e ka mëshiruar!" Vala hyri mes tyre të dyve, e ai (djali) u mbyt në ujë".[12]

[12] Hud, 42-43.

Pushtimi i gjithësisë

Lloji njerëzor, i cili deri më tani zvarritej nëpër tokë, hapëroi në gjithësi. Mahnitja e njeriut është e madhe dhe është e kuptueshme, sepse kjo sipas vlerësimit të tij ka qenë ndërmarrja më e madhe nga lashtësia. Për herë të parë arriti të shkelë me këmbën e tij në truallin e një planeti tjetër qiellor. Njeriu nuk duhet të nënvlerësojë këtë duke u bërë i padrejtë ndaj vetes. Nuk është kjo gjë e vogël. Edhe sipas normave fetare, ai këtë duhet çmuar si dhuratë e madhe e Zotit duke qenë falënderues ndaj Tij. Nuk duhej lejuar ta braktisë modestia e tij e të harrojë kush është Zoti i vërtetë. I tërë ky sukses është një sprovë, për këtë nuk duhet të rrokulliset me mendimet katanike.

Ai duhet të ketë ndërmend që udhëtimi i tij në kozmos, kudo që ka arritur, nuk është asnjë mbizotërim i gjithësisë. Këtë e këshillon feja, këtë ia mëson edhe shkenca.

Ja disa shënime (që është lehtë të kuptohen) të dhëna në shifra të rrumbullakuara:

Me raketat e tanishme rruga deri në Hënë zgjat shtatë ditë dhe këto raketa nuk vinë në shprehje për udhëtim në planetët tjerë.

Planeti më i largët i njohur – Plutoni, prej Tokës është larg 5. 756 milionë kilometra. Këtë rrugë drita e kalon për më shumë se 19 000 sekonda, gjegjësisht për më shumë se 5 orë. Raketa me shpejtësi 200km/s, e lëvizur nëpërmjet "motorit plazma", deri te Plutoni do të arrijë për një vit.

Raketa me shpejtësi afro 10 000 km/s, me ndihmën e motorit me energji "fisive", këtë rrugë do ta kalonte për 6 deri 7 ditë.

Ylli më i afërt prej Tokës, Alfa Centauri është larg më shumë se 4 vjet drite. Raketa me energji "fisive", te ky yll arrin për 120 vjet.

Duke llogaritur që teoria e Ajnshtajnit nuk lejon asnjë shpejtësi, që do të arrinte shpejtësinë e dritës, atëherë udhëtimi më i shpejtë deri te ky yll do të ishte për 4 vjet.

Për derisa Ajnshtajni llogariti që diametri i kozmosit afro 2 miliardë vjet drite, më vonë u bë korrigjimi në 6 miliardë, ndërsa sot në 10 miliardë, dhe fjala e fundit ende nuk është thënë.

Shpesh njeriu humb nga shikimi për çfarë largësie bëhet fjalë. Ai sheh vetëm shifrat të cilave u shtohet zeroja.

Nëse zbulojmë që një mjegullinë e gjithësisë është e larguar nga ne 100 milionë vjet drite, kjo është pamja e saj para 100 milionë vjetëve, e çfarë është sot, duhet të jetojmë 100 milionë vjetët e ardhshëm për ta ditur këtë, gjegjësisht që të nisemi në vizitë të kësaj mjegulline, duhet të lëvizim me shpejtësi drite, për të arritur tek ajo për 100 milionë vjet.

Nëse paramendojmë që në kozmos ka me miliona galaktika, e secila galaktikë me milion yje, dhe nëse vërejmë që koha që i nevojitet dritës të kalojë këto largësi është me dhjetëra, qindra, mijë dhe milionë shekuj njerëzor, edhe shumë e shumë më tepër, atëherë kur dëgjohet lavdërimi i njeriut se si njeriu u nis në pushtimin e kozmosit, atëherë vërtet jemi me dy mendje si ta quajmë këtë, kur ne ende s'i kemi pushtuar tërësisht as oqeanet e as polet e Tokës.

Të ashpra janë kushtet klimatike e më të ashpra në kozmos. Në Hënë nuk ka ajër, as ujë, ndërsa amplitudat e temperaturës janë shumë të mëdha. Ndërsa temperaturat në Merkur dhe Venerë janë jashtëzakonisht të larta për shkak të afërsisë së Diellit. Gravitacioni i Saturnit dhe Jupiterit është aq i madh sa që thjesht do të ngjiteshim në sipërfaqet e tyre. Vërtet Marsi është diç më i volitshëm, por larg nga ajo që lënë përshtypjet nga romani.

Duke mos marrë parasysh mendimet e pesimistëve, të cilët lejojnë hipotezën e takimit me qeniet inteligjente dhe më të civilizuara, kështu që ëndrra për pushtimin e kozmosit të kthehet në demoralizim dhe poshtërim, por duke marrë parasysh, qoftë rrotullimet shpirtërore, ose qoftë vizionet e skeptikëve, si duket së paku sipas asaj që për tani dimë, arritjet janë modeste.

Mirëpo, mu mendja ateiste e njeriut kryelartë nuk llogarit në faktet që i ofron shkenca, por mendon që ai, njeriu, në rrugë që të bëhet mbinjeri, zot i vetes dhe i natyrës.

Kuptimi i tij është çrregulluar, shpirti i është dehur me verën e suksesit. Mendimi për Zotin i duket i tepërt. Që tani e sheh veten si posedues i atributeve, të cilat feja ia përshkruan vetëm Krijuesit Absolut.

Imagjinon veten se është fitues i pamposhtur në Tokë dhe pushtues i afërt i kozmosit, andaj duke ngritur kokën kah qielli me arrogancë ulërin: "Nuk ekziston! Nuk je!

Ndërsa Kur'ani fisnik e këshillon:

"A nuk e ke ditur se vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve e i tokës, dhe se pos All-llahut nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar".[13]

"Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron *(nuk i bën tesbihë),* ***duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre*** *(pse nuk është në gjuhën tuaj).* ***Ai është i butë dhe fal shumë".***[14]

"Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut, madje edhe kur ju godet e keqja, ju vetëm te Ai e ngrini zërin *(me lutje)****".***[15]

"Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe diellin e hënën. Edhe yjet janë të nënshtruar me urdhrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon".[16]

"Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare".[17]

"Ja pra, Ne nuk kemi dërguar para teje pejgamber në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e begatshme e tij: "Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre".[18]

"A mendon ai, se atë nuk mund ta mposhtë askush?"[19]

---

[13] El Bekare, 107.
[14] El Isra, 44.
[15] En Nahl, 53.
[16] En Nahl, 12.
[17] Jusuf, 105.
[18] Zuhruf, 23.
[19] El Beled, 5.

"A nuk e ke kuptuar ti se All-llahu krijoi qiejt dhe tokën me urtësi, e nëse Ai do, juve ju zhduk e sjell krijesë** (popull) **të re. E kjo nuk është e vështirë** (rëndë) **për All-llahun".[20]

"I lartë është All-llahu, Sunduesi i vërtetë, nuk ka zot tjetër pos Tij, Zot i Arshit bujar".[21]

Dhe, ja kështu Kur'ani fisnik, nga verseti në verset, prej faqes në faqe, udhëheq luftën intelektuale kundër mendimit ateist.

Kur'ani është libri i cili tërheq vërejtjen dhe frikëson. Por, ai u shpall që të përgëzojë dhe sihariqojë ata që besojnë Zotin nga dashuria ndaj Tij, dhe në emrin e Tij bëjnë vepra të mira. Ky është mesazhi themelor i fesë.

Kur'ani së pari i drejtohet njeriut të asaj kohe, kulture dhe diturie. I ofrohet me argumente nga shumë anë, për ta bindur në humbjen e tij. I tërheq vërejtjen që Zoti është një, i sjell faktin e thjeshtë se shumë zota nuk janë të mundshëm, sepse Toka dhe qiejt do të shkatërroheshin. Tërheq vërejtjen idhujtarëve që idhujt e tyre nuk mund t'u shërbejnë, as t'i dëmtojnë asgjë dhe si gjëra të tilla janë më të ulët se ata, e pra si mund t'i adhurojnë ata.

Edhe pse sot në botën e arsimuar nuk është aktual paganizmi, ekziston mjaft i përhapur ateizmi dhe agnosticizmi. Për këtë argumentet e Kur'anit mbi ekzistencën e botës meritojnë gjithnjë vëmendjen tonë. Edhe pse kanë kaluar shekuj, argumentet e tij aspak nuk humbin rëndësinë e tyre.

Kur'ani fisnik vazhdimisht udhëzon njeriun në gjërat që janë "pranë duarve të tij", me të cilat përherë është në kontakt, si dhe në argumente mbi ekzistencën e një fuqie Krijuese, e cila udhëheq me çdo gjë. Ai i drejton vëmendjen kah bimët e cila mbin nga farat, përkujton se njerëzit dhe kafshët zhvillohen nga embrioni, i tregon për bletën dhe mundin e saj, në ndërrimin e natës dhe ditës, në yjet, Diellin, Hënën, Tokën etj. Përse këto argumente nuk mund të jenë edhe për ateistët e kohës sonë? Përse ndodhitë e përditshme në natyrë, manifestimi

[20] Ibrahim, 19-20.
[21] El Mu'minun, 116.

i jetës dhe ndryshimet nuk mund të jenë argument edhe për agnostikun bashkëkohor për ekzistencën e një Fuqie e cila me dëshirën dhe urtësinë e Tij udhëheq me çdo gjë?

Secili besimtar sot duke përcjellë emisionet televizive është i habitur me klimën e fuqishme ateiste dhe shumica mendojnë që ateizmi në vete ka argumente të fuqishme. Mirëpo, kjo është larg nga e vërteta. Ateizmi kurrsesi nuk ka argumente dhe as që i ka pasur ndonjëherë.

Kështu edhe ateizmi bashkëkohor nuk është fryt i shkencës dhe i njohurive shkencore, ashtu siç pohojnë ateistët. Në esencë ai është sikurse ateizmi që u drejtohet Kur'ani.

Kur'ani fisnik u drejtohet njerëzve që nuk kanë ditur as teorinë e Darvinit për krijimin e llojeve, as teorinë e Mendelit mbi trashëgiminë, si dhe as për njohuritë shkencore bashkëkohore, por ata kanë mohuar fenë në mënyrën që habit për shkak të ngjashmërisë së tyre me reagimin e ateistëve bashkëkohorë në mësimet e fesë.

Karakteri i ateizmit ka qenë gjithmonë i njëjtë. Kjo vërtetohet edhe në Kur'an, i cili kur u përgjigjet ateistëve u thotë:

"...Po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre..."[22]

Dialogu i madh, i udhëhequr me shekuj gjatë historisë së llojit njerëzor mes besimit dhe mosbesimit, vazhdon edhe më tej.

Mirëpo, përderisa ateizmi jo vonë ka menduar që zhvillimi shkencor udhëheq kah triumfi i materializmit në shkencë dhe kështu paralajmëroi fitoren përfundimtare të tij. Por kah fundi i shekullit të kaluar veç është mundur të dyshohet në të, ndërsa sot krejtësisht qartë i lëkundet trualli. Jo vetëm që materia ka humbur primatin, të cilën ai e ka propaganduar me këmbëngulje, por edhe termi materie, kështu i qartë u shkatërrua dhe ngeci vetëm termi forcë.

Zbulimet shkencore treguan që cilësitë e materies, që na janë paraqitur, kanë qenë mashtrim i qartë. Realiteti është krejtësisht tjetër. Përderisa ateizmi deri dje ka vrapuar kah argumentet shkencore për ta

[22] El Bekare, 118.

treguar qëndrimin e tyre, tani është treguar që këto argumente në esencën e tyre janë diç tjetër.

Për këtë, "ateizmi shkencor", as që bëhet fjalë. Meqë ateizmi pranon atë që mund të identifikojë, ai duhet të ndryshojë edhe qëndrimet për gjërat dhe proceset, në mënyrë sikurse në shkencë që ndryshohen kuptimet e realitetit.

Në këtë mënyrë ateizmi e demanton vetveten. Ateizmi i shekullit XIX ka vdekur. Ateizmi i tanishëm sipas formës i ofrohet mësimit fetar, sepse është i detyruar të pranojë fuqinë primare.

Intelekti detyrimisht udhëzon kah besimi në Zotin. Koncepti për Zotin nuk është absurditet shkencor. Koncepti i forcës nuk është i huaj për intelektin njerëzor, kjo është përvojë e fakteve dhe shkaseve të ndodhive, kjo është evidente. I tërë ky realitet material është rezultat i një fuqie.

Koncepti i inteligjencës gjithashtu është kategori e njohur. Kur vërejmë me vëmendje këtë botë, e rregulluar në mënyrë super inteligjente, pa kusht na shtynë të mendojmë thellë në mesazhin e thellë të Kur'anit famëmadh:

"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt".[23]

Literatura e konsultuar

1. H. Sherif Ahmeti: "Kur'ani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe", Prishtinë, 1987.
2. Hasan Nahi: "Kur'ani i madhëruar", Prishtinë, 1988.
3. Feti Mehdiu: "Kur'ani dhe hija e tij shqip", Shkup, 1999.
4. Tefsir Ibn Kethir, Sarajevë, 2000.
5. Sejjid Kutub: "U okrilju Kur'ana", Sarajevë, 1996.
6. Enes Karić: "Kur'an sa prijevodom na bosanskom jeziku", Sarajevë,1998.
7. Ramo Atajić: "Prijevod Kur'ana sa tefsirom i komentarom na bosanskom jeziku", Sarajevë, 2001.
8. Jusuf Ali: "The meaning of the holy Qur'an", Marryland, USA, 1991.
9. Muhammed Sha'ravi: "Mrekullia e Kur'anit", Prishtinë, 1996.
10. Husein Dhehebi: "Komentimi shkencor i Kur'anit", Dituria Islame, nr. 42, 1992.
11. Ali Iljazi: "Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore", Gjakovë, 2000.
12. Ali Iljazi: "Kur'ani famëmadh nga këndvështrimi shkencor", Gjakovë, 2002.
13. Ali Iljazi: "Kur'ani - prijatar i shkencës", Gjakovë, 2003.

[23] Ali Imran, 190.

THE NOBLE QUR'AN AND "SCIENTIFIC ATHEISM"

In the noble Qur'an, Allah the Magnificent says:

(Summary)

"He granteth wisdom to whom He pleaseth; and he to whom wisdom is granted receiveth indeed a benefit overflowing; but none will grasp the Message but men of understanding".

Thus, knowledge is the source of wisdom. In the noble Qur'an, Allah tells us to meditate, encourages us to embrace science in order to be able to recognize the existence of God through it. Everything that happens around us is a result of God's will and wisdom.

He is the lord of infinite power. The use of science by mankind is not a disruption of the divine order. The current wealth and strength of mankind derives from knowledge gained through science. According to Islam, science is an imperative for the believers. The first words revealed to Muhammad were:

"Read: In the name of thy Lord Who createth
Createth man from a clot.
Read: And thy Lord is the Most Bounteous,
Who teacheth by the pen,
Teacheth man that which he knew not".

القرآن الكريم و "الالحاد العلمى"

(خلاصة البحث)

يقول الله سبحانه و تعالى في القرآن الكريم:

يُؤتِي الْحِكْمَةَ مَن يَشَاء وَمَن يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلاَّ أُوْلُواْ الأَلْبَابِ.

اذن العلم هو منبع الحكمة.

الله سبحانه و تعالى يدعونا في القرآن الكريم إلى النفكر و يحثنا على طلب العلم و البحث العلمى و ذلك حتى نصل عن طريق العلم إلى معرفة الله سبحانه و تعالى و ان كل الذي يجرى من حولنا هو نتيجة لارادته و قوته و قدرته. الله سبحانه و تعالى هو المهيمن على كل شيئ و هو ذو القوة المتين. استخدام العلم و ساثله المختلفة ليس ضد الارادة الالهية. ان ثورة الانسان و قدرته مستمدة من العلم و التجارب العلمية و حسب التعاليم الاسلامية فان طلب العلم فريضة و ضرورية الاستقامة الحياة على الارض و الايات الاولى التي انزلت على نبيى الاسلام كانت تحثة على طلب العلم:

"اقْرَأْ باسْمِ رَبِّكَ الَّذي خَلَقَ. خَلَقَ الإِنسَانَ مِنْ عَلَقٍ. اقْرَأْ وَرَبُّكَ الأَكْرَمُ. الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ. عَلَّمَ الإِنسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ"

JURISPRODENCA ISLAME

Muhammed Asad

Parimet e shtetit dhe të qeverisë në Islam
QEVERISJE ME MIRËKUPTIM DHE KËSHILL

Synimet e shtetit islam

Synimi skajor i shtetit islam është të sigurojë suaza politike për unitetin dhe kooperimin mysliman:

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin *(fenë dhe Kur'anin)* ***e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju*** *(para se ta pranonit fenë islame)* ***ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit."*** *(Kur'ani, 3:103-104)*

Prandaj, shteti islam nuk është synim vetvetiu, por synimi i tij është përparimi i bashkësisë së qytetarëve të cilët pajtohen me barabarësinë dhe drejtësinë, me të mirën e kundër të keqes - apo, që të shprehemi edhe më saktë, përparimi i bashkësisë së qytetarëve të cilët

punojnë në krijimin dhe mbajtjen e rrethanave të tilla shoqërore në të cilat numri sa më i madh i njerëzve në kuptimin moral dhe fizik do të jetonte në pajtim me ligjin natyror të Allahut, Islamin. Që kjo të arrihet, është e domosdoshme të zhvillohet ndjenjë shumë e fuqishme e vëllazërisë në bashkësinë e tillë. Fjalët kur'anore **إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ** - ***"Pa dyshim besimtarët janë vëllezër".*** *(Kur'ani, 49:10.)* më hollësisht janë shprehur në shumë situata të Pejgamberit a.s.:

"Besimtari për besimtarin është sikurse muret e një ndërtese, të cilët e mbështesin njëri tjetrin." [1]

"Çdo mysliman është vëlla me çdo mysliman, as nuk i bën dëm as nuk lejon t'i bëhet dëm. Kush i ndihmon vëllait të vet kur ka nevojë për ndihmë dhe Allahu do t'i ndihmojë atij kur ai të ketë nevojë për ndihmë. Nëse dikush nga ju ia heq një brengë vëllait mysliman, dhe Allahu atij do t'ia heqë shumë brenga në Ditën e gjykimit; kurse atij që ia mbulon një turp vëllait të vet mysliman Allahu do t'ia mbulojë atij turpin e tij në Ditën e gjykimit." [2]

Cilat do të duhej të ishin bazat emocionale të kësaj vëllazërie?

Ky sigurisht nuk do të ishte përkushtimi fisnor as nacional, i cili në bashkësitë joislame siguron *raison d`etre* i vetëm të të gjitha grupeve politike kurse të cilin Pejgamberi a.s., me përbuzje e ka gjykuar si diç jodinjitoz për besimtarin e mirëfilltë:

"Vërtet ka njerëz të cilët krenohen me të parët e tyre të vdekur, por të këtillët në sytë e Allahut janë më të përbuzur sesa kandrra e zezë krahfortë, e cila me hundën e saj e përzien një copë bagël! Kujdes, Allahu e ka hequr nga ju arrogancën të cilën e keni pasur nga koha e xhahilijetit, kur jeni lavdëruar me lavdinë e të parëve tuaj. Njeriu është, pa dyshim, ose besimtar i cili gjithnjë e ka Allahun në mendje ose mëkatar i pafatshëm! Të gjithë njerëzit janë bijë të Ademit, kurse Ademi është i krijuar nga dheu (pluhuri)!"[3].

Nacionalizmi, në të gjitha format e tij dhe nuk e di në çfarë maskash, është i drejtuar kundër parimeve fondamentale të mësimit islam,

[1] Buhariu dhe Muslimi, me zinxhirin e transmetuesve nëpërmjet Ebu Musait.
[2] Buhariu dhe Muslimi, me zinxhirin e transmetuesve nëpërmjet 'Abdullah ibn 'Umerit.
[3] Et-Tirmidhiu dhe Ebu Davudi, nëpërmjet Ebu Hurejres.

sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe, sipas të cilit, ai domosdo duhet të mënjanohet si themel i mundshëm i bashkimit mysliman. Në pajtim me Kur'anin dhe Sunnetin, uniteti mysliman duhet të jetë i natyrës ideologjike; ai duhet t'i mbikalojë të gjitha konsideratat racore dhe fisnore: vëllazëria e njerëzve nuk është e përcaktuar me asgjë pos me vetëdijen e tyre të përbashkët se i përkasin një të njëjtës fe dhe një të njëjtit moral. Sipas mësimit islam, vetëm bashkësia e këtillë, e cila është e bashkuar në idealet e tilla, mund të sigurojë themele të drejta për të gjitha grupet shoqërore. Nga ana tjetër, Pejgamberi a.s., më së rrepti e gjykon dukurinë që lufta për interesat reale apo imagjinare nacionale apo shtetërore të jenë mbi konsideratat morale duke thënë:

"Nuk është nga ne ai që thërret në nacionalizëm (asabijjeh - pasionin fisnor); nuk është nga ne ai që lufton në emër të nacionalizmit dhe; nuk është nga ne ai që vdesë në emër të nacionalizmit!"[4]

Kur një nga as'habët e ka lutur ta sqarojë kuptimin e asabijjetit, i cili, krejt qartë, atë që e përfaqëson e nxjerrë nga fusha e islamit, Pejgamberi a.s. është përgjigjur:

"(Kjo do të thotë) ta ndihmosh popullin tënd në të padrejtë."[5]

Në një rast tjetër ka sqaruar se dashuria ndaj popullit vetjak nuk mund të cilësohet si asabijjet nëse ajo dashuri nuk çon në padrejtësi ndaj ndonjë grupi tjetër shoqëror.[6] Përkatësisht:

Pejgamberi i Allahut ka thënë:

"Ndihmoji vëllait tënd qoftë ai dhunues ose atij që i bëhet dhunë!"

Atëherë një njeri bërtiti:

"O Pejgamber i Zotit, e kuptoj se duhet t'i ndihmojmë atij të cilit i bëhet dhunë, por si t'i ndihmoj atij i cili bën dhunë?!"

Në këtë Pejgamberi i Zotit u përgjigj:

"Ti duhet ta pengosh atë që të mos bëjë dhunë, kështu do t'i ndihmosh!"[7]

[4] Ebu Davudi, nëpërmjet Xhubejr ibn Mut'imit.
[5] Ebu Davudi, nëpërmjet Wathila ibn al-Asqa'.
[6] Ahmed ibn Hanbeli dhe Ibn Maxheh, nëpërmjet 'Ubade ibn Kethirit.
[7] El-Buhariu dhe Muslimi nëpërmjet Enesit.

Prandaj, preventiva e padrejtësisë dhe vendosja e drejtësisë në tokë është synimi i parë i porosisë sociale të Islamit:

"Je jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. ...!" *(Kur'ani, 3:110.)*

Prandaj, urdhërimi i të mirës dhe ndalimi i së keqes është vlerë etike e bashkësisë myslimane, sikurse edhe e vëllazërisë myslimane; me këtë kërkesë realizohet ideali i drejtësisë - i drejtësisë ndaj myslimanëve sikurse edhe ndaj atyre që nuk janë myslimanë - dhe ky është koncept në të cilin shteti islam (i cili nuk është asgjë tjetër pos instrument politik në realizimin e këtij ideali) ekziston apo rrënohet.

Të bëhet legjislacioni i Allahut legjislacion në tokë në mënyrë që drejtësia ta ngadhënjejë të shtrembrën; të rregullohen marrëdhëniet sociale dhe ekonomike në atë mënyrë që çdo individ të mund të jetojë në liri dhe në mënyrë dinjitoze dhe me sa më pak pengesa dhe me sa më shumë trimërime në zhvillimin e personalitetit të vet; t'u mundësohet të gjithë myslimanëve, meshkujve dhe femrave, t'i realizojnë synimet etike të Islamit jo vetëm në sferën e besimit të tij por edhe në sferën praktike të jetës së vet të përditshme; t'u sigurohet të gjithë qytetarëve jomyslimanë siguria e plotë shpirtërore sikur edhe liria e plotë e religjionit, kulturës dhe zhvillimit shoqëror; të mbrohet vendi nga të gjitha sulmet mbi të nga jashtë dhe nga çdo aspekt i rrënimit të saj nga brenda; të propagandohet mësimi islam deri në kufijtë skajorë në botë - koncepti i shtetit islam në këta dhe vetëm në këta parime e gjen kuptimin dhe arsyetimin e vet. Vetëm nëse në të sendërtohen këta parime, për shtetin e tillë me të drejtë mund të thuhet se është "halifet'-ull-Llah fi'l-`erd - Përfaqësues i Allahut në tokë" - së paku në atë pjesë të tokës e cila bën pjesë në juridiksionin e tij faktik.

Parimet kryesore

Nga pikëpamja sheriatike, legjitimiteti i një shteti islam - që do të thotë, kërkesa e tyre fetare për përkushtim dhe respekt mysliman – bazohet në urdhëresën fundamentale të Kur'anit:

"O ju që besuat, nënshtrojuni All-llahut, dhe nënshtrojuni të dërguarit dhe përgjegjësve nga ju.! …" *(Kur'ani, 4:59.)*

Në këtë mënyrë koncize Kur'ani vendosë disa parime të rëndësishme, që kanë të bëjnë me natyrën e shtetit islam.

Parimi i parë

Detyrimi i parë i shtetit të tillë përbëhet në implementimin e dispozitave sheriatike në territorin i cili është nën juridiksionin e tij. Ky detyrim është theksuar fuqishëm në ajetin vijues:

"...E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë.!" *(Kur'ani, 5: 47)*

Prandaj, asnjë shtet nuk mund të konsiderohet autentik islam nëse kushtetuta e tij nuk përmban dispozitat të cilat do të mundësojnë që ligjet e sheriatit të cilët i përkasin punëve publike të formojnë bazën e pakontestueshme të tërë ligjvënies shtetërore.

Do të dëshiroja këtu të theksoj se ky kufizim i juridiksionit shtetëror në "punët me rëndësi publike", sipas natyrës së çështjes, nuk nënkupton që sheriati vetvetiu mund të kufizohet ndonjëherë në këtë rrethveprim - për arsye se ai, pa fare dyshim, ka të bëjë me tërë jetën njerëzore, si në atë publike, ashtu edhe në atë private. Mirëpo, nuk duhet shpërfillur faktin se shteti, si organizatë shoqërore, i përket aspektit shoqëror të jetës njerëzore dhe, në pajtim me këtë, në konsekuencë ai nga sheriati nuk kërkon asgjë më shumë pos asaj pjese të legjislacionit të tij lidhur me aspektin shoqëror.[8]

[8] Për kodifikimin e dispozitave të tilla sheriatike shih kapitullin VI të këtij libri.

Parimi i dytë

Edhe pse pjesa e përmendur e sheriatit përgjithmonë mbetet ajo baza në strukturë dhe veprim të shtetit islam, ai, sipas natyrës së tij, nuk mund t'i furnizojë të gjitha ligjet që janë të nevojshëm për administratën shtetërore. Për këtë arsye, siç kemi parë, ne do të detyrohemi t'i plotësojmë ato klauzola sheriatike lidhur me punët me rëndësi publike me ligje temporale, kohore, të caktuar, të plotësuar, të cilët do të ishin sajim i yni vetjak - duke nënkuptuar, natyrisht, se ne nuk do të mund t'i përshkruajmë asgjë që do t'i kundërvihej shkronjës dhe frymës së cilësdo dispozitë të sheriatit, sepse:

"Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon *(nuk i lejohet)* ***asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër fare...."*** *(Kur'ani, 33:36.)*

Prandaj, nga e theksuara pason se kushtetuta e shtetit autentik islam qartë duhet të vendoset ashtu që asnjë ligj temporal apo ndonjë urdhëresë administrative, pa marrë parasysh se a urdhërohet apo ndalohet me to diçka, nuk mund të jenë valide në qoftë se vërehet se janë në kundërthënie me çfarëdo klauzole të sheriatit.

Parimi i tretë

Menjëherë pas urdhëresës Kur'anore أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ ("Bëhuni të dëgjueshëm ndaj Allahut dhe ndaj Pejgamberit!") pasojnë fjalët وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ("dhe ndaj atyre në mesin tuaj që kanë autoritet" - d.m.th., të cilët kanë autoritet në bashkësinë myslimane (dhe në bazë të kësaj janë zgjedhur të qeverisin - përkthyesi), ka të bëjë me qëndrimin se për asnjë mysliman nuk është detyrim moral t'i nënshtrohet forcës së pushtetmbajtësit, i cili bashkësisë myslimane i imponohet nga jashtë, por në anën tjetër është detyrim fetar nënshtrimi ndaj pushtetit islam të cilin bashkësia myslimane e ka zgjedhur në mënyrë të pavarur. Nënshtrimi ndaj këtij pushteti është, natyrisht, nënshtrim parimeve të cilat qytetari i njeh si parime fundamentale në të gjitha bashkësitë qytetëruese, por është me rëndësi këtu të nënvizohet që, në kontekst të

politikës islame, ky detyrim mbetet deri sa qeveria nuk i legalizon veprat të cilat me sheriat janë të ndaluara ose derisa nuk fillon t'i ndalojë veprat të cilat sheriati i ka përcaktuar. Në rast të zhvillimit të këtillë të gjerave, bindja ndaj pushtetit të tillë pushon të jetë detyrim ndaj bashkësisë myslimane, sikur që mjaft qartë e ka thënë pejgamberi Muhammedi a.s.:

"Myslimani është i obliguar të dëgjojë dhe t'i nënshtrohet, pa marrë parasysh e dëshiron këtë apo e urren, derisa nuk i urdhërohet të bëjë diçka që shpie në mëkat; nëse i urdhërohet të bëj mëkat atëherë nuk ka as dëgjueshmëri as nënshtrim."[9]

Me fjalë të tjera, përkushtimi i ummetit ndaj "atyre që në mesin e juaj kanë autoritet" është e kushtëzuar me atë se a janë ata, sunduesit, të dëgjueshëm ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij. Nga ky parim rezulton se ummeti ka për detyrim ta mbikëqyrë aktivitetin e qeverisë, që atyre të cilët kryejnë funksionin myslimanët t'i japin përkrahje atëherë kur punojnë drejtë, por edhe ta tërheqin përkrahjen e tyre atëherë kur sunduesit të lajthitin nga rruga e drejtë dhe nga udhëheqja korrekte. Prandaj, nënshtrimi i qeverisë ndaj pëlqimit të qytetarëve është parakushti më i rëndësishëm thelbësor që një shtet të mund të quhet islam.

Parimi i katërt

Parimi i "miratimit popullor" supozon se qeveria zgjidhet në bazë të zgjedhjeve të lira popullore dhe se ajo në tërësi paraqet vullnetin e popullit. Ky është aspekt plotësues i formulimit Kur'anor "atyre që në mesin e juaj kanë autoritet". Ky formulim është në lidhje si me bashkësinë myslimane në tërësi, ashtu edhe, dhe më saktë, me çdo trup individual i cili këtë bashkësi e prezanton. Kurse nga kjo, më tej, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e legjislacionit islam, rezulton se udhëheqja shtetërore duhet të jetë e natyrës zgjedhore (elektorale), që do të thotë se përvetësimi i fuqisë politike me mjete joelektorale, sido që t'i quajmë dhe kushdo qoftë që këtë ta bëjë, qoftë ky një apo më

[9] El-Buhariu dhe Muslimi, nëpërmjet Ibn 'Umerit.

shumë individë të cilët konsiderohen myslimanë, automatikisht bëhet imponim jolegal i forcës pushtetmbajtëse ose përçarje e jashtme e bashkësisë myslimane.[10]

Burimi i sovranitetit shtetëror

Ky shqyrtim domosdoshmërisht para nesh shtron çështjen lidhur me burimet nga të cilat shteti islam e nxjerr sovranitetin e vet. Kjo çështje, edhe pse është interesante nga aspekti i filozofisë politike, nuk është vetëm teorike, si vlerësohet në shikim të parë.

Në parim, qytetarit të zakonshëm, sado qoftë kjo e paarsyeshme, nuk i interesojnë spekulimet për "burimet e sovranitetit shtetëror", deri atëherë kur institucionet dhe procedura administrative e shtetit kanë ose duket se kanë efekt pozitiv në mënyrën e tij personale të jetës dhe në mundësitë e përparimit të tij ekonomik. Por megjithatë, nuk ka historian që mund ta mohojë se vlerat morale të cilat qytetarët ia përshkruajnë shtetit të vet, tekefundit, janë vendimtare për ekzistimin e autoritetit të tij shpirtëror dhe, me fjalë të tjera, edhe për ekzistimin e disiplinës sociale në kuptimin më të gjerë të asaj fjale. Nuk ekzistojnë forma të jashtme politike, madje as më të mirat ndër to, të cilat, vetvetiu, mund t'i arrijnë synimet e tyre. Përdorimi (funksionaliteti) i tyre, fundja, varet nga përmbajtjet e tyre shpirtërore; nëse këto përmbajtje janë me defekte, pasojat mund të jenë të kobshme për bashkësinë.

[10] Do të dëshiroja këtu të theksoj se përdorimi im i termit "fuqia qeverisëse" (governmental power) në thelb koincidon me termin *sulltan* në atë kuptim në të cilin ky term paraqitet në disa hadithe autentike që kanë lidhje me çështjet politike. Në këtë kuptimin origjinal, termi *sulltan* nuk ka domethënie (jokorrekte) të kufizuar të "mbretit", domethënie të cilën e kanë dhënë shumë autorë mesjetarë dhe bashkëkohorë muslimanë dhe jomuslimanë, por kjo domethënie zgjerohet në gjithë sferën e administratës shtetërore. Në gjuhën klasike arabe - të gjuhës së Kur'anit dhe të Hadithit – *sulltan* para së gjithash domethënë "dëshmi, provë" ose "argument bindës", kurse si kuptim të dytë do të thotë "autoritet" ose "fuqi" në kuptimin abstrakt dhe konkret. Kurdo që Pejgamberi fletë për *sulltanin* në kontekst të jetës politike të ummetit, ai pashmangshëm mendon në atë që ne sot e përcaktojmë me "qeveri", kurse po kështu kanë vepruar edhe as'habët. Zbatimi i këtij termi mbi personin si emisar i qeverisë – d.m.th. mbi sunduesin apo mbretin – pa dyshim është shtrembërim postklasik i kuptimit të tij burimor. Shih për shembull *Arabic-English Lexicon të* Laneut, pjesa 4, fq.1405-1406.

Prandaj, është shumë e besueshme se mungesa shekullore e disiplinës sociale dhe e frymës qytetare në bashkësinë myslimane më së shumti i ka kontribuar konfuzionit (në ndryshimin e saj të orientimit, ndryshimin i cili është shkaktuar me vargun e zhvillimit të pafatshëm historik) në aspekt të bazave konceptuale të autoritetit inherent ndaj shtetit si të tillë. Ky konfuzion nganjëherë, mbase, mund të shpjegojë atë përçmim me të cilin myslimanët me shekuj i nënshtrohen çdo lloj opresioni dhe eksploatimi që ndaj tyre bëjnë sunduesit e paskrupull.

Qartë, klima politike e kohës sonë një kohë të gjatë nuk do të ketë simpati ndaj nënshtrimit të tillë përçmues ndaj padrejtësisë. Nën ndikimin e teorive politike perëndimore, gjithnjë e më shumë myslimanë të arsimuar fillojnë ta mbrojnë sovranitetin burimor, i cili i përket "populli", vullneti ekskluziv i të cilit duhet të jetë vendimtar në formimin e çdo institucioni shtetëror sikur edhe fushëveprimin e legjislativit aktual shtetëror. Por edhe në mesin e myslimanëve bashkëkohorë të cilët në parim e pranojnë idenë e shtetit islam ekziston një numër respektabil prej tyre të cilët pohojnë se sovraniteti absolut i përket "vullnetit unik të popullit" (ixhmai) në bazë të hadithit të Pejgamberit a.s.:

"Pa dyshim Allahu nuk do të lejojë që ummeti im të pajtohet në mashtrim (në rrugë të gabuar)".[11]

Nga ky hadith shumë myslimanë përfundojnë se për çka do qoftë që bashkësia myslimane - apo së paku pjesa më e madhe e tyre - të pajtohet, dhe këtë në të gjitha rrethanat, kjo duhet të jetë përzgjedhje korrekte.[12] Mirëpo, ky përfundim është plotësisht i gabueshëm. Thënia e sipërme e Pejgamberit a.s. është negative, e jo pozitive. Pejgamberi, në të vërtetë, me të saktësisht ka thënë: kurrë të gjithë myslimanët nuk do ta pasojnë vendimin e gabueshëm, do të thotë, se gjithnjë do të ketë individë apo grupe në mesin e tyre që nuk do të pajtohen me zgjidhjet e gabueshme dhe se të tillët gjithnjë do të kërkojnë zgjidhje të drejtë.

[11] Et-Tirmidhiu, nëpërmjet Abdullah ibn `Umerit.

[12] Ky përfundim është analog me thënien e lashtë romake: *Vox populi – vox Dei* (Vullneti i popullit është vullneti i Zotit), e cila ka gjetur jehonë në të gjitha konceptet perëndimore të demokracisë.

Kurdo që ne flasim për "vullnetin e popullit" në kontekst të mendimit politik islam, ne duhet që me mjaft kujdes t'i shmangemi asaj që në mënyrë popullarizuese përcaktohet si "nxjerrje e fëmijës me larjen" - me fjalë të tjera, ne "vullnetin e popullit" nuk guxojmë ta ndërrojmë me autokracinë joislame, e cila ndër popujt myslimanë ka ekzistuar në shekujt e fundit dhe e cila është barazuar me konceptin joislam të sovranitetit të pakufizuar vetëm të një pjese të bashkësisë në emër të saj si tërësi.

Pasi legjitimiteti i shtetit islam rrjedh nga pajtimi vullnetar i popujve rreth një mësimi dhe pasi ky legjitimitet, për më tepër, është kushtëzuar me pajtimin popullor lidhur me mënyrën se si shteti i tyre do ta konstituojë administratën e vet, atëherë vijmë në sprovë të themi: Po, sovraniteti zë fill në popull, por meqenëse në shoqërinë e vetëdijshme islame pëlqimi popullor lidhur me metodën e caktuar të qeverisjes dhe me skemën e caktuar të kooperimit shoqëror politik është vetëm pasojë e pranimit të tyre të Islamit si urdhëresë e Zotit, atëherë nuk ka dyshim se sovraniteti, i cili atyre iu falet, në të vërtetë është, e drejta e tyre vetjake. Kur'ani thotë:

"Thuaj: "O All-llah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do, e lartëson atë që do. Çdo e mirë është në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!" *(Kur'ani, 3:26.)*

Prandaj, burimi i mirëfilltë i sovranitetit të gjithmbarshëm është vullneti i Allahut xh.sh., i cili manifestohet në urdhëresat e Sheriatit. Fuqia e ummetit është i llojit ndërmjetësues, përfaqësues dhe ajo manifestohet, të themi ashtu, në besimin e Allahut xh. sh.; ashtu që shteti islam - i cili, siç kemi parë, ekzistimin e tij ia ka borxh vullnetit të popullit dhe i cili i është i nënshtruar kontrollit të nënshtetasve të vet – sovranitetin e vet, në rend të parë, e nxjerr nga vullneti i Allahut xh.sh.. Nëse është në pajtim me kushtet sheriatike, në të cilat jam ndalur pak më gjerë në faqet paraprake, shteti i tillë mund të pledojë për lojalitetin e nënshtetasve të vet atij - në pajtim me fjalët e pejgamberit Muhammedit a.s.:

"Kush më nënshtrohet mua, i nënshtrohet edhe Allahut; dhe kush nuk më nënshtrohet mua, nuk i nënshtrohet as Allahut; kush i nënshtrohet sunduesit më nënshtrohet edhe mua; dhe kush nuk i nënshtrohet sunduesit nuk më nënshtrohet edhe mua!"[13]

Prandaj, kurdo që shumica e umetit të vendosë që besimin e vet t'ia japë qeverisë nëpërmjet liderit të caktuar, çdo qytetar mysliman duhet të obligohet moralisht që të ndjekë këtë vendim madje edhe nëse ajo shkon kundër disa afiniteteve të tij personale.

Kryetari i shtetit

Pasi synimi i shtetit islam nuk është "i vetëpërcaktuar" me esencialitetin racor, nacional apo kulturor por me legjislativ islam si model praktik të të gjitha veprave njerëzore, atëherë është e vetëkuptueshme se vetëm personit i cili beson në prejardhjen Hyjnore të këtij legjislacioni - d.m.th. myslimanit - mund t'i besohet funksioni i shefit të shtetit. Pikërisht për shkak se nuk mund të ketë jetë të plotë islame pa shtet islam, as shteti nuk mund të quhet islam në kuptim të plotë të fjalës nëse administratën e tij nuk e aplikojnë ata për të cilët mund të parashtrohet se me vullnet i janë nënshtruar legjislacionit hyjnor të Islamit.

Sipas natyrës së gjerave, ky parim nuk nxit kurrfarë vështirësie në vende të populluara krejtësisht ose së paku me shumicë të myslimanëve (çfarë janë për shembull Arabia Saudite dhe Afganistani), por në ato vende myslimane në të cilat jeton pjesë e rëndësishme e pakicave jomyslimane - kurse shumica e vendeve myslimane bën pjesë në këtë kategori - kërkesa e sipërme ka mund të shpjerë deri te disa frika sipas së cilave kjo nënkupton diskriminimin e qytetarëve jomyslimanë në atë mjedis mysliman. Por, duhet qenë i sigurt se frika e tillë nga diskriminimi është vetëm teorike dhe se ajo nuk ka mbulesë në pushtetin real: sepse në vendet në të cilat myslimanët përbëjnë shumicën dërrmuese (dhe vetëm të tillat korrektësisht mund të quhen vende myslimane) qeverisja me shtetin automatikisht u përket atyre. Megjithatë, në

[13] El-Buhariu dhe Muslimi, nëpërmjet Ebu Hurejres.

kontekst të mendimit bashkëkohor politik, i cili është nën ndikim të fuqishëm të koncepteve dhe të paragjykimeve perëndimore, madje edhe diskriminimi teorik në fushë të religjionit do të mund të ishte i pakëndshëm për shumë myslimanë, e mos të flasim për atë se sa do të ishte e mundimshme ajo për pakicat jomyslimane të cilat jetojnë në mjedisin mysliman. Mirëpo, njeriu duhet, krejt sinqerisht, menjëherë në fillim të pranojë se është e pamundur të organizojë shtetin pa dozë të caktuar të diferencimit ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve madje edhe pse është ai shtet islam ose cilido version i shtetit i nxjerr nga parimet e Kur'anit dhe të Sunnetit. Në fund, çfarëdo pështjellim i kësaj çështjeje qoftë do të ishte krejt e pandershme edhe ndaj botës jomyslimane e cila na rrethon dhe ndaj bashkësisë sonë myslimane.

Kërkesa që shefi i shtetit islam duhet të jetë mysliman nuk do të thotë - dhe nuk mund të ketë kuptimin - se ne në jetën e përditshme duhet të zhvillojmë politikë diskriminuese ndaj qytetarëve jomyslimanë. Pikërisht e kundërta, ata duhet të barazohen në të gjitha liritë dhe mbrojtjen në të cilën pretendojnë edhe myslimanët; jomyslimanëve nuk mund t'u besohet vetëm pozita kyçe në qeverisjen e shtetit. Nuk mund t'i iket faktit se jomyslimani - sado të jetë i madh integriteti i personal i tij dhe sado qoftë ai i përkushtueshëm ndaj shtetit - nuk mund të punojë me përkushtim maksimal për synimet ideologjike të Islamit, as që do të ishte korrekte, fundja, kjo edhe të kërkohet nga ai. Nga ana tjetër, nuk ekziston organizatë ideologjike (e bazuar në religjion ose në ndonjë doktrinë tjetër, sidoqoftë) e cila do t'i lejonte vetes që qeverisjen me punët e saj t'ia besojë personit i cili nuk do të luftonte për ideologjinë e tij. Për shembull, a mund të imagjinohet që dikush që nuk është komunist ta fitojë pozitën kyçe - e të mos flasim për nivelin më të lartë në udhëheqje me shtetin - në Rusinë Sovjetike? E qartë se nuk mundet sepse për ne është krejt logjike, pasi komunizmi është bazë ideologjike e atij shteti, se vetëm personi që pakusht veten e ka identifikuar me synimet e atij shteti mund t'i zbatojë ato synime nëpërmjet politikës administrative.

Kjo për çfarë po flasim, e dhënë bashkë me urdhrin në nass:

"Bëhuni të dëgjueshëm ndaj Allahut dhe bëhuni të dëgjueshëm ndaj Pejgamberit dhe ndaj atyre në mesin tuaj që kanë autoritet", na shpie deri te një përfundim i pashmangshëm: ata që janë bartës të pozitave më të larta në shtetin islam sikurse edhe ata që janë përgjegjës për formësimin e politikës së saj gjithnjë duhet të jenë myslimanë, dhe këtë jo vetëm de facto - për shkak se ata janë shumicë në vendet myslimane, por edhe de jure - në bazë të dispozitave kushtetuese. Nëse jemi të vendosur që Islamin ta bëjmë faktor dominues në jetën tonë, ne duhet të kemi guxim moral dhe haptazi të flasim se nuk jemi të gatshëm ta rrezikojmë të ardhmen tonë duke rënë në "liberalizmin" e rrejshëm, i cili refuzon t'i japë çfarëdo rëndësie bindjes fetare; e kundërta, besimi i njeriut për ne është shumë më i rëndësishëm nga fakti që ai është i lindur ose i natyralizuar në vendin tonë.

Në këtë mënyrë, atëherë, shihet qartë që prijësi i shtetit islam duhet të jetë mysliman. Kjo është në pajtim me parimin e shpallur kur'anor:

"... s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)* ***...."*** *(Kur'an, 49:13.)*

që do të thotë se ai duhet pa tjetër të zgjidhet vetëm në bazë të vlerës vetjake; përjashtohet çdo konsideratë ndaj nacionalitetit, prejardhjes familjare dhe statusit të tij të mëhershëm shoqëror. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë:

"Dëgjojeni dhe nënshtrojuni, qoftë prijësi (emiri) juaj është ndonjë rob abisinas me xhufka në kokë!"[14]

Pavarësisht nga kjo dispozitë që emiri i ardhshëm[15] të jetë myslimman dhe "më i devotshmi në mesin tuaj", - që, krejt e qartë, nënkupton se ai duhet të jetë madhor, i mençur dhe superior sipas karakterit të tij - sheriati nuk ka specifikuar asnjë kusht të ri, i cili do të kërkohej për

[14] El-Buhariu, nëpërmjet Enesit.

[15] Unë këtu përdori designacionin *emir* (që mund të përkthehet si komandant, lider ose bartës i funksionit) vetëm si lehtësim të përshtatshëm. Edhe pse ky është një nga dy designacionet që më së shpeshti i janë dhënë Pejgamberit s.a.v.s., kur kjo ka të bëjë me udhëheqjen nga ana e tij të bashkësisë (designacioni i dytë është imam), muslimanët nuk e kanë për detyrim sheriatik ta përvetësojnë këtë titull nëse preferojnë ndonjë titull tjetër.

këtë funksion, as nuk ka shtruar ndonjë mënyrë të veçantë të zgjedhjes së tij, as nuk e ka kufizuar vëllimin e këtyre zgjedhjeve. Prandaj, për hollësitë e tilla vendos ummeti në pajtim me interesat dhe kërkesat e veta më të rëndësishme të kohës së vet. Po kjo vlen edhe kur është fjala për faktin sa kohë të gjatë emiri i zgjedhur do ta kryejë funksionin e tij. Është krejt e kuptueshme se numri i kufizuar të viteve të sundimit të tij do të fiksohet në pajtim me interesat e ummetit (me mundësi të rizgjedhjes); alternativisht, afati i kryerjes së funksionit më të lartë të emirit mund të jetë objekt shqyrtimi për pushimin e tij kur ai të arrijë kohën e caktuar të pleqërisë madje edhe nëse detyrat e tij i kryen me përkushtim dhe me efikasitet; por ekziston edhe alternativa e tretë: ky afat të kufizohet për shkak të moshës së pleqërisë në atë rast kur bëhet e qartë se ai nuk i kryen me përkushtim detyrat e tij apo se nuk është në gjendje që t'i kryejë në mënyrë efikase për shkak të gjendjes së tij shëndetësore apo për shkak të senilitetit. Në këtë vëllim të gjerë që i përket afatit të kryerjes së funksionit më të lartë shtetëror nga ana e emirit ne shohim edhe një ilustrim të fleksibilitetit të madh, i cili është karakteristik për rendin politik që e përfaqësojnë Kur'ani dhe Sunneti.

Parimi i konsultimit

Siç kemi parë, Sheriati me shumë largpamësi përmbahet nga dhënia e dispozitave të hollësishme për të gjitha çështjet duke nënkuptuar se vjen deri te ndryshimet e pashmangshme në ekzistencën tonë sociale, për ç'arsye është e vetëkuptueshme nevoja për legjislacion kontinuitiv, kohësisht të kushtëzuar. Në shtetin islam ky legjislacion do të bënte për shumë çështje të administratës të cilat nuk i prek sheri'ati në tërësinë e tij sikurse edhe për ato fusha ku ekzistojnë vetëm parimet sheriatike, por jo edhe dispozitat e hollësishme. Në të dy instancat, ummeti është i obliguar të sjellë legjislacion relevant, të hollësishëm me anë të gjykimit të pavarur (ixhtihadit) në pajtim me frymën e legjislacionit islam dhe me interesat më të mëdha nacionale. Por, kjo nuk do të thotë që ato çështje të jetës publike e të cilat nuk kanë legjislacion të arritur me anë të ixhtihadit mund të lihen në vullnet të individit;

ato duhet të bazohen në konsensusin përfundimtar (ixhma') të tërë bashkësisë (që, natyrisht, nuk e përjashton paraprakisht pajtimin e bashkësisë për çdo çështje të shqyrtuar me atë që me anë të ixhtihadit mund të vijë ndonjë muxhtehid apo ndonjë grup i tyre).

Kush është ai që i ligjëson këto dispozita temporale deri te të cilat ka ardhur bashkësia myslimane? E qartë, nga bashkësia si tërësi nuk mund të pritet që të mbajë mbledhje, të projektojë dhe të sjellë dispozita; duhet të ekzistojë personi ose numër i caktuar i personave të cilët i delegon bashkësia në mënyrë që ata të propozojnë ligjet e tyre, kurse vendimet e të cilëve do të ishin obliguese për të gjithë. Çështja, pra, është se cilit person apo persona duhet dhënë këtë detyrë dhe këtë besim.

Ka shumë myslimanë të cilët mendojnë - duke marrë shembull në Katër kalifët e drejtë, ashtu si ata e shohin dhe e kuptojnë - se tërë pushteti që ka lidhje me legjislativin temporal, josheritaik duhet përcjellë te një person, d.m.th. te emiri - për arsye që, nëse bashkësia e zgjedh në mënyrë të lirë, do të mund të dukej se si ai e prezanton bashkësinë jo vetëm në fushën ekzekutive por edhe në atë legjislative. Mirëpo, myslimanët e tjerë mbajnë mendimin i cili, po ashtu, është mbështetur me të dhëna historike - se akumulimi i fuqisë së tillë në duart e një njeriu gjithnjë ka qenë i përmbushur me rreziqet më serioze dhe këtë, së pari, për shkak se individi, sado qoftë ai i shkëlqyeshëm në mendim, i devotshëm dhe qëllimmirë, shumë lehtë mund të gabojë në gjykim për arsye të paragjykimeve të tij personale në këtë apo në atë gjë, dhe, nga ana tjetër, në këshillin, të përbërë nga më shumë anëtarë, gjithnjë vjen deri te mendimet e ndryshme, të kundërta - për ç'arsye vjen deri te diskutimi për këto mendime - që shpie deri te ndriçimi i ndonjë problemi nga kënde të ndryshme pikëpamjesh; në këtë rast, rreziku nga paragjykimet individuale dhe futja e tyre në legjislativ, nëse nuk është eliminuar plotësisht, atëherë sigurisht është shpënë në masën më të vogël. Kjo nuk është krejt - përvetësimi i fuqisë absolute shpeshherë e prish poseduesin e saj, duke e sjellë në sprovë që këtë fuqi, vetëdijshëm apo jo, ta keqpërdorë personalisht për vete apo për klanin e tij. Në pajtim me këtë mendim, fuqia legjislative e shtetit duhet të përcillet në një trup legjislativ të cilën e zgjedh bashkësia sidomos për këtë qëllim.

Në bazë të këtyre dy mendimeve, pra, myslimanët zgjedhin lirisht ndërmjet qeverisjes autokrate të cilën e zbaton emiri, nga një anë, dhe qeverisjes së shumicës (kuvendit apo parlamentit, sidoqoftë që ta quajmë), nga ana tjetër. Por, nëse ne më thellë e hulumtojmë këtë temë, do të vijmë deri te përfundimi se, në të vërtetë, liria e zgjedhjes ndërmjet dy alternativave të theksuara nuk mund të ekzistojë - për arsye se kjo çështje është zgjidhur me urdhër kategorik në Kur'anit:

"... konsultohen mes vete për punë të përbashkëta..." *(Kur'ani, 42:38.)*

Ky urdhër i nass-it duhet të trajtohet si klauzolë bazore dhe operative e mendimit të tërësishëm islam, i cili i përket qeverisjes me shtetin. Ai është krejt i qartë dhe i kuptueshëm dhe ai hyn në thuajse çdo pore të jetës politike; ai është në atë masë shprehimor dhe pa ekuivok sa që kurrfarë tentimi i interpretimit të saj me hamendje nuk mund ta ndërrojë kuptimin e tij. Fjala emr (أَمْر) në këtë urdhëresë ka lidhje me të gjitha fushat e jetës publike, por, në pajtim me këtë, edhe me mënyrën e qeverisjes në të cilën duhet të konstituohej shteti islam, d.m.th. mbi parimin zgjedhor në bazë të të cilit duhet të arrihen dhe të kryhen të gjitha funksionet qeverisëse. Edhe më shumë, fraza emruhum shura bejnehum (punët e tyre publike dakordohen ndërmjet tyre" - nuk do të thotë vetëm se kryerja e çdo pune politike është pasojë e dakordimit, porse ky është sinonim për marrëveshje, konsultim. Prandaj, fuqia legjislative e shtetit duhet të transmetohet mbi këshillin të cilin bashkësia e zgjedh vetëm për këtë qëllim.

Këshilli zgjedhor

Nga ky kontekst është e qartë se formulimi "mes vete" (بَيْنَهُمْ) në urdhrin e shqyrtuar Kur'anor është me lidhje me tërë bashkësinë. Prandaj, këshilli legjislativ - apo, ta përdorim termin e mirënjohur gjatë tërë historisë së tërësishme myslimane, mexhlisi-shura - duhet të jetë përfaqësuesi i mirëfilltë i tërë bashkësisë, meshkujve dhe femrave. Karakteri i tillë reprezentativ mund të arrihet vetëm me anë të zgjedhjeve të lira dhe të përgjithshme. Pra, anëtarët e mexhlisit duhet të zgjidhen me anë të së drejtës më të gjerë të votës, duke inkuadruar të drejtën e votës edhe për meshkuj edhe për femra. Vëllimi i kësaj të drejte dhe kualifikimet që kërkohen nga votuesi - njësojë sikurse edhe nga kandidati - këto janë hollësi për të cilat as Kur'ani as Sunneti nuk kanë sjellë kurrfarë dispozite kategorike dhe se, për këtë arsye, ata janë lënë si e drejtë e diskrecionit të bashkësisë në frymën e kërkesave të kohës në të cilën ajo jeton.

Këtu, natyrisht, mund të konfirmohet se, në vend që të zgjidhet direkt apo indirekt nga ana e tërë bashkësisë, mexhlisi mund të jetë mjaftueshëm reprezentativ edhe nëse anëtarët e tij thjesht i emëron emiri - meqenëse ai e ka pozitën dhe mandatin të cilin ia ka besuar populli; në bazë të kësaj, mund të konsiderohet se ai është manifestim i vullnetit të popullit. Por çfarëdo që të thotë në mbrojtje të kësaj pikëpamjeje historia myslimane, dobësia e tij menjëherë del në pah posa të na kujtohet se mënyra me të cilën konstituohet trupi legjislativ numërohet ndër çështjet më të rëndësishme shtetërore, dhe nëse e pranojmë disktumin hyjnor se të gjitha punët tona publike duhet të kryhen në bazë të konsultimit me popullin, ne nuk do të mund të ikim nga përfundimi se procesi i konstituimit të mexhlisit duhet, sipas natyrës së gjërave, të rezultojë nga "konsultimi" në kuptimin më të gjerë dhe më direkt të kësaj fjale.

Në kompleksin e shoqërive çfarë janë shoqëritë tona, konsultimi i këtillë nuk mund të marrë formë tjetër përveç zgjedhje të tilla gjatë të cilave për meritat e kandidatëve të njohur publikisht do të diskutohet

dhe në bazë të së cilës votuesit do të vlerësojnë kujt do t'ia japin votën e tyre. Mënyra e zgjedhjes - direkte apo indirekte, votës së transferueshme apo jo të transferueshme, përfaqësimit regjional apo proporcional etj., - nuk është e rregulluar me sheriat dhe kjo është, prandaj, çështje për të cilën vendimin e vet e merr vetë bashkësia.

Një gjë shumë të rëndësishme që ka të bëjë me shqyrtimin tonë e ka shpjeguar pejgamberi Muhammedi s.a.v.s., e kjo ka të bëjë me të gjitha emërimet publike dhe, së këtejmi, edhe me ato zgjedhore. Fjala është për ndalesën e agjitimit për vetveten. Muhammedi s.a.v.s. thotë:

"Mos i bezdisni zyrat e administratës (imarah), sepse nëse ju jepet ajo që e keni kërkuar, do t'i liheni vetëm aftësisë suaj, e nëse ju jepet pa lutje servile, do të ndihmoheni (nga ana e Zotit)!"[16]

Në dritën e mësimit islam, e qartë se Pejgamberi s.a.v.s. ka menduar, në atë që, në pajtim me përgjegjësinë e tij, njeriu mund të ndihmohet vetëm nga ana e Zotit; nga ana tjetër, mungesa e ndihmës së Zotit domosdo rezulton me shkatërrim sado qofshin aftësitë e njeriut. Që këtë gjë ta sqarojë, Pejgamberi s.a.v.s. në mënyrë konsistente ka refuzuar të aplikojë çfarëdo emërimi administrativ sa herë që dikush e ka lutur që të vendosë në funksion të caktuar. Për shembull, kur i është afruar një as'hab dhe ka kërkuar nga ai që të vendoset në ndonjë vend në qeveri, ai me brengosje është përgjigjur:

"Për Zotin, ne në këto funksione nuk e emërojmë atë që e kërkon as atë që lakmon pas atij vendi!"[17]

Prandaj, ruajtja e plotë e frymës së sheriatit është e mundur vetëm nëse në Kushtetutën e shtetit islam qartë theksohet se vetëkandidimi i cilitdo person që lakmon që të emërohet në funksion administrativ (duke e inkuadruar këtu edhe funksionin e shefit të shtetit) apo lakminë e këtij personi që të zgjidhet në këshillin apo kuvendin, automatikisht të diskualifikojë personin e tillë nga mundësia që të zgjidhet ose të emërohet. Ligji i këtillë kushtetues drejtpërdrejt do ta shmangte vërejtjen e shumë myslimanëve të asaj kohe, i cili do të mund t'i drejtohej

[16] El-Buhariu dhe Muslimi, nëpërmjet Abdur-Rrahman ibn Samura-s.
[17] Ibid., nëpërmjet Ebu Musait

"qeverisjes së kuvendit". Çdokush që posedon ndikim lokal ose pasuri - pa marrë parasysh autoritetin e tij real - mund t'i sigurojë vetes zgjedhje në këshillin legjislativ me anë të dozës së caktuar të "ndërmjetësimit" te zgjedhësit e tij, por me ligjin më parë të theksuar çdo përpjekje e tillë e vetagjitimit direkt do të shpinte në diskualifikim direkt të kandidatit të tillë. Atëherë, me këtë ligj, natyrisht, do të ekzistonte mundësia që kandidati me ndikim por jodinjitoz të tërhiqet nga vetëkandidimi publik, por ai do të mund të shërbehej me ndonjë organizatë apo me ndërmjetësuesit e tij të cilët për të bëjnë fushatë në publik.

Mirëpo, fakti se kandidati do të ishte i pamundësuar ta zhvillojë fushatën e tij parazgjedhore apo, që, edhe vetë t'i drejtohet trupit zgjedhor do ta bënte detyrën e tij skajshmërisht të rëndë; rezultati, sipas rregullit, do të ishte që vetëm personi i cili gëzon respekt të merituar dhe të paimponuar ndër zgjedhësit do të kishte shans të mirëfilltë që të zgjidhet.

Dallimet në mendim

Tashmë është thënë se puna legjislative e mexhlisi-shura-s ka të bëjë vetëm me çështjet me rëndësi publike, dhe kjo për ato hollësi të cilat nuk janë të rregulluara si dispozita ligjore në **nusus-in** e Kur'anit dhe të Sunnetit. Kurdo që interesi i bashkësisë e kërkon që të merret një vendim i tillë, i ri, mexhlisi së pari këtë duhet ta kundrojë në kontekst të sheriatit, duke u udhëhequr me parimin gjeneral me të cilin ka të bëjë çështja e shqyrtuar, dhe kur shihet se cili është ky parim, atëherë në fushëveprim të këtij legjislativi bën pjesë që të merr vendim në pajtim me dispozitën tashmë ekzistuese të sheriatit.

Por mexhlisi shumë shpesh do të ballafaqohet me problemet për të cilat sheriati nuk e ka thënë asnjë fjalë, me problemet të cilat nuk janë shënuar në nusus-in e dispozitave të hollësishme, e madje as në nususet e parimeve gjenerale. Në rastet e tilla, është detyrim i tij të mendojë dhe të sjellë dispozita të cilat kërkohen, duke pasur kujdes gjatë kësaj në frymën e Islamit dhe mirëqenien e bashkësisë.

Tërë kjo, sipas natyrës së çështjes, nënkupton që anëtarët e mexhlisit nuk posedojnë vetëm njohjen sipërore të nususe-ve të Kur'anit dhe Sunnetit, por edhe të kenë talente në perceptimin e thellë dhe në depërtimin lucid, që të jenë nga ulu'l-elbab-ët, mendjemprehtë, të shpirtëzuar, dhe të jenë në gjendje të depërtojnë thellë në rrethanat shoqërore dhe kërkesat e bashkësisë dhe në ndodhitë botërore; me fjalë të tjera, arsimimi dhe pjekuria janë kualifikime të domosdoshme që dikush të zgjidhet në mexhlisi shura.

Por edhe kur anëtarët e mexhlisit të posedojnë kualifikime të këtilla, vështirë do të ndodhë ndonjëherë që ata në rrethanat e dhëna shoqërore të shikojnë në mënyrë të njëjtë, në pasojë, të jenë unanim në lidhje me pikarritjet e dispozitave ligjore të cilën situata përkatëse e imponon. Kjo llojllojshmëri e pikëpamjeve është plotësisht e natyrshme, pasi që çdo meditim njerëzor është një proces mjaft subjektiv dhe se ai nuk mundet në tërësi të veçohet nga temperamenti, prirja, tradita, bekgraundi shoqëror dhe përvoja jetësore e mendimtarit, shkurtimisht, nga të gjitha ndikimet e llojllojshme që marrin pjesë në formësimin e asaj që e quajmë "personalitet të njeriut. Mirëpo, progresi i mirëfilltë nuk është i mundur pa dallimet e këtilla në mendim, meqenëse vetëm përballja e intelektualëve të konstituuar ndryshe shpie deri aty që ata njëri-tjetrin ta stimulojnë në diskutim në të cilën problemet shoqërore bëhen më të qartë dhe në këtë mënyrë më afër zgjidhjes.

Kjo është ajo që pejgamberi Muhammedi a.s. e ka pasur parasysh kur ka thënë:

"Dallimet në mendime ndër dijetarët e ummetit tim janë mëshirë (e Allahut)."[18]

Ne, ndërkaq, nuk duhet të shqetësohemi me atë që vendimet e mexhlisi-shura-s në shtetin islam - sikurse vendimet e organeve të ngjashme anekënd botës - gjithnjë vështirë do të miratohen unanimisht. Gjeja e vetme që ne në mënyrë legjitime mund ta presim është që këto vendime të miratohen mbi parimin e shumicës - apo së paku me shumicën relative kur është fjala për dispozitat e zakonshme apo, ndo-

[18] Es-Sujuti, El-Xhami'us-sagir.

shta, me dy të tretat në çështjet jashtëzakonisht me rëndësi çfarë janë, për shembull, ndërrimi i qeverisë (për të cilën temë më vonë do të diskutojmë), nxjerrja e amendamenteve në kushtetutë, shpallja e luftës e të ngjashme.

Duke i marrë parasysh mungesat e qarta të shumicës së sistemeve të ashtuquajtura "demokratike" në Perëndimin bashkëkohor, për disa myslimanë bashkëkohorë nuk është në rregull që aktiviteti legjislativ në shtetin islam të varet nga numri i thjeshtë i votave. Këtë mendim të tyre ata e bazojnë në faktin e qartë se nuk është e domosdoshme që dispozita e trupit legjislativ të mbështetet nga ana e shumicës, pasi që kjo është dispozitë "korrekte", dhe për arsye se gjithnjë është e mundur që shumica, pa marrë parasysh sa është ajo dhe sado qëllime të mira të ketë, nganjëherë të gabojë, kurse pakica - pa marrë parasysh në numrin e tyre të vogël - të ketë të drejtë.

Ky është mendim i drejtë, për këtë nuk duhet humbur kohë. Qenia njerëzore vërtet ka prirje të bëjë mëkat; njeriu nuk ndjek gjithnjë atë që është korrekte dhe e drejtë; historia është përplot shembuj të vendimeve të gabueshme të cilat i ka bërë shumica kokëtrashë dhe vetjake edhe krahas faktit se në këtë ka dhënë shenjë pakica më e mençur. Por, edhe krahas kësaj, është vështirë të shihet cila do të ishte ajo alternativë për parimin e vendimeve të marra me shumicën e votave brenda trupit legjislativ. Kush është ai i cili, nga rasti në rast, do të thotë se shumica apo pakica ka të drejtë? Cili mendim do të mbizotërojë? Natyrisht, këtu do të mund të sugjerohej se gjykimin përfundimtar do të duhej lëshuar emirit, por - pavarësisht nga fakti se dhënia e pushtetit të tillë absolut cilitdo individ shkon në dëm të parimit "emruhum shura bejnehum", në të cilin aq rreptë këmbëngul legjislacioni islam - po ashtu a nuk është e mundur që edhe emiri të gabojë e që shumica të ketë të drejtë? A ekziston garantim hyjnor i cili do t'i mbështesë qëndrimet e emirit? Lidhur me këtë, kritikët e parimit të shumicës zakonisht ofrojnë arsyetimin vijues: "Kur jemi te zgjedhja e emirit, ne duhet ta dimë se për këtë funksion e zgjedhim personin më të urtë dhe më të devotshëm, dhe vetë fakti se ai është zgjedhur në bazë të urtësisë dhe devotshmërisë së tij superiore duhet të jetë garantim i mjaftueshëm se

vendimet e tij do të jenë të drejta." Kjo është krejt e saktë, por a është po ashtu e saktë se myslimanët gjithnjë mexhlisi-shura-në do ta zgjedhin në bazë të urtësisë dhe devotshmërisë të cilat duhet të jetë karakteristika për çdo kandidat për këtë trup? A është "garanci e mjaftueshme" kjo se vendimet që i merr shumica e ligjvënësve gjithnjë do të jenë të drejta? Natyrisht se nuk është. Në të dy rastet - d.m.th. që gjykimin përfundimtar ta marrë emiri apo mexhlisi - "garanci e mjaftueshme" kurrë nuk mund të bëhet zëvendësim për garancinë e përkryer; kjo e fundit, për fat të keq, është jashtë mundësisë njerëzore. Më e mira që këtu mund të shpresojmë është që, pasi këshilli legjislativ i përbërë prej personave më të mençur ta zhvillojë shqyrtimin për çdo çështje, shumica nga ky këshill përfundimisht të pajtohet në aspekt të vendimit të caktuar i cili pa dyshim është i drejtë. Për këtë arsye Muhammedi s.a.v.s., në shumë raste ka tërhequr vërejtjen për myslimanët:

"Ndiqni grupin më të madh!"[19]

dhe:

"Është detyrim i juaji të qëndroni me bashkësinë e njësuar (xhematin) dhe me shumicën (el-'ammeh)!" [20]

Në të vërtetë, largpamësia njerëzore nuk erdhi deri te ndonjë metodë më e mirë për marrjen e vendimeve të përbashkëta sesa parimi i shumicës. Pa dyshim, edhe shumica mund të gabojë, por mund të gabojë edhe pakica. Nga cilido kënd ta vështrojmë këtë çështje, mundësia e gabimit të mendimit njerëzor shpie në bërjen e mëkateve dhe kjo është e pashmangshme në jetën e njeriut, por ne nuk kemi mundësi tjetër pos të mësojmë nga përpjekjet dhe gabimet dhe që vetë, më vonë, të përmirësohemi.[21]

Përktheu:
Nexhat Ibrahimi

[19] Ibn Maxhe, nëpërmjet Abdullah ibn 'Umerit
[20] Ahmed ibn Hanbeli, nëpërmjet Mu'adh ibn Xhebelit.
[21] Burimi: Muhamed Asad, Parimet e shtetit dhe të qeverisë në Islam (Origjinali: The Principles of State and Government in Islam, Publisher: University of California Press, Place of Publication: Berkeley, 1961).

Muhammed Asad

THE PRINCIPLES OF STATE AND GOVERNMENT IN ISLAM

Government by consent and council

(Summary)

The goals of the Islamic state

The innermost purpose of the Islamic state is to provide a political framework for Muslim unity and cooperation:

"Hold fast, all together, to the covenant of God, and do not separate. And remember God's favor unto you - how, when you were enemies, He united your hearts, so that by His favor you became brethren ; and how, when you were on the brink of an abyss of fire, He drew you back from it. Thus God makes His messages clear to you, so that you may find guidance, and that out of you may grow a community of people who issue a call to equity, enjoin what is right and forbid what is wrong: and it is these alone that shall attain to everlasting happiness". *(Quran 3:103-104)*

محمد أسد

مبادئ الدولة و الحكم في الاسلام

(الحكم بالتعاون و التشاور)

(خلاصة البحث)

اهداف الدولة في الاسلام

ان الهدف النهائ للدولة الاسلامية هو تأمين الظروف السياسية الملائمة لتوحيد و تعاون المسلمين فيما بينهم:

وَاعْتَصِمُواْ بِحَبْلِ اللّهِ جَمِيعًا وَلاَ تَفَرَّقُواْ وَاذْكُرُواْ نِعْمَةَ اللّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنتُمْ أَعْدَاء فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُم بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا وَكُنتُمْ عَلَى شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ النَّارِ فَأَنقَذَكُم مِّنْهَا كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ. وَلْتَكُن مِّنكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنكَرِ وَأُوْلَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ. (القرآن، **3**: **103–104**)

JURISPRUDENCA ISLAME

Abdullah Nasih Ulvan

ISLAMI - LIGJ I JETËS

Hyrje

Është gëzim e lumturi e madhe për myslimanët të gjejnë bashkëbesimtarë kudo në botën islame duke thirrur me krenari:

"Dëshirojmë që Islami të jetë sistemi me të cilin do të sundojmë, mënyrë e jetesës dhe Kur'ani të jetë ligj e kushtetutë e shtetit. Dëshirojmë të riarrijmë lavdinë dhe madhështinë tonë".

Në mesin e këtyre thirrjeve, gjenden edhe shumë thirrje tjera armiqësore, të deklaruara nga agjentët e jobesimtarëve, të cilët akuzojnë Islamin për apati, prapambetje, ngathtësi dhe iluzion.

Cilët janë këta agjentë të cilët i thërrasin njerëzit të heqin dorë nga Islami?

Ata janë ose orientalistë keqdashës, ateistë të ligë, kryqtarë tinëzarë, masonistë të dëmshëm, komunistë injorantë ose kolonialistë të ulët. Fatkeqësisht, disa myslimanë injorantë (myslimanë vetëm me emra), të cilët kanë pak ose aspak njohuri për Islamin, janë mashtruar me këto thirrje të njëanshme. Shumë shpesh, ata madje edhe i ndihmojnë ata. Vullnetarisht u besojnë thënieve të tyre duke mos i kuptuar faktet apo duke mos i njohur dimensionet e akuzave e komploteve.

Sipas mendimit tim, këta mbështetës, të cilët janë ndikuar nga ky invadim intelektual, duhet të gjejnë dikë që t'i udhëzojë në rrugën e drejtë, t'u tregohen faktet reale dhe t'u shpalosen konceptet e bukura të Islamit lidhur me gjithësinë, jetën e njeriut, në mënyrë që të refuzojnë pretendimet e akuzat e rreme. Gjithashtu ata do t'i kthehen besimit të drejtë të Islamit, si fe, besim e maturi dhe veç kësaj do të bëhen thirrës e luftëtarë për çështjen e tij.

Gjatë pjesës vijuese do të sqarojë detajisht për të rinjtë faktet për Islamin, në mënyrë që të njohin dhe të besojnë në vlerën e tij të madhe dhe mësimet e Kur'anit. Ata nuk do të kenë zgjedhje tjetër përveç që t'i kthehen të së vërtetës, rrugës së drejtë, në rrugën e myslimanëve të sinqertë mbi të cilën është bazuar madhështia e Islamit, kur uniteti i myslimanëve ishte i qëndrueshëm dhe Islami është përhapur në gjithë botën. Asgjë nuk është e vështirë për All-llahun.

Pjesa e parë
Karakteristikat e sheriatit islam

Juristët pajtohen që çdo ligj, qoftë ai hyjnor apo pozitiv, ka karakteristikat dhe natyrën e tij. Shtrohet pyetja: Cilat janë karakteristikat e ligjit Islam apo Sheriatit? Karakteristikat e Islamit do t'i gjejmë në pikat vijuese:

I. Karakteri hyjnor

Kjo do të thotë që parimet e Sheriatit nuk janë të miratuara nga njeriu, pasi që ai është plotësisht i paaftë të bëjë një ligj të harmonizuar, i cili është i zbatueshëm për të gjitha kohët, vendet, kulturat, civilizimet, preferencat dhe teket. Ligjet e islamit janë të miratuara nga Zoti i të gjitha gjërave, Krijuesi i Gjithësisë, i cili krijoi çdo gjë në formën më të përsosur. Prandaj, kur myslimani aderon një ligj hyjnor, ai e zbaton atë me kënaqësi, sinqeritet dhe me vullnet. Gjithashtu ai përpiqet që me sinqeritet dhe në mënyrë bindëse të praktikojë këtë ligj, pasi që të kuptojë me siguri që:

- All-llahu sigurisht është Krijuesi i Botës dhe Kontrolluesi i të gjitha krijesave. Ky Krijues i drejton çështjet e krijesave të Tij në mënyrën për të cilën Ai vendos dhe e zgjedh. Njeriu, si njëri prej krijesave të Tij, i nënshtrohet këtij vendimi. All-llahu xh.sh. thotë:

"Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë, atyre nuk u takon zgjedhja. I pastër dhe i lartë është All-llahu nga çka i përshkruajnë shok". *(el-Kasas: 68)*

"Kur All-llahu ka vendosur për një çështje ose i Dërguari i Tij, nuk i takon *(nuk i lejohet)* ***asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës".*** *(el-Ahzab: 36)*

- Ai e kupton që All-llahu është i Gjithëdijshmi për çdo gjë. Ai i shpall ligjet që janë të përshtatshme për rrethanat dhe natyrën e krijesave të Tij. All-llahu i Madhërishëm thotë:

"A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë". *(el-Mulk: 14)*

"…All-llahu di *(të fshehtat)* ***e ju nuk dini".*** *(en-Nur: 19)*

- Ai është i sigurt që All-llahu i Madhëruar është i Urtë në atë që krijon apo miraton. Mençuria e Tij do të thotë që Ai i vendos gjërat në vendin e duhur. Ai dëshiron që njerëzit të kenë dobi dhe t'u largojë humbjen. All-llahu xh.sh. thotë:

"…All-llahu i di të gjitha ndodhitë, vepron me urtësinë e Tij". *(el-Enfal: 71)*

"…Ai është i Gjithëfuqishëm, i Urtë". *(el-Enfal: 63)*

- Besimtari e di që All-llahu është Ligjvënësi i vetëm dhe që njeriu është plotësisht i paaftë të nxjerrë ligje për veten. All-llahu xh.sh. thotë:

"All-llahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët…". *(err-Rrum: 54)*

"…e megjithatë njeriu është i paaftë *(për t'u përballuar epsheve)".* *(en-Nisa: 28)*

"…e mbi secilin të dijshëm ka edhe më të dijshëm". *(Jusuf: 76)*

Përveç paaftësisë, njeriu është i ndikuar nga mjedisi, emocioni, prirja, besimi, tendenca dhe grupi të cilin e pason. Për shembull, kur ndokush nxjerr ligje për një komb, do të vijë dikush tjetër që ka më shumë përvojë e dituri në kodifikim dhe kështu do të abrogojë apo do të modifikojë këto ligje. Gjithashtu, ndonjë që është i ndikuar nga marksizmi do të nxjerrë ligje apo kushtetuta të cilat janë në përputhje me filozofinë e tij. Ai që është i ndikuar nga kapitalizmi do të nxjerrë ligje të cilat janë në pajtim me mendimin kapitalist perëndimor. Ai i cili është i prirë nga ekzistencializmi i shthurur do të nxjerrë ligje në pajtim me këtë prirje. Gjithashtu ekzistojnë edhe ndikime, prirje, mendime dhe teke tjera të cilat ndikojnë në mënyrën me të cilën njeriu nxjerr ligje për veten dhe të tjerët. Problemet ndërkombëtare, konflikti social dhe kontradiktat intelektuale për të cilat janë të prira shoqëritë njerëzore, sigurojnë dëshmi për fjalët tona. Gjithashtu ekzistojnë dëshmi tjera që tregojnë që njeriu është i ndikuar nga prirjet, paragjykimet, mjedisi, hipokrizia dhe besimi. Njeriu mund të mos nxjerrë ligje për veten, pavarësisht eksperiencës dhe diturisë së tij. Prandaj, myslimani i mençur dhe inteligjent është i vendosur të zbatojë ligjin hyjnor, pasi që beson që personaliteti dhe humanizmi i tij si një tërësi do të plotësohen dhe do të jenë të plota nëse pason (rrugën e) të Gjithëfuqishmit dhe i nënshtrohet Krijuesit të tij. Ai është All-llahu. Myslimanët duhet të pranojnë ligjin e All-llahut, pasi që ky është kusht paraprak për të qenë mysliman. All-llahu xh.sh. thotë:

"Kur All-llahu ka vendosur për një çështje ose i Dërguari i Tij, nuk i takon *(nuk i lejohet)* ***asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër.".*** *(el-Ahzab: 36)*

"(Thuaj) ***A pos All-llahut të kërkoj unë gjykatës*** *(mes meje e juve)?* ***Kur Ai është që ju zbriti librin në mënyrë të shkoqitur?...".*** *(el-En'amë: 114)*

"A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?" *(el-Maide: 50)*

A thua vallë rinia myslimane a e ka kuptuar tani kuptimin e karakterit hyjnor?

II. Universalizmi

Sheriati islam është zbritur për të mirën e gjithë botës dhe për të gjithë njerëzit pavarësisht racës, ngjyrës, vendit apo gjuhës. Në Islam nuk ka vend për racizëm, fanatizëm apo kasta. Të gjithë njerëzit janë të barabartë. Nuk ka dallim të njërit ndaj tjetrit përveç atyre që janë të devotshëm. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)**…".** (el-Huxhuratë: 13)*

Universalizmi i thirrjes islame është konfirmuar në shumë ajete kur'anore.

"E ne të dërguam ty *(Muhamed)* ***vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat".*** *(el-Enbija: 107)*

"Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë". *(Sebe'ë: 28)*

"Thuaj *(Muhamed):* ***"O ju njerëz! Unë jam iu dërguari i All-llahut te të gjithë ju…".*** *(el-A'rafë: 158)*

Gjithashtu Muhamedi a.s. e ka konfirmuar këtë universalizëm në shumë raste.

- Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Më janë dhënë pesë gjëra që nuk i janë dhënë askujt para meje:

1. All-llahu xh.sh. më ka bërë fitimtar ndaj armiqve të mi (duke ua futur frikën) në një distancë prej një muaj udhëtimi.
2. Toka është bërë për mua (dhe për pasuesit e mi) vend për faljen e namazit dhe gjë për t'u pastruar (për të marrë tejemum). Prandaj, çdo pasues imi mund të falet kudo që dëshiron në kohën e namazit.

3. Plaçka e luftës është lejuar për mua, derisa nuk ka qenë e lejuar për askënd tjetër para meje.
4. Më është dhënë e drejta e ndërmjetësimi në Ditën e gjykimit.
5. Çdo profet është dërguar vetëm te populli i tij, ndërsa unë jam dërguar për tërë njerëzimin".

- Gjithashtu transmetohet se Muhamedi a.s. kur u dërgonte mesazhe mbretërve dhe liderëve të kohës së tij, si Nexhashiut, Cezarit, Kisras dhe Mukavisit, që të pranonin Islamin u shkruante: *"Përqafoni Islamin që të jeni të sigurt dhe të shpërbleheni dy herë nga All-llahu. E nëse nuk e përqafoni Islamin, do të ngarkoheni me mëkatet e nënshtetasve tuaj".*

Po të mos ishte mesazhi i tij universal, nuk do t'u dërgonte mesazhe mbretërve të botës duke i thirrur në Islam.

Konfirmim tjetër për këtë universalizëm qëndron në faktin që Kur'ani i urdhëron të gjithë myslimanët të përhapin shpalljen Islame në gjithë botën. Në shumë ajete kur'anore All-llahu xh.sh. thotë:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun…". *(Ali Imran: 110)*

"E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej myslimanëve?" *(Fussilet: 33)*

Nga këto mësime hyjnore, myslimanët përhapën mesazhin islam në gjithë botën, duke i njoftuar njerëzit për shpalljen e All-llahut dhe të mos i nënshtrohen askujt përveç Tij. All-llahu na udhëzoi që të nxjerrim njerëzit nga adhurimi i krijesave në adhurimin e All-llahut, nga bota e ngushtë në të gjerën, nga padrejtësia e feve tjera në drejtësinë e Islamit.

Kjo karakteristikë është dëshmi që ligji islam është hyjnor, pasi po të ishte bërë ligj nga ndonjë individ apo grup, qëllimisht apo jo qëllimisht do të anonte nga raca, klasa dhe interesi i individit apo grupit. Por, LIGJVËNËSI është Zoti i njerëzimit. Të gjithë njerëzit janë robërit e Tij, dhe nuk ka preferencë të ndokujt mbi tjetrin për shkak të origjinës.

A i kupton rinia jonë këto fakte që kanë të bëjnë me Islamin?

III. Gjithëpërfshirja

Ligji islam përmban sistemet, rregullat dhe ligjet që kanë të bëjnë me të gjitha fushat e informimit, konstruksionit dhe reformës. Gjithashtu rregullon të gjitha fushat e shoqërisë dhe jetës lidhur me besimet, ritualet, parimet morale e ligjet publike siç janë: çështjet civile, e drejta penale, çështjet sociale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, ligjet qeverisëse, rregullat ekonomike dhe çështjet e brendshme të çdo shoqërie. Këto parime të sakta e precize janë hyjnore dhe mësime të përjetshme që japin, mbledhin e bashkojnë zemrat së bashku dhe ndërtojnë jetën njerëzore. Këto ligje nuk marrin, ndajnë dhe shpërndajnë urrejtje apo shkatërrim. Ato janë të shpallura nga i Gjithëdijshmi. Kur'ani konfirmon faktin që Ligji islam përfshin të gjitha çështjet e jetës. All-llahu xh.sh. thotë:

"…Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca…". *(el-En'amë: 38)*

"…Ne ty të shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët". *(en-Nahl: 89)*

Për të shpjeguar karakteristikën e gjithëpërfshirjes, do t'i trajtojmë vetëm ligjet civile, ekonomike, kushtetuese dhe penale si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

- Lidhur me problemet financiare, All-llahu xh.sh. thotë:

"O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga gjiri juaj le të shkruajë një shkrues i drejtë…". *(el-Bekare: 282)*

- Në çështjet kushtetuese, All-llahu xh.sh. thotë:

"…ata që konsultohen mes vete…". *(esh-Shura: 38)*

- Lidhur me problemet gjyqësore, All-llahu xh.sh. thotë:

"…dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve…". *(en-Nisa: 58)*

- Në ligjin penal:

"O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje: i liri për të lirin, robi për robin…". *(el-Bekare: 178)*

- Lidhure me përgatitjen ushtarake, All-llahu xh.sh. thotë:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force *(mjete luftarake)* ***e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre*** *(që tradhtojnë)* ***e me të*** *(me përgatitje)* ***ta frikësoni armikun e All-llahut e armikun tuaj…".*** *(el-Enfalë: 60)*

- Lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare, All-llahu xh.sh. thotë:

"All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësinë me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë". *(el-Mumtehine: 8)*

- Lidhur me ligjet ndërkombëtare, All-llahu xh.sh. thotë:

"…kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi juaj…". *(el-Bekare: 282)*

Përveç këtyre rregullave dhe ligjeve, ekzistojnë rregulla të tjera në Kur'an, sunet, konsensus dhe analogji. Ky është konfirmim i qartë për gjithëpërfshirjen e sheriatit islam, prej të cilit njerëzimi nxjerr ligje për të gjitha kohët dhe vendet.

"A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?" *(el-Maide: 50)*

Kështu një shkencëtar i ditur (Satilana) thotë: "Jurisprudenca islame përmban të gjitha ligjet që u nevojiten myslimanëve. Madje, të gjitha ligjet të cilat u nevojiten njerëzimit".

Hokingu, profesor i filozofisë në Universitetin e Hardvardit thotë: "Ligji islam është përtëritës. Ndiej se e kam drejt kur them që Ligji islam përmban të gjitha ligjet e domosdoshme për zhvillim".

Juristi i njohur Fembri thotë: "Jurisprudenca islame përmban të gjitha rregullat. Çuditem! Pse ju myslimanët nuk i nxirrni sistemet dhe ligjet në përputhje me kohën dhe vendin tuaj?"

Këto janë dëshmitë e njohësve të jurisprudencës dhe ligjeve në botën perëndimore për gjithëpërfshirjen e Ligjit islam. Çfarë qëndrimi tjetër pas kësaj do të besojnë?

IV. Zhvillimi dhe përtëritja

Ligji islam përmban parimet publike dhe rregullat gjithëpërfshirëse, të cilat i plotësojnë nevojat e kohëve moderne dhe janë në hap të njëjtë me kulturat e periudhave të ndryshme, veçanërisht rregullat dhe parimet lidhur me marrëveshjet, kushtetutën, ekonominë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për shembull, Kur'ani thekson sundimin e drejtësisë në çështjet kushtetuese dhe juridike. All-llahu xh.sh. thotë:

"…bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë…". *(el-Maide: 8)*

"…dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve…". *(en-Nisa: 58)*

Mbizotërimi i drejtësisë që është theksuar në dy ajetet e mëparshme është konstant dhe i pandryshueshëm. Ky rregull duhet të zbatohet në çdo vend dhe në çdo kohë. Por, mënyra në të cilën drejtësia aplikohet ndryshon prej një periudhe në tjetrën. Nuk është me rëndësi nëse drejtësia aplikohet në një gjykatë apo në shumë gjykata, apo aplikohet nga gjykata juridike apo nga ndonjë gjykatë ekzekutive. Gjykatësit janë ata të cilët vendosin dhe zbatojnë drejtësinë sipas rrethanave të njerëzve. Qëllimi i Ligjit islam është të zbatojë parimin e drejtësisë mes njerëzve me çdo mënyrë. Gjykatësi zbaton këtë nëse e sheh se përputhet me kohën dhe vendin si dhe arrin interesin e shoqërisë si tërësi.

Kur'ani e thekson rregullin e konsultimit. All-llahu xh.sh. thotë:

"…e konsultohu me ta…". *(Ali Imran: 159)*

"…ata që konsultohen mes vete…". *(esh-Shura: 38)*

Rregulli i shuras apo konsultimit që është përmendur në dy ajetet e lartpërmendura është gjithashtu konstant dhe i pandryshueshëm. Ai duhet të zbatohet në çdo kohë dhe vend. Por, mënyrat e zbatimit ndryshojnë varësisht prej rrethanave të asaj kohe dhe vendi. Prandaj, nuk është me rëndësi nëse ky rregull do të zbatohet nga njerëzit e opinionit

apo nga ndonjë këshill konsultativ apo nga ndonjë këshill i zgjedhur apo me çfarëdo mënyra tjera që janë në interes të njerëzve. Qëllimi më i rëndësishëm i Ligjit islam apo Sheriatit është zbatimi i rregullit të shuras apo konsultimit pavarësisht mënyrës në të cilën zbatohet, sa kohë që udhëheqësit dhe gjykatësit e kombeve e zbatojnë.

Ligji islam thekson zbatimin e rregullave vijuese, për shembull:

- Barazia:

"… më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)****…".*** *(el-Huxhuratë: 13)*

- Përgatitja e forcës kundër armiqve:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi forcë *(mjete luftarake)****…".*** *(el-Enfalë: 60)*

- Kushtet e borxhit:

"O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë…". *(el-Bekare: 282)*

- Animi kah paqja:

"Në qoftë se ata anojnë kah paqja, ano edhe ti kah ajo…". *(el-Enfal: 61)*

- Përmbushja e obligimeve që dalin nga kontratat:

"O ju që besuat! Zbatoni premtimet *(obligimet)****…".*** *(el-Maide: 1)*

Shtrohet pyetja: A duhet që rregullat e Ligjit islam të përtërihen apo të zhvillohen në mënyrë që të jenë në hap me kohën?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, duhet që rregullat e Sheriatit t'i klasifikojmë në tri pjesë:

1. rregullat që mund të përtërihen
2. rregullat që mund të zhvillohen
3. rregullat që nuk mund të përtërihen apo të zhvillohen

1. Rregullat që mund të përtërihen

Më parë kemi përmendur që këto rregulla kanë të bëjnë me sferën e marrëveshjeve financiare, çështjeve juridike, sistemeve ekonomike dhe çështjeve kushtetuese e administrative. Islami siç kemi cekur më lart, këto çështje i ka ngritur mbi rregulla të përgjithshme dhe parime

gjithëpërfshirëse. Nuk e trajton atë në tërësi apo pjesërisht. Detajet, zbatimi, koha dhe forma e rregullave të tilla nuk janë të shpjeguara, me qëllim që të jenë në përputhje me kushtet e njerëzve. Kështu, Sheriati islam për këto çështje, do të thotë marrëveshjet financiare, çështjet juridike, sistemet ekonomike, çështjet kushtetuese dhe administrative ka caktuar rregullat në përgjithësi, ndërsa mjetet dhe detajet e aplikimit ua ka lënë gjyqtarëve e zyrtarëve. Ata i kanë zbatuar me mjete, që janë në përputhje me kohën dhe vendin e njerëzve. Por këto mjete dhe detaje duhet të mos bien ndesh me asnjë tekst apo rregull eksplicite në Kur'an apo sunet.

2. Rregullat që mund të zhvillohen

Rregullat e tilla nuk janë përmendur në Kur'an apo në hadithet profetike apo në ndonjë tekst tjetër eksplicit. Këto rregulla janë temë e ixhtihadit apo detyrë e gjykimit në raste të veçanta, në përputhje me kohën dhe vendin. Ixhtihadi duhet të praktikohet nga dijetarët kompetentë, intelektualë dhe të devotshëm. Ata duhet të gjykojnë duke iu referuar rregullave që janë më afër interesit të njerëzve, në përputhje me jetën moderne dhe progresin shkencor. Për shembull, çështjet si sigurimi pensional për punëdhënës e punëtorë, largimi nga puna dhe kompensimi për familjen e një punëtori kërkon dijetarë kompetentë që të japin mendimin e Islamit, duke u bazuar në interesin e njerëzve, në pajtim me zhvillimin dhe qëllimin e Sheriatit. Prandaj, dijetarët e jurisprudencës islame thonë: "Këto rregulla mund të ndryshojnë në përputhje me kohët moderne".

3. Rregullat që nuk mund të përtërihen apo të zhvillohen

Këto rregulla janë përmendur në tekste eksplicite në Kur'an dhe hadithet e Muhamedit a.s. siç janë çështjet e besimit, shtyllat e fesë, rregullat lidhur me adhurimin, ndalimin e shkeljes së kurorës, kamatën, verën, bixhozin dhe vrasjen. Gjithashtu këto caktojnë kohën që duhet të presë gruaja pas divorcit apo vdekjes së burrit, dhe ndalon heqjen e mbulesës etj. Në këto rregulla nuk ka ixhtihad, ndryshim,

apo modifikim. Mendimi i dijetarëve islamë lidhur me këto rregulla nuk pranohet. Qëllimi që fshihet pas këtyre rregullave nuk mund të kuptohet nga mendja e njeriut. Arsyeja për ndalimin e ixhtihadit në këtë rast është të parandalojë ndryshimin, shtrembërimin apo modifikimin e Sheriatit. Kushdo që provon të ndryshojë apo të modifikojë Sheriatin llogaritet renegat. Prandaj, juristët thonë: "Nuk ka ixhtihad në rregullat që nxirren nga tekstet eksplicite".

Indikacionet që Sheriati mund të përtërihet dhe të zhvillohet që të jetë në përputhje me çdo kohë, do të thotë që rregulla të reja mund të nxirren apo tekstet eksplicite islame. Për shembull:

- Dëmi mund të largohet
- Dëmi nuk mund të zëvendësohet me një dëm tjetër
- Dëmi personal duhet të ndërmerret për të parandaluar dëmin publik
- Domosdoshmëria nuk njeh ligj
- E lejuara për shkak të nevojës është përshkruar sipas domosdoshmërisë
- Parandalimi i dëmit është shumë më mirë se të arrihet interesi

A thua vallë a e kupton rinia jonë se si mund të përtërihet Sheriati dhe të zhvillohet gjatë kalimit të kohës?

V. Balanca mes jetës në këtë botë dhe në jetën e përjetshme

Sheriati islam nuk dallon mes qenies fizike dhe shpirtit e as mes jetës në këtë botë dhe në botën tjetër. Madje, jetën e sheh si një tërësi të njësuar mes të drejtës së njeriut ndaj Zotit të tij, ndaj vetvetes dhe tjerëve. Në këtë mënyrë, njeriu mund të punojë shumë dhe të praktikojë realitetin e jetës bazuar në mësimet islame, të cilat janë në përputhje me natyrën dhe realitetin e jetës.

Islami, i cili është mënyrë jetese e harmonizuar, ndalon humbjen, murgjërinë dhe izolimin shoqëror. Në të njëjtën kohë, e ndalon njeriun që të zhytet në jetën materiale dhe të injoron të drejtën ndaj All-llahut dhe jetës në botën tjetër. Madje, e nxit që të bëjë ekuilibër, do të thotë

të plotësojë të drejtën që ka ndaj All-llahut, të drejtat ndaj vetes dhe të drejtat ndaj tjerëve, duke mos parapëlqyer ndonjë nga tri këto të drejta.

Kur'ani e thekson ekuilibrin mes qenies fizike dhe shpirtit në shumë ajete, dhe iu drejtohet emocionit e mendjes. Për shembull, All-llahu xh.sh. i përkujton njerëzit të kryejnë obligimet fetare edhe nëse janë të zënë me vepra dhe transaksione ditore.

- E rekomandon njeriun që të tregtojë, të punojë dhe të kryejë ritet e adhurimit në të njëjtën kohë:

"Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet". *(en-Nurë: 37)*

- Gjithashtu Kur'ani i rekomandon njeriut të tregtojë dhe të punojë pas faljes së namazit:

"E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e All-llahut…". *(el-Xhumua: 10)*

- Na rekomandon që të kërkojmë këtë botë dhe botën tjetër:

"Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko *(ta fitosh)* ***botën tjetër, e mos lë mangut atë që të takon nga kjo botë…".*** *(el-Kasas: 77)*

- I dënon ata që ndalojnë atë që All-llahu xh.sh. e ka lejuar:

"Thuaj: "Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet?" Thuaj: "Ato janë në këtë botë për ata që besuan , e në ditën e Kijametit janë të posaçme për ta…". *(el-A'rafë: 32)*

Qëllimi i këtyre rregullave është që vetëm të bëjë ekuilibër mes jetës shpirtërore të njeriut dhe mes jetës së kësaj bote e jetës së botës tjetër.

Në shumë raste, Muhamedi a.s. ka hedhur poshtë izolimin e murgjërinë, ngase e dinte që natyra dhe instinkti i njeriut duhet të jetë i rafinuar dhe i kënaqur. Muhamedi a.s. nuk dëshironte nga ne që të

kalojmë kufijtë e natyrës sonë dhe të mos largohemi nga rruga e drejtë e jetës, e ekuilibruar dhe e matur.

Muhamedi a.s. e ka theksuar këtë në shumë hadithe. Për shembull, tre njerëz shkuan te gratë e tij që të pyesin për veprat e tij. Një prej tyre tha: "Unë do të falem gjatë gjithë natës". I dyti tha, "Unë do të largohem nga gratë dhe kurrë nuk do të martohem". I fundit tha, "Unë do të agjëroj vazhdimisht dhe kurrë nuk do të prish agjërimin". Më vonë, Muhamedi a.s. erdhi dhe kuptoi se çka kishin thënë. Muhamedi a.s. iu përgjigj, *"Vërtet, betohem në All-llahun që prej juve, unë më së shumti kam frikë All-llahun dhe jam më i devotshmi. Megjithatë, agjëroj dhe e prish agjërimin, falem dhe fle, dhe jam i martuar. Prandaj, kushdo që largohet nga rruga ime nuk është prej pasuesve të mi".*

Ai gjithashtu e qortoi Abdullah ibn Amr ibn Asin kur ky i braktisi kënaqësitë e kësaj bote (do të thotë refuzoi të hajë mish, të flejë dhe të ketë marrëdhënie seksuale me gruan e tij). Muhamedi a.s. iu përgjigj, *"O Abdullah, unë jam shembulli më i drejtë për ty dhe unë falem, ha mish, fle dhe kam marrëdhënie seksuale. O Abdullah, All-llahu xh.sh. ka të drejtë mbi ty, ti vetë ke të drejtë dhe familja jote ka të drejtë. Prandaj, jepi çdokujt të drejtën e tij".*

Në përfundim, Islami është fe e natyrës së lindur të njeriut, ekuilibër dhe maturi. Ai përmban parime konstante dhe rregulla të përshtatshme për jetë të përditshme që të formojë personalitet të integruar. Nuk ka ekzagjerim e as neglizhencë madje edhe në kryerjen e namazeve. Ky është ligji i All-llahut, prandaj më trego ligjet e të tjerëve. Megjithëkëtë, njerëzit e padrejtë i kanë shpërfillur shenjat e All-llahut xh.sh.

VI. Ekuilibri mes interesit të individit dhe shoqërisë

Sheriati islam ka vendosur rregulla të koordinuara dhe të harmonizuara mes jetës së individit dhe të shoqërisë. Ai e thekson nderin e individit dhe përgjegjësinë e tij para All-llahut xh.sh., vetes dhe shoqërisë së tij. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ndalni ata, sepse do të merren në përgjegjësi". (es-Safatë: 24)

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". *(el-Israë: 36)*

Gjithashtu Sheriati islam i mbron të drejtat themelore të njeriut, do të thotë të drejtën për jetë. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni *(nga mbytja e njëri tjetrit)".* ***(el-Bekare: 179)***

I jep çdokujt të drejtën e besimit. All-llahu xh.sh. thotë:

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota…". *(el-Bekare: 256)*

E thekson të drejtën e edukimit.

"…Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?..." *(ez-Zumer: 9)*

I jep njeriut të drejtën e barazisë.

"… s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)****…".*** *(el-Huxhuratë: 13)*

E thekson të drejtën e pronësisë. All-llahu xh.sh. thotë:

"…jepuni nga pasuria që u ka dhënë All-llahu juve…". *(en-Nurë: 33)*

E thekson të drejtën e respektit:

"O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër…". *(el-Huxhuratë: 11)*

Këto janë të drejtat themelore të çdo njeriu. I ndalohet çdokujt t'i cenojë apo t'i shkelë ato.

Ndërsa sa i përket mbrojtjes së jetës shoqërore, Sheriati islam te secili e ngulit ndjenjën e përgjegjësisë për shoqërinë e tij. E këshillon që të jetë pajtues mes shokëve të tij brenda aktiviteteve shoqërore, përgjegjës për mbrojtjen e opinionit publik dhe kontribuues në përkrahjen e shoqërisë. I rekomandon që të thërrasë për interesat e shoqërisë. Këto rekomandime janë konfirmuar në ajetet vijuese:

"Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë". *(et-Tevbe: 71)*

Muhamedi a.s. ka theksuar faktin që të dy anët, do të thotë individi dhe shoqëria kanë të drejta ndaj njëri-tjetrit dhe se duhet t'i përmbushin ato. Ai dëshiroi të sigurohet për rolin e çdo myslimani ndaj kriminelëve dhe devijuesve me qëllim të mbrojtjes së besimit të shoqërisë lidhur me politeistët dhe tiranët, dhe të arrijë autoritetin e nderin për umetin islam. Buhariu transmeton nga Nu'man ibn Beshir që Muhamedi a.s. ka thënë:

"Shembulli i njeriut që i përmbahet urdhrave dhe ndalesave të All-llahut xh.sh. në krahasim me atë që nuk iu përmbahet i ngjan shembullit të një grupi njerëzish të cilët hedhin short për ulëset e tyre në barkë. Disa prej tyre marrin ulëset në pjesën e sipërme dhe të tjerët në pjesën e poshtme. Kur këta të fundit kanë nevojë për ujë, duhet të shkojnë sipër për të marrë ujë (dhe kjo u sjell telashe tjerëve), andaj thonë, le të hapim një vrimë në pjesën tonë të anijes që të mos i bezdisim ata që janë mbi ne. Nëse njerëzit që janë në pjesën e sipërme do t'i lejonin të tjerët për atë që kanë vendosur, atëherë të gjithë do të vdisnin, e po t'i ndalonin (nga ky veprim) të dy grupet do të shpëtonin".

Namazet i edukojnë myslimanët të jenë përgjegjës ndaj të tjerëve dhe të jenë të kujdesshëm në interesin e ndërsjellë dhe të shoqërisë. Për shembull:

- Namazi duhet të falet bashkërisht pesë herë në ditë. Kjo sigurisht se i jep arsye sistemit shoqëror, solidaritetit dhe bashkëpunimit.

- Zekati është detyrim për çdo mysliman nëse posedon sasinë e kërkuar apo nisabin. Ai është e drejtë e shoqërisë.
- Agjërimi është vepër fisnike dhe shoqërore, e cila e shtyn agjëruesin të paguajë të drejtën ndaj të varfrit, jetimit dhe udhëtarit.
- Haxhi është edukim shoqëror që i nxit haxhilerët të bashkëpunojnë, të këshillojnë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë në tregtinë e ndërsjellë.
- Xhihadi në Islam është obligim për çdonjërin, me qëllim të mbrojtjes së ekzistencës së umetit dhe shtetit islam.

Edukimi shoqëror në Islam është mënyrë e sigurt përmes së cilës njëri kujdeset për të drejtat e tjerëve, do të thotë të drejtat e prindërve, të drejtat e të afërmve, të drejtat e fqinjëve, të drejtat e mësuesve, të drejtat e shokëve dhe të drejtat e të moshuarve. Gjithashtu është mjet praktik për t'iu bashkuar sjelljeve publike siç është etika e të ngrënit, përshëndetjes, kërkimit të lejes, takimit, dialogut, shakasë, urimit dhe ngushëllimit.

Në përfundim, sheriati islam ka një ligj të harmonizuar, i cili urdhëron që çdo njeri ka të drejta ndaj shoqërisë dhe që shoqëria ka të drejta ndaj tij. Që të dy, individët dhe shoqëria duhet të përmbushin detyrimet e tyre dhe të marrin të drejtat e tyre. Kjo vendos ekuilibër, koordinim dhe harmoni mes tyre, i vendos kufijtë e duhur për ta dhe i ruan me vendosmëri lidhjet mes tyre.

Nëse ndonjë mosmarrëveshje ndodh mes interesit të individit dhe interesit të shoqërisë, Islami i jep përparësi interesit të shoqërisë. Prandaj, dijetarët e jurisprudencës islame kanë vendosur këtë rregull: "Nëse ka mosmarrëveshje mes interesit të individit dhe interesit të shoqërisë, atëherë ky i fundit ka përparësi".

A e kupton rinia jonë realitetin e Islamit, i cili e vë në ekuilibër interesin e individit dhe interesin e shoqërisë?

VII. Thjeshtësia, racionalizmi dhe lehtësia

Sheriati islam dallohet me thjeshtësinë, racionalizmin dhe lehtësinë e tij, ngase i urdhëron parimet vijuese të Kur'anit. All-llahu xh.sh. thotë:

"…All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju…". *(el-Bekare: 185)*

"…dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi…". *(el-Haxh: 78)*

"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij…". *(el-Bekare: 286)*

"…e kush shtrëngohet *(të hajë nga këto)* ***duke mos pasur qëllim shijen dhe duke mos tepruar, për të nuk është mëkat…".*** *(el-Bekare: 173)*

Këto ajete kur'anore e konfirmojnë faktin që Islami nuk e ngarkon njeriun mbi mundësitë e tij e as nuk i imponon përgjegjësitë mbi aftësinë e tij. Madje, të gjitha këto mësime dhe përgjegjësi mund të kryhen me lehtësi nga njeriu. Arsyeja pas kësaj qëndron në pamundësinë e ndonjë justifikimi nga njeriu në Ditën e Gjykimit, që të arsyetohet për braktisjen e këtyre mësimeve.

Shembujt vijues janë konfirmim për lehtësinë e Sheriatit islam.

- Islami e bën haxhin të obligueshëm për çdo mysliman, i cili është i aftë financiarisht dhe fizikisht ta kryejë atë. Haxhi duhet të kryhet një herë në jetë.
- E obligon zekatin ndaj të pasurit, i cili duhet të paguajë 2.5 % të pasurisë së tij nëse posedon nisabin apo sasinë e kërkuar për të paguar zekatin dhe atë një herë në vit.
- URDHËRON për faljen e pesë namazeve në ditë. Myslimani duhet t'i kryejë në kohët e caktuara në çdo vend që ndodhet. Ai mund të marrë tejemum nëse nuk gjen ujë. Ndërsa i gjymtuari mund ta falë namazin në mënyrën më të lehtë që mundet. Gjithashtu Islami lejon myslimanin të shkurtojë namazin e katër rekateve në dy re-

kate në rast të udhëtimit. E lejon myslimanin që të bashkojë dy namazet në një, nëse është i sëmurë apo udhëton.

- E urdhëron myslimanin të agjërojë muajin hënor të kalendarit Islam, do të thotë Ramazanin. E lejon të prishë agjërimin nëse është i sëmurë apo udhëton.
- E lejon myslimanin të pijë alkool apo të hajë mishin që zakonisht nuk është i lejuar, nëse është në nevojë të madhe për të. Dijetarët e jurisprudencës islame kanë vendosur këtë rregull: "Domosdoshmëria nuk njeh ligj" dhe "çka është e lejuar për nevojë është bërë në përputhje me këtë nevojë".

Mësimet e Sheriatit islam janë të thjeshta dhe të qarta deri në atë shkallë që çdo mendje e zgjuar mund të kuptojë dhe t'i përgjigjet. Ajo që pason është konfirmim i thjeshtësisë dhe racionalizmit të sheriatit islam.

- E urdhëron njeriun të mendojë, të përfill dhe të meditojë me qëllim që të arrijë bazat e besimit për ekzistencën e All-llahut dhe të pranojë Njëshmërinë e Tij.
- Vendos marrëdhëniet mes Krijuesit dhe të krijuarit të bazuara në besimin që All-llahu xh.sh. është Zoti i të gjitha gjërave, Suprem ndaj robërve të Tij, Plotësues i lutjeve kur robi kërkon dhe i Aftë të bëj çdo gjë.
- E lufton paragjykimin, priftërinë, besimin të Trini dhe idenë e ndërmjetësimit mes All-llahut dhe krijesave të Tij, dhe i qorton ata të cilët i mashtrojnë njerëzit të cilët kërkojnë rrëfim, privilegj dhe hyrjen në xhenet e mbrojtjen nga zjarri i xhehenmit.
- E pranon pendimin nga çdokush në çdo kohë pavarësisht krimeve dhe mëkateve të tyre. Porta e pendimit është gjithmonë e hapur për të penduarin pa pasur nevojë për ndonjë ndërmjetësues.
- Lidh besimin me jetën e kësaj bote dhe besimin me punë të mira. Mysliman i vërtetë është ai, i cili kontrollon gjuhën dhe duart e tij nga lëndimi i njerëzve. Besimtar i vërtetë është ai, i cili ruan pasurinë, nderin dhe jetën e njerëzve.
- Urdhëron që dashamirësia dhe sinqeriteti në vepra është kusht për çdo punë apo vepër të pranuar nga All-llahu. Kjo, sepse nëse si-

nqeriteti është prezent dhe praktikohet përherë, punën ose veprat e zakonshme i transformon në adhurim dhe bindje ndaj All-llahut xh.sh. Prandaj, dijetarët e jurisprudencës islame kanë vendosur këtë rregull: "Sinqeriteti i bën veprat si adhurim". Kjo është thjeshtësia, lehtësia, racionalizmi dhe realiteti i thjeshtë i Sheriatit islam. Pas kësaj, në çfarë paraqitje do të besojnë?

VIII. Kompletimi, vula dhe dominimi

Sheriati islam është zbritur që të jetë i kompletuar, mbizotërues dhe vula e të gjitha legjislacioneve hyjnore të mëparshme.

I - Dallohet me kompleksi, pasi që përmban mësimet e të dërguarve dhe profetëve të mëparshëm, të cilat janë në përputhje të plotë me mesazhin final të Islamit.

Kur'ani në shumë ajete vendos rregulla për myslimanët nga mësimet e të dërguarve të mëparshëm. Gjithashtu i kështillon myslimanët të besojnë në këta të dërguar, në shpalljen dhe librat e tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ai u përcaktoi juve për fe atë që i pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. *(I porositëm)* ***Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të…".*** *(esh-Shura: 13)*

"O ju që besuat, besoni vazhdimisht All-llahut të dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pati zbritur më parë. Kush nuk i beson All-llahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg". *(en-Nisa: 136)*

"Thuaj: "Ne i kemi besuar All-llahut, edhe asaj që na u zbrit neve edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që u është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar". *(Ali Imran: 84)*

Muhamedi a.s. në shumë raste ka pohuar faktin që është dërguar të paraqesë dhe të përfundojë të gjitha karakteristikat fisnike dhe se ai është i dërguari i fundit. Transmetohet nga Muslimi se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Ngjashmëria mes meje dhe të dërguarve para meje i ngjason njeriut cili ka ndërtuar një shtëpi të bukur dhe madhështore, por mungon një tullë në një prej qosheve të saj. Njerëzit do ta shikojnë, do ta vlerësojnë shtëpinë, por do të thonë: Pse edhe një tullë nuk është vendosur atje? Dhe unë jam ajo tullë dhe unë jam i fundit i profetëve".*

Është i njohur fakti që të gjitha shpalljet e profetëve janë në pajtueshmëri në parimet vijuese:

- Janë në pajtueshmëri në Njëshmërinë e All-llahut, i cili nuk ka shok apo homolog.
- Që të gjitha thërrasin për besimin në engjëjt, librat, të dërguarit dhe Ditën e Kijametit.
- Të gjitha janë në pajtueshmëri rreth pastrimit e reformimit të vetvetes dhe përkrahjes së tipareve fisnike.
- Janë në pajtueshmëri rreth adhurimit të All-llahut të Madhërishëm dhe lirimit të njeriut nga adhurimi i ndonjë prej krijesave të tij.
- Janë në pajtueshmëri në vendosjen e paqes, sigurisë, mëshirës dhe nxitjen e njerëzve të bëjnë vepra të mira dhe ndalimin e tyre nga bërja e veprave të këqija.

Kur'ani iu referohet këtyre parimeve. All-llahu xh.sh. thotë:

*"**Thuaju** (o i Dërguar): "**O ithtarë të librit** (Tevrat e Inxhil), **ejani** (të bashkohemi) **te një fjalë që është e njëjtë** (e drejtë) **mes nesh dhe mes jush. Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zot pos All-llahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë** (besuam Një Zot)**!"** (Ali Imran: 64)*

*"**Ata** (ithtarët e librit) **nuk janë të njëjtë. Nga ithtarët e librit ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e All-llahut duke u lutur. I besojnë All-llahut dhe ditës së Gjykimit, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat, përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve. E çfarëdo të mire që bëjnë, ajo*

nuk u mohohet. All-llahu i di shumë mirë të devotshmit". (Ali Imran: 113-115)

II. Është sheriati i fundit, sepse përmban të gjitha karakteristikat dhe pjesët përbërëse të një ligji të kompletuar, do të thotë fleksibilitetin, përtëritjen dhe gjithëpërfshirjen. Kjo është ajo që e bën ligj dhe mesazh të përhershëm deri në Ditën e Kijametit. Më herët kemi cekur disa prej këtyre karakteristikave dhe pjesëve përbërëse.

Kur'ani konfirmon përjetësinë dhe tërësinë e tij.

"…Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe…". *(el-Maide: 3)*

"Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve…". *(el-Ahzabë: 40)*

Gjithashtu kemi cekur më lart fjalët e Muhamedit a.s.: *"Unë jam kjo tullë dhe profeti i fundit".*

III. Sheriati islam dallohet edhe me udhëheqjen mbi shpalljet tjera të mëparshme, ngase i abrogon ligjet e shpalljeve të mëparshme dhe i plotëson ato me sheriatin islam. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne edhe ty** (Muhamed) **ta zbritëm librin** (Kur'anin) **e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantues i tyre…". *(el-Maide: 48)*

"Ai është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fe, e mjafton All-llahu dëshmitar". *(el-Fet'h: 28)*

Prandaj, secili pavarësisht fesë, racës apo ngjyrës duhet të besojë në thirrjen islame dhe t'u bashkohet mësimeve të tij.

"E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit". *(Ali Imran: 85)*

Më herët e kemi specifikuar faktin që ithtarëve të librit do t'u paraqiten prova kundër tyre për arsyet vijuese:

- All-llahu xh.sh. i ka urdhëruar në Tevrat dhe Inxhil që të pasojnë profetin analfabet, Muhamedin a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

***"Që pranojnë të dërguarin** (Muhamedin), **pejgamberin arab** (që nuk shkruan as nuk lexon), **të cilin e gjejnë të cilësuar** (të përshkruar me virtytet e tij), **te ata në Tevrat dhe në Inxhil…".** (el-A'rafë: 157)*

- Profetizimi i Muhamedit a.s. dhe besimi në të është deklaruar dhe vërtetuar nga murgjit dhe rabinët si Abdullah ibn Seleme, Zejd ibn Su'na, Nexhashiu, murgu Bahira[1] dhe të tjerë.
- All-llahu xh.sh. i urdhëron në Kur'an që të besojnë Muhamedin a.s. dhe shpalljen e tij. All-llahu x.sh. thotë:

***"O ju që u është dhënë libri, besoni në atë që e zbritën** (Kur'anin) **e që është vërtetues i atij që e keni** (Tevratit), **para se të shlyejmë fytyra** (t'ua fshijmë shqisat) **dhe t'i rrotullojmë ose t'i mallkojmë ata si i mallkuam ata të së shtunës. Urdhri i All-llahut është i kryer".** (en-Nisa: 47)*

***"Përkujtoni** (o ithtarë të librit) **kur All-llahu mori zotimin e pejgamberëve: nga ajo se juve ju desh libër e urtësi, ju pa tjetër do ta besoni dhe ndihmoni pejgamberin që vjen pas juve, e që vërteton atë që ju keni pranë vetes. Tha** (All-llahu): **"A pranuat, a e morët sipër obligim Tim?" Ata thanë: "Ne e pranuam!" Tha** (All-llahu): **"Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju!"** (Ali Imran: 81)*

Shumë prej tyre besuan në Islam pasi që kuptuan realitetin dhe të vërtetën e shpalljes, si dhe shenjat e profetësisë. Kur'ani i referohet këtij fakti:

***"Po edhe nga ithtarët e librit ka që e besojnë All-llahun, e besojnë atë që u është shpallur juve, e besojnë atë që u është shpallur atyre, janë të bindur ndaj All-llahut, dhe argumentet e All-llahut në shpallje nuk i shesin për pak send të kësaj jete, të tillët kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre, e All-llahu është që llogarinë e bën shpejt".** (Ali Imran: 199)*

[1] Ai ishte murg nga Nestoriani, të cilën Muhamedi a.s. e takoi derisa ishte në udhëtim prej Sirisë në Mekë me axhën e tij Ebu Talibin. Ky murg e njohu dhe u bind se ishte Muhamedi a.s. prej shenjave të ndryshme.

Këto janë faktet lidhur me kompletimin, vulën dhe dominimin e Sheriatit islam. A e kupton çdo njeri këtë fakt dhe a beson në këtë?

IX. Origjinaliteti dhe përjetësia

Sheriati islam dallohet edhe me autenticitetin dhe përjetësinë e vazhdueshme të teksteve e burimeve të tij, të cilat nuk janë as të ndryshuar e as të shtrembëruara.

* Kur'ani Fisnik, për shembull është burimi i parë i Sheriatit, për të cilin All-llahu xh.sh. ka garantuar ta ruajë nga shtrembërimi deri në Ditën e Kijametit. All-llahu xh.sh. thotë:

***"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij".** (el-Hixhr: 9)*

Që katërmbëdhjetë shekuj, nuk ka ndodhur asnjë ndryshim apo shtrembërim në fjalët, kuptimet apo leximet e Kur'anit. Ndihem shumë i kënaqur kur dëgjoj një Kur'an që lexohet në radiot kudo në botë. Padyshim, fakti i ekzistimit të një Kur'ani që lexohet kudo në botë e rrit origjinalitetin dhe autenticitetin e Kur'anit gjatë gjithë historisë dhe periudhave.

Armiqtë e Islamit gjatë gjithë historisë janë përpjekur të shtrembërojnë, ndryshojnë dhe të ndërrojnë qoftë edhe një fjalë, por kanë dështuar të arrijnë këtë qëllim të tyre të lig. Bota e di dhe historia dëshmon për faktin që përpjekjet e tyre skandaloze kanë dështuar. Madje, skandali, turpi dhe mallkimi i historisë kanë rënë mbi ta. Mendimtarët e drejtë të Perëndimit gjithashtu kanë dëshmuar për origjinalitetin dhe përjetësinë e Kur'anit. Ata i kanë shprehur këto fjalë të drejta dhe i kanë zbuluar faktet me sinqeritet. Prej tyre është prof. Ronald Nikolson në librin e tij "Historia letrare e arabëve". Ai ndër të tjera thotë: "Kur'ani Fisnik është i mrekullueshëm dhe dokument njerëzor, i cili me saktësi shpjegon sekretin e veprave të Muhamedit a.s. gjatë jetës së tij. Në të gjejmë tema përmes së cilave ndjekim historinë e Islamit. Tema të tillë nuk ekziston në Budizëm, Krishterim apo në ndonjë fe tjetër".

* Syneti (hadithet) i Muhamedit a.s. është burimi i dytë i sheriatit islam. Ai e shpjegon dhe e plotëson atë. All-llahu xh.sh. ka hapë rrug-

ën për të që të regjistrohet nga dijetarët dhe të ruhet nga degjeneruesit, të cilët dëshirojnë ta shtrembërojnë atë. Këta dijetarë kishin aftësi gjeniale dhe ishin të saktë në regjistrimin e tyre sa që arritën nivelin e autenticitetit të hadithe, duke njohur zinxhirët e transmetuesve dhe tekstin e një hadithi dhe transmetimin e tij. Prandaj, suneti ka arritur deri te ne në gjendje të pastër, i ruajtur nga shtrembërimi apo ndryshimi. Nëse u kthehemi librave dhe referencave të hadithit, atëherë do të njohim nivelin e autenticitetit dhe dobësisë së hadithit. Këto referime të sakta dhe libra janë rezultat i punës së dijetarëve të hadithit gjatë gjithë periudhave. Ngjarja vijuese e vërteton thënien tonë. Kur një prej halifëve abasij dëgjoi që një jobesimtar ka trilluar hadithe dhe ia ka atribuar Muhamedit a.s., dërgoi ushtarë për ta vrarë. Para vdekjes së tij, ateisti i tha halifës: "Kam trilluar shumë hadithe. Pavarësisht faktit që Muhamedi a.s. nuk i ka thënë asnjë prej tyre, ju do t'i merrni dhe gjërat e palejueshme do t'i bëni të lejueshme dhe anasjelltas. Halifja iu përgjigj: "O ateist, Ebu Is'hak el-Fazari dhe Abdullah ibn Mubareku (prej dijetarëve të njohur të asaj kohe) do t'i pastrojnë ato dhe do t'i largojnë shtrembërimet". Pastaj urdhëroi që të vritet. Kjo është origjinaliteti i Sheriatit dhe përjetësia e burimeve të tij gjatë gjithë kohëve dhe periudhave.

X. Drejtësia absolute

Çdo person i arsyeshëm e di që qëllimi kryesor i Sheriatit islam është përhapja e drejtësisë mes njerëzve, arritja e vëllazërisë mes tyre dhe mbrojtja e pasurisë, nderit dhe gjakut të njerëzve. Kështu, qëllimi i vetëm i Sheriatit është të arrijë interesat e njerëzve në këtë botë dhe në botën tjetër.

Qëllim i tij nuk është arritja e interesave të ndonjë klase të veçantë dhe lënia e tjerëve, apo arritja e interesave të një race ndaj tjerave, apo një kombi më shumë se tjerëve. Gjithashtu nuk është qëllim i tij arritja e interesave të kësaj bote dhe lënia e interesave të botës tjetër ashtu siç bëjnë ligjet e sotme apo arritja e interesave të botës tjetër dhe lënia e interesave të kësaj bote siç bëjnë shumë religjione tjera.

Është e pamundur për njeriun të arrijë dhe t'i pëlqejë të gjitha këto elemente në ligje, ashtu siç kërkojnë të arrijnë drejtësinë dhe kjo kërkon njohurinë, mëshirën dhe mençurinë e All-llahut xh.sh. Njeriu gjithmonë i shikon çështjet dhe problemet vetëm nga një perspektivë dhe i neglizhon të tjerat, derisa All-llahu xh.sh. i shikon gjërat nga të gjitha anët, pasi që Ai është Krijuesi, i Gjithëdijshmi, i cili e mbush tokën me mëshirë, mençuri dhe dituri. All-llahu xh.sh. thotë:

"A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë". *(el-Mulk: 14)*

Lidhur me këtë perspektivë gjithëpërfshirëse të Islamit, e cila synon formimin e një personaliteti të plotë e të fuqishëm, dijetarët e jurisprudencës thonë: "Sheriati islam synon arritjen e pesë qëllimeve: mbrojtjen e fesë, mbrojtjen e shpirtit, mbrojtjen e mendjes, mbrojtjen e pasardhësit dhe mbrojtjen e pasurisë". Gjithashtu ata kanë shtuar: të gjitha parimet, rregullat, urdhrat, ndalesat dhe dënimet e sheriatit të cilat kanë si synim mbrojtjen e këtyre pesë qëllimeve. Kjo e konfirmon faktin që Sheriati është legjislacion që synon arritjen e interesit publik dhe drejtësisë absolute në jetën e kësaj bote dhe në jetën e botës tjetër. Atëherë, a e kupton rinia jonë pikëpamjen e Islamit në formimin e personalitetit human dhe të një shoqërie fisnike?

Në përfundim:

- Sheriati islam dallohet me karakterin hyjnor, universalizëm dhe gjithëpërfshirje.
- Dallohet me përtëritje, zhvillim dhe vazhdimësi.
- Ekuilibron mes kësaj jete dhe jetës në botën tjetër.
- Ekuilibron mes interesave të individëve dhe të shoqërisë.
- Gjithashtu dallohet me lehtësi, thjeshtësi dhe racionalizëm.
- Dallohet me kompletim, vulë dhe dominim.
- Dallohet me origjinalitet, konsistencë dhe përjetësi.
- Dallohet me drejtësinë absolute për njeriun.

Nëse Sheriati islam dallohet me këto karakteristika, atëherë e meriton të jetë ligj i përjetshëm, pasi që njeriut i jep nderin, lartësinë, i dhuron dritat e drejtësisë, mirësjelljes dhe diturisë, e ndihmon njerëzi-

min me udhëzim, edukim dhe civilizim, dhe e vë kufirin për lavdi, madhështi dhe vazhdimësi.

***"…juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë. All-llahu e vë me atë** (me Kur'anin) **në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë". (el-Maide: 15-16)*

- vijon -

Abdullah Nasih Ulvan

ISLAM – THE LAW OF LIFE

(Summary)

There is great joy in the fact that Muslims can find fellow-believers throughout the Muslim world saying:

"We want Islam to be the system through which we rule, our way of living, and we want the Qur'an to be our constitution. We want to regain our glory".

Yet, there are others who are hostile towards Islam, who accuse Islam of backwardness. Who are those who invite people to give up their religion?

They are malevolent Orientalists, atheists, crusaders, masons, communists or colonialists. Unfortunately, a number of ignorant Muslims, who have little knowledge of Islam, have been deceived by such calls.

عبدالله ناصح علوان

الاسلام – شريعة الحياة

(خلاصة البحث)

مدخل:

المسلمون يشعرون بسعادة كبيرة عندما يجدون في جميع انحاء العالم الاسلامي أخوة لهم الذين يقولون: نريد ان يكون الاسلام هو نظام حياتنا و ان يكون القرآن الكريم شريعة و دستور الدولة. نريد ان نعيد عزتنا و وكرامتنا السابقة.

و لكن إلى جانب هذه الدعوات هناك دعوات مضادة من قبل الأعداء الاسلام الذين يتهمونه بالتأخر و عدم مسايرة المعاصرة. و من هؤلاء العداد الذين يحرضون الناس على التخلى عن الاسلام. غالبيتهم من المستشرقين و الملحدين و الصلبيين و اعضاء الحركات الماسونية و الشيوعيين و آخرون. مع الاسف ينتمى إلى هذه الفئة عدد من المسلمين الجهلة (يحملون اسماء اسلامية فقط) و لديهم معلومات قليلة جدا عن الاسلام وو لا يعرفون شيئا عنه و هم عادة يكونوا ضحايا هذه الدعوات المغرضة.

JURISPRUDENCA ISLAME

Dr. Mahmud Halil

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE NË KUSHTETUTËN E SHTETIT ISLAM

Islami i ka dhënë rëndësi të madhe marrëdhënieve të jashtme dhe ndërkombëtare. Që nga fillimi, Muhamedi a.s. ka vendosur marrëdhënie të mira me mbretërit e princërit e shteteve joislame dhe çdo çlirimi iu paraprijnë marrëdhëniet dhe delegacionet e ndryshme. Muhamedi a.s. ka përdorë ndërmjetësimin, autorizimin dhe delegimin në disa punë në këto shoqëri, pasi që detyrat e ligjshme në shoqëritë jomyslimane nuk mund të kryhen në formën më të mirë të mundshme vetëm se në këtë mënyrë. Dhe këtu fshihet rëndësia e marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërmjetësimit dhe ndërrimit të ambasadorëve. Por, ajo që është më e rëndësishme është fakti se pas marrëdhënieve ndërkombëtare qëndron interesimi i Islamit për arritjen e sigurisë për ata që jetojnë në shoqëritë jo islame.

Domosdoshmëria e ekzistimit të ambasadorëve dhe vendosja e marrëdhënieve të jashtme në Islam

Për vendosjen e marrëdhënieve të jashtme me shoqëritë jomyslimane dhe ndërrimin e ambasadorëve me to dallohen një grup arsyesh. E në krye të tyre është ndalimi i ngatërresave në fe, ngase myslimanët në çdo shtet jomysliman janë në të vërtetë në ballë të thirrjes brenda saj. Islami me këtë kërkon që të jenë shembull të gjallë për drejtësinë e tij si sistem hyjnor i drejtë. Por, Islami nga ana tjetër nuk e lë mishërimin e shembullit të tij pa privilegj apo mbrojtje, që të punojnë me të udhëheqësit dhe banorët e këtyre vendeve jomyslimane çka të dëshirojnë prej politikave apo vendimeve, duke plotësuar interesat e tyre kombëtare edhe nëse për këtë kërkohet përdorimi i forcës ndaj këtyre myslimanëve. Lënia e myslimanëve pa mbrojtje është mjerim dhe hedhje në shkatërrim pas të cilës qëndron ngatërresa në fe, e cila është më e rëndë se vrasja. Prandaj urdhrat për largimin e kësaj ngatërrese kanë qenë të qarta edhe qoftë me luftim, derisa tërë adhurimi të bëhet vetëm për All-llahun xh.sh.

"Luftoni ata derisa të mos mbetet idhujtari *(besimi i kotë),* ***e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për All-llahun…".*** *(el-Enfalë: 39)*

Justifikimi i dytë është domosdoshmëria e ndihmës në fe dhe zbatimi i kësaj është i qartë në fjalën e All-llahut xh.sh.:

"…Ata që besuan por nuk u shpërngulën, ju nuk keni përkujdes as ndihmë për ta derisa të shpërngulen edhe ata. E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që me të keni marrëveshje *(nuk mund t'i ndihmoni në luftë kundër atij populli)****…".*** *(el-Enfalë: 72)*

Kushtet e mbështetjes së myslimanëve jashtë kufijve të shtetit islam

Edhe pse ndërhyrja për mbështetjen e myslimanëve jashtë kufijve të shtetit islam është e detyrueshme, megjithatë kjo kushtëzohet me disa kushte:

- **Së pari**: Mbështetja të mos jetë në çështje jashtë fesë për shkak të qartësisë së ajetit kur'anor. E nëse është në ndonjë çështje që nuk ka të bëjë me vlerat e fesë e të ngjashme, atëherë kjo është mbështetje e pavlefshme.
- **Së dyti:** Që mbështetja të mos jetë te një popull jomyslimanë, duke pasur marrëveshje apo traktat mes tyre dhe myslimanëve, sepse Islami i urdhëron myslimanët në këtë rast që t'u përmbahen marrëveshjeve të tyre deri në fund dhe të mos humbin besimin ndaj atyre me të cilët kanë bërë marrëveshje.
- **Së treti:** Duhet që mbështetja e myslimanëve të jetë për shkak se ata janë të dobët në tokë, ose se janë pakicë që kanosen me persekutim apo vuajtje nga shumica ose për shkak se janë të detyruar që të mbesin në mesin e kësaj shumica dhe nuk kanë mundësi që të emigrojnë në shtetin islam. Duhet të kërkohet nga ata justifikim për rënien e domosdoshmërisë së shpërnguljes së tyre në shtetin islam. Është thënë që lufta e parë mes myslimanëve dhe romakëve është zhvilluar për shkak të persekutimit fetar të myslimanëve, pasi që disa banorë të Shamit kishin pranuar islamin dhe më pastaj ishin vrarë nga guvernatori romak i Shamit. Prandaj, Muhamedi a.s. ka dërguar ushtri që t'i mbrojnë dhe t'i ndihmojnë të fitojnë lirinë e tyre.
- **Së katërti:** Nevoja e largimit të padrejtësisë nga myslimani. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ndëshkimi i së keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët. E kush hakmerret për padrejtësitë që i

janë bërë, ndaj të tillëve nuk ka ndonjë përgjegjësi". *(esh-Shura: 40-41)*

Për këtë kemi edhe hadithin profetik: "Ndihmo vëllanë tënd qoftë i padrejtë apo i shtypur. Sahabët thanë: O i Dërguari i All-llahut! Po e kuptojmë që ta ndihmojmë kur është i shtypur, po si ta ndihmojmë kur është i padrejtë? Ndërsa Muhamedi a.s. tha: "Ta ndaloni nga padrejtësia ngase kjo është ndihma ndaj tij".

Ibn Haxheri ka përmendur që mbështetja e të shtypurit është ferd kifaje

"…e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë". *(el-Munafikunë: 8)*

Të drejtat dhe kufizimet e myslimanëve në shoqëritë jomyslimane

Këto kufizime janë përmbledhje e asaj që kanë paraqitur shumë prej dijetarëve në lidhje me atë që gëzon myslimani dhe me çka ngarkohet në këto vende, që t'i sigurojë vetes para se t'i sigurojë atij ummeti të tij përgjegjësinë e ruajtjes së sigurisë së tij dhe respektimin e të drejtave e shenjtërisë së tij.

- **Së pari:** Prej këtyre kufizimeve është respektimi i marrëveshjeve e traktateve të tyre dhe respektimi i zakoneve e ligjeve të tyre sa kohë që nuk ka ndonjë gjë që e ka ndaluar Islami dhe largimi nga tradhtia që të mos i nënshtrohen shkatërrimit. Myslimanët duhet t'u përmbahen kushteve të tyre sa kohë që janë të sigurt që nuk do të sulmohen, duhet të mos e sulmojnë askënd ose përndryshe kanë tradhtuar dhe tradhtia është e ndaluar.
- **Së dyti**: lejohet për myslimanët të bartin të mira të ndryshme te jomyslimanët për tregti, pasi që myslimanët kanë nevojë për këtë.
- **Së treti:** kush ka qëndruar në vendet jomyslimane për shkak të robërisë dhe pastaj është liruar e siguruar, e më pastaj i janë besuar disa punë që t'i drejtojë apo nuk i janë besuar, siguria e jo myslimanëve për të është siguri e tyre për të. Atij nuk i lejohet që të

vret apo të tradhtojë, por i lejohet lufta. E nëse e zë lufta, atëherë i lejohet të mbrojë veten, të vrasë ata që arrin dhe marrjen e pasurisë së vet nëse dëshiron të largohet.

- **Së katërti:** Myslimanët e mbrojtur në vendin jomysliman, kur të fillojë lufta mes tyre dhe vendeve të tjera, duhet të sqarohen para se të caktojnë qëndrimin e tyre. Nëse lufta ka filluar për shkak të sulmit të banorëve të vendit në të cilin jetojnë myslimanët, u obligohet këtyre tjerëve prishja e marrëveshjeve të tyre dhe lufta për të shpëtuar myslimanët nëse janë në gjendje të bëjnë këtë, ngase për myslimanët lënia e vëllezërve të tyre në mëshirën e këtyre agresorëve është si konfirmim i padrejtësisë.
- **Së pesti:** Ka të bëjë me disa transaksione të myslimanëve brenda shoqërive jomyslimane, veçanërisht në fushat e blerjes e huas e të ngjashme. Nëse i krishteri që jeton në shtetin islam i merr hua myslimanit apo i shet apo ndodh e kundërta apo e grabisin njëri-tjetrin dhe dalin nga ky vend në shtetin islam, asnjërit nuk iu kryen obligimet, pasi që jomyslimani në shtetin islam nuk i është nënshtruar ligjeve islame më parë, por më pas. Ndërsa myslimani obligohet që të kthejë gjënë e grabitur nga ky jomysliman, dhe gjithashtu kthimin e borxhit apo zbatimin e ligjeve islame që ndalojnë tradhtinë dhe mbajtjen e premtimeve. Ndërsa kur myslimani del nga vendi jomysliman dhe me vete ka ndonjë gjë që e ka fituar në mënyrë jo të lejuar për shkak të tradhtisë, obligohet që ta japë lëmoshë (sadaka).
- **Së gjashti:** Kur njeriu bëhet mysliman më pas. Nëse ka pranuar Islamin në shtetin jomysliman pastaj ka shkuar në shtetin islam apo nuk ka dalë apo ka dalë në shtetin islam e pastaj ka pranuar Islamin, në të gjitha rastet rezulton që e tërë pasuria e tij që ka pasur në tokën e fundit qoftë pasuri e patundshme apo shtëpi apo tokë apo kafshë apo diçka tjetër prej të mirave në shtëpi apo borxh, të gjitha këto i takojnë atij dhe askush tjetër nuk ka të drejtë për to. Nuk u lejohet myslimanëve që nëse e çlirojnë atë vend dhe dikush ka grabitur ndonjë gjë nga kjo qoftë mysliman, jomysliman në shtetin islam apo mysliman duhet t'ia kthejë pronarit të vërtetë.

Kërkesat më të rëndësishme për sigurinë e ambasadorëve dhe të të dërguarve

- Mund të thuhet që **kërkesa e parë** është domosdoshmëria e sigurisë së tyre, pasi që Muhamedi a.s. u ofronte siguri të dërguarve të idhujtarëve. Kur i erdhën dy të dërguarit e Musejleme el-Kedhabit u tha: "Sikur të mos ishte që të dërguarit nuk vriten, do t'u vrisja". Arsye tjetër është se nevoja e kërkon këtë dhe sikur të vriten të dërguarit e tyre, atëherë do të vrisnin të dërguarit e myslimanëve dhe me këtë do të humbte vlera e të dërguarve. Pasi çështja e luftës apo e paqes nuk mund të arrihet vetëm se me të dërguar, atëherë është e domosdoshme që të sigurohen në mënyrë që të arrihet deri te ajo që kërkohet.
- **Kërkesa e dytë** është vazhdimësia e sigurisë së tyre gjatë gjithë periudhës të qëndrimit të tyre në vendet islame. Pavarësisht se shoqëria politike myslimane nuk e ka njohur sistemin e përfaqësimit politik të përhershëm sikur që është sot, megjithatë dijetarët janë përpjekur që të përballen me këtë çështje, por nuk janë pajtuar se a është siguria për të ambasadorët dhe të dërguarit e pakufizuar apo e kufizuar. Disa e kanë lejuar marrëveshjen për siguri të pakufizuar dhe të kufizuar për disa vite, qofshin të gjata apo të shkurtra, për dallim me armëpushimin, i cili nuk lejohet vetëm se i kufizuar, ngase nëse lejohet e pakufizuar atëherë është obligim për luftë (xhihad). Ndërsa hanefijët dhe shafi'ijët e kanë lejuar renovimin e marrëveshjes për siguri vit pas viti, varësisht se si e kërkojnë interesat e punës dhe të tregtisë.
- **Së treti:** Prej kërkesave të sigurisë së ambasadorëve dhe të dërguarve për daljen nga shteti islam është që të dalin ashtu siç del ai që ka kërkuar mbrojtje. Dhe parimisht nuk duhet të marrë me vete diçka me të cilën do të forcojë jomyslimanët kundër myslimanëve çfarëdo qoftë forma e saj. Ndërsa pasuria e tij nuk lejohet të konfiskohet apo të shpronësohet apo të sekuestrohet dhe falet nga taksat e ndryshme. Përjashtim i kësaj rregulle janë ambasadorët dhe të dërguarit me qëllim të tregtisë, ku me këtë rast u merret 1/10, ndërsa për të mirat tjera nuk u merret asgjë.

- **Së katërti:** Duhet t'u sigurohet siguria gjatë kryerjes së ritualeve fetare. Nuk u kufizohet e drejta e tyre në zbatimin e obligimeve të tyre fetare, ndërsa ndërtimi i kishave të veçanta për ta nuk lejohet, ngase koha e misionit të tij zakonisht është e caktuar. Por, nëse ambasadori dëshiron që të caktojë një vend të veçantë për adhurim në shtëpinë e tij, nuk pengohet nga kjo gjë.

Detyrimet e ambasadorëve

Siguria e ambasadorëve dhe ndërmjetësuesve është e njëjtë si siguria e njerëzve tjerë qofshin myslimanë apo jo myslimanë shikuar nga aspekti i domosdoshmërisë së lidhjes së kërkesave të tij qofshin ndaj myslimanëve apo edhe ndaj vetë atyre. Nga këtu mund të themi që ambasadori apo ndërmjetësi është i obliguar të kthejë atë që ka marrë nga pjesëtarët e shoqërisë myslimanë qoftë pasuri apo të mira para se të bëhet ambasador apo ndërmjetës. Gjithashtu është i detyruar të heqë kompetencat e atyre që nuk e meritojnë brenda territorit mysliman. Obligohet të largohet nga kryerja e veprimeve armiqësore kundër myslimanëve veçanërisht që ka të bëjë me prishjen e sigurisë drejtpërdrejt si spiunimet e ndryshme. Dhe nëse i kupton disa prej sekreteve të myslimanëve, që do të thotë se kur të kthehet te vendi i tij është kthyer me gjëra që do të dëmtojnë myslimanët, ngase do të tregojë për të metat e myslimanëve dhe do t'u sjellë dëme të mëdha. Prandaj, në këtë rast është e drejtë e udhëheqësit mysliman të burgosë të dërguarin vetëm për siguri do të thotë ndalimin e tij dhe pamundësinë që të udhëtojë e jo burgosjen e tij. Por, rezultat i kësaj mund të jetë sipas parimit trajtimi në mënyrë të njëjtë do të thotë ndalimi i ambasadorit mysliman që të kthehet në shtetin islam. Prandaj, është më mirë që në raste të spiunimit ose të shpallet ambasadori person non grata (jo i dëshiruar) në shtetin islam ose që përmes marrëveshjes reciproke që më parë të caktohen disa vepra të cilat do të dënohen. Prandaj, në këtë mënyrë shmanget ndjekja e parimit të trajtimit të njëjtë. Gjithashtu është i obliguar që të mos ndihmojë në prishjen e marrëveshjeve dhe traktateve mes vendit tij dhe shtetit islam. Nuk i lejohet të kundërshtojë sigurinë e ambasadës për shkak të kryerjes së ndonjë gjëje që dëmton myslimanët, pasi që Islami nuk lejon ekzistimin e ndonjë vend të shenjtë në vendet islame vetëm se për disa vende të shenjta, për të cilat kanë dëshmuar burimet e Islamit dhe zakonet e myslimanëve kanë pranuar këtë vend të veçantë që kanë, e ato janë Mekeja dhe Medineja. Por, kjo nuk do të thotë mos marrjen e të gjithë mjeteve të mundshme për mbrojtjen e vendndodhjes së ambasadës kundër çdo sulmi dhe ndalimin e çdo ndryshimi të sigurisë dhe përmirësimin e dinjitetit të saj sa kohë që kryen rolin e saj sipas marrëveshjes apo sipas zakonit.

Përfundimi

Marrëdhëniet e jashtme janë parim themelor në Islam. Islami ka thirrur në vendosjen e marrëdhënieve të mira dhe shtetet jomyslimane. Prandaj, gjejmë që Islami i ka kushtuar rëndësi ambasadës dhe ambasadorëve. Përfundimi rreth kësaj çështjeje është që ambasada sipas kuptimit islam është punë reformuese nga aspekti i mosndarjes së saj nga punët e thirrjes dhe nga nevojat e thirrjes për reformim të punës.

All-llahu xh.sh. thotë:

"E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira…". *(Fussilet: 33)*

Prandaj, qëllimi i ambasadës e nga këtu përmbajtja e saj është reformimi dhe paraqitja e së drejtës në mesin e palëve të saj, i cili është qëllim i çdo thirrjeje të profetëve që është reformimi.

"…unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrijë vetëm me ndihmën e All-llahut…". *(Hudë: 88)*

Dhe në fund, themi që thirrja është proces bashkëveprues që ngrihet mbi gërshetimin e marrëdhënieve dhe bashkëveprimin e tyre në mes shumë palëve dhe ambasadorët janë një prej mjeteve të thirrjes për suksesin e këtij bashkëveprimi. Ata janë pasues në vendet e tyre, të cilët kryejnë punë të ndryshme që kanë për qëllim përhapjen e thirrjes dhe arritjen e sigurisë për myslimanët në shoqëritë jomyslimane.

Përktheu nga arabishtja:
Admir Temja

Mahmud Halil

INTERNATIONAL RELATIONS IN THE CONSTITUTION OF THE ISLAMIC STATE

(Summary)

Islam has placed great importance on international and foreign relations. Since the very beginning, Muhammad established good relations with the leaders of non-Muslim states. The aim of such relations was to guarantee security to Muslims living in non-Muslim states.

محمود خليل

العلاقات الدولية في الدستور الاسلامى

(خلاصة البحث)

ان الاسلام اعطى أهمية كبيرة للعلاقات الخارجية و الدولية، و هذا يتضبح من سلوك الرسول (صلعم) في اقامته علاقات جيدة مع ملوك و امراء الدول غير الاسلامية و اثناء استقباله الوفود التي كانت تأتى اليه من قبائل و أرجاء مختلفة. و كان الرسول (صلعم) يستخدم التوسط و التكليف و التخويل لقضاء بعض الاعمال في تلك المجتمعات و ذلك لانه لم تكن هناك وسيلة أخرى لقضاء هذه الامور في المجتمعات غير المسلمة. و هنا تكمن أهمية العلاقات الدولية و تبادل السفراء. و تكمن أهمية العلاقات الدولية في الاسلام لتوفير فرص العيش الكريم و الآمن للمسلمين في المجتمعات غير المسلمة.

JURISPRUDENCA ISLAME

Osman Nuri Haxhiq

ORGANIZIMI DHE RREGULLIMI I BRENDSHËM I HALIFATIT - SHTETIT ISLAM -

Me të arritur në Medine Muhamedi a.s. menjëherë ia kumtoi popullit këtë shpallje: "Të gjithë myslimanët i takuan ata: kurejshëve, evsit, hazrexhit ose cilitdo fis tjetër arab, përbëjnë një bashkësi nacionale të tillë: popull arab. Kurejshitët të cilët janë vendosur në Medine, muhaxhirët do ta kategorizojnë mes vete taksën dhe do t'i paguajnë gjaqet dhe do t'i lirojnë me kompensim robërit e tyre. Të njëjtën gjë do ta bëjnë edhe fiset Evs e Hazrexh dhe fise tjera arabe. Besimtari që është i varfër dhe nuk është në gjendje për ta paguar gjobën ose çmimin (e gjakut) do të kërkojë ndihmën nga vëllezërit e tij prej feje dhe ata do ta ndihmojnë. Besimtarët e vërtetë nuk guxojnë t'i mbysin vëllezërit e tyre prej feje për shkak të hakmarrjes për jomyslimanin e mbytur. Myslimani nuk guxon kurrë dhe në asnjë rast të jetë në anën e idhujtarëve. Të pasurit dhe të fuqishmit le të respektojnë të varfrit dhe të dobëtit dhe mbrojtjen e Zotit, e cila për të gjithë është e barabartë. Besimtarët janë aleatë të natyrshëm dhe kjo aleancë (lidhje) është më e fuqishme se çdo tjetër. Gjendja e paqes dhe e luftës është çështje e përbashkët e të gjithë myslimanëve. Prandaj, asnjë mysliman nuk guxon krye në vete të lidhë marrëveshje të paqes me armiqtë e Islamit. Asnjë mysliman ose hebre i Medinës nuk guxon për t'i marrë në mbrojtje idhujtarët e Medinës. Hebrenjtë që na bashkohen neve do të jenë të mbrojtur nga çdo ndjekje ose sulm. Ata kanë të drejtë të plotë në ndihmën dhe në shërbimet tona miqësore. Të gjithë hebrenjtë e Medinës bashkë me myslimanët përbëjnë një tërësi nacionale. Ata do të predikojnë lirisht fenë e Musait si dhe myslimanët të veten. Klientët dhe miqtë e hebrenjve të Medinës do të gëzojnë mbrojtjen e plotë sikurse ata vetë. Vetëm ata që bëjnë vepër penale do të jenë të dënuar sipas ligjit. Hebrenjtë bashkë me myslimanët do ta mbrojnë Medinën dhe kur myslimanët zhvillojnë luftë jashtë Medinës me armiqtë e tyre, hebrenjtë e Medinës do të kontribuojnë për shpenzimet e luftës. Medina është vend i vizituar dhe strehimore e sigurt për të gjithë ata që u drejtohet kjo shpallje. Klientët dhe aleatët e myslimanëve dhe çifutëve kanë të drejta të njëjta sikur ata vetë. Të gjithë besimtarët e drejtë duhet gjykuar më së rrepti çdo krim, çrregullim dhe padrejtësi. Askush nuk guxon për të marrë nën mbrojtje kriminelin edhe nëse është më i afërmi i farefisit të tij. Kush e mbyt myslimanin pa arsye ligjore do të jetë i dënuar me vdekje. Të gjithë myslimanët duhet të bashkohen kundër hajdutëve dhe plaçkitësve. Mallkimi i Zotit qoftë mbi secilin, pa dallim, që i ofron kriminelit ndihmë ose strehë. Të gjitha mosmarrëveshjet të cilat do të paraqiten në të ardhmen mes atyre që u drejtohet kjo shpallje, do t'i zgjidhë Muhamedi a.s. sipas ligjeve të Zotit".

Shpallje të ngjashme Muhamedi a.s. u dërgoi edhe hebrenjve që banonin në rreth të Medinës. Mirëpo derisa Muhamedi a.s. ishte angazhuar rreth ndërtimit të xhamisë së Medinës, hebrenjtë, përkundër privilegjeve të tilla të gjëra, filluan fshehtazi të bëjnë intriga kundër tij dhe të ardhurve të Mekës. Ata në mes ensarëve (vendasve) zhvillonin agjitacion të gjallë se muhaxhirët do t'ua marrin jo vetëm pushtetin dhe udhëheqjen, por edhe pasurinë e tyre, kurse për Muhamedin a.s. thoshin se është falltar i thjeshtë. Hebrenjve iu bashkuan edhe disa myslimanë të Mekës të cilët vetëm sa për sy e faqe e kishin pranuar Islamin, kurse në shpirt kishin mbetur idhujtarë. Në krye të këtyre

munafikëve-hipokritëve të cilët i gjykoi ashpër Kur'ani, qëndronte prijësi i Medinës Abdullah bin Ubejje bin Seluli.

Muhamedi a.s. për t'i penguar intrigat e munafikëve i organizoi të gjithë myslimanët në një lloj vëllazërie me të drejtë trashëgimie reciproke. Secili muhaxhir ka pasur në mesin e ensarijve (vendësve) vëllanë e vet, tek i cili banonte, kurse për t'u treguar këtyre të fundit nder të posaçëm, Muhamedi a.s. pranoi të jetë shef-nakib i fisit Benu Nexhar. Kështu që është bërë i pamundur çdo aksioni i munafikëve, kurse Muhamedi a.s. ka mundur t'i përvishet rregullimit të çështjeve më të rëndësishme fetare dhe shoqërore.

Të ardhurat e komunës së re Islame të Medinës, në ditët e para kanë qenë shumë të vogla dhe janë përbërë nga kontributet në para dhe fushë, të cilat i jepnin myslimanët e pasur për mbajtjen e të varfërve. Si ka qenë ajo bashkësi e thjeshtë ideale më së miri është përshkruar në këtë shpallje të Muhamedit a.s. "Kur të vdesë ndonjë mysliman dhe të lërë fëmijë të dobët dhe me borxh, unë e marrë mbi vete kujdesin për fëmijë dhe pagesën e borxhit, kurse nëse lë pas vetes ndonjë pasuri, ajo u takon trashëgimtarëve ligjorë të tij".

Të gjitha kontributet vullnetare Muhamedi a.s. vetë i ndante mes të varfërve dhe nevojtarëve. Pas përfundimit të ndërtimit të xhamisë së Medinës, kah fundi i vitit të dytë të hixhretit është urdhëruar taksa e konsiderueshme fetare në para dhe fushë-zekati. "Faluni dhe jepeni zekatin" (11:43), ka qenë urdhëruar në Meke, dhe vetëm në Medine është aplikuar në praktikë. Përqindjen e tatimit e ka caktuar vetë Muhamedi a.s. kurse Ebu Bekri dhe Omeri r.a. në shkresat e tyre detajisht e kanë rregulluar. Zekati është obligimi i pastër fetar dhe është përcaktuar vetëm për myslimanët, ndërsa lëndët në të cilat paguhet ndahen në dy lloje. Në llojin e parë bëjnë pjesë paratë e gatshme, argjendi e ari, gjërat e çmueshme dhe malli tregtar. Me qëllim që ky obligim fetar të mos i ngarkojë edhe besimtarët e varfër, është vendosur ky princip: Nëse në fund të vitit të hyrat e pastra të një myslimani janë në shumë prej dyqind dërhem argjend të gatshëm, përkatësisht në vlerë të lëndëve të lartpërmendura, atëherë është i obliguar të paguajë 2,5% në emër të zekatit.

Në llojin e dytë bëjnë pjesë kafshët e trasha dhe të imta, e prodhimet e fushës, kurse nga pemët: hurmet, rrushi i thatë dhe ullinjtë. Nga këto lëndë zekati jepet në fushë sipas caktimit të saktë proporcional.

Sipas parimeve të Kur'anit (IX:61) nga fondi i Zekatit kanë mbështetje tetë kategori njerëzish: i varfëri i këputur pa asgjë-mesakin, skamnorë i cili mjetet e veta nuk i mjaftojnë për jetesë të thjeshtë, amilin-tatimbledhësit, paria e Mekes të cilët pas çlirimit të Mekës e pranuan Islamin, por ende gjithnjë është dashur të merren me të mirë dhe t'u zbuten zemrat el-muel-lefetu kulubihim, robërit për blerjen e lirisë së tyre, borxhlinjtë për pagesën e borxhit, nëse ka hyrë borxh nga zori, vullnetarët (që luftojnë në rrugë të Zotit) dhe udhëtarët që nuk kanë mjete. Emri mesakin ka të bëjë njësoj edhe me hebrenjtë e të krishterët, sikur me myslimanët. Prandaj, kjo kategori e të varfërve pa marrë parasysh fenë vetëm nëse janë teist-ehli kitab, kanë të drejtë në mbështetje nga fondi i zekatit.

Pas luftës në Bedër në janar të viti 624, myslimanët për herë të parë arritën te preja e luftës të cilën Muhamedi a.s. e ndau në pjesë të barabarta në mes luftëtarëve. Në shkurt të të njëjtit vit 624, pas konfliktit me fisin çifut Kajnuka dhe shpërnguljes së tyre në Siri, erdhi shpallja për ndarjen e presë së luftës: "Një e pesta e presë së gjithmbarshme të luftës do t'i takojë arkës së shtetit, për mbajtjen e të Dërguarit të Zotit, familjes së tij si dhe për dhënien e ndihmave jetimëve të mitur, të mjerëve dhe udhëtarëve. (VIII:41). Katër të pestat tjera ndaheshin mes luftëtarëve në pjesë të barabarta.

Muhamedi a.s. një të pestën e vet prapë e ndante në pesë: Pjesën e parë për mbajtjen e vetvetes për familjen e tij dhe për qëllime të dobisë së përgjithshme, pjesën e dytë për farefisin e të afërmve të tij, pasardhësit e Hashimit dhe Abdyl-Muttalibit, të cilët kanë qenë të përjashtuar nga marrja e mbështetjes nga fondi i Zekatit, pjesën e tretë për mbajtjen e jetimëve, pjesën e katërt për mesakin, atyre të varfërve të cilëve mjetet tjera nuk iu mjaftonin për jetesë, kurse pjesën e pestë për udhëtarët e varfër.

Me marrëveshjen në El-Merare të dymbëdhjetë shkurtit të vitit 628 Meka dhe banorët e saj e pranuan Muhamedin a.s. për sovran të

komunës së Medinës dhe qytetit të saj. Muhamedi a.s. duke qenë i vetëdijshëm se sa është e rëndësishme kjo marrëveshje, me të kthyer në Medine vendosi t'u dërgojë delegatë disa sovranëve të jashtëm dhe të thërret në Islam. Për t'u dhënë karakter zyrtar, dërgesave të tij ai e mbaroi dhe vulën e vet "Muhamed Resulullah" - Muhamedi i Dërguari i Zotit. Vetëm në prill të vitit 628 i dërgoi mesazh mbretit të Persisë, Abisinisë dhe guvernatorit bizantin në Egjipt. Në vitin e ardhshëm 629 në muajin maj pas marrjes së Hajberit, Muhamedi a..s lidhi marrëveshje me hebrenjtë e mundur sipas të cilës ata mbetën në pronat e tyre të deriatëhershme, me liri të plotë fetare, personale dhe të pasurisë, me kusht që të paguajnë njëfarë haraçi vjetor, dhe se shteti kur do që ta gjejë të përshtatshme mund t'i shpërngulë në tjetër vend të territorit të vet.

Pas marrjes së Mekës dhe para nisjes për në Medine Muhamedi a.s. e emëroi Atab bin Usajdin për guvernator të Mekës, ndërsa Muadh bin Xhebelin për gjykatës. Muadhi si gjykatës në fushëveprimin e tij ka qenë indipendent dhe i pavarur nga guvernatori i Mekes, kurse për punët e tij zyrtare ka qenë përgjegjës drejtpërdrejt Muhamedit a.s. Në të njëjtën kohë Muhamedi a.s. e dha rregulloren sipas së cilës të gjitha kontratat e lidhura mes palëve gjithsesi duhet të jenë të shkruara të përgatitura nga shkruesi i aftë dhe të nënshkruar nga dy dëshmitarë, qytetarë të drejtë. Këta shkrues kanë qenë një lloj shënuesish publikë dhe merrnin pjesë me rastin e kurorëzimeve martesore, ndërmjetësonin si zëvendës të gjykatësve, me rastin e lidhjes së marrëveshjeve dhe pajtimin e palëve të paditura, kurse për këtë merrnin leje të posaçme nga gjyqi i rregullt. Në vitin 630 Muhamedi a.s. ua ndau disa privilegje hebrenjve dhe të krishterëve të Nexhranit. Në qarkoren të cilën ua dërgoi të gjithë banorëve të asaj treve shkruante: "Ky është udhëzim nga Zoti dhe i Dërguari i Tij për ju të cilët keni pranuar fenë e drejtë që sipas saj të qeverisni dhe të udhëhiqni. Muhamedi i Dërguari i Zotit u dërgon këtë mesazh me anë të Amr bin Hazmit, të cilit i ka dhënë udhëzimet e duhura dhe ia ka tërhequr vërejtjen në emër të frikës së Zotit që kurrë në asnjë rast të mos shmanget nga rruga e drejtë dhe drejtësia. Zoti është në anën e atyre që janë të moralshëm dhe të

devotshëm. Detyra e fundit është që t'u tregojë rrugën e shpëtimit (Islamin) dhe t'u udhëzojë në dispozitat e Kur'anit, të cilin nuk guxon ta marrë në dorë e të shërbehet me të askush që nuk është i pastër (LVI: 78). Ai do t'u tregojë çka është e drejtë, dhe çka është e gabuar dhe do t'u tërheqë vërejtjen që të mos bëni padrejtësi, sepse padrejtësinë dhe të padrejtën i urren Zoti. I Dërguari im do t'u mësojë obligimin e zekatit, sadakasë, agjërimit të Ramazanit dhe mënyrën e të falurit si dhe obligimin e Haxhit. Ai do t'u tregojë se si duhet të pastroheni para faljes së namazit dhe si do të faleni pesë herë brenda njëzet e katër orëve: para lindjes së diellit, në gjysmë të ditës, para akshamit, kur të perëndojë dielli dhe kur të bjerë terri i plotë në Tokë.

Sidomos do t'u theksoj që të mos e leni lutjen e përbashkët solemne të premten në drekë – xhumanë" (LXII: 9-10) dhe se më parë gjithmonë të laheni mirë dhe të visheni mirë.

Bashkëfisnikët tuaj, hebrenjtë dhe të krishterët të cilët pranojnë islamin, bëhen vëllezër tuaj në çdo gjë të barabartë me ju. Ata prej tyre të cilët mbesin në fenë e tyre të deritashme, do të paguajnë nga një dinar (të arit) ose vlerën e tij për çdo person moshëritur.

Kush e paguan këtë kontribut rregullisht, ai do të jetë nën mbrojtjen e Zotit dhe të Dërguarit të Tij, ndërsa ai që refuzon do të konsiderohet për kundërshtar të Zotit dhe për armik të Dërguarit të Tij".

Mesazhe të ngjashme Muhamedi a.s. ju dërgoi edhe banorëve të Jemenit e të Bahrejnit dhe i dërgoi përfaqësuesit e tij të posaçëm si gjykatës dhe nëpunës administrativ. Jemeni ka qenë me rëndësi të posaçme, ngase atje përveç myslimanëve dhe idhujtarëve ka pasur edhe një numër të konsiderueshëm të hebrenjve dhe të krishterëve.

Për këtë arsye Muhamedi a.s. në Jemen e dërgoi shokun e tij të shkëlqyeshëm Muadh bin Xhebelin, të cilin e thirri nga Mekja. Nuk është e painteres për ta theksuar këtu bisedën e tij dhe ndarjen me Muadhin, sepse ajo është një tipar i bukur i shpirtit të Muhamedit a.s.

Kur Muadhi u nis për në Jemen, Muhamedi a.s. me dorë të vet ia vuri në kokë turbanit-çallmën e re dhe i ndihmoi për t'u ulur në deve. Duke shkuar pas tij në këmbë e përcolli deri jashtë qytetit, duke i dhënë udhëzime të nevojshme. Muadhi i habitur nga përzemërsia e tillë,

deshi të zbresë nga deveja dhe edhe vetë të ecën në këmbë, me ç'rast Muhamedi a.s. e vërejti: "Rri ku je, miku im i dashur. Unë po zbatoj urdhrin e Zotit dhe për mua kjo është kënaqësi e jashtëzakonshme, e cila zemrën dhe shpirtin po ma qetëson. Njeriut që i është besuar një detyrë fisnike dhe e lartë e tillë meriton nderimin më të madh. Ty të është dedikuar një detyrë e madhërishme që popullin e atij vendi ta njoftosh me parimet e Islamit". "O Zoti im" mori thellë frymë Muhamedi a.s. dhe pas një heshtjeje të shkurtër vazhdoi: "Vetëm ta kisha ditur se edhe një herë në jetë do të shiheshim, unë do ta kisha shkurtuar bisedën tonë. Por kështu – Zoti më së miri i di gjërat e fshehta – sipas të gjitha gjasave, ne pas kësaj ndarjeje, për herë të parë do të takohemi në Ditën e ringjalljes para Sunduesit të gjithësisë". Të dy miqtë për një moment heshtën, Muadh bin Xhebelit i rrodhën lotët për faqe. Ti shkon, e vazhdoi Muhamedi a.s., në viset ku ka idhujtarë, hebrenj dhe të krishterë dhe detyra e jote është që të gjithë t'i thërrasësh në Islam me butësi dhe bindje, që të pranojnë se Zoti është vetëm Një dhe se Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij". Nëse këtë e pranojnë, atëherë thuaju se Zoti besimtarët i ka urdhëruar që brenda njëzet e katër orëve të falen pesë herë. Kur të pranojnë këtë, atëherë tregoju se si bëhet falja e namazit. Pastaj shpjegoju se Zoti i ka obliguar besimtarët që një pjesë të pasurisë së tyre ta japin për qëllime të përgjithshme dhe për ndihmë e mbajtje të të varfërve dhe shpjegoju prej çka përbëhet ajo". – Pra aty në dyert e Medinës u ndanë dy shokë dhe miq të besueshëm, për t'u mos u parë kurrë më në këtë botë".

Dhëndrit të tij Aliut r.a. të cilin e dërgoi në trevën tjetër të Jemenit, para se të ndahen ia vuri dorën e vet në zemër dhe tha: "Zoti të ndihmoftë, kurse unë në emër të Tij të porosis të jesh në të gjitha i drejtë dhe kurrë mos gjyko ndonjë kontest, në dobi ose në dëm të njërës anë derisa mos të dëgjosh edhe kundërshtarin".

Trashëgimtari i parë i Muhamedit a.s. Ebu Bekri r.a. ka shkuar gjurmëve të mësuesit të tij të madh dhe siç e kemi parë atij i takon merita dhe lavdi për forcimin e themeleve të halifatit, duke vendosur paqen dhe rregullin në vend dhe me këtë i ka siguruar ardhmëri dhe prosperitet Islamit. Në mes dispozitave më të rëndësishme gjithsesi

është urdhëresa mbi zekatin dhe përkitazi me të vendimi për ndalimin e dhënies së ndihmesës parisë së Mekës nga fondi i zekatit, ngase ligjshmëria racionale e kësaj dispozite nuk ekzistonte më, pasi që Islami tashmë aq fort ishte forcuar sa që nuk kishte nevojë askënd për ta përfituar duke marrë me të mirë, ky ishte vendim shumë i rëndësishëm, ngase kjo ishte heqje dorë e parë prej njërës nga urdhëresat e qarta të Kur'anit.

Rregullimi i parë i brendshëm i shtetit arab (Islam) fillon me pasardhësin e dytë të Muhamedit a.s., Omerin r.a. Kur Sa'd bin Ebi Vekasi e pushtoi Irakun-arab, ushtarët kërkuan prej tij që këtë vend ta shpallë si pre lufte dhe ta ndajë mes tyre. Sa'di këtë e lajmëroi në Medine dhe e pyeti për këshillë Halifin, me ç'rast Omeri iu përgjigj: "Toka u takon atyre që e punojnë dhe në duart e të cilëve ajo gjendet. Ata në të ardhmen do ta mbajnë tokën e vet, kurse shtetit duhet t'i paguajnë haraç të caktuar në para dhe në fushë për mbajtjen e ushtrisë".

Të krishterëve dhe hebrenjve në viset e pushtuara të Sirisë, Palestinës, Mesopotamisë dhe Egjiptit, të cilët nuk donin ta pranojnë islamin, Omeri r.a. u caktoi të paguajnë xhizjen dhe haraçin, tatim personal dhe për tokë, kurse me dekret të posaçëm iu garantoi sigurinë personale të pasurisë, lirinë e fesë dhe mbrojtjen e shtetit kundër çdo zullumi dhe padrejtësie. Omeri r.a. saktësisht e caktoi lartësinë e xhizjes dhe haraçit për trevat e pushtuara. Më vonë, halifët arabë dhe sulltanët turq shpeshherë këto përcaktime i ndryshuan dhe pamëshirshëm i keqpërdorën në dëm të rajës.

Omeri r.a. nga pagesa e xhizjes i lironte klerikët e fesë krishtere dhe çifute, fëmijët dhe gratë, pleqtë dhe të varfrit, ndërsa pas kësaj e bëri edhe një përjashtim të rëndësishëm në favor të fisit Ben Taglib. Ky fis i madh arab i vendosur në Mesopotami, nuk ka dashur ta pranojë Islamin, por më me dëshirë i është nënshtruar pagesës së xhizjes dhe haraçit. Përkundër tërë kësaj, Omeri r.a. nuk deshi që një fis të gjakut arab ta barazojë me popujt e mundur të Mesopotamisë, por caktoi që Benu Taglibi në vend të xhizjes dhe haraqit të paguajnë zekat të dyfishtë.

Me qëllim të evidencës së saktë të të ardhurave dhe të të dalave të gjithmbarshme shtetërore Omeri r.a. sipas shembullit të Persisë e themeloi komoren supreme të llogarisë - Divanin, e në provincat e pushtuara, regjistrat, në të cilët janë shënuar të ardhurat dhe të dalat, përshkrimi i tokave pjellore, maleve e minierave dhe emrat e tatimpaguesve. Në Medine ku nëpunësit ishin arabë myslimanë, regjistri është mbajtur në gjuhën arabe, në Siri dhe Egjipt, ku nëpunësit ishin të krishterë, në greqisht kurse në Persi në gjuhën persiane. Krahas kësaj është mbajtur regjistri i emrave për të gjithë individët të cilët kanë marrë ndihma shtetërore, me çfarë rendi dhe në çfarë lartësie, me të gjitha ndryshimet të cilat kanë ndodhur, me rastin e vdekjes, lindjes, fejesës ose martesës. Jetimët e luftës dhe familjet e atyre që gjendeshin në fushëbeteja, merrnin ndihmë të posaçme nga arka e shtetit.

Edhe hierarkinë e nëpunësve, Omeri r.a. e rregulloi. Në krye të administratës qëndronte halifja dhe sekretari i tij, drejtori i të mirave shtetërore, arkëtari kryesor shtetëror përfaqësuesit e disa viseve, gjykatësit – kadilerët dhe nëpunësit e ulët tatimorë. Omeri r.a. edhe në ushtri bëri reforma të rëndësishme, caktoi garnizone të përhershme me gjeneralët e armatës në krye. Këta gjeneralë njëherësh kanë qenë edhe guvernatorë të atyre viseve.

Për ta bërë Arabinë shtet vetëm arabo-islam, Omeri i shpërnguli nga Hajberi edhe hebrenjtë tjerë të mbetur, kurse nga Fedeki dhe Nexhrani të krishterët të cilët edhe Muhamedi a.s. dhe Ebu Bekri r.a. i patën lënë të qetë duke iu ndarë edhe privilegje speciale. Omeri kishte urdhëruar që në Arabi të mos guxojë të shkelë këmba e mosbesimtarit ose mosbesimtari të ketë pronë në arabi. Për t'i ruajtur arabët vetëm si popull ushtarak dhe për t'i mbajtur të tubuar duke i kërcënuar me dënimin më të ashpër Omeri r.a. ua ndaloi arabëve për ta pasur ndonjë pronë jashtë Arabisë dhe për t'u marrë me punimin e tokës. Me qëllim të njëjtë ua ndaloi atyre mësimin e gjuhëve të huaja, dhe të krishterëve gjuhën arabe dhe shërbimin me shkrimin arab.

Qëllimi i Omerit ka qenë që arabët si ngadhënjyes me kurrfarë çmimi të mos asimilohen me popujt e mundur, por rreptësisht të dallojnë si ngadhënjyes nga raja e ngadhënjyer. Omeri r.a. vendosi që arabi

nuk mund të jetë kurrsesi rob, madje edhe nëse është i shitur si rob ose është zënë rob në luftë.

Kjo politikë nacionale arabe, e cila në fe nuk ka asgjë të përbashkët, më së miri shihet në dokumentin në të cilin të krishterët e Sirisë i formuluan kushtet sipas të cilave do t'i nënshtrohen pushtetit të Omerit. Ky dokument të cilin vetë Omeri e diktoi, fillon kështu: "Në emër të Zotit të gjithëmëshirshmit, mëshiruesit, Omerit sunduesit të besimdrejtëve, nga të krishterët e qytetit x. Kur të kaloni në tokat tona iu lutemi të na mbroni neve dhe familjet tona, pasuritë tona dhe bashkëbesimtarët tanë, kurse ne marrim për obligim se do t'u respektojmë, se nuk do të vishemi si myslimanët, qoftë në lidhje me kapelë, shall, sandale, ose ndarjen e flokëve në kokë.

Se nuk do të flasim në gjuhën e atyre as emrat e tyre nuk do t'i vejmë, vetes as fëmijëve tanë. Nuk do t'u shesim verën dhe teshat tona do t'i bartim ashtu siç i kemi pasur gjithmonë".

Ky ekskluzivitet arabo-racional i Omerit r.a. nuk ka qëndruar gjatë; qysh në kohën e pasardhësit të tij filloi tërheqja prej tij. Me ardhjen e Osmanit r.a. në fron të halifetit, erdhi në shprehje dhe në pushtet ajo aristokracia e Mekës e cila pa vullnet e pranoi edhe Islamin, kurse në shpirt vazhdimisht mbet e disponuar paganisht. Ajo ishte familja Beni Omeje, të cilës i takonte edhe Osmani r.a. dhe e cila më vonë e hoqi nga froni Aliun r.a. dhe themeloi dinastinë e saj Omejade. Osmani i dobët, plak dhe mbi të gjitha mendjelehtë shpejt ra nën ndikimin e farefisit të tij të fuqishëm nga Meka dhe qysh në ditët e para të sundimit të tij filloi të shmanget nga drejtimi të cilin e trasoi Omeri i drejtë dhe i rreptë. Ai pa marrë parasysh në vlerën personale dhe aftësinë, në të gjitha vendet më të rëndësishme dhe të leverdishme i emëroi të afërmit e tij të cilët në administratën e brendshme të halifatit e filluan korrupsionin e paparë dhe të pamirat dhe me to e hodhën mikrobin e rënies dhe shkatërrimit të halifatit. Mjaft është të përmendim se Osmani të afërmit të tij, të korruptuarit të njohur dhe njeriut të prishët, Mervanit, i bëri koncesion një të pestën e presë së luftës nga Egjipti, e cila me urdhër të prerë kuranor i takonte arkës së shtetit dhe se në përgjithësi paratë nga arka e shtetit pa marrë parasysh ua ndante të afërmve të

vet. Ai në favor të të afërmit të tij Muavisë, guvernatorit të Damaskut, keq e shkeli një ligj themelor të shtetit, të cilin Omeri me aq energji e aplikoi, përkatësisht që myslimanët në vendet e pushtuara nuk munden as nuk guxojnë të kenë pronë të tokës. Ai thjesht të gjitha fushëveprimet shtetërore në Siri ia dha të afërmit të tij Muavisë dhe me këtë arkën e shtetit e privoi nga të ardhurat e mëdha.

Pasi që guvernatorët e disa krahinave ishin bërë të padrejtë dhe pasi që nuk e dërgonin me rregull tatimin e mbledhur, kurse Halifit prapë iu duheshin shumë mjete për vete dhe për të afërmit e tij, ai u përpoq për të ndarë administratën tatimore nga administrata politike. Kjo i shkoi përdore vetëm në Kufe, ku ishte guvernator Amër bin Jesari. Ai edhe pse nuk iu kundërvu kësaj, por i ofenduar rëndë me këtë vendim të Osmanit, ai ishte më i dalluari në komplotin kundër Osmanit. Në gjyqësi, Osmani nuk ka ndryshuar asgjë, mirëpo edhe këtu është shmangur nga një praktikë shumë e rëndësishme të paraardhësve të tij. Edhe Ebu Bekri edhe Omeri sipas shembullit të Muhamedit a.s. në kryeqytet e kryenin detyrën e gjykatësit suprem. Osmani vetëm një kohë të shkurtër këtë e praktikoi e pastaj e emëroi gjykatësin e posaçëm për Medine.

Pas mbytjes së Osmanit në mes besimdrejtëve u formuan tri parti religjioze politike, në të cilat pak a shumë edhe sot vepron tërë bota islame: synitë, shiitë dhe harixhitë. Kontesti mes këtyre partive nuk është për shkak të komentimit të Kur'anit, ose të dogmave tjera fetare, për shkak të cilave u formuan sekte të shumta fetare-islame, por ai ka karakter të pastër politik: cili duhet pranuar për halif të drejtë e ligjor, pasardhës të Muhamedit a.s. në gradën e udhëheqësit profan të myslimanëve.

Sipas mendimit synitë (ehli sunet vel-xhemaat) halif të tillë kanë qenë katër: Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu r.a.. Shiitë këtë të drejtë ia mohojnë tre të parëve dhe vërtetojnë se halif i vërtetë dhe emirul-mu'minin ka qenë vetëm Aliu r.a.. Sipas mendimit të tyre, tre të parët janë uzurpatorë të cilët me të padrejtë kanë ardhur në pushtet. Përkundrazi, harixhitë e pranojnë vetëm Ebu Bekrin dhe Omerin për halif të vërtetë. Sipas mendimit të tyre, Osmani është mbytur me të

drejtë, Aliu e ka humbur të drejtën në halifat në atë moment kur hyri në bisedime me Muavijen dhe pas luftës së përgjakshme që pranoi që kontestin e tyre ta zgjidhë "gjyqi i zgjedhur".

Sundimi i halifit të katërt dhëndrit të Muhamedit a.s., Aliut r.a., siç e kemi parë në vend të vet, është shënuar me trazira të brendshme të pandërprera dhe me luftëra qytetare të përgjakshme, kurse me vdekjen e tij shteti islam e humbi karakterin e vet patriarkal dhe teokratik të pastër. Në vend të kësaj erdhi monarkia absolute me rendin e legalizuar të trashëgimit. Muaviu, i cili me dinakëri dhe tirani të përgjakshme erdhi deri te pushteti sundues dhe qendrën e halifatit nga qyteti i shenjtë i Medinës e barti në kryeqytetin e Sirisë-Damask, as që ka pasur të drejt të quhet halif.

Përktheu nga boshnjakishtja:
Hajrullah Hoxha

Marrë nga: "Muhamed a.s. i Kur'an",
botimi i dytë, viti 1968, Sarajevë

Osman Nuri Haxhiq

THE INNER ORGANIZATION AND REGULATION OF THE CALIPHATE – ISLAMIC STATE

(Summary)

Upon arriving to Medina Muhammad announced: the believers constitute a single community [umma]. The Quraysh emigrants according to their present custom shall pay the bloodwit within their number and shall redeem their prisoners with the kindness and justice common among believers. The B. Aws and B. Khazraj (as well as other Arab tribes) likewise. Believers shall not leave anyone destitute among them by not paying his redemption money or bloodwit in kindness. A believer shall not slay a believer for the sake of an unbeliever, nor shall he aid an unbeliever against a believer.

عثمان نوری حاجیش

التنظيم و الترتيب الداخلى للخلافة – الدولة الاسلامة

(خلاصة البحث)

بعد وصول النبي صلى الله عليه و سلم إلى المدينة قام بابلاغ هذا الاعلان إلى سكان المدينة: "ان جميع المسلمين اكانوا هم من قريش أو اوس او حزرج او إلى آية قبيلة عربية أخرى قانهم يمثلون أمة وحدة.

ان القريش الذين استوطنوا بالمدينة المهاجرون سوف يقومون بدفع الضريبة و بدفعون ما عليهم من ديون و سوف يقومون بتحرير ارقائهم. و سوف تقومون بنفس الشئ قبائل الاوس و الخزرج و بقية القبائل العربية. المسلم الذي ليس باستطاعته دفع ضريبة الدم و سوف يطلب المساعدة من اخوته الذين سيقوموه بمساعدته. الاخوة في الدين لن يقوموا بالانتقام من اخوته المسلمين لقتلهم غير المسلمين".

ARSIMIMI

Nazim Agaj

SISTEMI ARSIMOR-SHKOLLOR NË TERRITORIN E KOSOVËS SIPAS SALLNAMEVE 1885/1900*

Jemi kufizuar vetëm në territorin e sotëm të Kosovës, meqenëse Vilajeti i Kosovës gjatë periudhës së Perandorisë osmane përfshinte territorin prej Novi Pazarit dhe Plavles deri te Shtipi.

Në Vilajetin e Kosovës në shekullin XIX. Në sallnamat e Vilajetit të Kosovës, përveç çështjeve të tjera, është shqyrtuar edhe çështja e arsimit.

Nga mungesa e materialit burimor të administratës osmane dhe e materialeve të lëndës arkivore në gjuhën osmane-turke të Ministrisë së Arsimit, deri diku atë, e plotësojnë disa libra të botuara për arsimin dhe shkollimin në shtetin osman, si dhe disa broshura për zhvillimin historik të sistemit shkollor në Perandorinë Osmane.

Pas reformës së madhe politike me emrin "Tanzimat-i Hayriye", filloi periudha e reformave në perandorinë osmane të cilën e shpalli

* Edhepse redaksia ka disa vërejtje rreth këtij shkrimi, sepse autori nuk i ka shfrytëzuar shumë burime të botuara, në radhë të parë ato mbi arsimin, shkollat në vilajetin e Kosovës në bazë të sallnameve. Megjithatë, e pa të arsyeshme ta botojë, pas disa intervenimeve në të.

më 3 nëntor 1839 Sulltan Abdyl Mexhiti në Gylhane të Stambollit. Kjo reformë quhej "Tanzimat Fermani" (Urdhëresë e reformës) me të cilën parashikohej siguria e jetës, pasurisë si edhe barazia ligjore për të gjithë nënshtetasit myslimanë dhe jomyslimanë të Perandorisë Osmane.

Zbatimi i reformës zhvillohej shumë ngadalë dhe me vështirësi. Për këtë arsye në vitin 1856 Qeveria Osmane për të përmirësuar gjendjen e rëndë ekonomike dhe shoqërore, nxori Ligjin mbi rregullimin e vilajetit për ndarjen e re territoriale dhe juridiko-administrative në Perandorinë Osmane.

Do të paraqesim gjendjen e disa shkollave gjatë periudhës së Perandorisë Osmane dhe zhvillimin e tyre sipas reformave të reja arsimore-kulturore, të cilat shteti Osman i ka planifikuar ose ka dashur t`i zbatojë.

Perandoria Osmane si shtet islamik si të gjitha shtetet tjera islame, kulturën dhe trashëgiminë kulturore dhe arsimore e ka marrë nga arabët dhe përveç kësaj, ishte i pranishëm edhe ndikimi i kulturës iraniane.

Medresetë në të cilat fitonin njohuri të shkencave islame kanë qenë institucione të vetme shkollore, ku ishte përgatitur kuadri për imamë, gjykatës dhe nëpunës të tjerë shtetërorë. Përveç medreseve kanë ekzistuar edhe sibjan mejtepet për meshkuj dhe ndaras për femra. Në këto shkolla në fillim ishte mësimi në gjuhën arabe, kures më vonë në ato turke. Në to kanë mësuar shkrim-lexim, matematikë, si dhe bazat e fesë islame. Ligjërues kanë qenë njerëzit me arsimim teologjik.

Sistemi arsimor-shkollor në vilajetin e Kosovës në bazë të burimeve osmane-turke dhe të literaturës është mjaft i rëndësishëm për ta njohur këtë sistem të asaj kohe. Në këtë rast jemi përkufizuar vetëm në materialin të cilin na e ofrojnë sallnametë.

Në vitin 1867 është nxjerrë rregullorja për të gjitha vilajetet (Vilayetler nizamnamesi) dhe në këtë mënyrë është bërë ndarja e territorit të Perandorisë Osmane në 55 vilajete.

Në vitin 1871 është formuar vilajeti i Prizrenit ku përfshihej edhe sanxhaku i Novi Pazarit dhe ai i Nishit, ndërsa në vitin 1877-1878 for-

mohet Vilajeti i Kosovës, ku bënte pjesë edhe Sanxhaku i Prizrenit dhe ai i Novi Pazarit, ndërsa ai i Nishit mbetet jashtë Vilajetit të Kosovës.

Në frymën e këtyre reformave ishte paraparë që edhe në sistemin arsimor dhe shkollor të bëheshin ndryshime rrënjësore.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX edhe në vilajetin e Kosovës paraqiten shkollat e rregullta shtetërore në gjuhën turke iptidaije (fillore), rushdije (gjimnazet e ulëta) dhe idadijet (gjimnazet), darul mualimin (shkollat normale) etj.

Natyrisht se më herët kanë ekzistuar shkollat fillore private dhe medresetë, që kanë vazhduar të punojnë me plan-programin e vjetër.

Në medrese janë mësuar lëndët fetare, natyrisht edhe gjuha arabe, turke, ajo persiane dhe e drejta e sheriatit. Ndërsa në shkollat shtetërore plan-programi është dalluar nga ai i shkollave private dhe atyre fetare, ngase janë mësuar edhe shkencat natyrore, fizika, kimia, gjeometria etj.

Në Kosovë kanë ekzistuar sibjan mektebet, iptidaijet, rushdijet dhe idadijet, ndërsa në qendrat tjera si në Shkup, Manastir, Stamboll etj. kanë ekzistuar edhe daryl mualimin dhe shkollat e larta të ashtuquajtura: “Sultaniye” dhe “Aliye“.

Prej vitit 1869 nën ndikimin e reformave dhe në vilajetin e Kosovës, krahas shkollave private që ekzistonin më herët, fillon edhe hapja e shkollave shtetërore.

Do t`i përmendim në pika të shkurtra disa nga ato shkolla duke folur për rolin e tyre dhe duke i ndarë në kapituj:

Shkollat sibjane, iptidaije, rushdije, dhe medresetë si dhe disa tabela të lëndëve javore sipas sallnameve të Vilajetit të Kosovës.

I. MEKTEB-i SİBYAN SİBYAN MEKTEBİ[1]

a) Të dhëna mbi mektebet (shkollat)

Osmanlinjtë këtë sistem shkollor e kanë trashëguar nga arabët dhe persianët, ndërsa nga gjysma e shek. 19 kanë prezantuar edhe ide dhe zgjedhje të shteteve të Perëndimit, sidomos sistemit arsimor të Francës.

b) Shkollat (mektebet) sibjane në Vilajetin e Kosovës

Në këtë punim do të bëjmë përpjekje që ta ndriçojmë sadopak sistemin shkollor në Vilajetin e Kosovës e posaçërisht në Kazanë e Prishtinës.

Ne këto shkolla së pari janë mësuar:

a) Leximi i pjesëve të Kur’anit në mënyrë gojore si dhe përmendësh,
b) Shkrimi dhe drejtshkrimi i alfabetit arab dhe atij osman,
c) Po ashtu janë mësuar 4 operacionet aritmetike (mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi), ruajtja e shëndetit, etika historia osmane etj.

Sipas sallnames së Vilajetit të Kosovës të vitit 1885 në Prishtinë kanë ekzistuar këto Sibjan mektebi dhe në këto vende dhe institucione:

1. Cami-i kebir (Xhamia e Madhe), mësues i kësaj shkolle ka qenë Selim-efendiu.
2. Cami-i sagir (Xhamia e Vogël), mësues-Yahya-efendiu,
3. Junus-efendi, mësues-mulla Abdullahu,
4. Hasan-beg, mësues-hafiz Sulejmani,
5. Alaeddin, mësues-mulla Ibrahimi,
6. Hatunije, mësues-mulla Hajrullahu,
7. Yusuf çelebi, mësues-mulla Osmani,
8. Ramadanije, mësues-mulla Rama,
9. Jarar çeribaşi, mësues-hafiz Mehmedi,
10. Kaderije, mësues-Muhtar-efendiu.

[1] Sibyan-rrjedh nga fjala arabe prej s. Sabiy-yun, p. Sibyan, do të thotë popullore.

Në këto shkolla kanë qenë mbi 770 nxënës. Të ardhurat kanë qenë në shumë prej 9936 groshëve.[2]

Gjatë vitit 1886 nuk është zhvilluar mësimi në shkollat Ramadanije, Kaderije dhe Yusuf Çelebi. Numri i nxënësve në këtë vit ka arritur në 470.[3]

1. Hasan-beg. Mësues-hafiz Jusuf-efendiu, nxënës 60,
2. Yunus-efendi. Mësues-hafiz Sulejman-efendiu, nxënës 100,
3. Yarar Çeribaşi. Mësues-hafiz Ejub-efendiu, nxënës 40,
4. Ramadanije. Mësues-Rashid-efendiu, nxënës 50,
5. Hatunije. Mësues-Şakir-efendiu, nxënës 100,
6. Kaderije. Mësues-Muhtar-efendiu, nxënës 70 etj.[4]

Në Kazanë e Prishtinës funksiononin këto shkolla:

1. Në fshatin Babush 47 nxënës,
2. Zaskok 18 nxënës,
3. Ribari 28 nxënës,
4. Kosharë 20 nxënës,
5. Shtime 30 nxënës,
6. Pleshinë 15 nxënës,
7. Magurë 25 nxënës,
8. Hajvali 46 nxënës,
9. Sllatinë 47 nxënës.

Në këto shkolla të lartpërmendura kishte afër 332 nxënës.

Në sallnamen e vitit 1885/6 gjenden edhe shkollat e këtyre fshatrave:

1. Pleshinë 12 nxënëse dhe 40 nxënës,
2. Zaskok 15 nxënëse dhe 38 nxënës,
3. Ribar 7 nxënëse dhe 30 nxënës,
4. Kosharë 14 nxënëse dhe 40 nxënës,
5. Shtime 8 nxënëse dhe 25 nxënës,

[2] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885 f. 83.
[3] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1886 f. 88.
[4] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1898 f. 547.

6. Azizije 18 nxënëse dhe 50 nxënës,
7. Magurë 10 nxënëse dhe 27 nxënës,
8. Hajvali 5 nxënëse dhe 20 nxënës.

Gjithsej këto shkolla kishin 89 nxënëse dhe 270 nxënës. Në fshatin Pleshinë mulliri që gjendej afër shkollës sillte të ardhura vjetore rreth 20 kg. grurë për shkollën.

Në Shtime dhe Magurë ekzistonin vakëfet, kurse mësuesit e fshatrave të tjera paguheshin nga fshatrat tjera.[5]

Sallnameja e vitit 1887/8 na jep të dhëna për shkollat tjera:

1. Magurë 10 nxënëse dhe 25 nxënës,
2. Hamidije 47 nxënës,
3. Azizije 72 nxënës,
4. Hajrije 46 nxënës,
5. Janjevë 56 nxënës,
6. Tollmovicë 33 nxënës,
7. Kushovë 28 nxënës,
8. Shtime 30 nxënës,
9. Med-hije 41 nxënës,
10. Shukrije 54 nxënës,
11. Hajvali 46 nxënës,
12. Pleshinë 15 nxënës,
13. Babush 47 nxënës,
14. Zaskon 18 nxënës,
15. Ribar 28 nxënës,
16. Koshare 20 nxënës,
17. Sllatinë 47 nxënës.

[5] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1886 f. 95.

Në këtë sallname përmenden edhe shkollat ortodokse:

1. Lipjan 48 nxënës,
2. Dobrotin 26 nxënës,
3. Gushtericë 15 nxënës,
4. Graçanicë 15 nxënës,
5. Nerodime e Ulët 12 nxënës,
6. Janjevë 39 nxënës.[6]

Sallnameja e Vilajetit të Kosovës e vitit 1886 na jep të dhëna vetëm për shkollat e Sanxhakut të Shkupit.

Këto shkolla quheshin sipas themeluesve të tyre:

1. Hafiz Ismail-efendiu. Kjo shkollë kishte 37 nxënës,
2. Myderriz Sulejman-efendiu , 31 nxënës,
3. Hafiz Sulejman-efendiu, 54 nxënës,
4. Myderriz Yusuf-efendiu, 26 nxënës,
5. Hafiz Omer-efendiu, 15 nxënës,
6. Ragip-efendiu, 15 nxënës,
7. Osman-efendiu, 35 nxënës,
8. Ramadan-efendiu, 30 nxënës,
9. Bayazit-efendiu, 30.[7]

Sallnamet tjera të Kosovës nuk japin të dhëna për shkollat sibjane në sanxhakun e Shkupit.

Në kazanë e Pejës sipas të dhënave të vitit 1886 ekzistonin dhjetëra shkolla sibjane. Të dhëna të sakta na sjellë edhe sallnameja e vitit 1900/1 ku përmenden 16 shkolla sibjane për meshkuj dhe një për femra, ku dy shkolla sibjane shtriheshin nëpër fshatra.[8]

Në Kazanë e Mitrovicës sipas të dhënave të vitit 1896 kishte dy shkolla sibjane në qytete. Në qytet shkolla quhej "Haci Yaman" me 30 nxënës.

Shkolla tjetër sibjane e kishte mësues Mustafë efendiun me 50 nxënës.[9]

[6] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1887/8 f. 76.
[7] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885/6 f. 74.
[8] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1900/1 me siguri gabimisht është zëvendësuar me faqen e parë të sallnameve të viteve të më parshme, sepse Sallnameja nga viti 1900/1 ofron krejtësisht të dhëna të tjera.
[9] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1896/7 f. 361.

II. Iptidaije
(Shkollat fillore)

a) Disa të dhëna mbi shkollat iptidaije

Reformat që u ndërmorën gjatë viteve të dyzeta të shekullit XIX sollën deri te shkollimi i obligueshëm fillor. U themelua sistemi i shkollave laike (iptidaije, rushdije dhe idadije), të cilat i financonte shteti.

Megjithatë, këto reforma në fillim nuk u vërejtën në Vilajetin e Kosovës, meqë sistemi i ri shkollor, që filloi nuk e ndërpreu menjëherë të vjetrin.

Shkollat fillore iptidaije gjatë kësaj periudhe morën rolin paralelisht me shkollat sibjane.

Në Prishtinë shkolla fillore iptidaije u dallua në vitin 1883.

Natyrisht këtë e mundësoi interesimi i numrit të madh të nxënësve nga mektebet, të cilat ishin në Prishtinë dhe rrethinë, gjë që ishte e mjaftueshme.

Sipas të dhënave të vitit 1896 për herë të parë në qendrën e vilajetit u formua komisioni që duhej t'i zbatonte reformat në shkollat fillore.

Në shkollat sibjane dhe mektebet, ishte formuar komisioni nga 5-10 anëtarë, i cili binte vendim që të zbatoheshin reformat në shkollë.

Këto ndryshime ishin në interes të nxënësve, për t'i përparuar metodat e punës gjatë procesit mësimor.

Një përparësi e këtyre ndryshimeve ishte se edhe shkollat tjera i morën parasysh këto reforma.

Rezultatet e këtyre reformave ishin shumë të rëndësishme, meqë fshatarët filluan t'i rinovojnë shkollat gjegjëse, t'i hapin shkollat të cilat ishin të mbyllura dhe të ndërtojnë shkolla të reja me mund të madh dhe mjete vetjake.

Komisioni për arsim nën udhëheqjen e valiut të vilajetit e kishte nxjerrë këtë rregullore me këto nene:

Neni 1:

Në çdo fshat të ndërtohen shkolla të veçanta për djem e vajza. Fëmijët duhet të vijojnë shkollën që nga mosha 5-10 vjeçare. Pasi që nuk ka mjete për të ndërtuar shkolla, shkollat të ndahen me një rrethojë të veçantë.

Neni2:

Në fshatrat ku ka shkolla fillore, fshatarët nuk janë të obliguar të ndërtojnë shkolla të reja. Në këto raste banorët e fshatit janë të detyruar vetëm t'i rinovojnë dhe zgjerojnë ato.

Neni 3:

Shkollat duhet të punojnë çdo ditë përveç të premteve dhe në ditët kur bien festat fetare. Në rastet kur fëmijët janë të sëmurë ose vetë i kryejnë punët shtëpiake, nëse s'ka ndonjë zgjidhje tjetër, atëherë ata lirohen nga mësimi.

Neni 4:

Në rast kur fshati nuk ka shkollë, fshatarët do ta formojnë komisionin e arsimit, i cili merr vendimin mbi ndërtimin e shkollës. Banorët e fshatrave të vogla të cilët nuk kanë shkollë, atëherë fëmijët e tyre duhet t'i dërgojnë në fshatin më të afërt ku ka shkollë.

Për këtë çështje duhet të informohet Drejtorati i Arsimit.

Neni 5:

Fëmijët duhet parapërgatitur që të kenë interes për shkollë. Vijimi i mësimit të jetë i domosdoshëm. Mësuesit të jenë të përgatitur mirë dhe të jenë të rregullt. Për këtë çështje banorët e fshatit mbajnë përgjegjësi, si për angazhimin e mësuesve, ashtu edhe për mbikëqyrjen e punës së tyre.

Neni 6:

Mbikëqyrjen e shkollave e bën imami i fshatit me anëtarët e komisionit, pastaj njerëzit me autoritet apo edhe kujdestarët e klasave.

Në rast se prindi pa arsye nuk e dërgon fëmijën në shkollë dhe mësuesit të cilët nuk janë të rregullt në mësim do të qortohen dhe do t'u tërhiqet vërejtja.

Në qoftë se këto parregullsi përsëriten, atëherë mbikëqyrësit janë të obliguar që ta lajmërojnë Drejtoratin e Arsimit me qëllim që të fillojë procedura e paraparë ligjore ndaj tyre. Në rast se nuk i jepet deklaratë komisionit, i cili e bën kontrollin, do të shpallen fajtorë.

Neni 7:

Në ato fshatra ku bamirësi jep vakëf për shkolla (tokë, shtëpi, të holla) dhe në rast se ky vakëf keqpërdoret apo tjetërsohet, atëherë kjo çështje patjetër duhet të vërtetohet dhe menjëherë merren masa që vakëfi i shkollës të kthehet nën mbikëqyrjen e fshatit.

Të ardhurat e vakëfit të shpenzohen për shkollë. Me këtë çështje duhet të njoftohet Drejtoria e Arsimit dhe këto vakëfe të regjistrohen në të. Në raste kur dikush dëshiron të japë vakëf për shkollë, përsëri duhet të informohet Drejtorati për Arsim.[10]

Të njëjtin vit kur u formua ky komision, përveç rregullave të lartpërmendura mbi shkollat me udhëzim të cilat u dedikoheshin mësuesve:

Neni 1:

Mësuesi i çdo shkolle në fshat, gjatë kohës së shkollimit duhet ta ketë regjistrin dhe numrin e saktë të nxënësve meshkuj dhe femra.

Mësuesi duhet të ketë ditarin ku regjistrohen nxënësit me shënime të hollësishme.

[10] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1896 f. 330.

Ditari duhet të ruhet dhe në të, të shënohet suksesi. Mirëvajtja e mësimit dhe çdo gjë që ndodh gjatë orës së mësimit. Në ditar regjistrohen fëmijët, të cilët kanë mbetur në riprovim, apo ata të cilët për shkaqe të ndryshme e kanë lëshuar shkollën. Kontrollimi i nxënësve bëhet rregullisht duke i thirrur në ditarin e përmendur.

Neni 2:

Shkollimi i fëmijëve fillon prej moshës 5-15 vjeçare, si për fëmijët e gjinisë mashkullore, ashtu edhe për ata të gjinisë femërore. Shkollimi i fëmijëve të kësaj moshe është i obligueshëm.

Neni 5:

Ky nen flet për lehtësimet në shkollë. Në shkollë duhet të punohet në bazë të metodave të caktuara të reja, ndërsa atje ku nuk ka kushte të punohet sipas metodave të vjetra dhe mësohen këto lëndë: Elifbaja, Kur`ani, Texhvidi, Ilmihali, në të njëjtën kohë edhe Drejtshkrimi dhe Llogaritja.

b) Shkollat iptidaije në vilajetin e Kosovës

Me dispozitat e përmendura të cilat i kishte nxjerrë komisioni i Arsimit për Vilajetin e Kosovës, u arrit një përparim në formimin e shkollave të reja fillore. U rihapën shkollat e mbyllura dhe dukshëm u arrit një përparim në procesin mësimor në këto shkolla.

Shkollat fillore përveç në Prishtinë u themeluan edhe në disa qytete tjera. Diku nga një e diku nga dy shkolla.

Rrjeti i shkollave iptidaije në shek.XIX në territorin e vilajetit të Kosovës sipas burimeve osmane përafërsisht dukej kështu:

Në vitin 1883 komisioni për arsimimin e vilajetit ishte i formuar nga kryetari dhe dy anëtarë. Kryetar ishte Osman efendiu, kurse anëtarë ishin Ali Begu dhe Iljaz Aga. Ispektor ishte Haxhi Omer efendiu, kurse anëtarë ishin Salih efendiu dhe Vinko efendiu. Ofiqar ishte Mehmet Shakik efendiu.

Në këtë vit në Prishtinë përmendet vetëm një shkollë iptidaije, ku mësues i parë ishte Abdurrahim efendiu. Mësues i dytë ishte Mustafë efendiu, i cili kishte 70 nxënës.[11]

Në vitin 1885 kjo shkollë e kishte kuadrin e njëjtë, kurse numri i nxënësve u rrit në 118.[12]

Sipas të dhënave të vitit 1886 shkolla iptidaije në Prishtinë kishte më shumë arsimtarë.

Edhe shkolla iptidaije e grave në Prishtinë filloi në të njëjtin vit. Ndërtimi i shkollës filloi gjatë kohës së udhëheqjes së valiut Sadik Abdi pashës, kurse u përfundua gjatë udhëheqjes së valiut Faik pashës.

Shkollën iptidaije e femrave në qytet e themeloi Faik pasha. Për mësuese të parë kishte zojën Rukie Hanusha. Mësuesja e dytë ishte Ibishe hanëm. Mësuese për rrobaqepësi ishte Ismete Hanëm, ndërsa shërbëtore ishte Shahzade Kaduna.

Sipas sallnames së vitit 1887, në këto dy shkolla iptidaije, arsimtarët ishin të njëjtë dhe numri i nxënësve meshkuj ishte rritur prej 207 në 282 nxënës, kurse ai i femrave kishte 130 nxënëse.[13]

Në vitin 1896, në Prishtinë përmendet edhe shkolla e madhe iptidaije dhe mësuesit e kësaj shkolle ishin: Ramadan efendiu dhe Omer efendiu.[14]

Kjo shkollë kishte më pak nxënës se vitet tjera. Numri i nxënësve arriti në 130 në shkollën fillore të grave Faik Pasha. Mësuesja e parë ishte Hazimet hanëm. E dyta ishte Taibe hanëm. Kjo shkollë në këtë vit kishte 60 nxënëse.

Më 1885 në Gjilan funksiononte edhe më tutje shkolla iptidaije. Në këtë vit kishte 121 nxënës. Mësues i parë ishte i njëjti, kurse i dyti ishte Osman efendiu. Vetëm pas një viti kjo shkollë kishte 102 nxënës.

[11] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1882/3 f. 55.
[12] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885 f. 58.
[13] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1887 f. 60.
[14] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1887 f. 88.

Në Gjilan më 1887 u themelua edhe një shkollë iptidaije. Mësues i parë ishte Abdyl Halim efendiu. Mësues i dytë ishte Behram efendiu.

Numri i nxënësve në këtë shkollë është i panjohur. Sipas të dhënave të sallnames të vitit 1900/1 në Gjilan përmenden edhe këto shkolla fillore:

1. Në lagjen e çarshisë shkolla fillore (Çarşi mahalesi Iptidaiye mektebi), mësues ishte Alim-efendiu, Haxhi Osman-efendiu dhe në këtë shkollë kishte 120 nxënës.
2. Shkolla iptidaije e femrave. Mësues i parë ishte Haxhi Ali-efendiu, kurse shkolla kishte 45 nxënëse.
3. Shkolla iptidaije e meshkujve në lagjen "Eski cami". Mësues i kësaj shkolle ishte Hajrullah-efendiu. I dyti Hafiz Mustafë-efendiu dhe kishte 110 nxënës.
4. Shkolla iptidaije për femra në lagjen "Eski cami". Mësues i kësaj shkolle ishte Tahir-efendiu. Në këtë shkollë mësimet i vijonin 30 nxënëse.
5. Shkolla iptidaije për meshkuj në lagjen "Yeni mahale". Mësues ishte Hafiz Halim-efendi. Kjo shkollë kishte 30 nxënës.

III. Rushdije (Progjimnaze)

a) Disa të dhëna mbi shkollat rushdije

Për dallim nga mektebet sibjane dhe medresetë ku mësohej mësim-besimi islam, shkollat rushdije ishin shkollat e para shtetërore në Vilajetin e Kosovës.

Sipas rangut të tyre ato iu përgjigjeshin shkollave të mesme, të ulëta dhe ishin një lloj i shkollave qytetare.

Në këto shkolla nxënësit aftësoheshin për thirrje të gradave të ulëta.

Nxënësit e këtyre shkollave, kanë mundur ta vazhdojnë shkollimin e tyre edhe në shkolla në idadie dhe medrese.

Më 1863 në këto shkolla mësimet kanë zgjatur 5 vite. Prej vitit 1869 Ministria e Arsimit vendos që në këto shkolla studimet të jenë në kohë zgjatje prej katër vjetëve.

Fëmijët që kishin kryer shkollat sibjane apo mektebet iptidaije kishin përparësi të regjistrohen në shkollat rushdije. Këto shkolla i vijonin fëmijët e shqiptarëve, turqve e myslimanëve kurse në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit XX regjistroheshin edhe fëmijët e pakicave, të krishterëve (vllehëve, bullgarëve dhe serbëve).

Vijimi i dobët i fëmijëve të krishterë në këto shkolla ishte i kuptueshëm, meqë gjuha në të cilën zhvillohej mësimi ishte turqishtja.

Shpenzimet rreth ngritjes dhe mbajtjes së këtyre shkollave i hoqi qeveria e vilajetit dhe atë, në rend të parë nga të ardhurat e të ashtuquajturit Maarif Sandiği (fondi shkollor), i cili u themelua pas Hatisherifit nga Gylhaneja.

Para ligjeve shkollore turke është dhënë një urdhëresë, e cila vlente për të gjitha shkollat rushdije në shtetin osman.

Në vitin tjetër 1896 doli ligji themelor osman mbi shkollat, i cili parashihte themelimin e shkollave rushdije në të gjitha vendet e mëdha, si për popullsinë myslimane, por edhe për popullsitë tjera jomyslimane që jetonin në shtetin osman.

Edhe pse ligji ishte i paraparë që shkollat rushdije të formoheshin edhe për banorët jomyslimanë, kjo mbeti vetëm në letër.

Ky lloj i shkollave për femra dhe meshkuj (të rushdijes) u paraqit në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit XX.

Rushdije e vijuan në fillim fëmijët e funksionarëve dhe të shtresave të pasura e të privilegjuar, kurse më vonë regjistroheshin edhe fëmijët e zejtarëve.

Neni 18:

Çdo vendbanim që ka 500 shtëpi do të ketë rushdijen. Nëse banorët janë të konfesionit mysliman, do të kenë shkollat myslimane-rushdije. Nëse banorët janë të konfesioneve të tjera do të themelohen shkolla të llojit rushdije për ta.

Nëse banorët janë të konfesioneve të përziera të themelohen rushdijet për të dy konfesionet. Të themelohen shkollat rushdije, në vendbanimet me popullsi të përzier. Vendbanimi së paku të ketë 100 shtëpi, pa marrë parasysh të cilit besim i përkasin.

Neni 19:

Shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve, pagesat e arsimtarëve dhe shërbëtorëve, të paguhen nga arka e drejtorisë së Ministrisë së Arsimit të vilajetit.

Neni 20:

Për ndërtimin e shkollave rushdije duhet kërkuar leje nga Këshilli Arsimor.

Neni 21:

Çdo rushdije sipas numrit të nxënësve, duhet të ketë mësuesin e parë dhe të dytë. Ata duhet të jenë të ngritur profesionalisht sipas ligjit shkollor. Të caktohen mbikëqyrësit si dhe shërbëtorët.

Neni 22:

Mësuesi i parë në këtë shkollë duhet të marrë 800 grosh, kurse i dyti 500 grosh. Mbikëqyrësi 200 grosh dhe shërbëtori 150 grosh.

Neni 23:

Shkollimi në këtë shkollë zgjat katër vjet.

Lëndët të cilat mësoheshin në këtë shkollë ishin:

1. Mebad-i ulūm-i diniyye (Bazat e mësim besimit fetar-islam),
2. Kavaid-i lisan-i osman-i, (Gramatika e gjuhës Osmane),
3. Imla ve inşa (Drejtshkrim dhe diktim),
4. Kavaid-i arabiye ve farisiye (Rregullat e gjuhës arabe dhe perse)
5. Tersim-i hutut (Vizatim),

6. Mebad-i hendese (Bazat e gjeometrisë),
7. Tarih-i umumi ve tarih-i osmani (Historia e përgjithshme dhe historia osmane),
8. Coğrafiye (Gjeografi),
9. Cimnastik (Edukatë fizike),

Neni 25:

Pushimet vjetore në këto shkolla (myslimane dhe jomyslimane), fillojnë me 1 gusht dhe mbarojnë më 23 gusht. Shkolla rushdije i përfundon ligjëratat më 1 korrik. Prej 1-15 mbahen konsultimet me nxënës, kurse nga 15-1 gusht mbahen provimet.

Në shkollat rushdije myslimane të këtij lloji, mësimi nuk mbahet prej javës së tretë të muajit Ramazan deri në javën e parë të muajit Sheval. Të ketë gjithashtu një javë pushim gjatë festës së Kurban Bajramit. Përveç ditëve të premte dhe festave të lartpërmendura shkollat, në ditët e tjera të zhvillojnë rregullisht procesin mësimor.

Neni 26:

Nxënësit të cilët e përfundojnë këtë shkollë marrin dëftesat me të cilat mund të regjistrohen në shkollat idadiye. Ata të cilët nuk diplomojnë me kohë, mund të vijojnë shkollimin edhe për një vit.

Neni 27:

Ky nen flet për rushdije për femra. Sipas kësaj pike, këto lloje të shkollave duhet të themelohen nëpër qytetet e mëdha. Në qoftë se komunitetet janë të përziera, atëherë duhet të themelohen shkolla të veçanta. Si kusht për të formuar një shkollë të tillë duhet që së paku i njëjti komunitet të ketë 500 shtëpi.

Neni 28:

Në këto shkolla për mësues do të caktohen femrat dhe në raste kur nuk ka mësuese atëherë caktohet një mësues i moshuar.

Neni 29:

Në këto shkolla shkollimi zgjat katër vjet dhe mësohen këto lëndë:

1. Mebad-i ulūm-i diniyye (Bazat e mësim-besimit-islam),
2. Kavaid-i Lugat-i osmaniye (Gramatika e gjuhës osmane),
3. Mebad-i kavaid-i arabiye ve farisiye (Gramatika e gjuhës arabe dhe perse),
4. Imla ve Inşa (Drejtshkrimi) ,
5. Tedrib-i menzile (Amvisëria),
6. Muntehabat-i edebiye (Pjesë të zgjedhura nga letërsia),
7. Muhtasar tarih ve coğrafya (Pasqyrë e shkurtër nga historia dhe gjeografia),
8. Hesap ve defter tutmak usulu (Kontabilitet),
9. Nakşa medar olacak derecede resam (Vizatim),
10. Ameliyat-i hiyatiy-e (Rrobaqepësi),
11. Muzik (Muzikë).

Neni 30:

Në shkollat rushdije për femra të caktohen dy deri në katër mësuese, të cilat do t'iu mësojnë nxënësve prerjen, qepjen e rrobave si dhe lëndën e muzikës.

Shpenzimet të paguhen nga arka e Drejtoratit të Arsimit.

Neni 31:

Në këto shkolla mund të regjistrohen, vetëm ata nxënës, të cilët i kanë përfunduar mektebet sibjane, kurse ata të cilët nuk posedojnë këto dëftesa do t’i nënshtrohen provimit pranues.

Më 1870 u hartua urdhëresa e re mbi shkollat rushdije në Turqi, e cila përbëhej prej 74 neneve. Në këto nene trajtoheshin dispozita të përgjithshme, të cilat u dedikoheshin shkollave. Sipas kësaj urdhërese, të gjitha shkollat rushdije në Turqi ishin nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit.

Drejtoria e rushdijes intervistonte mësuesin e parë, detyrë e të cilit ishte që të kujdesej për përparimin e mësimit dhe edukimin e nxënësve, për mbajtjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve ndërmjet mësuesit dhe nxënësit.

Mësuesi i parë duhet të ishte në shkollë në kohë të caktuar. Ai nuk guxonte të largohej nga vendi i punës pa lejen e Ministrisë së Arsimit, në të kundërtën do të përjashtohej.

Në këtë kohë parashiheshin dënime për nxënësit dhe mësuesit. Dënimet dukeshin të ishin të matura. Nxënësi i cili bënte ndonjë shkelje-gabim dhe nuk vijonte mësimin paralajmërohej në mënyrë të përgjegjshme. Nëse tri vërejtje nuk ndikonin te nxënësi dhe nxënësi përsëri shkelte ligjin shkollor, atëherë mësuesi me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit e largonte atë nga shkolla.

Mësuesi i parë, patjetër së paku një herë në javë duhet të prezantonte në mësim dhe me këtë rast duhej të vështronte se si mësuesi ligjëronte mësimin dhe si e pranonin atë nxënësit.

Mësuesi, gjithashtu iu tërhiqte vërejtjen për gabimet e mundshme. Nëse këto vërejtje nuk kishin efekt atëherë e informonte Ministrinë e Arsimit.

Shpenzimet e shkollës rushdije kryheshin me dijeninë e mësuesit të parë. Shpenzimet e veçanta nuk guxonin të kalonin shumën e 40 groshëve, ndërsa të gjitha shpenzimet mujore nuk guxonin të kalonin shumën mbi 100 grosh.

Në çdo tre muaj drejtoria e kësaj shkolle ishte e obliguar që ta informonte Ministrinë e Arsimit për punën e përgjithshme në shkollë dhe notimin e nxënësve.

Para fillimit të mësimit, nxënësit thirreshin me emra nga mësuesi dhe shënoheshin ata të cilët mungonin.

Çdo javë mësuesi pyeste nga 15 nxënës afërsisht dhe suksesin e tyre e shënonte në librin për vlerësim. Qëllimi tij ishte që t'i aftësonte nxënësit dhe të shihte përgatitjen e tyre arsimore. Ai i kategorizonte sipas përgjigjeve në tri nivele:

1. Më të mirë,
2. Të mesëm,
3. Të dobët.

Mësuesi duhej të ligjëronte sipas plan-programit dhe nuk guxonte ta ndryshonte. Nëse nxënësi kishte sjellje të këqija gjatë mësimit largohej nga ora dhe shënohej në libër. Gjithashtu i shënoheshin edhe mungesat e paarsyeshme. Mësuesit dhe nëpunësit e shkollës rushdije nuk guxonin të merreshin me punë të tjera qytetare.

Nxënësit ishin të obliguar që të silleshin mirë në shkollë dhe jashtë saj dhe të largoheshin prej veprimeve që ishin në kundërshtim me etikën. Të gjithë nxënësit ishin të barabartë, dalloheshin vetëm në bazë të suksesit dhe sjelljes së tyre. Kur mësuesi hynte në klasë, nxënësit ngriheshin në këmbë.

b) Rushdije në vilajetin e Kosovës

Në vitin 1869 në Prishtinë u themelua shkolla rushdije, të cilën në vitin 1869 e ndërtoi Abdurrahman Pasha. Kjo ishte shkolla e parë osmano-turke-laike në Prishtinë.

Kjo shkollë më 1882/3 kishte 105 nxënës. Mësues i parë u emërua Sabit-efendiu, i cili në të njëjtën kohë ishte edhe drejtor shkolle.

Mësues i dytë ishte Shaqir-efendiu dhe mësues i tretë Arif-efendiu dhe mulla Abdyli.[15]

Kjo shkollë edhe në vitin 1885 kishte të njëjtit mësues dhe të njëjtin drejtor me 147 nxënës.[16]

Në vitin 1886 kishte 127 nxënës dhe lëndët e mësimit ishin të njëjta si në vitet e mëparshme.[17]

[15] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1882/3 f. 45.
[16] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885 f. 55.
[17] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1886 f. 74.

Në këtë shkollë një vit më vonë erdhi edhe mësuesi i tretë Arif-efendiu. Numri i nxënësve që e vijonin mësimin arriti në 136.[18]

Kazaja e Vushtrrisë

Në këtë kaza, rushdija u formua në vitin 1882/3. Kjo shkollë kishte 38 nxënës. Mësues i parë ishte Xhelaludin efendiu. Mësues i lëndës Rik'a ishte Rexhep efendiu. Mësues i dytë ishte Rexhep Tevfik efendiu, ndërsa shërbëtor ishte Abdyl Xhelil efendiu.[19]

Më 1885/6 numri i nxënësve rritet prej 30 në 67.[20]

Në shkollën rushdije në vitin 1896 kishte më së shumti nxënës 111.[21]

Kazaja e Mitrovicës

Ishte e vendosur në ndërtesën e posa ndërtuar, e cila kishte 9 lokale. Në këtë ndërtesë ishte vendosur edhe shkolla iptidaije. Në këtë vit shkolla kishte 40 nxënës. Mësues i parë ishte Arif-efendiu, ndërsa mësues i lëndës Rik'a (lloj i shkrimit nga kaliografia arabo-osmane) ishte Bekir-efendiu.

Në vitin 1900/1 kjo shkollë nuk kishte mësues tjetër.[22]

Sanxhtaku i Pejës

Në Pejë Rushdija ishin themelua diku ka fundi i shekullit XIX. Në vitin 1896 në këtë shkollë mësuesi i parë nuk ishte i përfaqësuar. Mësues i dytë ishte Abdullah-efendiu, ndërsa mësues i lëndës Rik'a (lloj i shkrimit nga kaliografia arabo-osmane) ishte Shaban-efendiu. Shërbëtor mulla Jashari. Këtë shkollë e vijonin 33 nxënës.[23]

Edhe në burimet tjera na paraqiten të njëjtat të dhëna.

[18] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1887 f. 72.
[19] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1882/3 f. 55.
[20] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885 f. 59.
[21] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1896 f. 374.
[22] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1882/3 f. 98, 1896 f. 467.
[23] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1896 f. 572.

Sanxhaku i Prizrenit

Krahas shkollave iptidaije dhe medreseve, në Prizren ishte e formuar edhe shkolla rushdije, e cila kishte 85 nxënës. Mësues i parë i së cilës ishte Shefki-efendiu. Mësues i dytë ishte Aziz-efendiu, ndërsa mësues i tretë ishte Haxhi Osman-efendiu dhe mësues i lëndës Rik'a ishte Hasan-efendiu. Të njëjtat të dhëna na paraqiten edhe në burimet tjera të kësaj periudhe.[24]

Kazaja e Gjakovës

Rushdije në Gjakovë u themelua me siguri para vitit 1886. Kjo shkollë kishte 120 nxënës. Mësues i parë ishte Xhafer-efendiu. Mësues i dytë ishte Emin-efendiu, ndërsa mësues i lëndës Rik'a ishte Islam-efendiu.[25]

IV. SHKOLLAT IDADIJE (Gjimnazet)

Shkollat idadije si institucione arsimore u themeluan pas vitit 1869 në bazë të ligjit për arsimin.

Qysh në vitin 1845 në disa qendra administrative ushtarake u formua nga një paralele. Vijuesit e këtyre klasave ishin nxënësit e moshës ndërmjet 11 dhe 14 vjeç. Programi i kësaj shkolle dallonte nga programi i shkollës rushdije. Pas një periudhe të caktuar paralelja u rrit në katër klasë.

Sipas burimeve osmane erdhi deri tek ideja që shkollat rushdije dhe paralelet e krijuara të jenë 8- klasëshe me emrin idadadije.

Kështu që shkolla rushdije katërvjeçare u plotësua më tre klasë plotësuese. Në këto shkolla u arsimuan fëmijët myslimanë dhe jomyslimanë me qëllim që këto komunitete t`i afrohen njëri-tjetrit.

[24] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885 f. 135, 1896 f. 591.
[25] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1885.

Megjithatë, kjo ide mbeti vetëm në letër, kurse u implementua vetëm në Stamboll me emrin "Mulki-Idadi".

Këto shkolla ishin 5-klasëshe dhe të tipit konviktorë. Vijuesit e shkollës idadije të sanxhakut vitin e fundit e kryenin në Shkup.

Duke iu falënderuar këtyre shkollave u përgatit kuadër për ndjekjen e ligjëratave nëpër shkolla të larta dhe kuadër për punë administrative. Programi i parë me të cilin punoi në fillim shkolla idadije nuk është ruajtur.

Sipas burimeve osmane, nuk është gabuar nëse është punuar me programin të cilin e kanë hartuar në vitin 1869, i cili mbeti në fuqi të përdorimit deri në vitin 1908. Kështu që u krijua një program i punës që i përgjigjej shkollës idadije dhe gjimnazit në Evropë.

Programi i ri ngërthen në vete shkollën rushdije 3- vjeçare me dy vjet plotësim nëpër sanxhaqe që do të thotë në shkollat idadije 5-vjeçare. Siç është rasti me shkollën idadije të Prizrenit, Pejës, Prishtinës dhe shkollën idadije 7-vjeçare në qendrën e vilajetit siç ishte "Shkolla idadije" e Shkupit. Kështu në këtë mënyrë vijuesve u mundësohej shkollimi i mesëm.

Në shumicën e qyteteve shkollat rushdije ishin të vendosura në ndërtesa të veçanta dhe kishin vetëm nga 4 klasë. Me kalimin e kohës u paraqit nevoja në vitin 1902 që në qendrat e vilajetit të formoheshin shkollat idadije 6-klasëshe të tipit konviktorë me lëndë të reja (nga bujqësia) ose 8-vjeçare, të cilat kishin klasë plotësuese që përcillnin përveç tjerash edhe lëndë nga tregtia dhe bujqësia.

Më 1906 Ministria e Arsimit ndërpreu këtë tip të arsimit dhe e ktheu tipin e vjetër të shkollimit nga viti 1902. Me interes është të përmendet se në vitin 1882 në Stamboll u formua shkolla për fëmijët e gjinisë femërore në rang të shkollës së mesme idadije (gjimnazit) .

Kështu u formuan shkollat nëpër qendrat e vilajeteve duke e marrë emrin "Sultaniye". Më 1893 u formua shkolla idadije e quajtur Sulltanija në Shkup.

Në Vilajetin e Kosovës këto shkolla ibtidaije dhe rushdije u formuan në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kurse idadije u formuan më vonë.

Në shkollën idadije administrative shtetërore ekzistonte një komision për shitblerje. Drejtor i këshillit arsimor ishte Kenan-beg salese[26] kurse anëtarë ishin:

Drejtori i shkollës idadije Ismail Haki-efendiu. Zëvendësi i parë Edib-efendiu. Mësues i gjuhës arabe Hasan-efendiu. Mësues i letërsisë Halil-efendiu. Nëpunësit dhe personeli ndihmës në shkollë-nëpunësi (furnizuesi) për imam dhe hafëz, libra dhe ushqim ishte Basri-efendiu, ndërsa shërbëtorë Hafiz Sherif-beg dhe Abdurrahman-efendiu.

Përveç të tjerash në Ligjin mbi arsimin shkollor kanë ekzistuar edhe shumë dispozita ligjore.

Pika 34:

Pika 34 parasheh që në vendbanimet në të cilat ka më shumë se 100 shtëpi, sipas nevojës të themelohen shkollat idadije.

Pika 35:

Parasheh që financimi i shkollës, pagesa e kuadrit arsimor dhe personelit ndihmës të bëhet nga arka e Drejtorisë së Arsimit të vilajetit.

Pika 36:

Çdo shkollë idadije duhet të ketë 6 arsimtarë me zëvendësit e tyre, të cilët kanë dëftesat e shkollimit të lartë për mësues dhe aktvendimet e Ministrisë së Arsimit për emërtimet e tyre.

Çdo shkollë duhet të ketë edhe personelin ndihmës.

Pika 37:

Rrogat e të gjithë arsimtarëve të shkollës idadije të jenë 600 grosh. Shpenzimet tjera për nevoja të shkollës të jenë 800 grosh, ndërsa të gjitha shpenzimet vjetore të kapin shumën 80.000 grosh.

[26] Salise-Kjo gradë i është ndarë funksionarëve shtetëror, prej gradave ushtarake i është përgjigjur grada e majorit.

Pika 38:

Pushimi shkollor dhe provimet në shkollën idadije do të jenë të njëjta si në shkollën rushdije.

Pika 39:

Nxënësit të cilët me sukses i kanë kryer të gjitha provimet fitojnë diplomën mbi kryerjen e kësaj shkolle, kurse ata të cilët nuk e kanë kryer iu lejohet edhe një vit që të vijojnë mësimin në këtë shkollë.

V. Medresetë

Termi “medrese“ e ka kuptimin e institucionit edukativo-arsimor, ku fitohet dituria e arsimimit të mesëm apo edhe të lartë fetar.

Medreseja e parë sipas literaturës arabe u formua më 13. 10. 1065 në Bagdat. Themelues i kësaj medreseje ishte burrë shtetasi i njohur, Selxhuk Nizam-ul Mulk (1018-1092), dhe kjo medrese është e njohur me emrin Nizamiye.

Gjatë kohës së osmanlinjve u formua medreseja e parë në Iznik me emrin Gazi Orhan në vitin 1331. Pastaj në Brusë në vitin 1400 me emrin Dar-ul Tib, dhe në Edrene me emrin Dar-ul Hadis më 1435.

Gjatë kohës së Mehmed-el Fatihut është ngritur xhamia pranë së cilës u formua medreseja me emrin Sahn-i Seman (tetë medresetë e drejta). Shumica e medreseve ishin ndërtuar pranë xhamive, të cilat ishin ndërtesa njëkatëshe të ndërtuara prej gurëve, me një arkitekturë të njëjtë.

Dhomat ishin të vogla, të ngushta dhe me dritare të vogla. Këtu bananin studentët e teologjisë (talebi-i ulūm-i diniyye). Pranë medreseve ishin imaretet në të cilat ushqeheshin nxënësit e medreseve.[27]

Në klasë nuk kishte tabela për të shkruar dhe banka për t’u ulur. Mësimin e dëgjonin të ulur në gjunjë. Në këto ndërtesa banonte edhe

[27] Imaret - është emër i cili ipet për kuzhinë në të cilën përgaditet ushqimi për nxënësit e medresesë dhe qytetarë të varfër.

myderrizi. Në medrese pranoheshin të rinjtë, të cilët përfundonin shkollën sibjane ose në shtëpi mësonin shkrim lexim.

Në fillim mund të regjistroheshin edhe ata të cilët nuk dinin shkrim-lexim. Sipas shkallës së arsimimit që jepte medreseja ishin të ndara në:

1. Iptida-i haric
2. Iptida-i dahil
3. Dahil

1. Müsela-i sehn

Dy të parat i takonin arsimimit fillestar-fillor, pastaj vinte shkolla Iptida-i Dahil dhe Dahil, të cilat jepnin arsimimin e mesëm, Müsela-i Sehn ishte si gjimnazi, ndërsa sa i përket Sehn mund të themi lirisht që kjo atëherë ishte si shkollim në rang universiteti.

Medreseja është kryer me provimin e diplomës, i cili quhej Ixhazet. Ndërsa diploma e cila merrej pas përfundimit quhej Ixhazetname.

Nxënësit provimin përfundimtar e kanë mbrojtur te Sahn Myderriz, e ata të cilët diplomonin e fitonin titullin Mulazim.

Nxënësit e diplomuar mund të punësoheshin si imam me disa shërbime tjera fetare sikurse myderrizët. Oratorët mund të njiheshin si gjykatës të sheriatit në disa Nahije.

Në shkollën Iptida-i haric është mësuar shkrim-leximi, ilmihalli dhe Kur'ani si dhe katër operacione tjera aritmetike.

Në shkollën Iptida-i Dahil është mësuar lënda: Hyrje në shkencat (shoqërore), gramatika, sintaksa, ligjërimi, gjeometria, matematika, logjika, e drejta islame si dhe bazat e drejtimit Islam.

Lëndët e mësimit janë mësuar në bazë të disa librave dhe ato quheshin sipas titujve të librave.

Më e rëndësishmja dhe një ndër të parat e medreseve të Vilajetit të Kosovës, sipas dokumenteve të cilat deri më tani janë të njohura, ishte medreseja e Is`hak Begut në Shkup e themeluar në vitin 1440.

Në Prizren medresenë e parë e ka themeluar Mehmed Pasha, ndërsa përmendet edhe medreseja e xhamisë së Sofi Sinan Pashës me emrin medreseja e Sinan Pashës.

Medreseja e Mehmed Pashës kishte 8 dhoma dhe një sallë mësimi. Për mbajtjen e medresesë dhe mektebit janë lënë në testament disa lokale në vlerë prej 15.000 akçeve.

Në medresetë e Vilajetit të Kosovës mësohej osmanishtja, e drejta Islame, filozofia dhe retorika, matematika, gjeometria, higjiena, medicina, astronomia etj.

Programi shkollor i medreseve të formuara në Vilajetin e Kosovës ka qenë i konceptuar sipas programit shkollor të medreseve të Stambollit megjithatë, nuk mund të thuhet se të gjitha medresetë punonin sipas këtij plan-programi, sepse për këtë nuk kishte kushte dhe kuadër të mjaftueshëm.

Në shekullin e XIX medresetë punonin sipas plan-programit të vjetër pa sistem dhe metoda bashkëkohore. Ligjëruesit e tyre ishin të pakualifikuar dhe joracionalë.

Sipas të dhënave të vitit 1882 në Prishtinë ka qenë një medrese që përmendet edhe në vitin 1896.

Në Vushtrri më 1882 përmendet një medrese, kurse më 1896 u themelua një tjetër.[28]

Në Vushtrri ka punuar medreseja sipas rangut më të lartë në krahasim me shkollën rushdije, sepse këtu regjistroheshin pasi përfundonin shkollën rushdije. Kjo medrese i kishte vetëm tri klasë.

Në këtë shkollë mësoheshin lëndët fetare dhe krijoheshin kuadro për hoxhë nëpër fshatrat përreth. Këtë medrese materialisht e ndihmonte vakëfi. Kjo medrese ka funksionuar edhe pas luftërave ballkanike.[29]

Më 1885 në kazanë e Gjilanit ekzistonin dy medrese. Myderriz i kësaj medrese ka qenë Adem-efendiu, ndërsa në medresenë e Dobërçanit ka qenë Halid-efendiu.

Sipas të dhënave statistikore që na japin Sallnamet shihet se medresetë pikësëpari formoheshin nëpër qytetet e mëdha dhe vendbanimet e mëdha, ku shtrihej popullata myslimane.

[28] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1882.
[29] Salname-i Vilayet-i Kosova, 1896/7.

Këto shkolla edhe pse kishin karakter fetar, megjithatë luanin rol të madh në ngritjen e dijes te popullata myslimane në Vilajetin e Kosovës.

Nga këto shkolla dolën një numër i madh i punëtorëve të vyeshëm arsimorë në Vilajetin e Kosovës.

KOSOVA SALNAMESİ

Lëndët që do të mësohen në shkollën rushdije dhe idadiye si dhe tabela e lëndëve javore sipas sallnameve të Vilajetit të Kosovës

Viti VII.	**Viti VI.**	**Viti V.**	**Viti IV.**	**Viti III.**	**Viti II.**	**Viti I.**	**Emërtimi i lëndëve**
Në javë	Në javë	Në javë	Në javë	Në javë	Në javë	Në javë	Esami-i Durus
2	1	2	2	2	2	3	Mësim besimi fetar, Kur`ani -Kerim dhe Texhvid
0	0	2	3	4	6	7	Gjuhë turke
1	2	0	0	0	0	0	Letërsi dhe etikë
1	1	0	0	0	0	0	Art figurativ
1	1	2	2	2	2	1	Gjuhë arabe
0	0	0	1	2	1	0	Gjuhë perse
5	4	4	3	3	0	0	Gjuhë frënge
2	2	0	0	0	0	0	Ligjet
0	0	1	2	2	2	2	Matematikë
0	0	1	1	0	0	0	Kontabilitet

Më lart dhamë tabelën e lëndëve mësimore prej klasës së parë deri në klasën e pestë të shkollës idadiye-pesë vite, dhe prej vitit të katërt deri në vitin e shtatë të shkollës idadije, ndërsa prej vitit të parë deri në të tretin është shkollë rushdije.

MEKTEB- i IDADIYE DERS CEDVELI
(Tabela mësimore në shkollën idadiye)

0	2	2	0	0	0	0	Algjebër
0	2	2	2	1	0	0	Inxhinieri
1	0	0	0	0	0	0	Trigonometri
1	0	0	0	0	0	0	Kosmografi
1	0	0	0	0	0	0	*Makineri*
3	3	0	0	0	0	0	Shkenca natyrore dhe kimi
2	2	0	0	0	0	0	// - //
1	2	2	2	2	2	2	Gjeografi
1	1	2	2	2	2	0	Histori
2	0	0	0	0	0	0	E drejta trashëgimore
0	0	1	1	1	1	1	**Dituri shoqërore dhe higjienë**
0	0	1	1	1	1	1	Bukurshkrim
0	0	1	1	1	1	1	Vizatim
24	23	23	23	23	20	18	Gjithsej
1	2	2	2	0	0	0	Gjuhët e huaja

2. Në disa shkolla sipas nevojës mësohej greqisht, ermenisht dhe bullgarisht.

VITI I PARË – Klasat e shkollës rushdije

Birinci sene – SINIF-i Ruşdiye

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Biblioteka arsimore		7	20	Mus`haf-i Şerif (Hediyesi)	Mësim besim fetar
	Shtypshkronja shtetërore			10	Ilmihali i parë	
	Biblioteka Kasbar	Hafiz Ferid – efendi		10	Texhvid	
	Shtypshkronja shtetërore	I ndjeri Mustafa Hami Pasha		15	Musehah vezaif-i atfal	Etikë
Pjesa e gramatikës	“	Haci Zihni efendi	1	20	El-muşezeb	Gjuhë arabe
	“			5	Bina	
Viti i I.	Biblioteka Karabet	Komisioni i veçantë	1		Gramatika e re osmane	Gjuhë osmane
“	“	Reşad bey	1	20	Kiraet	
	Biblioteka Kasbar	Tahir bey	1	20	Libri i ri Matematikës	Matematikë
	Biblioteka Karabet	Hikmet bey	1	20	Gjeografi	Gjeografi
Pjesa e I.	“	Ismail cenani bey	2		Arsim teknik	Arsim Teknik

VITI I DYTË

Ikinci sene

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Biblioteka Arsimore	(1)	7	20	Mus‘hafi şerif (Hediyesi)	Mësim besim fetar
	Shtypshkronja Shtetërore	Haci Zihni -efendi		15	Nimet- i Islam	
	Biblioteka Kasbar	Hafiz Ferid -efendi		10	Texhvid	
	“Tefiid	Ali Irfan efendi	1	10	Rehber- i ahlak	Etikë
Pjesa e Gramatikës	Shtypshkronja Shtetërore	Haci Zihni efendi	1	20	El-muşezeb	Gjuhë arabe
	“			5	Maksud	
VITI II	Biblioteka Karabet	Komisioni i veçantë	2		Gramatike e re osmane	Gjuhë osmane
“	“	Reşad bey	2		Kiraet	
	Shtypshkronja Shtetërore			5	Njohuri Perse	Gjuhë perse
	Biblioteka karabet	Habib efendi		20	Rehberi Farisi	
Pjesa II	“	Celal bey	2		Hisab –i Ameli	Matematikë
	“ Kasbar	Ali Cevad Bey	2	20	Gjeografi	Gjeografi
	Shtypshkronja Shtetërore	Mahmud Esad efendi	2	20	Histori Islame	Histori
“	Biblioteka Karabet	Ismail Cenani Bey	3		Arsim Teknik	Arsim Teknik

VITI I TRETË
Üçüncü sene

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Biblioteka Arsimore		7	20	Mus-hafi şerif (hediyesi)	Mësim besim fetar
	Shtypshkronja Shtetërore	Imam zade merhum Esad efendi		15	Musahah derikta	
Pjesa e Sintaksës	“	Haci Zihni efendi	2		El-muşezeb	Gjuhë arabe
	“			5	A’ vamil	
	Biblioteka Karabet	Ahmed Rasim bey	1	10	Ruajtja e shëndetit	Ruajtja e shëndetit
	“	Komisioni i veçantë	1	30	Sintaksa e re Osmane	Gjuhë osmane
Viti i III.	“	Reshad bey	3	20	Kiraet	
	Biblioteka Osmane	Habib Efendi		30	Hulasa rehnimaye Farisi	Gjuhë perse
	Kasbar, Karabet Kütüphanesi	Neim bey	1		Muntehabat -i Gülistan	
	Karabet Kütüphanesi	Terziyan efendi	1		Elifba	Gjuhë frenge
Pjesa e I.	“	Vizintal efendi	3		Tes`hil-i Lisan	
Viti III.	“	Celal bey	1		Hisab-i ameli	Matematikë
	“	Hasan Fuad bey	2	20	Amel-i hendese	Inxhinjeri
	Kasbar Kütüphanesi	Tahir bey	1	20	Muhtasar uruba ve memalik Osmaniye	Gjeografi
	“				Cografiyasi	
	“ Karabet	Abdurrahman Efendi	3		Fezleke-i ta-rih-i devlet-i Osmaniye	Histori
	“				Aliye-i Osmaniye	
Pjesa e III.	“	Ismail cenani bey	2	20	Arsim Teknik	Arsim Teknik

VITI I KATËRT – Klasat e shkollës idadije
Dördüncü sene – sinif – i i’dadiye

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Shtypshkronja Osmane	Merhum imam Zade Esad- efendi	1	20	Derikta şerhi	Mësim besim fetar
	Shtypshkronja shtetërore	Merhum Ahmed Rifat- efendi	1		Berkizar-i Ahlak	Etikë
Pjesa e Sintaksës	“	Haci Zihni Efendi	2		El-muşezeb	Gjuhë arabe
	“				Metn-i iz-har	
Viti IV	Bibloteka karabet	Reşad- efendi	3	20	Kiraet	Gjuhë osmane
	Shtypshkronja Shtetërore	Merhum Cevdet Pasha	1	10	Tertib-i cedid Kavaid-i Osmaniye	
	“	Şeyh sead-i Merhum	1	20	Gülistan	Gjuhë perse
Pjesa II	Biblioteka Karabet	Vizintal - efendi	2	10	Tes`hil-i lisan	Gjuhë frenge
“ “	Biblioteka Arakil	Hristoforid- efendi	3		Lekturë	
	Shtypshkronja Shtetërore	Manevri usuli		10	Hüsnihat defteri	
	Bibloteka Karabet	Ahmet Şukri Paşa	5		Amel-i ve nazri Ilm-i hisab	Matematikë
Pjesa e I	Biblioteka Kasbar	Abdi bey	3	20	Ta’ lim-i Hendese	Inxhinjeri
	Biblioteka Kasbar	Celal bey	8		Coğrafya Umumi	Gjeografi
	Biblioteka Karabet		Gratis		Muhtesin tarihi Umumi ve Zeb’ detul Kasas	Histori
Vëllimi i I.	Shtypshkronja Shtetërore	Abdurrahman efendi	5			
	Biblioteka Kasbar	Celal bey	5		Ma’ lumat-i Ziraiye	Arsim Teknik
“	Shtypshkronja Shtetërore	Halid Izet bey	2		Ruajtja e shëndetit	Ruajtja e shëndetit

VITI I PESTË
BEŞINCI SENE

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimet		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Shtypshkronja Osmane	Merhum imam Zade Esad efendi	1	20	Derikta şerhi	Mësim besim fetar
Pjesa I.	“		4		Mecmua-i Zuhdiye	
Pjesa e sintaksës	“ Amire	Haci Zihni efendi	2		El-muşezeb	Gjuhë ararbe
	“ “				Metn-i iz-har	
	“ “	Sei`d efendi			Ahlak-i hamide	Etikë
Viti V.	Biblioteka Karabet	Reşad efendi	4		Kiraet	Gjuhë osmane
	Shtypshkronja shtetërore	Şeyh Seadi Merhum	1	20	Gülistan	Gjuhë perse
Pjesa III.	Biblioteka Karabet	Veyzintal efendi	3		Tes-hil-i Lisan	Gjuhë frenge
	“ Arakil	Hristoforid efendi	3		Lekturë	
	Biblioteka Karabet	Ahmed Şukri paşa	5		Amel-i ve Nazri ilm-i Hisab	Matematikë
Bu sene-ittir reyisiye yi mahsus olarak muvekattir.	“	Hikmet Bey	2	20	Kontabilitet	Kontabilitet
	“	Izet Bey	6		Njohuri të Al-xhebrës	Al-xhebër
Pjesa II.	“ Kasbar	Abdi Bey	3	10	Talim-i Hendese	Inxhinjeri
	“ Karabet	Abdurrahman efendi	5		Cografya-yi umumi	Gjeografi
	“ Karabet		Gratis		Muhtesir tarihi umumi ve zübdet-ül Kisas	Histori
“ “	Shtypshkronja shtetërore	Abdurrahman efendi	5			
	Biblioteka Kasbar	Celal Bey	5		Malumat-i sanaiye ve ticariye	Arsim Teknik

VITI I GJASHTË
ALTINCI SENE

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri i librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Shtypshkronja shtetërore				Hulasa-i ilmi kelam ve şerh-i akaid-i	Mësim besim fetar
Xhuzi i I. Dhe pastaj	Shtypshkronja Osmane	Tahir Bey	4		Mecmua`-i zuhdiye	Gjuhë osmane
	Biblioteka Kasbar	Abdurrahman Bey	5	20	Letërsi Osmane	
	Shtypshkronja shtetërore		2		Ilmi ahlak	Etikë
	Shtypshkronja shtetërore			20	Magna et-tulab	Gjuhë arabe
Viti i II.	Biblioteka Kasbar	Lariveat Fleury	3		Gramatikë	Gjuhë frenge
	Biblioteka Arakil	Terziyan efendi	2		Mühtesar ilmi servet	Trashëgimia
	Biblioteka Karabet	Nadhim efendi	5		Telhis-i hukuk-i mevdua`	Ligjet
	Biblioteka Karabet	Izet Bey	6		Njohuri të al-xhebrës	Al-xhebër
Pjesa III.	Biblioteka Kasbar	Abdi Bey	4		Talim-i hendese	Inxhinjeri
Vëllimi I.	Biblioteka Karabet	Salih Zeki Bey	9		Mühtesar hikmet-i tabi-iye	Shkenca natyrore
	Biblioteka Arakil	Nişan efendi	20		Kimya gayri uzri	Kimi
	Biblioteka Kasbar	Ali Tevfik Bey	9	20	Gjeografia Osmane	Gjeografi
Vëllimi I.	Biblioteka Karabet	Abdurrahman efendi	7	20	Historia shtetërore Osmane	Histori
	Biblioteka Karabet	Rifat Bey	2	20	Müselesat-i musteviye	Trigonometri

VITI I SHTATË
YEDINCI SENE

Vërejtje	Vendi i shitjeve	Emrat e autorëve	Çmimi		Emri librave	Emri i lëndëve
			Groshë	Pare		
	Shtypshkronja shtetërore				Koncepte Apologjetik e dhe akaid	Mësim besim fetar
Pjesa II.	Shtypshkronja Osmane		2		Mecmua`-i Zuhdiye	
	Shtypshkronja shtetërore			20		Gjuhë arabe
	Biblioteka Kasbar	Tahir Bey	5	20	Letërsi Osmane	Gjuhë osmane
Viti II.	Biblioteka Kasbar	Lariveet Fleury	3		Gramatikë	Gjuhë frenge
	Biblioteka Arakil	Terziyan efendi	4	20	Livre d`or	
	Shtypshkronja shtetërore	Nail Bey	3		Muhtesar ilmi servet	Trashëgimi
Vëllimi II.	Biblioteka Kasbar	Mustafa Reşid efendi	7		Kosmografi	Kosmografi
	Biblioteka Kasbar	Salih Zeki Bey	9		Muhtesar hikmeti tabia	Shkenca natyrore
	Biblioteka Arakil	Nişan efendi	20		Kimya uzri	Kimi
	Shtypshkronja shtetërore	Mahmud Esad efendi			Zoologjia	Mevalid-i selese
	“	Huseyn Remzi efendi	7	20	Botanika	
	“	Halil efendi	6		Gjeologjia	
	Biblioteka Arakil	Hikmet Bey	12		Coğrafya imrani	Gjeografi
Vëllimi II.	Biblioteka Karabet	Abdurrahman efendi	9		Historia shtetërore osmane	Histori
	Biblioteka Karabet	Besim Umer Bey	6		Ruajtja e shëndetit	Ruajtja e shëndetit

Kosova Salnamesi – Mekteb-i Idadiye Fikirat Nizamiyesi Faqe 276-282.

Burimet:

1. Salname-i Vilayet-i Kosova 1882
2. Salname-i Vilayet-i Kosova 1882/3
3. Salname-i Vilayet-i Kosova 1883/4
4. Salname-i Vilayet-i Kosova 1885
5. Salname-i Vilayet-i Kosova 1885/6
6. Salname-i Vilayet-i Kosova 1886
7. Salname-i Vilayet-i Kosova 1887
8. Salname-i Vilayet-i Kosova 1887/8
9. Salname-i Vilayet-i Kosova 1896
10. Salname-i Vilayet-i Kosova 1896/7
11. Salname-i Vilayet-i Kosova 1898
12. Salname-i Vilayet-i Kosova 1900/1

Nazmi Agaj

THE EDUCATIONAL SYSTEM IN KOSOVA ACCORDING TO THE 1885/1900 SALNAME (YEARBOOK)

(Summary)

This study focuses on the territory of present-day Kosova (as the vilayet of Kosova, during the Ottoman rule, covered a much larger area).

The study of issues having to do with education in the vilayet of Kosova in the XIX century, relying on Ottoman sources, is a very difficult job. The salnames of the vilayet of Kosova, among others, contained information having to do with education.

The lack of original archival sources is compensated by a number of documents having to do with education in the Ottoman Empire as well as a number of brochures on the historical development of the educational system in the Ottoman Empire.

ناظم آغاي

النظام التعليمى – المدرسى في ولاية كوسوفا

حسب الوثائق العثمانية خلال سنوات 1885/1900

(خلاصة البحث)

لقد قمنا بتحديد حدود كوسوفا الحالية و ذلك لان ولاية كوسوفا خلال الدولة العثمانية كان يشمل المنطقة من نوفى بازار و بدولة و مدينة شتيب في مكدونيا.

لقد تم ناقشة موضوع التعليم في ولاية كوسوفا في القرن التاسع عشر حسب الوثائق العثمانية المسمى "صالنامه".

و في غياب الوثائق الرسمية للدولة العثمانية و كذلك الوثائق الخاصة بوزارة التعليم اعتمدنا على الكتب المنشورة و المطبوعة عن التعليم أثناء الفترة التي حكم فيها العثمانيون شبه جزيرة البلقان.

LEKSIKOGRAFI

Mr. Qemajl Morina

GLOSARI I NOCIONEVE FETARE

Njohja e fesë është domosdoshmëri e kulturës bashkëkohore. Sepse nuk mund të njihet njeriu pa njohur fenë e tij. Fetë nuk kanë të bëjnë vetëm me kultin dhe moralin, ato janë thellë të lidhura me artin, letërsinë, si dhe me organizimin e jetës shoqërore.[1]

Shkenca, ashtu siç e dimë ne, zanafillën e saj e ka në qendrat fetare. Ndërkaq, sa i përket shkencës mbi fenë, ajo relativisht është e re. Ajo është paraqitur vetëm atëherë kur janë ngritur zërat kundër fesë.

Feja ka luajtur një rol të dorës së parë në mbijetesën e kombit shqiptar, në po atë shkallë si për disa popuj të tjerë të lashtë. Në fillim ishte Krishterimi, ai që i dha një identitet më të fortë popullit shqiptar, kurse në një periudhë të mëvonshme ishte feja Islame, ajo që i diferencoi shqiptarët nga politika sllavizuese dhe helenizuese e fqinjëve, që synonin asimilimin dhe zaptimin e trojeve shqiptare.

Flaka morale e përbashkët për parinë shqiptare, të të gjitha besimeve, ishte ajo e një zelli të lashtë gërshetuar me një ndjenjë patriotike të zjarrtë.[2]

[1] Religije svijeta, Krscanska sadasnjost, Zagreb, 1987, s.3.
[2] www.shqiperia.com/fr/besimet_fetare.php

Definimi më i thjeshtë i fjalës terminologji është: tërësia e fjalëve të veçanta që përdoren në fushat e ndryshme të shkencës, të teknikës, të arteve, të fesë, të gjuhës etj.

Njohja e terminologjisë fetare duhet të luajë rolin edukativ. Njerëzit lypset të jetojnë në rrethana normale dhe në respektin e ndërsjellë. Në aspektin edukativ kemi për qëllim që terminologjia fetare të jetë në shërbim të gjuhëtarëve, gazetarëve, politikanëve, diplomatëve, humanitarëve si dhe nëpunësve fetarë, imamëve, priftave, rabinëve si dhe të gjithë mësuesve të fesë e të tjerëve si dhe njerëzve të kulturës.

Duke i njohur të tjerët, ashtu siç janë ata vetë, do t'u shmangemi ksenofobive të rrezikshme nga të tjerët, dhe në këtë mënyrë me vetëdije të plotë luftojmë të gjitha ekstremizmat e të gjitha llojeve.

Terminologjia fetare në leksikun e gjuhës shqipe

Pyetja, e cila shtrohet para nesh është: cili është trajtimi i terminologjisë fetare në leksikun e gjuhës shqipe?

Fjalori i vitit 1980, botuar në Tiranë, ribotuar në Prishtinë më 1981, dhe ai i vitit 1984 për **fenë** thotë:

FE,~JA f.sh.~,~**TË**. ”Besimi i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyrshme, hyjnore, i cili ka lindur qysh në kohë shumë të hershme dhe është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; tërësi që japin një botëkuptim fund e krye materialist e reaksionar, i cili është armik i përbetuar i përparimit të shkencës, dhe përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; besimit te zoti. Feja e krishterë (ortodokse, katolike, myslimane). Origjina (përhapja) e fesë. Lufta kundër fesë. Ndërroi fenë. Mohoj (luftoj) fenë. Feja është opium për popullin”. (faqe 459 , Tiranë, 1980.

Në fjalorin e sipërpërmendur nuk i shpëtuan fyerjeve as **kisha, xhamia, prifti, hoxha, Bibla, Kur’ani, madje** edhe vetë Zoti apo **Perëndia.**

Kisha: “Kërkon mbrojtje atje ku s’duhet, shkoi të zgjedhë çështje atje ku nuk ia zgjidhin”, (f. 832).

XHAMI,~A f. sh. ~ , ~ TË, "Ndërtesë ku bëhen shërbesat sipas riteve fetare të myslimanëve, faltore e myslimanëve (në vendet ku vepron feja islame). *Xhami e vjetër. Minarja e xhamisë. Hajati i xhamisë. Kur s'ke bukë në shtëpi, pse çon vaj në xhami"?, (f. 2196).*

Prifti: "Barku i priftit është hambar për të ngrënë e për të marrë", (f. 1545).

Hoxha: "Kush ha djathë nga hoxha, pëlcet nga uji", (f. 693).

Për librat e shpallur nga Zoti i madhërishëm: Biblën e Kur'anin, thuhet:

Bibla: Përmban dogma e mite të përbashkëta për fenë e hebrenjve e për fenë e krishterë, (f. 138).

Kur'ani: Libër që përmban dogmat e fesë myslimane dhe legjenda të ndryshme mitike. *Suret e kuranit* (f. 922).

Për **Zotin,** Krijuesin e gjithësisë, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, i ribotuar në Prishtinë në vitin 1981 shkruan:

Zot,~I m. sh**.~A, ~AT:** "Sipas parafytyrimeve fetare e mistike: qenie më e lartë mbinatyrshme, e trilluar nga fetë e ndryshme, e cila gjoja ka krijuar botën qëndron mbi të dhe drejton gjithçka; perëndi. *S'ka zot. Nuk i lutemi më zotit,*" (f. 2248).

ISLAMZ/ËM, ~MI m "Feja e myslimanëve, myslimanizmi; botëkuptimi e zhvillimi kulturor, që mbështetet te kjo fe. *Përhapja e islamizmit. Dogmat e islamizmit." (f.730).*

MYSLIMANIZ/ËM,~MI m. "Fe që sipas gojëdhënës është krijuar në shekullin VII nga Muhamedi dhe që përhap e mbron dogmat e kuranit, islamizmi; botëkuptimi që mbështetet te kjo fe. *Dogmat e myslimanizmit. Zakonet (ligjet fetare të myslimanizmit).*

Në parathënien e botimit të dytë të "Fjalorit të Shqipes së Sotme", botuar nga "Toena", Tiranë, 2002, thuhet: "Janë përmirësuar shpjegime ose përkufizime fjalësh e temash, duke i shkarkuar ato nga ngarkesa të panevojshme ose me karakter politizues etj., ndërsa leksiku fetar është rivlerësuar e trajtuar në përputhje me të drejtën dhe lirinë e besimit që ekziston sot në vendin tonë..."

Po, është e vërtetë se janë përmirësuar shpjegime e përkufizime fjalësh, termash, leksiku fetare, gjithashtu deri diku është rivlerësuar

në Fjalorin e ri, por ende kanë mbetur shumë gabime e paragjykime të vjetra. Ja vetëm disa shembuj sa për ilustrim:

"Gjeti kishë (xhami) ku të falet, kërkon mbrojtje a ndihmë atje ku nuk duhet ose ku nuk jepet", (f. 580).

"Kur s'ke bukë në shtëpi, pse çon vaj në xhami"?! (f. 1483).

Kurse ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se nëpër kisha, sinagoga e xhami përmendet, adhurohet e lavdërohet Zoti që është Një. Nga ana tjetër, kishat dhe xhamitë përveç rolit fetar ato gjatë historisë luajtën edhe një rol të rëndësishëm kombëtar. Nëpër ato u mbajtën kuvende me rëndësi të madhe në momentet vendimtare për të ardhmen e kombit si: Kuvendi i Lezhës më 1444, nëpër xhami u zhvilluan, në xhami u zhvilluan kuvende të njohura shqiptare si, Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), Lidhja e Pejës "Besa-Besë" 1899 e shumë kuvende të tjera. Nëpër kisha e xhami u edukuan dhe u arsimuan mendjet, zemrat e shpirtrat e shqiptarëve gjatë shekujve dhe u flijuan për fe e atdhe, siç ishin: Myderriz Ymer Prizreni, Myderriz haxhi Zeka, Myderriz Idriz Gjilani, Myderriz Haki ef. Sermaxha, pastaj Papa Kristo Negovani, Ndoc Nikaj, At Anton Harapi, Nikollë Kaçorri, At Shtjefen Gjeçovi e shumë atdhetarë të tjerë.

Për librat e shenjtë, për të cilët Madleine Debbare thotë: *"Fjalët e librave njerëzore mund të kuptohen dhe peshohen. Fjala e Zotit na peshon ne. Në mes të fjalës së zotit dhe vullnetit tonë duhet të ndërtojmë një ujdi jetësore'".* Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë, 2002 thotë:

Bibla: "Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re (e para përmban mësime e mite të përbashkëta për fenë e hebrenjve e për fenë e krishterë dhe e dyta është vetëm për fenë e krishterë", (f. 109).

Kur'ani: "Libër që përmban parimet e fesë myslimane", (f. 635).

Me gjithë të metat dhe mangësitë, botimi i "Fjalorit të shqipes së sotme" i vitit 2002 është shumë më i mirë se ai i vitit 1980. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ai nuk ka nevojë për një ripunim të ri të leksikut fetar. Sepse, ai është fjalori që më së shumti e përdorin shqiptarët kudo që jetojnë.

Në këtë aspekt vlen të përmendim "Fjalorin e feve" i botuar në vitin 2000 në Prishtinë, dhe i ribotuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, autor i të cilit është akademik Ekrem Murtezai. Fjalori në fjalë, shquhet me saktësinë dhe objektivitetin e definimit të termave dhe nocioneve fetare në përgjithësi.

Kohëve të fundit po përdoret shumë fjala **zot**, në vend të fjalës zotëri, gjë që po krijon një averzion te një numër i madh i besimtarëve të të gjitha besimeve. Këtë po e them duke u mbështetur në reagimet e shumta qofshin ato me gojë apo me shkrim, në media të shkruara apo mediat tjera. Kjo për arsye se fjala zot po asociocon me emrin e Zotit, krijuesit të gjithësisë. Nga ana tjetër, ky emërtim që po përdoret në gjuhën shqipe nuk praktikohet në gjuhët tjera.

Kjo për faktin se komunikimi kulturor shihet si mjet për harmoninë, mirëkuptimin dhe si njëra nga fushat kryesore të shërbimit kulturor ndërmjet popujve. Pa dyshim se gjuha në përgjithësi dhe terminologjia fetare në veçanti, si mjet i rëndësishëm i komunikimit, konsiderohet korridori më efikas për studimin e llojeve të shkëmbimeve kulturore së bashku me historikun e tyre dhe përfshirjen e gjuhës në kultura të popujve të tjerë përmes brezave dhe kohërave.

Në këtë prizëm terminologjia fetare në përgjithësi dhe ajo islame në veçanti meritojnë një vëmendje të veçantë, pasi ajo hedh dritë mbi shumë të dhëna historike, gjuhësore dhe kulturore. Gjithashtu, ajo krijon mundësinë për të diskutuar çështje të shkëmbimeve gjuhësore, fetare e kulturore ndërmjet popujve, të cilët kanë pasur lidhje të forta në rrjedhën historike, të cilat, me kalimin e kohës, janë rrënjosur në kulturën e këtyre popujve.[3]

Në rrafshin kulturor, terminologjia islame është shprehje e inteferimeve pozitive ndërmjet kulturave e gjuhëve, të cilat kanë dhënë e marrë ose kanë ndikuar te njëra-tjetra pa prekur aspak identitetin dhe origjinalitetin e vlerave kombëtare, ku përfshihet edhe leksiku, si një ndër elementet më të lëvizshme të gjuhës gjatë historisë së marrëdhënieve kulturore ndërmjet popujve. (F.O.f.VIII).

[3] Tahir Dizdari, Orientalizmat në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005, fq. 7.

Nisur nga nevoja, që në kontaktet e përditshme, jo vetëm njerëzit e fesë, por edhe strukturat tjera të shoqërisë kanë nevojë për njohjen e terminologjisë fetare, jemi përpjekur, që për nevojat tona të përgatisim një glosar të nocioneve të feve të shpallura apo monoteiste. Duke filluar me glosarin e nocioneve islame, ortodokse, katolike dhe hebraike. Me këtë rast jemi shërbyer me përvojat e gjuhëve të popujve tjerë, të cilët na kanë paraprirë në këtë aspekt. Ky glosar mund të jetë një nismë e mirë që në një të ardhme të afërt me përpjekje të përbashkëta të ekspertëve të gjuhës dhe të fesë, do të jemi në gjendje, që në gjuhën shqipe të hartojmë fjalorin e terminologjisë dhe nocioneve fetare, me ç'rast do t'u bëhej një shërbim gjuhës shqipe, feve si dhe të gjithë atyre që merren me terminologjinë fetare në përgjithësi, qofshin ata gjuhëtarë, njerëz të fesë, studiues dhe hulumtues të shkencave të lëmenjve të ndryshëm.

Glosari i nocioneve islame

A

abdest: pastrim i vogël fetar, i domosdoshëm para faljes së namazeve ose leximit të Kur'anit; (ar.vudu).

abdes-hane: vendi për marrjen e abdestit, përdorimi i ujit të pastër.

Adem, a.s.: njeriu i parë në tokë dhe Pejgamberi i parë.

adl: drejtëpeshim, baraspeshë, ekuilibër; drejtësi, (koncept themelor kuranor).

agjërimi i ramazanit: agjërimi në muajin e ramazanit; agjërimi i obligueshëm, shtylla e tretë e islamit.

ahiret: bota e përhershme; vendbanimi i njeriut pas vdekjes së kësaj bote pas ringjalljes.

ahlak: sjellje e mirë e bazuar në principet islame; etika islame; shkenca mbi sjelljet islame.

Ahmed ibn Hanbel: dijetar i njohur, jurist i sheriatit dhe transmetues i traditës së Pejgamberit a.s., sipas mësimeve të të cilit është themeluar dhe emërtuar shkolla juridike në Islam- medhhebi hanbelij.

ahmedija: (çallma): fesi i kuq i lidhur me pëlhurë të bardhë; pjesë e uniformës zyrtare të imamëve; kapelë për destinim të veçantë.

Aisheja r.a.: bashkëshortja e të dërguarit Muhamedit a.s.; nëna e besimtarëve.

ajet: shenjë; fjali, paragraf apo fragment në Kur'anin e madhërishëm.

ajatullah: "shenj i Allahut", titull i prijësve shiitë të rangut të lartë; Ajatullah el-'udhma është kryesori.

akaid: besimi islam, i cili mbështetet në principet e besimit në Allahun xh.sh., melaqet, shpalljen e librave të shenjta, të dërguarit e Allahut xh.sh., ditën e Gjykimit, si dhe në urdhëratë e Allahut për të gjitha ato që kanë ndodhur, ndodhin dhe për ato që do të ndodhin; shkenca mbi besimin islam.

akika: prerja e kurbanit me rastin e lindjes së fëmijës, 7, 14 apo 21 ditë pas lindjes; emërtimi solemn i fëmijës.

akriba: të afërmit, të afërmit prej gjaku.

aksham: momenti i perëndimit të diellit, muzg-u; shih. namazi i akshamit.

alejhis-selam *(alejhi-s-selam):* "paqja (e Zotit) qofshin mbi të; thuhet apo shkruhet pas përmendjes apo shkrimit të emrit, të cilit do qoftë prej pejgamberve të Allahut xh.sh.; shkurtimisht a.s.

alejkumus-selam *(alejkumu-s-selam):* "edhe mbi ju qoftë paqja e (Zotit)"; përgjigjet në përshëndetjen islame.

alem: maja prej bakri e kupolës kryesore të xhamisë dhe minares i përbërë prej tri ose pesë kupolave me madhësi të ndryshme, madhësia e asaj që pason është më e vogël sesa e asaj të parës, si dhe të gjysmë hënës me yll në maje; bota.

Ali ibn Ebu Talib: djali i axhës së Pejgamberit a.s., si fëmijë kishte pranua misionin e Muhamedit a.s., si i dërguar i Allahut; halifi i katërt.

alim: dijetar i fesë (shumësi: ulema).

Allah: Emri i Allahut i shpallur në Kur'an.

Allah mubarek (olsun)!: "Allahu të bekoftë!": shprehje me të cilën myslimanët ia urojnë njëri-tjetrit ndodhitë e lumtura.

Allah raziola! (Allah razi olsun!): "Allahu qoftë i kënaqur me ty!"; përgjigje në çfarëdo urim i pa marrë parasysh rastin.

Allahemanet: "Allahut në amanet"; njëra prej përshëndetjeve islame në ndarje.

amanet: besim; çështje e besueshme; amanet.

amin: prano, o Zot!

Amina: shih: Emina.

Aminim: ngritja e duarve lart, përcjellja e lutjeve me gjysmë zëri duke thënë "amin".

Arefat: një kodër në lindje të Mekes në rrugë për në Taif, në të cilin hanxhinjtë janë të obliguar të qëndrojnë, si njëri prej kushteve kryesore të haxhit, ku janë të obliguar të kalojnë kohën e caktuar më 9 dhul-hixhe.

Arsh: froni i Allahut xh.sh.

a.s.: shih: alejhis-selam.

as-hab: bashkëkohanik dhe njohës personal i të dërguarit të Allahut Muhamedit a.s.

ashere: pjesë e Kur'anit që lexohet me zë, (zakonisht përmendsh) në vend publik.

ashik: i dashuruar në Allahun xh.sh.

ashk: dashuria dhe respekti ndaj Allahut xh.sh.

ashura: *(ar. Jevmu-l-'ashura):* dita e dhjetë e muajit muharrem, dita e agjërimit vullnetar; dita e vrasjes së Huseinit, nipit të Pejgamberit a.s., në vendin e quajtur Qerbela në Irak; emër i ushqimit të veçantë që te ne është zierja e grurit, i cili shërbehet me ditët e ashureve.

Azhar: (ar, el-Ez-her): universiteti i vjetër dhe i njohur, të cilin në Kajro e ka themeluar çliruesi i Egjiptit dhe themeluesi i Kajros Xhevher es-Sikil-li në vitin 970.

Azrail: meleku i vdekjes; meleku, i cili është i obliguar që në momentin e caktuar ta ndajë shpirtin prej trupit të njeriut.

B

bajrak: flamur; flamuri i Bashkësisë Islame me ngjyrë të gjelbër me gjysmë hënën dhe yllin e bardhë në mes të pjesës së hapur të gjysmëhënës së kthyer në anën e kundërt të shtizës.

balig: person i moshës madhore; person që ka arritur moshën e pjekurisë.

Bajram: festë myslimane; shih: Bajrami i Ramazanit dhe Kurban-Bajrami.

bajramluk: dhuratë e bajramit.

Bajram (sherif) mubarek (olsun)!: "me fat të qoftë bajrami"; shprehje me të cilën myslimanët ia urojnë njëri-tjetrit bajramin; përgjigjja në këtë urim është: Allah raziola!

Bajrami i Ramazanit: (ar. 'idu-l-fitr): me Bajramin e Kurbanit janë festat më të rëndësishme islame, i cili festohet më 1, 2 dhe 3 të muajit shev-val sipas kalendarit hixhri; shënon përfundimin e muajit të Ramazanit.

Bajrami i haxhit: shih: Kurban-Bajrami.

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK): bashkësi e organizuar e myslimanëve të Kosovës dhe jashtë saj, të cilët e pranojnë atë si bashkësi të tyre.

basluk: shenjë e përkohshme apo nga një herë e përhershme e vendosur mbi varr, zakonisht prej druri.

bedel: zëvendës formal-juridik në kryerjen e obligimit të haxhit; personi që e kryen haxhin me autorizimin dhe në emër të një personi tjetër, i cili për shkaqe shëndetësore nuk ka mundësi vetë ta kryejë haxhin.

Bedr: një kodër dhe burim në jugperëndim të Medinës, ku në ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit ramazan, të vitit 624, apo të vitit të dytë sipas hixhretit, myslimanët me në krye Muhamedin a.s. kanë korrur fitoren historike kundër politeistëve të Mekes.

bektashijt: rend heterogjen i dervishëve, themelues i të cilit është Haxhi Veli Bektashi, të cilin e ka ndaluar sulltani reformator Mahmuti i II-të (1826); kanë qenë në lidhje me jeniçerët; një numër i konsideruar i tyre gjendet në Shqipëri, ku njihen si komunitet i veçantë dhe në Tiranë gjendet kryegjyshata botërore bektashiane.

Bejtullah: "faltorja e Allahut"; shih: Qabeja.

bejtul-mal (bejtu-l-mal): fondi i Bashkësisë Islame, të cilin e përbëjnë mjetet e tubuara nga zeqati, sadekatu-l-fitri, kurbanat etj.; arka e shtetit në kohën e Muhamedit a.s. dhe më vonë në kohën e shumë halifëve dhe sulltanëve.

bidat: risi në fe, mënjanim nga tradita e njohur islame; herezi.

bismila: sintagmë arabe "Bismilahi-rr-Rrahmani-rr-Rrahimi", e cila zakonisht përkthehet: "Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit", me të cilën çdo mysliman dhe myslimane fillon çdo punë të mirë.

D

dava: (ar. da'ëa): shih: davet.

davet: thirrje në islam, propagandim i fesë; në kuptimin e gjerë: aspekti social i aktivitetit misionarist.

Davudi a.s.: Pejgamber i Allahut, propagues i shpalljes së Allahut Zeburit (Telmudit); Dauti a.s..

Dexhall: shfaqje (fenomen) (sipas disave gjallesë), që do të paralajmërojë ditën e Gjykimit.

ders: ligjëratë shkencore, fjalim; leksion, mësim.

dert: dhembje, brengë, vuajtje, mundim; sëmundje e brendshme shoqërore për diçka.

dervish: sufi, mistik; modest dhe njeri i përkushtuar i etshëm për ta njohur të vërtetën; personi që iu ka bashkangjitur njërit prej radhëve të dervishëve për ngritje shpirtërore.

dimi: pjesa e poshtme e veshjes popullore të grave myslimane në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë, Turqi etj.

din: feja, e cila nënkupton obligim, udhëzim, përulje dhe shpërblim; jetë përplot devotshmëri.

Dita e kiametit: dita e gjykimit; shih: kiameti.

Drejtorati i vakëfeve: Institucioni i Bashkësisë Islame, i cili merret me çështjen e pasurisë vakëfnore në kuadër të Bashkësisë Islame.

dova: lutja; lutja drejtuar Zotit të madhërishëm.

dunja: bota, jeta e kësaj bote.

dunjalluku: kjo botë.

dushman: armik; armik i fesë dhe i besimtarit.

E

Ebu Bekr es-Siddik: njëri prej pasuesve të parë të të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s. dhe pasuesi i tij i pandarë, ndihmës dhe shok; halif i parë.

Ebu Hanife: juristi dhe teologu i njohur mysliman i shekullit të shtatë, sipas mësimeve të cilit është themeluar shkolla më e përhapur juridike islame e medhhebit hanefi.

edeb: edukatë; metoda e sjelljes së myslimanit; sjellje e vërtetë në suaza të parimeve islame.

exhel: (i caktuar nga Allahu xh.sh.) momenti i vdekjes; fat; kësmet.

ef.: shkurtuar. prej efendiu.

efendija (shkur. ef.): zotëri; popullore: imam ose personi i cili ushtrohet për thirrjen e imamit; autoritet fetar; shqiptohet apo shkruhet para mbiemrave apo pas emrave.

ehli-sunnet: anëtarët, pjesëtarët e sunnetit; shumica dërrmuese e myslimanëve të botës.

Elham: emërtimi popullor i kaptinës së parë të Kur'anit, i cili është quajtur sipas fjalës së parë të kësaj kaptine; shih Fatiha.

emanet: shih: amanet.

Emina: nëna e të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.

emer (ar. emr): urdhër i Allahut.

emir: princ; sundues.

emirul-muminin (emiru-l-mu'minin): sundues i besimtarëve të vërtetë; shih: Ebu-Bekr es-Siddik.

Esmaul-husna (ar. el-esmau-l-husna): emrat e bukur të Allahut; emri i përbashkët për 99 emrat (atributet) e Allahut, prej të cilëve shumica të përmendur në Kur'an.

evlija: i dashur i Allahut; njeri i mirë; person i inspiruar dhe i zgjedhur në mesin e besimtarëve të rëndomtë me fuqinë e tij shpirtërore.

ezan: thirrje me zë njeriu, besimtarët në namaz të përbashkët.

F

fakih: ekspert juridik; ekspert për të drejtën e sheriatit islam.

fakir: i varfër; lypës; pasues i misticizmit që ka pranuar të jetojë në varfëri, apo ka braktisur të mirat e kësaj bote.

Fakulteti i Studimeve Islame (FIS): institucioni më i lartë edukativo-arsimor islam i Bashkësisë Islame të Kosovës, themeluar në vitin 1992 në Prishtinë.

falja: falja e namazeve.

farz *(ar.fard):* obligim islam kryerja e të cilit është e domosdoshme për secilin mysliman apo myslimane të moshuar; ibadet i obliguar.

fasik: gabimtar, gjynahqar; cenues i rregullave të Zotit.

Fatiha (ar. el-Fatiha): hapje; kaptina e parë e Kur'anit, e cila përbëhet prej shtatë ajeteve.

fesad: ngatërrim, turbullim; vepër që e prish abdesin.

fetva: dekret; mendim zyrtar juridik ose vendim i dijetarëve rreth çështjeve të ligjit islam; vendimi lidhur me ndonjë çështje të juridiksionit islam.

fidje: kompensimi i obligueshëm në aspektin e dhënies materiale të varfërve për persona, të cilët për shkak të sëmundjeve kronike të pashërueshme nuk janë në gjendje të agjërojnë.

fikh: shkencë fetare mbi të drejtën, e cila përfshin ceremonitë dhe obligimet fetare, familjare, trashëgimisë, qytetare, penale dhe të drejtën kushtetuese si dhe rregullat lidhur me udhëheqjen e luftës (të drejtën e luftës).

Furkan: "Dallues i të vërtetës nga e pavërteta"; njëri prej emrave kuranor për Kur'anin në Tevrat.

G

gusul: pastrim i madh; larja e domosdoshme pas marrëdhënieve seksuale (ose daljes së spermës), pas lindjes dhe kalimit të menstruacionit te gratë; larja e obliguar e të vdekurve para faljes së namazit të xhenazes.

H

hadd: *(shumësi: hudud)*: 'kufiri'; dënimi i caktuar i Kur'anit për vjedhje, shkelje të kurorës (adulteri), kurvëri, dëshmi të rreme dhe pirje të alkoolit.

hades: gjendje e papastër; gjëra dhe veprimet, të cilat individin e bëjnë të papastër për kryerjen e obligimeve fetare.

hadis *(ar. hadith):* atë që i dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. ka thënë, si dhe atë që për të dhe sjelljet e tij kanë thënë shokët e tij; Hadis:- burimi i dytë i sheriatit islam; disiplinë shkencore në kuadër të shkencave islame.

hadis-kudsi: fjalët e Pejgamberit a.s., kurse kuptimi dhe domethënia nga Allahu xh.sh.

haxh (ar. haxh-xh): vizitë vjetore Mekkes, duke i kryer ceremonitë fetare, e cila është obligim për çdo mysliman dhe myslimane, nëse janë të aftë, së paku një herë në jetë; kryhet gjatë muajit të dhulhixh-xhe; kushti i pestë i islamit.

haxherul-esved (haxheru-l-esved): "Guri i zi"; një gur i madh në formë të vesë, ngjyrë të zezë (për të cilin supozohet se është meteor), i cili me rastin e renovimit të Qabesë vetë Muhamedi a.s. (në atë kohë ende nuk ishte Pejgamber) e ka vendosur në këndin e Qabesë në anën e majtë të derës.

haxhi: shtesë para emrit të personit që e ka kryer haxhin.

haxhija: thirrje nderi për çdo mysliman dhe myslimane, të cilët kanë vizituar Mekken dhe i kanë kryer ceremonitë e haxhit.

hajz: e përmuajshme, e përmuajshmja; ciklusi mujor te femrat; pastrimi mujor te femrat e moshës madhore; menstruacioni.

hallall: sipas parimeve islame, gjërat dhe sjelljet e lejuara nga ana e Allahut të madhërishëm; e kundërta e hallallit është harami.

halif: trashëgues, zëvendës i të dërguarit Muhamedit a.s., në të gjitha veprimet përveç misionit të pejgamberisë; sundues i të gjithë myslimanëve, të cilët në vetvete i bashkon udhëheqësia dhe autoriteti shpirtëror dhe laik.

haram: sipas principeve islame gjërat dhe sjelljet e ndaluara nga ana e Allahut xh.sh; e kundërta e kësaj është hallall.

harem: oborri i xhamisë; dikur pjesë e shtëpisë e rezervuar vetëm për gjininë femërore; shih: haremi-sherif.

Haremi-sherif: oborri i Qabesë.

harf: shkronjë; shenjë i shkruar i shkrimit arab.

Haruni a.s.: pejgamber i Allahut xh.sh., vëlla i Musait a.s.

hatib: personi i autorizuar me dekretin e kryetarit të Bashkësisë Islame për mbajtjen e hytbes në xhami.

Hatixha: gruaja e parë e të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.

hatme: leximi i tërë Kur'anit prej fillimit në mbarim.

hazreti: i (e) nderuar, i (e) respektuar; shpesh herë vendoset para emrave të dërguarve të Allhaut xh.sh., anëtarëve të familjeve të tyre të respektuara dhe katër halifve të parë.

hedije: dhuratë, peshqesh.

hiqaje: shih: hikaje.

hidajet: udhëzim në rrugë të drejtë.

hixhab: veshje e përshtatshme e paraparë sipas principeve islame, e cila parasheh mbulimin e tërë trupit, përveç fytyrës, shuplakave dhe shputave.

hixhret: shpërngulja e Pejgamberit a.s. prej Mekkes në Medine në vitin 622; prej kësaj date fillon njehsimi i kalendarit islam; shënohet si njëra prej datave më të rëndësishme në historinë islame.

hikaje: tregim i shkurtër domethënës, anekdotë; hiqaje.

hikmet: urtësi; njohuri për të fshehurën.

hizbullah: Partia e Zotit.

hoxhë: shih imam.

huda: udhëzim.

hurija: banore e xhenetit; vajzat e xhenetit,

hytbe: fjalim i hapur i personit të autorizuar në xhami gjatë namazit të xhumasë apo namazit të bajrameve.

I

ibadet: konsiderohet çfarëdo formë adhurimi, i jashtëm apo i brendshëm, publik ose sekret, i obliguar dhe jo i obliguar, formal dhe joformal.

Ibrahimi a.s.: pejgamber i Allahut xh.sh.; Abraham.

ibret: habitje, shastisje; mësim.

Idriz: emri i njërit prej të dërguarve të Allahut xh.sh.

ixhma: koncenzus i juristëve myslimanë lidhur me ndonjë çështje juridike, që nuk është zgjidhur në mënyrë eksplicite në Kur'an e as në sunet; burim i tretë i të drejtës islame.

ixhtihad: përpjekja dhe angazhimi i individit të kualifikuar, myslimanit dhe myslimanes, për të arritur deri te zgjidhja e ndonjë çështjeje të hapur juridike.

iftitahi-tekbir*:* "tekbiri fillestar": tekbiri me të cilin fillon apo hyhet në namaz.

ihram: veshje e veçantë e përbërë prej dy pjesëve të paqepura, të cilën janë të obliguar ta veshin meshkujt gjatë kohës së kryerjes së haxhit dhe umres; nijeti dhe vendosmëria për të filluar ceremoninë e haxhit ose umres.

ihsan: dashamirësi, mirësi, njerëzi, sjellje e mirë, sjellje e hijshme; mirësjellje; gatishmëri,(koncept i rëndësishëm kuranor).

ikamet: thirrja apo lajmërimi (në kuptimin formal shumë i ngjashëm me ezanin) në fillimin e çdo namazi farz; sikurse ezani, zakonisht muezini është ai që e bënë ikametin.

ilham: inspirim.

ilm: dituri.

insaf: drejtësi

insan-i-kamil: njeri i përkryer, përdoret për të dërguarit e Allahut xh.sh.

ilmihal: libër themelor mbi besimin dhe obligimet islame. Ekzistojnë disa lloje të ilmihalit, varësisht prej nivelit për të cilin janë përpiluar.

imam: personi i aftësuar profesionalisht për t'u kujdesur për jetën fetare në një xhemat.; udhëheq regjistrin e të lindurve të xhematit dhe

e përfaqëson xhematin në çështje të fesë; prijës shpirtëror dhe politik te shiat.

iman: besimi në ekzistencën e Zotit; besim.

Inxhil: Libër i Zotit i shpallur të dërguarit të Allahut xh.sh., Isait a.s. (Unxhilli).

insan: njeri, individ, person.

inshallah: "nëse donë Allahu".

Isa a.s.: i biri i Merjemes; i dërguar i Allahut; pranues i librit të Inxhilit; Isa a.s.

islam: nënshtrimi i plotë ndaj Allahut xh.sh.; koncept i përgjithshëm që përfshin të gjitha aspektet e jetës së njeriut të shpallura në librat e Zotit në Zebur, Tevrat, Inxhil dhe në veçanti në Kur'an; feja e Allahut.

Isra: udhëtimi i natës i Muhamedit a.s., prej Mekes në Jerusalem; shih: Lejletul-miraxh.

istibra: rregulli i pastrimit pas kryerjes së nevojës së vogël.

istigfar: kërkim falje nga Zoti i madhërishëm.

istihada: rrjedhje e jo e rregullt te femrat e moshës madhore; pastrim i bardh apo lulet e bardha.

istinxha: rregulli i pastrimit pas kryerjes së nevojës së madhe.

itikaf (ar. i'tikaf): mënjanimi, veçimi, izolimi i një personi në emër të gjithë xhematit, sipas shembullit të pejgamberit, Muhamedit a.s., në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit me qëllim të ibadetit më intensiv. Ky izolim bëhet në xhami, apo në ndonjë vend të veçantë të ndërtuar në kuadër të xhamisë apo drejtpërdrejt në xhami.

izen: leje.

J

Jacia (namazi) : shih: namazi i jacisë.

Jevmul-Arefe (Jeëmu-l-'Arefe): "Dita e Arefatit"; dita e nëntë e muajit dhul-hixhe, kur haxhinjtë qëndrojnë në rrafshnaltën e Arefatit; shih: Arefat.

Jevmul-ashura (Jeëmu-l-'ashura): "Dita e Ashureve"; shih: ashura.

K

Kaba: shih: Qabeja.

kabur: varr.

kader (ar. el-kadr): urdhër i Allahut, urdhër; fati; vendimi i fundit.

kadiu: gjykatës i gjyqit të sheriatit.

kalendari hixhri (takvim): kalendari i myslimanëve për njehsimin e kohës, që fillon prej hixhretit dhe shërben për përcjelljen dhe shënimin e ndodhive me rëndësi të historisë islame si dhe për kryerjen e shumë obligimeve fetare; sipas mënyrës së njehsimit të kohës; është kalendar mujor.

kafir: pabesimtar, ai që e fsheh të vërtetën pasi që ajo i është bërë e qartë atij; ai që nuk e donë Zotin; qafir.

kefaret: kompensimi i obligueshëm në aspektin e dhënies të varfërve për gabime apo lëshime të bëra, si për shembull gjatë agjërimit të muajit të ramazanit.

kelime: (La i lahe il-lallah, Muhamedun resulullah – Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i dërguar i Allahut), shih: kelimei-shehadet.

kelimei-shehadet: (Eshhedu en la i lahe il-lallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu - Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi a.s., është rob i Allahut dhe i dërguar i Tij); kredi (sintagmë) e besimit islam; deklaratë me të cilën në kuptimin formal, nëse thuhet me vetëdije dhe vullnetarisht, bëhet mysliman; hapi i parë i Islamit.

kevther: shumë të mira që Zoti i ka dhuruar njeriut; emri i kaptinës së 108 të Kur'anit; burimi i Pejgamberit a.s., në xhenet.

Këshilli i reis-ulemas; trup i përbërë prej reisu-l-ulemas, dekanit të FSI-së dhe myftinjve që e ndihmojnë reisu-l-uleman në punën e tij.

kibla: drejtimi në të cilin kthehen myslimanët gjatë faljes së namazit, shih: Qabeja.

kijam: qëndrim; pjesa e obligueshme e namazit, që kryhet duke qëndruar në këmbë.

kiamet: fundi i botës; përfundimi dramatik i ekzistimit të kësaj bote kalimtare dhe fillimi i botës tjetër, botës së amshueshme; Dita e Kiametit, dita e Gjykimit.

kijas: analogjia; burimi i katërt i të drejtës islame.

kiraet: mësimi (leximi melodik) i Kur'anit; pjesa e obligueshme për çdo namaz; disiplinë shkencore, që merret me rregullat dhe mënyrën (melodike të leximit) të Kur'anit.

kismet: fati.

Kitab: libri; shpallja e Zotit për njerëzimin në formë të librit; shih: Kur'ani, Inxhili, Tevrati, Zeburi, ehlul-kitab; qitap.

kube: kupola; forma më e njohur e pjesës qendrore të konstruksionit të xhamisë.

kudret: i gjithëfuqishëm, njëra prej cilësive të Allahut të madhërishëm.

kufr: pabesim; fshehje e të vërtetës për Zotin; mohimi i ekzistencës së Allahut xh.sh.

Kur'ani: shpallja e fundit nga ana e Allahut të madhërishëm në formë libri, që i është dhuruar njerëzimit nëpërmes pejgamberit të fundit Muhamedit a.s.

kurban: sakrifica, qoftë ajo dashi, viç apo deve prehet në tre ditët e para të Kurban-Bajramit. (Përveç aspektit fetar, Kurban-Bajrami ka edhe karakter humanitar-social).

Kurban-Bajrami (ar. 'Idu-l-'ad-ha); dita e sakrificës; së bashku me Fiter-Bajramin, festën e Ramazanit, ku myslimanët festojnë më 11, 12, 13 dhul-hixhe sipas kalendarit hixhri; paraqet përfundimin e haxhit ; Bajrami i haxhillëkut.

kursi: vend në xhami i ngritur mbi dysheme, i mbështetur në mur, zakonisht në anën e majtë të mihrabit, nga i cili duke qëndruar ulur ligjërohet apo këshillohet; foltore.

Kushtetuta e Bashkësisë Islame: akti më i lartë normativ i Bashkësisë Islame të Kosovës; i aprovuar nga Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë.

Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës: organi më i lartë përfaqësues dhe ligjdhënës i Bashkësisë Islame të Kosovës.

L

Lejletul-Berat: (ar.lejletu-l-berat): "Nata e përcaktimit të fateve dhe faljes së mëkateve"; nata e pesëmbëdhjetë e muajit shaban; nata e mirë (e madhe).

Lejletul-Kadr (ar. lejletu-l-kadri): "Nata e vendimeve"; nata e njëzet e shtatë e muajit Ramazan, në të cilën besohet se në vitin e nëntë para hixhretit ka filluar shpallja e Kur'anit të madhërishëm; natë e mirë (e madhe).

Lejletul-Miraxh (ar. lejletu-l-miraxhi): "Nata e ngritjes"; nata e njëzet e shtatë e muajit rexhep, në të cilën natë, Muhamedi a.s. me vullnetin dhe ndihmën e Allahut ka kaluar prej Mekes në Jerusalem (Isra) dhe prej Jerusalemit në afërsi të Zotit (miraxh) dhe është kthyer prapa; natë e mirë (e madhe).

Lejleletu-Regaib (ar. Lejletu-r-regaib): "Natë e dëshirës"; nata në prag të ditës së xhuma në muajin rexhep, në të cilën besimtarët u drejtohen me lutje Allahut të madhërishëm dhe luten për përmbushjen e dëshirave të tyre; natë e mirë (e madhe).

levha: tekst i shkurtër i Kur'anit i shkruar me shkrim kaliografik në ndonjë material apo në ndonjë mbajtëse për shkrim; shfrytëzohet për zbukurimin e mureve të brendshme të xhamisë, apo të shtëpive private, zyrave etj.; shprehje kulminante në artin islamik.

M

mahrem: i afërm i gruas me të cilin ajo nuk lejohet të martohet për shkak të afërsisë familjare; përcjellës i gruas në haxhillëk.

mahfil: galeri apo pjesa e sipërme e hapur në xhami, e caktuar për faljen e namazit dhe aktiviteteve tjera fetare. Në pjesën qendrore të përparme të mafilit, zakonisht ulet muezini gjatë kohës së faljeve të namazeve të përbashkëta. Në mafil zakonisht në disa xhami falen gratë.

Malik ibn Enes: jurist dhe dijetar i njohur i shekullit të tetë, sipas mësimeve të të cilit është themeluar shkolla e njohur juridike islame: medhhebi maliki.

Medina: qytet në Arabinë Saudite të sotme, në të cilin Muhamedi a.s. ka gjetur strehim pas dëbimit të tij prej Mekes; qyteti në të cilin ka vdekur dhe është varrosur Muhamedi a.s.; qyteti në të cilin gjendet xhamia e Pejgamberit a.s.; qyteti i Pejgamberit të Allahut".

medrese: shkollë e mesme islame në të cilën përgatiten imamët e ardhshëm, hatibët dhe mualimët (mësuesit).

mexhlis: njësi organizative e Bashkësisë Islame, e cila në realitet përfshin së paku shtatë xhemate, të cilët përbëjnë një tërësi të përbashkët; kuvend.

mehr: me rastin e martesës, obligimi material që merr mbi vete burri për t'ia paguar gruas; dhuratë e martesës.

mejit: njeri i vdekur.

mejtash: gur në formë kënddrejtë në oborr të xhamisë apo në hapësirën e varrezave, në të cilin me rastin e faljes së namazit të xhenazes, vendoset tabuti me të vdekurin; gur i xhenazeve.

Meka: qytet në Arabinë Saudite të sotme, në të cilin është lindur Muhamedi a.s., në të cilin ka filluar shpallja e Kur'anit, ku gjendet Qabeja dhe në të cilin për çdo vit shkojnë myslimanët nga të gjitha anët e botës për ta kryer haxhin.

mekruh: ajo që është e keqe dhe e qortueshme për ta kryer.

mekteb *(ar.kuttab):* mejtep**,** klasë, mësojtore**;** hapësirë apo objekt, në të shumtën e rasteve pranë xhamisë, në të cilin zhvillohet baza e mësimit fetar; institucioni i mësimit fillestar islam.

melek: qenie shpirtërore që nuk shihet e krijuar prej drite, e cila i nënshtrohet vazhdimisht urdhrave dhe adhurimit të Zotit të madhërishëm; nuk posedon lirinë e vullnetit.

mendub: ajo që është e bukur dhe e lëvdueshme për ta kryer; i deleguar apo përfaqësues.

menshura: akti me anë të cilit reisu-l-ulemaja i Bashkësisë Islame i jep legalitet dhe e legjitimon dikën për kryerjen e obligimeve islame, zakonisht kjo u lëshohet imamëve me rastin emërimit të tyre; menshuren reisu-l-ulema ia jep Komisioni, të cilin e emëron Kuvendi i Bashkësisë Islame.

merhamet: mëshirë, dhembshuri, shpirtmirësi, brenga për të tjerët.

Merjema: nëna e të dërguarit të Allahut, Isaut a.s.; Mejremja.

mesxhid: vendi në të cilin bihet në sexhde; vendi për kryerjen e namazit, i cili nuk është i domosdoshëm të jetë në kuadër të xhamisë; xhamia pa minare.

mesele (ar. mes'eletun): pyetje, temë, çështje, problem: teori shkencore, qëndrim.

meshihat: organi më i lartë fetar dhe administrativ i Bashkësisë Islame.

mevlud: lindje, i dymbëdhjeti i muajit rebiul-evel, dita e lindjes së pejgamberit të fundit, Muhamedi a.s.; manifestimi fetaro-kulturor me të cilin shënohet ditëlindja e Muhamedit a.s.

mezar: varreza; vendi në rrethinën e varrezave e shënuar me simbole apo pa to, në të cilin janë të varrosur të vdekurit.

mezaristan: shih: varreza.

medheb: (ar. medhheb) drejtim; shkollë juridike islame.

medhhebi hanefi: shkolla juridike apo drejtim islam i themeluar sipas mendimit juridik të Ebu Hanifes.

medhhebi hanbeli: shkollë juridike ose drejtim islam që është themeluar sipas mendimit juridik të Ahmed ibn Hanbelit.

medhhebi shafii: shkollë juridike apo drejtim në islam i themeluar sipas mendimit juridik të Ebu Abdullah Muhamed Shafiiut.

medhhebi maliki: shkolla juridike apo drejtim në islam i themeluar sipas mendimit të Malik ibn Enesit.

mihrab: pjesë e thelluar në brendi të pjesës së brendshme, në mes të murit të përparmë të xhamisë, ku qëndron imami, kur ai u prin xhematit me rastin e faljes së namazeve të përbashkëta.

minber: piedestal prej së paku tri shkallëve në anën e përparme të djathtë të këndit të xhamisë, nga i cili hatibi u drejtohet të pranishmëve ditën e premte gjatë faljes së namazit të xhumasë si dhe namazeve të bajramave.

miraxhi: ngritja shih: lejletul-miraxh.

mizan-terezi: peshorja absolute e saktë e Allahut të madhërishëm; mënyrë, metodë, instrumenti me të cilin do të vlerësohen dhe do të maten veprat e njerëzve në ditën e Gjykimit.

mualim (ar. mual-lim): mësuesi i cili ua mëson të tjerëve parimet e fesë islame.

mubarek: i bekuar; i zgjedhur.

mubarek (ditë): ditë e mirë, e zgjedhur, e bekuar; festë, ditë feste, e kremte.

mubarek (natë): natë e bekuar; natë e mirë, e madhe.

muderris (ar. muderr-rrsiun): profesor në medrese.

mullah[et: funksionarë myslimanë, të caktuar për kujdesin e xhamisë.

muxhahid: personi që bën përpjekje shpirtërore, intelektuale apo fizike për të ngadhënjyer e mira mbi të keqen dhe të drejtën e çdokujt ta praktikojë pa pengesë islamin; tekstualisht do të thotë; luftëtari në rrugën e Zotit.

muxhize (ar. mu'xhizetun): çudi; mundësia e krijimit të veprave të mbinatyrshme me të cilat ishin të pajisur disa pejgamberë të Allahut të madhërishëm.

muxhtehid: personi i përgatitur profesionalisht, mysliman apo myslimane, i cili bën përpjekje individuale për të arritur te një zgjidhje e çështjeve të hapura juridike; dijetari islam i rangut dhe autoritetit më të lartë.

mufsid: ngatërrestar, intrigant, i prishur.

myftija: organi kryesor fetar që përfaqëson Bashkësinë Islame në çështje që kanë të bëjnë me fenë në rajonin e myftillukut, komenton normat islame dhe jep fetfa, mbikëqyr punën e imamëve, hatibve, mualimve dhe muderrisve.

myftinija: zyra apo selia e myftillëkut.

muftillëku: njësi e organizuar e Bashkësisë Islame me myftiun në krye, e cila sipas rregullit duhet të përfshijë një apo dy kështilla, të cilët përbëjnë një tërësi të përbashkët.

Muhamedi a.s.: I dërguari i fundit i Allahut, nëpërmes të cilit njerëzimit i është shpallur Kur'ani i madhërishëm.

muharrem: muaji i parë sipas kalendarit hixhri.

muezin: person, i cili duke e kënduar ezanin me melodi i thërret besimtarët në faljen e përbashkët të namazit.

mumin: (ar. mu'min): besimtar; e kundërta e kafir.

munafik: hipokrit; dyfytyrësh në fe; personi që paraqitet se beson, në realitet është jobesimtar.

munara: (minaret): ndërtesë e lartë dhe e hollë në anën e djathtë të xhamisë, e cila para majës ka një ballkon (sherefe) nga e cila muezini thërret ezanin në namaz, deri tek e cila arrihet nëpërmes shkallëve të brendshme në formë spiraleje.

murasele: dekret; autorizim me shkrim të cilin reisu-l-ulemaja ia dorëzon myftive, muderrizve, imamve dhe hatibve për kryerjen e obligimeve të tyre.

murid: personi i cili pa fjalë i shërben tarikatit dhe shehit të vet; pasuesi i tarikatit me betim që është ende në fazën e nxënies së mësimit.

murtat; shih: murted.; tradhti.

murted: renegat i fesë; personi që ka zgjedhur një besim të ri; tradhtar; tekstualisht: murtat.

Musa a.s.: i dërguari Allahut nëpërmes të cilit Allahu i madhërishëm ka shpallur Tevratin, Musa a.s.

musala (musal-la): vend falje; vend publik në hapësirë të hapur, në lagje apo pranë saj, ku falen namazet e përbashkëta (në veçanti ato ku marrin pjesë një numër më i madh i besimtarëve, siç janë namazi i xhumasë dhe namazet e bajrameve).

Mus-haf: të gjitha tekstet e Kur'anit të përmbledhur në një koleksion, të cilët në kohët e hershme të islamit ishin të shkruara në materiale të ndryshme, të ndarë njëri prej tjetrit.

mysliman: personi që i nënshtrohet Allahut të madhërishëm, i cili i kryen urdhëratë e Tij dhe i largohet gjërave që i ka ndaluar Ai; tekstualisht: pasues i islamit.

Viti i ri mysliman (viti i ri i hixhretit): 1 muharrem; dita e parë i muajit të parë sipas vitit hixhri; dita kur myslimanët e shënojnë shpërnguljen e Muhamedit a.s., prej Mekes në Medine.

mustehab: atë që Muhamedi a.s. e ka porositur që të bëhet; gjëra të caktuara, të cilat e zbukurojnë namazin, por edhe pa të cilat namazi plotësisht do të jetë i saktë.

mushrik: politeist; ai që beson në shumë zota.

mutevelija: udhëheqës i vakëfit; kjo thirrje është familjarizuar për kryetarin e këshillit të xhamisë, do të thotë mutevilijët dhe emërtimet e tyre, sepse ata në mes tjerash kanë udhëhequr me pasurinë vakëfnore të xhamive.

Muzdelife: vend në rrugën mes Arefatit dhe Mines, në afërsi të Mekes, ku haxhilerët, në kuadër të obligimeve të haxhit janë të obliguar të qëndrojnë aty.

N

nafile: jo i obliguar, ibadet vullnetar; çdo namaz apo agjërim që nuk bie në rangun e obligimeve të domosdoshme (farz), e nuk është në nivel të sunetit.

namazi: (koha): koha e namazeve.

namazi (koha): periudha kohore e kryerjes së namazeve është 24 orë gjatë ditës dhe natës e ndarë në pesë kohë të namazit; vakti i kohëve të namazit.

namaz: (ar, salat): forma islame e kthimit të drejtpërdrejt të njeriut kah Krijuesi i vet; kushti i dytë i islamit.

nexhaset: i papastër, papastërti; gjërat që trupi i njeriu, rrobat dhe vendi rreth tij e bëjnë të papastër për kryerjen e obligimeve fetare.

namazi sabahut (ar. salatul-fexhr): namazi i sabahut, i cili falet para lindjes së diellit.

namaz (i drekës): (ar. salatu-dh-dhuhri): namaz i drekës, i cili falet në mes të ditës.

namazi i iqindisë (ar. salatu-l-'asr): namazi i pas drekës.

namazi akshamit (ar. salatu-l-magrib): namazi i akshamit (mbrëmjes), i cili falet menjëherë pas perëndimit të diellit.

namazi i jacisë: (ar.salatu-l-'isha): namazi i mbrëmjes, i cili falet kur mbretëron errësirë e plotë.

namazi i xhumasë (ar, salatu-l-xhumu'ah): namazi i obligueshëm i përbashkët javor, i cili falet në xhami ditën e premte në drekë.

namazi i teravisë (ar. salatu-t-teravih): namaz i natës i cili falet vetëm netëve të muajit ramazan pas namazit të jacisë; teravija.

nefs: në aspektin e gjerë shpirti, e në aspektin e ngushtë: ego.

nifas: çrregullimet pas lindjes (gjakderdhja e pakontrolluar) te gratë që mund të zgjasin deri në dyzet ditë; gjatë kohës së nifasit gruaja nuk është e obliguar të falet, nuk mund të lexojë Kur'an dhe nuk mund të ketë marrëdhënie seksuale.

nijeti (nijjet): qëllimi, vendimi për kryerjen apo destinimi; shprehja e cila është kusht për kryerjen e shumë obligimeve fetare islame siç janë namazi, agjërimi, zekati etj.

nikahi: kurorëzimi sipas sheriatit**.**

nishani: shënimi mbivarrezor në gur apo në dru në varreza.

O

Omer ibnul Hatab: as-hab, bashkëpunëtor dhe shok i pejgamberit Muhamedit a.s.; halifi i dytë.

Osman bin Affan: as-hab, dhëndër, bashkëpunëtor dhe shok i të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.; halif i tretë.

P

pejgamber: shih: resulullah, (i dërguari Allahut).

perdja: perde.

pir: shejh; epror; kryetar i familjes; prijës shpirtëror dhe themelues i një rendi të dervishëve.

i dërguar: shih i dërguari Allahut.

pustekija: postaqi e veçantë në të cilën është falur namazi në një mënyrë të veçantë e bërë prej lëkurës së deles.

Q

Qabeja: (ar. el-Ka'betu): qendra kryesore e botës islame; është e vendosur në xhaminë e shenjtë në Mekke; objekti i parë fetar apo shtëpia e parë për t'iu lutur Allahut të madhërishëm, të cilën e ndërtoi Ibrahimi a.s.; vendi në drejtim të cilit kthehen myslimanët gjatë faljes së pesë kohëve të namazit; shih: kibla.

R

r.a. shih: redi Allahu anhu: "Zoti qoftë i kënaqur me të (te)"; thuhet apo shkruhet pasi të përmendet apo të shkruhet njëri prej shokëve apo anëtarëve të familjes së Pejgamberit a.s.; shkurtimisht r.a.

rahmet: mëshirë e (Allahut).

rahmetli: ai që është në mëshirën e Allahut; shtohet para emrit të personit që ka vdekur.

rahmetlija: personi që ka vdekur.

ramazan: (ar. ramadan): muaji i agjërimit islam; muaji i nëntë i kalendarit sipas hixhretit.

Ramazani (agjërimi): agjërimi në muajin e ramazanit; agjërimi i obligueshëm; shtylla e tretë e islamit; shih: agjërimi islam.

rebiul-ahir (rebiu-l-ahir): muaji i katërt sipas kalendarit hixhri.

rexheb: muaji i shtatë i kalendarit hixhri.

reisul-uelema (reisu-l-ulema): titullar më i lartë fetar dhe myftiu kryesor i Bashkësisë Islame të një vendi; kryetar i Bashkësisë Islame.

resul: i dërguar; shih: resulullah.

resulullah: (ar. resulullah; pers. pejgamber): i dërguari i Allahut; personi të cilin Allahu i madhërishëm e ka zgjedhur që nëpërmes tij të dërgojë mesazhin ndonjë populli apo njerëzimit në tërësi; në përdorimin e përditshëm të myslimanëve, fjala i dërguari i Allahut ka për qëllim të dërguarin Muhamedin a.s.

riaset: organi më i lartë fetar dhe administrativ i Bashkësisë Islame të një vendi.

ruh: shpirt

ruku: përkulje; pjesë e namazit, e cila kryhet duke qëndruar në këmbë me boshtin e kurrizit të shtrirë përpara për afër nëntëdhjetë shkallë dhe krahët e mbështetur në gjunjë.

S

Sabah (namaz): shih: namazi i sabahut.

sabr: durim; cilësi njerëzore të cilën e potencon Kur'ani në shumë ajete.

sadaka: lëmoshë; ndihmë jo obligative, por e rekomanduar materiale ndaj të varfërve.

sadakatul-fitr (sadakatu-l-fitr): obligim fetar-material, i cili u jepet gjatë ramazanit, para Bajramit, të varfërve myslimanë dhe myslimane. Te ne është bërë traditë që kjo ndihmë materiale t'i dedikohet fondit për mirëmbajtjen e institucioneve të Bashkësisë Islame, Fakultetit të Studimeve Islame dhe Medresesë "Alauddin" në Prishtinë.

saf; radhë; radha e besimtarëve, të cilët radhiten në radhë të gjata dhe të drejta gjatë faljes së namazeve të përbashkëta.

safer (saffer): muaji i dytë i kalendarit hixhri.

sahibi-uzur: personi që ka ndonjë problem të përhershëm apo të përkohshëm që e prish abdestin. Personi i tillë derisa të vazhdojë problemi në fjalë është i obliguar që për çdo namaz të marrë abdest të ri.

saim: agjërues; personi që është agjërueshëm në momentin kur flitet për të.

salat: shih: namaz

savm: (ar.savm): agjërimi islam.

sebeb: shkak.

sebebi-nuzul: shkaku i zbritjes së disa ajeteve të Kur'anit apo të kaptinave të tij.

sexhde: rënia barkas, vendosja e ballit dhe hundës në tokë para Allahut të madhërishëm; pjesa obliguese e namazit.

syfir (ar. sehur): shujte para sabahut të cilën e hanë agjëruesit gjatë muajit të Ramazanit apo gjatë agjërimit vullnetar, para mëngjesit, para se të zdritet; syfiri nuk është obligim, kurse agjërimi edhe pa të do jetë i rregullt.

selam: paqe; versioni i shkurt i përshëndetjes islame; shih: selamun alejkum!

selamun alejkum! (ar. es-selamu 'alejkum!): "paqja (e Zotit) qoftë mbi ju!", (forma më e gjatë e selamit: es-selamu 'alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu: (Le te jetë me ju paqja, mëshira dhe begatia e Zotit!); përshëndetja islame.

sevab: shih: sevab.

sevab (ar. thevab): shpërblim; mirëbërja për të cilat Allahu në mënyrë direkte apo indirekte ka premtuar shpërblim; shpërblimi për mirëbërësi.

softa: vijuesi në medrese; nxënësi i cili edukohet dhe përgatitet për profesionin e imamit.

sulltan: sundues-komandant në shekujt e mesëm të islamit në vendet islame.

Dita e Gjykimit: Dita e kiametit; shih: kiameti.

sufara (supara): libër fillestar për mësimin e Kur'anit dhe të gjuhës arabe; njëri prej librave fillestar për ndjekjen e mësimit në mejtepe në të kaluarën.

sufija: ai zemra e të cilit është e pastër prej intrigave dhe dyshimeve; pasues i shkollës sufiste (mistike); shih: dervish.

sufizmi: shih: tesavuf.

sunetlluk: riti islam i sunetimit të fëmijëve meshkuj.

sunitët (sunni): ata të cilët në komentimin përveç Kur'anit, mbështeten në sunetin e Pejgamberit a.s.; shumica dërrmuese e popullatës islame në botë.

sunnet: përvoja e Pejgamberit a.s., e cila nënkupton atë që Pejgamberi a.s. e ka vepruar, duke folur apo në heshtje e ka lejuar; ibadeti, të cilin Pejgamberi a.s. vazhdimisht e ka vepruar "sunneti muekkede" (sunneti i fort) si dhe ato, të cilat nga një herë i ka lënë "sunneti gajri muekkede" (sunneti jo i fortë).

sure: kaptinë e Kur'anit.

SH

Shaban (sha'ban): muaji i shtatë sipas kalendarit hixhri

shalli: copë e pëlhurës së bardhë apo shall i lidhur rreth fesit të kuq; simbolizon njohuri islame; çallmë.

Shafiiu, Ebu Abdullah Muhamed: dijetar dhe jurist i njohur islam i shekullit të tetë dhe nëntë, në bazë të mësimeve të të cilit është themeluar dhe është quajtur shkolla juridike islame: medhhebi shafii.

medhhebi shafii: shkolla juridike apo drejtimi në islam që është themeluar në bazë të mendimeve juridike të Ebu Abdullah Muhamed Shafiiut.

shahid: dëshmitar.

shehadet: dëshmi; shih: kelimei-shehadet.

shehid: personi, i cili në luftën e tij të drejtpërdrejtë për vlerat islame dhe të drejtat e njeriut, me vetëdije të plotë dhe në emër të Allahut e sakrifikon jetën e vet; personi, i cili për shkak të veprave të tij të jashtëzakonshme në këtë botë u bashkëngjitet pejgamberëve të Allahut në xhenet.

shejh: dijetar i fesë; plak, i shtyrë në moshë; epror, mësues i fesë që merret me edukimin dhe mësimin e rregullave të misticizmit në teqe apo në ndonjë vend tjetër; personi që udhëheq hallkën e ziqrit, pranon dhe i prezanton në tarikat; epror i një rendi të dervishëve; shih: pir.

shejtan: qenie e padukshme shpirtërore, i cili mundohet ta çojë njeriun në mëkate dhe ta bëjë të padëgjueshëm ndaj Zotit.

sherefa: ballkoni i rrumbullakët para majës së minares nga i cili myezini thërret për namaz, tek i cili arrihet me anë të shkallëve spirale në brendi të minares.

sheriati: ligji islam.

sheval (shevval): muaji i dhjetë sipas kalendarit hixhri.

shiitët: pasuesit e medhhebit të veçantë të së drejtës islame dhe mbrojtësit të idesë se Aliu r.a.,ka qenë dashur të jetë halifi i parë pas vdekjes të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.

shirk: nënshtrimi dhe adhurimi kujtdo qoftë tjetër përveç Allahut të madhërishëm; politeizmi.

shura: kuvendim, këshillim, konsultë; marrëveshje; institucioni islam për marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe rregullimin e problemeve të rëndësishme.

T

tabut: bartëse e rrafsht prej druri në të cilën të vdekurit myslimanë apo myslimane barten deri te varrezat, edhe vendoset në varr.

takvim: kalendari sipas hixhretit; alamanku vjetor, i cili përveç teksteve shkencore-fetare përmban edhe kalendarin sipas hixhretit me datat kryesore si dhe me netët e mëdha në traditën islame, si dhe kohët e faljes së pesë kohëve të namazit; boton Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës.

tarikat: rrugë apo drejtim**;** metodologjia ideo-praktike e misticizmit.

tesavvuf: rrugë apo drejtim mistik.

texhvid: rregullat e leximit të Kur'anit; lëndë e veçantë në mejtepe; medrese. Fakultetet islame; libri për lëndën e texhvidit.

tefsir: komentimi; egzegeza e Kur'anit; disiplina shkencore që merret me studimin e llojeve dhe metodave të komentimit të Kur'anit.

tejemum (tejem-mum): pastrimi simbolik islam me dhe apo me lëndë prej dheu, i cili në mungesë të ujit të pastër e zëvendëson gusulin apo abdesin.

tekbir: (Allahu ekber! - Allahu është më i madhi!); madhërimi dhe lëvdimi i Allahut; fjalia me të cilën fillon secili namaz dhe me anë të së cilës ndahen pjesët përbërëse të tij; në formën e tij të zgjeruar janë edhe adhurimet tjera jo obligative siç janë: tevhidi (kelime-i- tevhidi), mevludi etj.

tekija (teqeja): institucioni themelor i tarikatit për kultivimin dhe përhapjen e arsimimit, shkencës dhe kulturës në thellimin e devotshmërisë; vend edukimi shpirtëror, e sipas nevojës edhe bujtinë.

namazi i teravisë (ar. salatu-t-teravih): namazi i natës i cili falet vetëm netëve të muajit ramazan, pas namazit të jacisë; teravia.

teravija shih: namazi i teravisë.

tesavuf (tesavvuf): zhvillimi i njohjes dhe forcimi i besimit se ekziston Krijuesi dhe se këtë e dëshmon dhe e vërteton e tërë natyra; shikoni fenë dhe jetën nëpërmes dashurisë ndaj Zotit.

teslim: përparësi Zotit; bindje (dëgjueshmëri) shejhit në tarikat.

tespih: adhurimi i veçantë, i cili përbëhet në formulimin e caktuar në të përmendurit të Zotit, i cili bëhet në fund të namazit e para lutjes (duasë) së namazit; mbyllja prej 33 apo 99 kokrrave të tespiheve, të cilat përdoren që me rastin e numërimit të tespiheve të mund të kontrollohet numri i fjalëve të shqiptuara apo sintagmave me anë të të cilave madhërohet Allahu apo falënderohet, por përdoret edhe për ibadetet tjera, siç është zikri.

Tesheh-hud: pjesa e obliguar e namazit, e cila kryhet duke qëndruar në pozitë ulur.

tevhid: njëshmëria e Zotit; tekstualisht: ritual vullnetar në të cilin madhërohet emri i Allahut dhe potencohet njëshmëria e Tij.

Tevrati: libri i Allahut i zbritur të dërguarit të Tij Musait a.s.

U

Uhud: kodër jo larg Medinës, në të cilin në luftën me politeistët e Mekkes, ka rënë shehid mixha i Pejgamberit a.s. hazreti Hamza së bashku me një numër të sahabeve të njohur.

ulema: dijetarë, shih: alim.

ummet: bashkësia botërore myslimane; populli.

Usuli – fikh: burimet e fikhut; shkenca që merret me studimin e burimeve të fikhut dhe metodat me anën e të cilave nxirren dispozitat (rregullat) e fikhut

V

vakufimi: me lënë testament, me lënë vakuf.

Vaxhib: dispozitë islame që ka obligueshmëri të shkallës së dytë për çdo mysliman dhe myslimane të moshës madhore; ato obligime islame edhe pse nuk bien në obligime rigoroze (farz), Muhamedi a.s. nuk i ka lënë.

Vahdanijet: njëshmëria e Zotit; shih: tevhid.

Vahj: shpallje; shpallja e Zotit; shpallja e fjalës së Zotit të dërguarve dhe pejgamberëve.

Vaiz: personi që mban ligjëratë- këshillë.

Vakat: koha; koha e namazit.

Vakif: testamentari i pronës personale.

Vaktija: koha e saktë për falje të kohëve të namazit për çdo ditë gjatë tërë vitit.

vakuf: pasuria e lënë testament për qëllime bamirësi, nën kushte të veçanta që gjenden në vakëfname. Kjo pasuri shfrytëzohet vetëm për destinim të caktuar dhe ajo nuk është në dispozicion të lirë të askujt; me pasurinë vakëfnore në Kosovë udhëheq Bashkësia e Kosovës; zyra e vakëfit ka për qëllim Këshillin e Bashkësisë Islame.

vakufname: dokument juridik për vakufim.

Vasiet (vasijet): testament.

vaz: shih: vaz e nasihat.

vazife: anëtarësia vullnetare vjetore që paguan çdo familje myslimane në një xhemat, me qëllim të pagimit të shpenzimeve të imamit dhe mirëmbajtjes së xhamisë.

vitr (namazi): namaz i obligueshëm (vaxhib) që falet natën, pas namazit të jacisë përbëhet prej tri reqateve.

viti i ri hixhri: shih: viti i ri i myslimanëve.

vudu (ar.ëudu'): shih: abdest.

XH

xhahil: injorant, i painformuar; i pa udhëzuar në rregullat fetare.

xhahilijet: gjendje e injorancës fetare; historikisht do të thotë periudhë para islame; kohë e mosnjohjes së adhurimit të Zotit.

xhaiz: i lejuar, e lejuar.

xhamia: institucioni themelor edukativo-arsimor i myslimanëve; objekti qendror me minare, ku myslimanët tubohen për ta kryer bashkërisht faljen e namazit, marrjen e mësimeve fetare si dhe kryerjen e obligimeve tjera ndaj Zotit.

xhehenem: vend në botën tjetër, ku mëkatarët do ta kryejnë dënimin e merituar sipas peshës së mëkateve që kanë bërë, apo kanë shkaktuar në këtë botë.

Xhelaluddin Rumi Mevlana) (1207-1273): poeti më i madh në gjuhën persiane, i cili ka themeluar rendin mevelevi të dervishëve.

xhemat: (ar. xhama'atun): grup, grumbull; njësia themelore e organizuar e bashkësisë islame, të cilën sipas rregullit e përbëjnë grupi prej njëqind familjeve të organizuara në mes vete për të kryer obligimet e përbashkëta islame; grup i besimtarëve në namazin e përbashkët në xhami apo në ndonjë vend tjetër.

xhematli: anëtar aktiv i xhematit.

xhenaza: ceremonia për varrimin e myslimanit apo myslimanes; shih: namazi i xhenazes.

xheneti: vend në botën tjetër për besimtarët e vërtetë dhe ata që kanë kryer vepra të mira, ku do t'i përjetojnë frytet e jetës së tyre të drejtë dhe të veprave të tyre të mira që kanë bërë në këtë botë.

Xhibrili (Xhebraili): meleku i ngarkuar për dërgimin e shpalljes pejgamberve; Xhebraili; i pari në mesin e meleqeve.

xhihad: synim, aspiratë, përpjekje; luftë; përpjekja shpirtërore, intelektuale apo fizike për inkurajimin e të mirës kundër të keqes dhe mbrojtjen e të drejtës të çdo njeriu, që në mënyrë të lirë dhe i papenguar ta praktikojë islamin; gjuhësisht: lufta në rrugën e Allahut.

xhind: krijesa të papapara të krijuara prej zjarrit, të cilët posedojnë inteligjencë dhe vullnetin e lirë dhe të cilët kanë aftësi të paraqiten në forma të ndryshme dhe të kryejnë punë të vështira.

xhybe (xhube): mantel i gjatë; zakonisht me ngjyrë të zezë apo të kaltër; pjesë e veshjes solemne e imamit.

xhumadel-ula (xhumade-l-ula): muaji i pestë sipas kalendarit hixhri.

xhunub: i papastër; personi i papastër për kryerjen e obligimeve fetare.

xhuz: njëri prej tridhjetë pjesëve me faqe të njëjta të Mus-hafit; përgjithësisht: pjesë e tërësisë.

Z

zahiri (medhhebi**):** shkollë juridike apo drejtim pak i njohur në islam, të cilin e themeloi Davud ibn Halef ez-Zahiri.

Zebur: Libri i Allahut që i është shpallur pejgamberit Davudit a.s.; Psalmet.

zekat: obligim vjetor për dhënien e përqindjes së caktuar nga lloje të caktuara të pasurisë, në Kur'an për qëllime të caktuara; shtylla e katërt e islamit.

zikr: përkujtimi dhe të përmendurit të Allahut, duke shqiptuar emrat e Tij si dhe duke menduar për Të; praktikë e rregullt, të cilën mistikët të udhëhequr nga shejhi e bëjnë në teqe.

zinaluk: kurvëri, amoralitet; marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore.

zul-hixhe (dhu-l-hixhxhe): muaji i dymbëdhjetë i kalendarit hixhri.

zul-kade (dhu-l-ka'de): muaji i njëmbëdhjetë i kalendarit hixhri.

Format e gabuara në përdorimin e disa nocioneve

Gabimisht	**Drejt**
Esselamun alejkum	Esselamu alejkum
	Selamun alejkum
Zotëri myfti	Shkëlqesia e tij myftiu....
Zotëri reisu-l-ulema	Eminenca e tij reisu-l-ulema ...
Bashkësia fetare islame	Bashkësia Islame
Lehva	Levha
Nata e Lejletul-Kadrit	Nata e Kadrit, Lejletul-Kadr
Tehvid	Tevhid
Besimtarë të fesë islame	myslimanë

Në numrin vijues: ***Glosari ortodoks***

Literatura:
1. Glosar religijskih pojmova, Sarajevë 1999.
2. Abdulah Skaljic, Turcizmi u srpskohrvatskom-hrvatskosrpskom jeziku, Sarajevë, 1973.

3. Nerkez Smailagaic, Leksokon Islama, Sarajevë, Svjetlost, 1990.
4. Teufik Muftic, Arapsko-Bosanski rjecnik, Sarajevë, 1997.
5. John L.Esposito, Oksfodrdska Istorija Islama, Beograd, 2002.
6. Religije svijeta, Krscanska sadsnjost Zagreb, 1987.
7. Akbar S. Ahmed, Zivi Islam, Srarjevë, 1993.
8. Deeb Al-Khudrawi, Dictionary of Islamic Terms, Damscus, 2004.
9. Akademik Ekrem Murtezai, Fjalor i terminologjisë fetare, Prishtinë, 2007.
10. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
11. Fjalor i shqipes së sotme, Toena, Tiranë, 2002.
12. Terminologjia islame, Prishtinë, 2006.
13. Tahir Dizdari, Orientalizmat në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.

Qemajl Morina

THE GLOSSARY OF RELIGIOUS NOTIONS

(Summary)

The study of religion is a necessity in the contemporary world. Religion does not have to do only with issues of cult, but is also closely connected with arts, literature and the organization of social life.

Science has its origins in religious centers. The science on religion is relatively new.

Religion has played a very important role in the survival of the Albanian nation. Initially, it was Christianity, which gave a strong sense of identity to the Albanians. Later on, it was Islam that helped the Albanians withstand the policies of their neighbors to occupy their territories and assimilate them.

The definition of the word terminology is a structured set of concepts and their designation in a particular subject field.

كمال مورينا

قاموس المفردات الدينية

(خلاصة البحث)

معرفة الدين تعتبر من ضروريات الثقافة المعاصرة، لانه من الصعب معرفة الانسان بدون معرفة عقيدته. الاديان لا تهتم فقط بال الدينية و الاخلاق بل هي تهتم بالفنون و الادب و تنظيم الحياة الاجتماعية. العلم كما هو معلوم لدينا فان بداياته قد نشأت في المراكز الدينية، اما فيما يتعلق عن علوم الدراسات الدينية انها حديثة العهد و هي ظهرت عندما بدأت الاصوات تعلو ضد الدين.

لقد لعب الدين دورا مهما عند العشب الالبانى بنفس الدرجة التي لعبها عند العشوب الاخرى و كان الدين المسيحى هو الذي رفع من شأن الشعب الالبانى و في فترة زمنية متأخرة كان الاسلام هو الذي حافظ على هوية الشعب الالبانى من السياسة السلافية و اليونانية من الذوبان في هو يتهما الصربية و اليونانية و ذلك عن طريق احتلال الاراضى الالبانية.

TRASHËGIMI

Zymer Ramadani*

SÂL-NÂMET - VJETARËT

Një ndër dokumentet më të rëndësishme që e shndrisin dhe ia rrisin vlerën historisë dhe pasurisë së Shtetit Osman, pa dyshim se janë edhe sâl-nâmet - vjetarët. Dihet se ky shtet kishte një administratë shumë të madhe dhe shumë të drejtë, andaj mu për këtë ka mundur të qëndrojë në këmbë mbi 500 vjet me radhë. Fjala *sâlnâme* është një fjalë persiane e formuar nga *sâl* që ka kuptimin *vit* dhe *nâme* që ka kuptimin *libër, shkresë*[1] etj. Kuptimi terminologjik i kësaj është se sâlnâme do të thotë vjetar, regjistër i tubuar për ngjarjet, ndodhitë, statistikat, gjendjen ekonomike, prodhimet dhe të bërat e një shteti (në këtë rast Shteti Osman) brenda një viti të caktuar të përfshira në një libër të veçantë.[2] Këtë nuk duhet ta kuptojmë se kjo ka të bëjë vetëm me pasurinë dhe arkën shtetërore të qendrës së Stambollit - gjegjësisht popullit turk, përkundrazi, gjatë kohës kur dominonte Shteti Osman, janë futur në regjistër të gjitha veprimtaritë e rajoneve që ishin brenda kufijve të këtij shteti. Për këtë duhet t'i largohemi bindjes dhe paramendimit se

* Selçuk Üniversitesi, Sosyal Bilimleri Enstitüsü, Yüksek Lisans öğr. Konya.

[1] Ferit Devellioğlu, Osmanlica Türkçe Ansiklopedik Lugat, f. 1100, Ankara, 1970.

[2] D. Mehmet Doğan, Büyük Türkçe Sözlük, f. 1137, boton Vadi Yayınları, botimi 15, Ankara, 2001; Türk Dil Kurumu (T.D.K.), Türkçe Sözlük, f. 1692, botimi 10, Ankara, 2005.

kur të përmendet fjala *sâlnâme* nuk donë të thotë se kjo ka të bëjë vetëm me regjistrimin e statistikave të turqve të vjetër, por kjo është e ndërlidhur direkt edhe me trojet shqiptare. Sepse që nga viti 1879 deri në vitin 1900 në trojet tona janë shkruar dhe botuar libra vjetarë apo *sâlnâme* të veçanta dedikuar trojeve tona, si; Salnamet e Vilajetit të Kosovës, Shkodrës, Shkupit etj. Këtë nuk duhet ta ngatërrojmë edhe me fjalën takvim-kalendar, edhe pse takvimi tregon për kohën dhe vendin e saktë të ndonjë gjëje pa marrë parasysh se çka është ajo, sâlnâmeja është krejtësisht tjetër.[3]

Duke u bazuar në burimet që kemi mundur t'i hasim nëpër disa arkiva dhe në disa libra tjera që gjenden nëpër biblioteka të ndryshme qoftë shtetërore apo private, më poshtë do të sjellim shkurtimisht njohuri rreth *sâlnâmeve* të Vilajetit të Kosovës dhe rrethinës së saj. Por, gjithmonë duke e pasur parasysh se në të ardhmen mund të dalë në pah edhe ndonjë dokument apo sâlnâme tjetër që nuk është zbërthyer apo regjistruar nga ana e drejtorisë së arkivave deri në ditët e sotme. Sepse, lirisht mund të themi se ende nuk është bërë mikrofilmimi, dokumentimi apo emërtimi i të gjitha dokumenteve që gjenden në arkiva. Është për t'u çuditur se këto dokumente të vjetra të trevave tona, mund t'i hasim edhe në pjesën e Anadollit, gjegjësisht në Arkivin Kombëtar të Dorëshkrimeve dhe atij Yusuf Ağa Kütüphanesi në ish-kryeqytetin e Selxhukëve në Konja si dhe në Arkivin Shtetëror në Antalja.

Për herë të parë në Shtetin Osman ka ndihmuar dhe që ka kërkuar të shkruhet sâlnâmeja, është Koxha Reshid Pasha me ndihmën e Ahmed Vekif Efendiut dhe Ahmed Xhevdet Pashës. Këtu duke dhënë kontributin e madh historiani Hajrullah Efendiu, në mes të viteve 1263-1847. Nga viti 1263 deri në vitin 1334 janë botuar 68 sâlnâme, e që këto janë quajtur *Sâlnâme-i Devlet-i Aliyye-i Osmaniyye* – Sâlnâmeja e Portës së Lartë Osmane, apo Sâlnâmet e Shtetit Osman. Më pas kjo detyrë iu transferua qendrës *Irade-i Seniye* dhe *Maarif Nezareti Mektubi Kalemi*. Me kalimin e kohës, kjo ka kaluar nëpër organe të

[3] M. E. B. Islam Ansiklopedisi, vëll. 10, f. 134, Istanbul, 1966.

ndryshme të shtetit. Nga sâlnâmet tjera që janë botuar, mund t'i klasifikojmë në pesë grupe kryesore, e që këto ndahen në nëngrupe tjera:

A. Devlet Sâlâmeleri - Salnametë Shtetërore:

Siç përmendëm edhe më lart, për herë të parë është shkruar me iniciativën e Koxha Reshid Pashës. Këtu bëjnë pjesë vetëm dokumentet zyrtare shtetërore.

B. Vilayet Sâlâmeleri - Salnametë e Vilajeteve:

Termi vilâjet me kalimin e kohës është përdorur edhe si ejâlet dhe sanxhak, që këtu mund të themi se në këtë grup hyjnë salnamet e komunave, krahinave, provincave dhe rajoneve të ndryshme. Për herë të parë thuhet se nga ky lloj i salnameve është shkruar në Trabzon - *Ilk Trabzon Vilayet Sâlâmelesi* në vitin 1866 (1286 h.) Mirëpo, sipas Sami Frashërit[4], Salnameja e parë e vilajeteve është ajo e Halebit, e shkruar në vitin 1284-1328. Edhe këto salname janë zyrtare por në një nivel më tjetër se ato të parat. Këtu do t'i përmendim vetëm salnamet e Ballkanit: Salnameja e Vilajetit të Bosnjës 1283-1308 (15 numra), Bosnja Hersek 1301 (5 nr.), Salnameja e Shkodrës-1299-1315 (5 nr.), e Kosovës - 1296-1318 (8 nr.), Manastir - 1292-1314 (9 nr.), Prizren - 1290 (1 nr.), Selanik, 1287-1325 (23 nr.), Shkup - 1311 (1 nr.).

C. Resmi Kurum ve Kuruşlara ait Sâlâmeler -Salnametë e Institucioneve dhe të Organizatave Zyrtare:

Këtu bëjnë pjesë salnametë e punuar nga disa burrështetas që me vullnetin e tyre kanë filluar një punë të tillë, për t'i tubuar veprimtaritë e tyre, që ishin të varura për ta etj. *Sâlnâme-i Askeri* (në mes viteve 1282-1326 janë shtypur 17 salname), *Harbiye Nezâreti ve Makam Seraskeri, Rasad'hane-i âmire Sâlnâmesi* (më 1288 është botuar vetëm një), *Sâlname-i Bahrî* (1307-1330, 17 numra), *Maârif Nezâreti Sâlnâmesi* (në mes viteve 1316-1321 janë shtypur 5 apo 6 salname), *Rüsûmât Sâlnâmesi* (1332, një numër), *İlmiyye Sâlnâmesi* (1334, një salname)[5]

[4] Şemseddin Sami, Kâmûsu'l A'lâm, III, 1916.
[5] M. E. B., po aty, f. 135.

D. Özel Konulu veya / Kişi ve Kuruluşlara Ait Sâlnâmeler – Salnametë me tematika të veçanta apo organizatave të individeve:

Nga vetë emri kuptohet se janë të llojit privat, e që këto i kanë shkruar organizatat private apo edhe ndonjë myfti etj. Mund të përmendim atë të Ali Suvariut, Ebuzziya Tevfik Beut etj.[6]

Në vitet e para të Tanzimatit Shteti Osman, trevat që i udhëhiqte i kishte ndarë në kontinente, qytete dhe krahina. Ato të Evropës, Azisë dhe të Afrikës. Sipas renditjes së tyre, shihet se Shteti Osman në Evropë ka pasur nën kontroll 15 ejâlete - krahina dhe 42 livâ[7] treva apo sanxhaqe, në Azi 17 ejâlete dhe 83 livâ, në Afrikë 3 ejâlete dhe17 livâ. Pra gjithsej 35 ejâlete, 142 livâ bashku me 1320 zonat tjera. Nga këto ejâlete Serbia dhe Egjipti ishin muhtâr (të pavarur në punët e brendshme, por nën kontroll nga jashtë).[8] Kjo kishte një veçanti për portën e lartë të Stambollit. Në krye të vilajeteve tjera ishte valiu, kurse të livâve ishte kajmekami, ndërsa te zonat tjera qëndronte një drejtor apo mbikëqyrës. Këtë po e paraqesim përmes një tabloje:

Nr. Rendor	*Emri i Ejâleteve*	*Emrat e Livâve*
2[9]	Silistre	Silistre - Varna
3	Bogdan	x
4	Eflak	x
5	Vidin	Vidin - Tërnova
6	Nish	Nish - Sofja - Samakov - Kostedil
7	Shkup	Prizren - Prishtinë
8	Serbi	x

[6] Hasan Duman, Osmanlı Sâlnâmeleri ve Nevasilleri, vëll. I, f. 3-17, Ankara, 1999.
[7] Këtu janë dhënë 15 ejalete dhe 42 liva, mirëpo në tabelën e dhënë ky numër nuk po na del. Sipas tabelës janë 12 ejalete dhe 26 liva.
[8] Ferit Devellioğlu, Osmanlica Türkçe Ansiklopedik Lugat, f. 939.
[9] Numër 1 është i shenuar ejaleti i Edirnës dhe kjo renditje vazhdon gjerë në numrin 35 tek ejaleti i Tunisit. Por këtu paraqitëm vetëm ejaletet ballkanike.

9	"Kalaja e Beogradit"	x
10	Bosnja	Bosnja - Hersek - Izvornik - Kliss
11	Rumeli "Shqipëria dhe Maqedonia"	Manastir - Shkodër - Ohër - Kesrije
12	Yanya (Epir)	Yanya - Berat - Ergiri - Prevezë
13	Selanik	Selanik - Tërhalla - Serez - Drama

Në vitet 1280 / 1863, për sistematizimin e ejaleteve Ali dhe Fuad Pasha, morën një iniciativë. Në atë kohë Valiu i Nishit Mit'hat pasha u ftua në Stamboll. Kurse Fuad Pasha bëri bashkimin e ejaletit të Nishit, Silistres, Vodinit dhe i dha emrin Tuna eyaleti. Në këtë mënyrë emri i eyaleteve u shndërrua në vilayete. Në Anadoll dhe Rumeli u formuan qendra të veçanta për këto çështje. Qëllimi ishte që edhe në vendet tjera të bënin një sistematizim të tillë.[10] Pasi që më herët e kishin emëruar Tuna vilajeti qytetin e Nishit, Silistres dhe Vodinit, përgatitën planin për Vilajetin e Bosnjës dhe kështu me radhë vazhduan të veprojnë sipas kësaj rregulle dhe vendimi të ri të cilin e vunë në fuqi edhe në vendet tjera. Për këtë më 1867 u shkrua edhe një dokument lidhur me këto ndryshime "*Idare-i Vilâyet Nizâmnâmesi*" dhe sipas kësaj u caktua kufiri dhe sipërfaqja e çdo vendi. Siç duket kjo ka ndikuar në të mirë të vendeve dhe popullit sepse, sipas kësaj ndarjeje, iu lehtësua orientimi popullatës. Ndarja apo sistematizimi i dytë duket në këtë mënyrë:

Tuna Vilayeti - Vilajeti i Tunes:

- Sanxhaku Rusçuk (qendra e vilajetit): Rusçuk, Silistre, Hezar grad, Xhuma, Zishtoj, Shumnu, Nigbolu, Plevne, Totrakan.
- Sanxhaku i Tulçës: Tulça, Synne, Maçin, Babadagi, Kostenxhe, Hërsova, Mexhidije.
- Sanxhaku i Vidinit: Adlije, Berkofça, Loma, Ivraca, Rahva, Beogradi i vogël (Belgradcik)

[10] Duman, I, 169.

- Sanxhaku i Sofjes: Sofja, Kostendil, Samakov, Dupnice, Raodmir, Izlad, Ihitman, Orhanije.
- Sanxhaku i Tërnovës: Tërnova, Gabrova, Lofca, Servi, Osmanpazari.
- Sanxhaku i Nishit: Nish, Shehirkoy, Leskofca, Ivranja, Yrgyp, Izenbol.
- Sanxhaku i Varnës: Varna, Pazarcik, Balçik, Piravadi, Mankalya.

Bogdan Eyaleti - Ejaleti i Bogdanit:

Jash, Bodiçan, Porogoj, Suçuva, Jinamç, Pijatra, Roman, Bakeno, Putna, Kaverluj, Totova, Vasluj, Fallçi, Hush.

Eflak Eyaleti - Ejaleti i Eflakut:

- Sanxhaku i Eflakit të Madh: Ilfovi me Bukureshtin, Jalomice, Ibrail, Silam, Riminku me Fokshan, Ruzao, Sokajni me Buko, Pirahuve, Dimojifce, Moshitel, Ercish, Otto, Deliorman me Turnu, Villashka me Jergok.
- Sanxhaku i Eflakit të Vogël: Dulci me Kiravje, Romançi, Vulçe me Rimnik, Gorçi, Mehedinçi me Gerneç.

Sırbistan Eyaleti - Ejaleti i Serbisë:

Beogradi me Hisarcikun, Semendere, Pozhorofca, Kranja me Nevahi, Cernycic, Gurgusefc, Allafsince me Isferragojefce, Rudnik, Çaçka, (Xhaak)Uzie, Valjevo, Kalaji Semendere, Kal'ayi Fet'hislam i e Klladuvja, Kal'aji Bogyrdlen, Kal'aji Sokol, Kal'ayi Uziçe.

Bosna Vilayeti - Vilajeti i Bosnjës:

- Sanxhaku i Saraj Bosnjës (Qendra e Vilajetit): Saraj Bosna, Visoka, Ronice, Klladine, Vishgrad, Çelebipazari, Çaniçe.

- Sanxhaku i Novipazarit: Novi Pazar, Metroviçe, Yeni (Novi) Varushi me Akoven, Buhur, Tergovishte, Tashleça, Brepol, Kollashën, Berata dhe Vasojuk.
- Sanxhaku i Benallukës: Gradishte, Teshne, Derbend.
- Sanxhaku i Izvornikut: Izvornik, Borcka, Sirebrenice, Muglaj (Magla) Beline, Berce, Grad çanie, Gradaç.
- Sanxhaku Bihke: Bihke me Piriduz Kozarca Magden, Kontenice, Istrosince, Krupe me Kellaç Nevesil.
- Sanxhaku i Hercegovinës: Hersek, Tirebin, Istollca, Liboshka me Nitrova Gonice, Foça, Nyvesin, Ballagaj, Gaçko, Tefeshnik.
- Sanxhaku i Travnikut: Travnik me Golhisar Jajca, Pridor Akhisar, Ihlivne, Galamaç.

Iskodra Vilayeti - Vilajeti i Shkodrës:

- Sanxhaku i Shkodrës: Shkodra, Podgorica, Ushbozi, Darci me Krovaje Peklin, Bar, Ylgyn, Zadrime, Bukai Ikbal, Tirana me Akhisar, Gusine, Ohri.
- Sanxhaku i Prizrenit: Prizreni, Peja, Gjakova me Alltuneli, Loma, Prishtina Kejlan, Vushtria (Vilçitirn).
- Sanxhaku i Dibrës: Debre, Elbasan, Mat, Kalkandelen (Tetova).

Yanya Vilayeti - Vilajeti i Janinës

- Sanxhaku i Janinës: Yanya, Meçova, Grebene, Ajdonat.
- Sanxhaku Ergiri: Ergiri, Delvinë, Filat, Pirmedi, Tepedelen.
- Sanxhaku i Beratit: Iskrapa, Tomanica, Avlonja.
- Sanxhaku i Narda Preveze: Narda, Margalic, Fener Pargo.
- Sanxhaku Yenishehir Fener: Glos, Terhalla, Çatallça, Kartaca, Alasonja.

Selanik Vilayeti - Vilajeti i Selanikut:

- Sanxhaku i Selanikut: Selaniku, Vodina, Karaferije, Kesendire, Dojran.
- Sanxhaku i Manastirit: Manastiri, Kopryly, Ergiri, Buxhak, Kesrije, Gorice.
- Sanxhaku Siroz ose Serez: Siroz, Nevrekop, Menlik.
- Sanxhaku Drama: Drama, Kavala, Jenixhe.
- Sanxhaku i Shkupit: Shkupi, Radofca, Romanova, Kalkandelen.[11]

Një ndarje tjetër e këtyre vilajeteve është bërë edhe ka fundi i sulltanatit të Sulltan Abdylhamidit II-të në vitin 1908.

A. Ejaletet që ishin të lidhura në qendrën kryesore:

Fillimi i mandatit (1876)	Sqarim	Fundi i mandatit (1908)
2. **Tuna**: Rusxhuk Varna Vidin Tullxha Tërnova	I është dhënë Bullgarisë (1878) “ “ “ “	
3. **Sofja:** Sofja Nishi	I është dhënë Bullgarisë (1878) “	
4. **Selanik**: Selanik Serez Drama		2. **Selanik**: Selanik Serez Drama Tashoz

[11] Hasan Duman, Osmanlı Sâlnâmeleri ve Nevasilleri, vëll. I, f. 168-172, Ankara, 1999. Emrat e qyteteve janë dhenë sipas asaj që janë shënuar nga Hasan Duman duke u bazuar në salnamet origjinale. Sigurisht se shumica e këtyre qyteteve sot kanë emra pak më ndryshe.

5. **Bosna**:		
Saraj	I është dhënë Imperatorisë	
Izvornik	Austro-Hungareze (1878)	
Benalluka	“	
Bilke	“	
Travnik	“	
Yenipazar	“	
6. **Hersek:**	I është dhënë Imperatorisë	
Hersek	Austro-Hungareze (1878)	
Goçkoll	“	
		3. **Kosova**:
		Shkup
7. **Manastir**:		Prishtinë
Manastir		Senixhe
Prizren		Pejë
Shkup		Tashllexha
Debre		Prizren
8. **Yanya**:		
Yanja		4. **Yanya**:
Terhalla		Yanya
Ergeri		Ergeri
Preveze		Preveze
Berat		Berat
		5. **Shkodra**:
9. **Shkodra**:		Shkodra
Shkodra		Drac

B. Sanxhaqet e pavarura.

C. Ejaletet tjera të zgjedhura:

1. Eflaku dhe Bogdani: Janë bërë të pavarura më 1877
2. Bejliku i Serbisë: “
3. Bejliku i Malit të Zi[12]: “

[12] Duman, I, 181-185.

SALNAMET E VILAJETIT TE KOSOVES
سالنامهء ولايت قوصوه

Vilajeti i Kosovës u formua në vitin 1877. Valiu i parë i saj ishte Halil Rifat Pasha. Siç e cekëm edhe më lart, në periudhën e fundit të Dinastisë Osmane vilajetet-prefekturat janë emëruar apo përdorur si ejalete - administrata lokale apo krahina dhe si udhëheqës i saj ishte valiu. Sanxhakët që ishin të lidhura me vilajetet, udhëhiqeshin nga kajmekami - nënprefekti që në kohën tonë quhet edhe prefekturë apo edhe komunë. Si udhëheqës më të mëdhenj për regjionet që ishin të lidhura me sanxhaqet ishin muteasarrifet, kurse për komunat dhe trevat tjera ishin drejtorët e po këtyre trevave.

Kufijtë e Vilajetit të Kosovës; në lindje Bullgaria, në perëndim Shkodra së bashku me Malin e Zi dhe Bosnjën, në jug vilajeti i Manastirit dhe Selanikut dhe në veri si fqinjë e ka Serbinë. Ky Vilajet ishte një vilajet shumë i madh me pozitë gjeografike që shtrihej nga Rumelia - jugu i Shtipit të Maqedonisë së sotme dhe që zgjat gjerë në veri jug të saj dhe nga sanxhaku i Tashlëxhes (Plevjes) që është në kufi me Bosnjën. Ky Vilajet ishte një vend i madh që dominonin etnitete të shumta si: Turqit, Shqiptarët dhe Boshnjakët e Ballkanit -të gjithë këta myslimanë-, pastaj Bullgarët, Maqedonët[13], Serbët, Romët, Ullahët-të gjithë këta të krishterë. Ishte fqinjë edhe me Serbinë, Malin e Zi që nga pushtimi i Austrisë - Hungarisë më 1878 edhe me Bosnja Hercegovinën.

Si kryeqendër e këtij vilajeti në mes viteve 1879-1893 ishte Prishtina, kurse nga viti 1893 ishte bërë qyteti i Shkupit. Në vitin 1893 ajo kishte një popullsi me 847.419 banorë. Nga këta 507.080 Myslimanë, 340.339 të Krishterë. Salnamja e Vilajetit të Kosovës gjithsejtë tetë herë është botuar. Së pari:

[13] Perandoria Osmane në regjistrimin dhe numërimin e popullatës këta i ka emëruar si Bullgar Maqedon.

- Në vitin 1879 (1296 hixhri) në Prishtinë në Shtypshkronjën e Vilajetit të Kosovës[14], plotë 154 faqe shtyp guri. Kurse të tjerat me radhë
- Në vitin 1883 (1300 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 178 faqe.
- Në vitin 1885 (1302 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 176 faqe.
- Në vitin 1887 (1304 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 314 faqe.
- Në vitin 1888 (1305 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 283 faqe.
- Në vitin 1893 (1311 hixhri) në Shkup, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 239 faqe.
- Në vitin 1896 (1314 hixhri) në qytetin e Shkupit, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 753 faqe.
- Dhe për fund Salnameja e Vilajetit të Kosovës është shtypur në Shkup më 1900 (1318 hixhri) në Shtypshkronjën e Vilajetit të Kosovës me plotë 936 faqe.[15]

I gjithë koleksioni i Salnameve të Vilajetit të Kosovës për fat të keq përveç bibliotekës Fatih Millet Kütüphanesi nuk gjenden askund nëpër bibliotekat tjera të Stambollit. Besojmë se është shumë e dobishme të ofrojmë një listë të bibliotekave që mund të gjenden këto vepra të çmuara. Koleksioni i plotë në fotokopje i këtyre salnameve gjendet në shoqatën Rumeli Vakfi.

[14] Origjinali: Kosova Vilayeti Matbaasi.
[15] Hasan Duman, Osmanlı Sâlnâmeleri ve Nevasilleri, Ankara, 1999.

BIBLIOTEKAT NË TË CILAT GJENDEN SALNAMET E VILAJETIT TË KOSOVËS[16]

Emri i Bibliotekës	*1296/ 1879*	*1300/ 1883*	*1302/ 1885*	*1304 1887*	*1305/ 1888*	*1311/ 1893*	*1314/ 1896*	*1318/ 1900*
Arkeoloji Müzesi Kütüphanesi		X		X				
Atatürk Kitaplığı (Taksim)	X	X	X	X	X		X	X
Başbakanlık Osmanlı Arşivi Kütüphanesi				X	X	X	X	
Beyazit Devlet Kütüphanesi				X				
Hakkı Tarık Us Kütüphanesi						X	X	
İstanbul Üniversitesi Kütüphanesi	X				X		X	
İ.Ü. Edebiyat Fakültesi Tarih Bölümü Kitaplığı	X	X						
Millet Kütüphanesi (Fatih)	X	X	X	X	X	X	X	X
Rumeli Türkleri Kültür ve Dayanışma Derneği Kütüphanesi	X	X	X	X	X	X	X	X

[16] Në listën e më poshtme paraqiten vitet sipas hixhretit dhe kalendarit miladi, kurse në rubrikat ku gjendet X-i gjenden Salnamet vetëm të atij viti që shënon aty. Pra, nëpër këto biblioteka tjera janë vetëm fotokopjet.

NJOHURI RRETH SALNAMES SË VILAJETIT TË KOSOVËS TË VITIT 1314 (1896)[17]

Ndër Salnamet e Vilajetit të Kosovës që ne i posedojmë dhe nga hulumtimet e bëra, më me përmbajtje të gjerë mund të themi se është ajo e vitit 1896 (1314), pasi që është nga më të vonshmet dhe për këtë ndarjen e qyteteve, fshatrave dhe vendeve tjera e ofron më në hollësi.

Në këtë salname në radhë të parë marrin vend takvimi dhe kohet e namazeve të vitit, më pas janë dhënë njohuri të hollësishme për mënyrat dhe format e të shkruarit nga shtresa e ulët dhe e lartë diplomatike, data e lindjes dhe vdekjes së padishahëve, viti i ardhjes së tyre në pozitë dhe vendet se ku janë të varrosur. Pas këtyre janë ofruar informata rreth medaljeve dhe shpërblimeve që u është ndarë ushtarëve dhe parisë me pozita më të larta.

Pasi që janë shënuar qendrat dhe organizatat ushtarake të Vilajetit, janë dhënë edhe emrat, pozitat, detyrat e të gjithë punëtorëve të shtetit dhe sanxhaqeve që ishin të lidhura për këtë vilajet. Këto gjashtë sanxhaqet dhe rrethinat e tyre janë:

1- Sanxhaku i Qendrës së Shkupit me rajonet; Shtip, Bereketli, Kumanovë, Radovishte (Radofcë), Palanka, Koçana dhe Orhanije.
2- Sanxhaku i Prishtinës me rajonet; Mitrovicë, Vuçitërnë, Gjilan, Preshevë.
3- Sanxhaku i Novi Pazarit me rajonet; Akova, Novi Varosh, Kollshin.
4- Sanxhaku i Prizrenit me rajonet; Tetovë dhe Luma, dhe krahinat; Gostivar, Radofc dhe Kalis.
5- Sanxhaku i Pejës me rajonet; Gjakovë, Brane, Tergovisht dhe Gosine.
6- Sanxhaku i Plevjes me rajonet; Prepol dhe Priboj.

[17] Kjo salname, është transkriptuar në alfabetin latin nga organizata dhe shtëpia botuese *"Rumeli Türkleri Kültür ve Dayanışma Derneği Yayınları"* në Stamboll, 2000.

Në salname mund të hasim data dhe vite të ndryshme që ndoshta nuk mund t'i hasim edhe nëpër enciklopeditë dhe fjalorët enciklopedikë. Prandaj, ne këtu do të sjellim njohuri rreth Salnames së Vilajetit të Kosovës سالنامهء ولايت قوصوه të vitit 1896. Këtu, në formë të një tabloje sa për ilustrim po fillojmë të japim informata rreth ditëve dhe netëve të shenjta fetare islame.

Data	*Muaji*	*Dita*	*Emri dhe dita e festës*
10	Muharrem	Dita e hënë	Dita e Ashurës
12	Rebiulevvel	Mbrëmja e Xhumasë	Nata e Mevludit
5	Rexheb	Mbrëmja e Xhumasë	Nata e Regaibit
27	Rexheb	Mbrëmja e Xhumasë	Nata e Miraxhit
15	Shaban	Mbrëmja e së martës	Nata e Beratit
15	Ramazan	Dita e mërkurë	Vizita e mjekrës Pejgamberit
27	Ramazan	Mbrëmja e së mërkurës	Nata e Kadrit
1	Shevval	Dita e Xhuma	Festa e Fitër Bajramit
9	Dhilhixhxhe	dita e mërkurë	Dita e Arefës dhe Qëndrimi në Arafat
10	Dhilhixhxhe	Dita e enjte	Festa e Kurban Bajramit

Katër Stinët e vitit

Vjeshta - Fasl-i Harif; Fillon me 15 Rebiulahir apo sipas kalendarit Rumi më 11 shtator, ditën e mërkurë.

Dimri - Fasl-i Shita; fillon më 16 Rexheb apo më datën 9 sipas Kanunit të parë Rumi.

Pranvera - Fasl-i Rebi'; fillon më 16 Shevval apo më 8 mars sipas kalendarit Rumi, ditën e xhuma.

Vera - Fasl-i Sajf; fillon më 10 Muharrem apo 9 qershor sipas kalendarit Rumi, ditën e hënë.

Zgjatja e kohës së stinëve						
Pranvera	91	Ditë	9	Orë	16	Minuta
Vera	92	Ditë	4	Orë	15	Minuta
Vjeshta	91	Ditë	4	Orë	18	Minuta
Dimri	90	Ditë	8	Orë	19	Minuta
	364		28		68	

Zgjatja e përbashkët e ditëve dhe netëve të Vjeshtës dhe Pranverës				
Masa e ditëve të Vjeshtës	16	Shtatorë - Rumi	28	Miladi
Masa e ditëve të Pranverës	3	Mars - Rumi	15	Miladi

Pas kësaj tabloje që paraqitëm këtu, shkurtimisht po ofrojmë njohuri të përgjithshme rreth përmbajtjes së salnames. Kjo salname, është shkruar në vitin 1896 (1314 hixhri) në Shkup, e shtypur për të shtatën herë në shtypshkronjën e po këtij vilajeti. Edhe pse është shkruar e shtypur në Shkup, titullohet "سالنامهء ولايت قوصوه - **Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova".** Flet rreth vilajetit të Shkupit, sanxhakut të Prishtinës, Novi Pazarit, Prizrenit, Pejës, Plevljes, rreth shqiptarëve, Shqipërisë dhe historisë së saj, të gjitha këto me rrethinat e tyre, duke filluar nga fshatrat, komunat e deri te qytetet. Për çdo fshat apo qytet janë dhënë informacione të hollësishme, si p.sh., numrit të popullatës së atij vendi, numrin e meshkujve dhe femrave, myslimanëve dhe të krishterëve, medreseve, xhamive, kishave, urave, qendrës së komisariatit policorë, tubimit të pasurisë vjetore, drithërave, kohen e korrjes së tyre, hyrjes dhe daljes së mallrave nga jashtë. Pastaj rreth historisë dhe pozitës gjeografike të këtyre vendeve, ndarjen administrative, ekonominë, kulturën, rreth personaliteteve të ndryshme etj. Thënë shkurt, gjithçka që ka ndodhur është regjistruar me një përpikëri të madhe.

Në fund të salnames nga ana e transkriptesit H. Yıldırım Ağanoğlu është dhënë edhe një lloj fjalorthi, që sadopak t'i mundësohet lexuesit për kuptimin e disa fjalëve të vjetra. Përveç kësaj janë dhënë edhe disa fotografi të xhamive dhe qendrave ushtarake. Fotografia e Xhamisë së Isa Beut në Shkup, Mustafa Pashës, Shkup, fotoja e Mektebit Ushtarak në Shkup, mirëpo kjo foto nuk ekziston në origjinal, por vetëm në arkivin e shoqatës, Spitali ushtarak në Shkup, fotoja e Xhamisë së Sulltan Muratit dhe Saat Kulesi (edhe kjo foto nuk gjendet në origjinal por është vendosur nga arkivi i shoqatës), Ura e Gurit në Shkup, Xhamia e Sulltan Muratit të II-të në Shkup, ndërtesa e qendrës Bujqësore në Bardofc të Shkupit, foto nga pamja e fshatit Janjevë të Prishtinës, Stacioni i Kaçanikut, Qendra Shtetërore në Prishtinë, një pamje e Prizrenit (vendosur nga arkivi i shoqatës), fotoja e Xhamisë së Sinan Pashës, një pamje tjetër e Prizrenit fotografuar nga kalaja, foto nga reparti ushtarak në Novi Pazar, dhe xhamia e Valide Sulltanit në Seniçe. Kjo salname ka gjithsej 382 faqe bashkë me fjalorthin dhe fjalën hyrëse.

Zymer Ramadani

SALNAME-YEARBOOK

(Summary)

Among the most important documents that shed light on the history and wealth of the Ottoman Empire are the salname. It is a well-known fact that the Ottoman Empire had a huge and proficient administration, which guaranteed its prolonged existence. Salname comes from the Persian words *sal* ("year"), and *name* ("book"). Salnames contained information on different events, statistical data, the economic situation, etc. They were first published by the central Ottoman government and later by provincial authorities as well. Between 1879 and 1900 a number of yearbooks were prepared having to do with the territories inhabited by Albanians.

زمر رمضان

الصالنامه – السجل السنوى

(خلاصة البحث)

من الوثائق التي ترفع من شأن تاريخ الدولة العثمانية لا شك انها الصالنامه أو السجلات او التقارير السنوية. و كما هو معروف فان الدولة العثمانية مع مساحتها الواسعة و حدودها مترامية الاطراف كانت لها ادارة منظمة و عادلة الامر الذي مكنها ان تسيطر على مساحات شاسعة من الارضى لمدة خمسمائة عام.

الكلمة "صالنامه" هي كلمة من أصل فارسى و مشتقة من كلمة "صل" و معناها "سنة" و "نامه" و معناها "كتاب" أو "رسالة". و معناها الاصطلاحى سجل أو تقرير سنوى حيث يتم تسجيل تقارير مختلفة عن الاحداث و الاحصائيات و الحالة الاقتصادية و المنتجات المختلفة التي تم انجازها من قبل الدولة العثمانية خلال سنة واحدة و التي يتم تسجيلها في كتاب واحد.

PORTRETE

Dr. Riza Sadiku *- Muzeu i Kosovës*

KONTRIBUTI SHKENCOR DHE KOMBËTAR I prof. dr. HASAN KALESHIT

Më 19 korrik të vitit 2006, u bënë 30 vjet, prej kur studiuesi, hulumtuesi dhe poligloti i kohës me famë botërore, prof dr. Hasan Kaleshi ndërroi jetë në moshën 54-vjeçare në Prishtinë, i cili tërë jetën ia kushtoi veprimtarisë shkencore, duke lënë pas vetes mbi 400 njësi bibliografike. Punimet e të cilit për shkak të origjinalitetit dhe rreptësisë shkencore, jo vetëm që u botuan në revistat më të njohura evropiane, por zgjuan interesim të veçantë edhe tek institucionet më të larta me famë evropiane dhe botërore, të fushave përkatëse, si në atë të orientalistikës, turkologjisë, historisë, gjuhësisë, etnologjisë etj.

Ky personalitet kaq i lartë shkencor, për mendimin tim, ende i pazëvendësueshëm në fushën e shkencës në mbarë trojet etnike shqiptare, përvjetori i të cilit thuajse kaloi në heshtje, pa u shënuar askund. Me gjithë që një numër i studentëve tij sot janë profesorë të universiteteve, disa janë edhe në pozita të larta institucionale dhe politike. Shpresoj se një lëshim i tillë do të kompensohet gjatë vitit 2007, me rastin e shënimit të 85-vjetorit të lindjes së dr. Hasan Kaleshit, me ndonjë akademi përkujtimore, ose tribunë shkencore.

Prof. Dr. Hasan Kaleshi

Me qëllim të shënimit të përvjetorit të lartpërmendur, provokimit të ndërgjegjes institucionale dhe intelektuale të përfaqësuesve kompetentë, si dhe për të zgjuar interesimin intelektual dhe kombëtar për ato që nuk e njohin dhe nuk kanë dëgjuar sa duhet për veprimtarinë shkencore, intelektuale dhe kombëtare me përmasa botërore, në kuadër të këtij punimi do të provoj të vë në spikamë, në pika të shkurtra shënimet biografike dhe të disa njësive bibliografike të kolosit të shkencës, prof. dr. Hasan Kaleshit.

Hasan Kaleshi rrjedh prej një familjeje intelektuale. Gjyshi i tij Aliu ka kryer shkollën fetare në Stamboll. Ai ka pasur dy djem, Hasanin dhe Ahmedin. Ahmedi, ka ndjekur rrugën e babait, i cili ka kryer shkollën "Fatih" në Stamboll, më vonë ka shërbyer si hoxhë me autoritet në Kërçovë dhe rrethinë. Për shkak të rrethanave politike të kohës, në vitin 1919 vendoset në fshatin Sërbicë, 10 km larg Kërçovës. Ahmedi martohet me Hajrijen[1] nga Kërçova, me të cilën kishte *pesë djem* dhe *katër vajza*. Njëri ndër pesë djemtë e Ahmedit është dr. Hasan Kaleshi. Në vitin 1957, në kohën e shpërnguljes së madhe me

[1] Hajrija, është shqiptare myslimane nga Kërçova e martuar për Ahmed Kaleshin, me te ka pasur katër vajza dhe pesë djem, (Hysenin, Hasanin, Jonuzin, Omerin dhe Llukmanin). Njëri ndër djemtë e Hajries siç theksohet është edhe Omeri. Artikulli i botuar në gazetën Ylliria në vitin 2004, në te cilin bëhet fjalë për veprimtarinë artistike të Omer Kaleshit në Paris, në të thuhet se nëna e tij është maqedone, një teori e tillë është e pa qëndrueshme dhe në kundërshtim me realitetin, argumentet flasin ndryshe.

dhunë të shqiptarëve, familja e ngushtë e Hasan Kaleshit shpërngulet në Turqi, në Jugosllavi mbetet vetëm Hasani[2].

Hasan Kaleshi u lind më 7 mars 1922 në fshatin Sërbicë të Kërçovës, në Maqedoni. Si gjashtëvjeçar, mësimet e para i mori në gjuhën arabe nga i ati, ndërsa në moshën dhjetëvjeçare e dinte *Kur'anin* përmendësh[3].

Hasani shkollën fillore në gjuhën serbo-kroate e kreu në vendlindje, gjashtë klasë në *Medresenë e Madhe "Kral Aleksandar" në Shkup*, kurse dy vjet të shkollës së mesme në gjimnazin *"Sami Frashri" në Prishtinë*. Pas mbarimit të gjimnazit, gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore punësohet si përkthyes, pasi në atë kohë ka njohur mirë disa gjuhë të huaja, në mes të cilave edhe gjermanishten e italishten[4].

Në shtator të vitit 1946 regjistrohet në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në *Degën e Orientalistikës* dhe atë të *Romanistikës*, në të dyja degët i jep të gjitha provimet, kurse diplomon orientalistikën në vitin 1951, me sukses të shkëlqyeshëm, me notë mesatare *nëntë (9)*. Gjatë studimeve, për shkak të kushteve të vështira ekonomike punon punë të ndryshme fizike. Prej vitit 1947-1950, punon si përkthyes dhe lektor në redaksinë e gjuhës shqipe të Radio Beogradit. Në shkurt të vitit 1952 emërohet profesor i shkollës së mesme në *Katedrën e Filologjisë Orientale në Beograd*, ndërsa në vitin 1955 asistent. Më *26 shkurt 1960*, në Fakultetin Filozofik në Beograd, në mënyrë brilante mbron tezën e doktoratës me titull: "*Najstarij vakufski dokumenti iz Makedonije na arapskom jeziku"* (Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Maqedoni). Po këtë vit konkurron për docent në katedrën e lartpërmendur, në bazë të referatit pozitiv, të nënshkruar nga dy profesorë të rregullt dhe autoritativ të Universitetit të Beogradit, por zgjedhja e tij pezullohet për arsye të pa njohura, deri në vitin

[2] *Abdulla Bekteshi*, deklaratë gojore, Kërçovë 1996, bashkahonik i vendlindjes i H. Kaleshit, ende jeton në f. Sërbicë të Kërçovës, tani 83 vjeçar. Ndërroi jetë në vitin 2006.
[3] Dr. *Hasan* Kaleshi, *"Najstari Vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku"*, Prishtinë 1972, f.11. Gjerësisht shiko: Dr. Hasan Kaleshi, Intervistë dhënë gazetës AL MASA, 20 maj 1967, Kajro.
[4] *Abdulla Bekteshi*, deklaratë e cituar.

1965, për shkak të kësaj zhagitje demoralizohet dhe e lëshon fakultetin[5].

Dr. Hasan Kaleshi me publikime shkencore filloi të merret prej vitit 1949, por punimet e Hasanit, sidomos nga fusha e turkologjisë u bien në sy shkencëtarëve më eminent të kohës dhe përcillet me simpati të veçantë dhe vlerësim të lartë, për çka në vitin 1965 i ndahet edhe bursa shtetërore gjermane përmes *Shoqatës së Studimeve Uralo-Altaike të Universitetit të Hamburgut*. Në këtë qytet qëndron dy vjet, duke specializuar turkologjinë te profesori me famë botërore *Dr. Annemarie von Gabain*. Gjatë qëndrimit të tij në Hamburg, mban edhe disa ligjërata në gjuhën shqipe pranë *Katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Hamburgut*[6].

Ka mesi i vitit 1967, me ftesën e qeverisë të Egjiptit, dr. Hasan Kaleshi qëndron tre muaj mysafir në institucionet shkencore të Kajros. Gjatë kësaj kohe së bashku me *Kamil el Buhajin* përgatisin për shtyp fjalorin e madh serbokroatisht-arabisht, punë që mbetet e pa përfunduar për shkak të shpërthimit të luftës arabo-izraelite[7].

Në shtator të vitit 1967, dr. Hasan Kaleshi zgjidhet bashkëpunëtor i *lartë shkencor në Institutin Albanologjikë të Prishtinës*, tre vjet më vonë zgjidhet profesor ordinar në *Fakultetin Filozofik të Prishtinës*, kurse gjatë vitit akademik 1973/74, me iniciativën e dr. Hasan Kaleshit hapet për herë të parë *Katedra e Orientalistikës* pranë Universitetit të Prishtinës. Derisa punonte në Prishtinë dr. Hasan Kaleshi, në bazë të punës së tij shkencore zgjidhet anëtar redaksie gati në të gjitha revistat shkencore që botohen në Kosovë, dhe koncepti i tij ka qenë, disa nga ato revista të botohen në gjuhë të huaja, me qëllim që opinioni i gjerë botëror të njihet me rezultatet shkencore të Kosovës, mirëpo në atë kohë si duket nuk gjeti mirëkuptim sa duhet. Duhet theksuar se dr. Hasan Kaleshi gjatë kësaj kohe ka qenë anëtar redaksie edhe në disa revista shkencore, të cilat botoheshin në *Beograd, Shkup, Sarajevë, Minhen, Istambul, Berlin, Getingen, Hamburg* etj., si dhe bashkëpunë-

[5] Gjerësisht shiko: *Bilten Beogradskog Universiteta*, br. 201, 16 juli 1960, Beograd.
[6] *"Politika"* 30 jul 1967, Beograd, 6.
[7] *AL-MASA*, 20 maj 1967, Kajro.

tor i disa enciklopedive me karakter botëror: *Enciklopedisë Islame* që botohej në *Stamboll, Enciklopedisë Arabe* me qendër në *Frankfurt, Enciklopedisë Kinematografike* në *Gotingen*, Leksikonit *Zyr Geschichte Sudoseuropas,* që botohej në Minhen etj[8].

Dr. Kaleshi për shkak të aftësive të tij shkencore dhe profesionale ishte anëtar nderi, anëtar me korrespondencë dhe bashkëpunëtor i disa shoqatave shkencore, institucioneve dhe disa akademive botërore si: *Anëtar me korrespondencë i Akademisë të Gjuhës Arabe të Kajros,* i vetmi nga ish- Jugosllavia, anëtar i *Shoqatës Ndërkombëtare Shkencore "Uralo-Altaica"* në *Hamburg*, anëtar i *Konferencës Altaistike të Blomingtonit në SHBA-së*, Bashkëpunëtor i *Akademisë të Shkencave të Bullgarisë në Sofje*, Bashkëpunëtor i Institutit të *Filmave Shkencor dhe Dokumentar të Gotingenit, në Gjermani,* etj, institucioneve[9].

Veprimtaria shkencore e dr. Hasan Kaleshit është shumë e gjerë dhe shumëdimensionale. Këtë ia mundësuan njohuritë e gjëra enciklopedike që posedonte si një erudit dhe poliglot i madh, talenti dhe metodologjia e punës shkencore. Dr. Hasan Kaleshi ishte një burim i pashtershëm i njohurive shkencore që posedonte, pasi ishte në gjendje rregullisht t'i përcjellë rezultatet e publikuara shkencore në të gjitha qendrat botërore, këtë ia mundësonin njohja e disa gjuhëve të huaja. Pos gjuhës amtare *shqipes*, nga gjuhët orientale, botërore dhe ballkanike, me të cilat komunikonte, shkruante dhe i lexonte për mrekulli ishin: a*rabishtja, osmanishtja, turqishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja, latinishtja, serbishtja, maqedonishtja, kurse anglishten, rusishten dhe bullgarishten* e ka lexuar dhe shkruar. Ai, në të vërtetë nuk ishte vetëm njohës i mirë i këtyre gjuhëve, por edhe kulturave të tyre. Si i tillë i kishte të gjitha parakushtet e prirjet të merrej me veprimtari shkencore në shumë disiplina. Problemet që shtronte dhe me të cilat merrej prof. dr. Hasan Kaleshi, nuk i trajtonte në mënyrë sipërfaqësore, por në mënyrë të thelluar dhe të argumentuar, duke depërtuar

[8] Riza SADIKU, Hasan Kaleshi, Jeta dhe vepra, Monografi 413 fq., Shkup 1996, fq. 18-20.

[9] *Qani Mehmedi*, Bibliografi selektive e punimeve të Dr. Hasan Kaleshit, JEHONA IV, 1976 Shkup, 235.

thellë në ndriçimin dhe në studimin e tyre në mënyrë shumë kritike e analitike, jo vetëm në çështjet e pa studiuara e të pazbuluara, por edhe për ato të keqinterpretuara ose të studiuara sipërfaqësisht, si nga fusha e orientalistikës, turkologjisë, albanologjisë dhe historia e Perandorisë Osmane. Dr. Hasan Kaleshi me punën e tij shkencore nuk shquhet vetëm si orientalist dhe turkolog i njohur dhe i pranuar në botë, por kontributi i tij nuk është i vogël as në fushën e gjuhës, letërsisë dhe historisë kombëtare shqiptare[10].

Bibliografia e punimeve shkencore e dr. Hasan Kaleshit paraqet një opus shumë të gjerë në fusha të ndryshme si: në *onomastikë, në arabistikë, në turkologji, në albanologji, në filologjinë komparative, në historinë e kulturës shqiptare gjatë periudhës së Perandorisë Osmane*. Kontribute të veçanta dr. Kaleshi ka dhënë në zbulimin e shkrimeve më të vjetra arabe në *Maqedoni dhe në Kosovë*, në botimin e veprave dhe studimeve të veçanta, në përkthimin e librave të veçanta, në hartimin e fjalorëve dhe teksteve të veçanta për Katedrën e Orientalistikës, në botimin e fejtoneve, kritikave dhe reçenzioneve të ndryshme etj. Opusi i përgjithshëm i veprimtarisë shkencore i dr. Hasan Kaleshit arrin në afro *400 njësi bibliografike*. Punimet e tij i shquan rreptësia shkencore, objektiviteti i rrallë, paluhatshmëria dhe paanësia. Dr. Kaleshi kishte energji, guxim dhe aftësi intelektuale të merret me shumë disiplina shkencore, pasi njihte shumë gjuhë orientale dhe botërore dhe dispononte dokumente autentike burimore, kishte mundësi të ballafaqohet me çështjet më të ndjeshme shkencore, virtyte të cilat emrin e tij në fushën e dijes dhe shkencës e bëjnë të njohur dhe të pranuar në përmasa botërore. Duke qenë i tillë, punimet e tij janë botuar në shumë revista shkencore në qendra të ndryshme të botës si në:

[10] *Riza SADIKU*, Dr. Hasan Kaleshi, Muncher Zeitschrift Fur Balkankunde, I Band, 1978 Munchen, 1-15. Gjerësisht shiko: *Riza Sadiku*, In Memoriam, Dr. Hasan Kaleshi "J I Ç", nr. 1-2 1979, Beograd.

Minhen, Berlin, Paris, Hamburg, Romë, Stamboll, Athinë, Ankara, Bukuresht, Kajro, Damask, Vjenë, Çikago, Nju-Jork etj[11].

Dr. Kaleshi përmes publikimeve shkencore krijoi autoritet ndërkombëtar, si i tillë ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë në më se 40 kongrese ndërkombëtare me referate dhe kumtesa si në ish-Jugosllavi ashtu edhe në vende të ndryshme të botës si në: *Paris, Romë, Vjenë, Insbruk, Hamburg, Berlin, Minhen, Bukuresht, Athinë, Sofje, Stamboll, Ankara, Napoli, Berrnë, Stasburg, Getyngen, Grac, Tiranë, Çikago etj*. vende[12].

Dr. Hasan Kaleshi punoi pa ndërprerje dhe gjithmonë i preokupuar me shkencë dhe me fushën e paskajshme të dijes, duke mos u kujdesur sa duhet për shëndetin, ndërrojë jetë nga sulmi në zemër në moshën 54-vjeçare, më 19 korrik 1976, në Entin për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kosovës në Prishtinë, duke lënë pas vetes bashkëshorten dhe dy djem. Vdekja e gjeti në detyrën e *shefit të Katedrës të Orientalistikës*. Pas katër ditë bisedimesh dhe polemikash lidhur me vendvarrimin e të ndjerit, me dëshirën e familjes së ngushtë, më 23 korrik varroset në Beograd te varrezat e myslimanëve[13].

Vepra më monumentale e prof. dr. Hasan Kaleshit është "*Najstariji Vakufski Dokumenti u Jugoslaviji na Arapskom Jeziku"* (Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në Jugosllavi në gjuhën arabe), në të cilën është botuar kodeksi më i madh i vakëfnameve deri atëherë në botë në gjuhën arabe nga terreni i Maqedonisë dhe i Kosovës. Vepra ka një rëndësi të madhe kulturore jo vetëm për historinë e monumenteve të kulturës osmane, por edhe ma gjerë. Një vepër e tillë zgjoi interesim të madh në qarqet shkencore ndërkombëtare, për të cilën janë shkruar dhe botuar një numër i madh recensionesh afirmative, në revistat më të njohura të Evropës si në: *Sudost-Forschungen* në Munih, *Revue des*

[11] Gjerësisht shiko: *Riza Sadiku*, Hasan Kaleshi Jeta dhe Vepra, Monografi, Shkup 1996, fq. 18-76, *Idriz Lamaj*, Hasan Kaleshi Dr.Ibrahim Temo, frymëzues revolucionar dhe mendimtar nga Struga, New York 1982, fq. 44-62.

[12] *Qani Mehmedi*, Bibliografi selective e punimeve të prof. dr. Hasan Kaleshit, "JEHONA" IV, Shkup 1976, fq. 235

[13] In Memoriam, BOTA E RE, 1976, Prishtinë.

Etudes Balkanique në Sofje, *Der Islam* në Hamburg, *Zeitschrift der deutschen Morgenlandschen Gesellschaft* në Bon, *Arabica* në Paris, *Oriente Moderne* në Romë, *Revue des Etudes Islamiques* në Paris, etj[14].

Para se të flasim për zbulimin e vakufnameve më të vjetra në ish-Jugosllavi nga dr. Hasan Kaleshi, të sqarojmë se çka janë fakufnamet. Sipas rezultateve shkencore, vakufnamet janë dokumente zyrtare gjyqësore që flasin për themelimin e një vakëfi nga ana e një mirëbërësi. Këto dokumente ndahen në *mbishkrime të vakëfeve, shënime të vakëfeve* dhe *vakifije*. Sipas dr. Kaleshit, është ruajtur një numër shumë i vogël i mbishkrimeve dhe shënimeve të vakëfeve, dhe mjerisht nuk ekziston një kriter i unisuar i botimit të tyre[15].

Vakufnamja më e vjetër në ish-Jugosllavi, qoftë në gjuhën arabe apo turke, si dhe dokumenti më i vjetër nga periudha osmane është ai i *Sunkur Çaush Beut nga Manastiri,* i cili daton prej vitit *1435*. Sunkur Çaush Beu ka qenë një nga komandantët e Sulltan Muratit të Dytë (1421-1451), pas një lufte kundër Skënderbeut, kur ushtria e Sulltanit kthehej nga Shqipëria, Sunkur Beu ndalet në Manastir (sot Bitol), për shkak të pozitës gjeografike të këtij qyteti. Në Manastir Sunkur Beu ndërtoi një xhami, e cila ka qenë më e vjetra në ish-Jugosllavi, dhe njëra ndër më të vjetrat në Ballkan. Xhamia në fjalë ka ekzistuar deri në vitin 1946 në rrugën "Ivan Milutinoviq" (kur autori ka bërë hulumtimet), kurse ky vend më herët është quajtur "Tereke pazari" (pazari i drithit) të cilën e kanë prishur, dhe në vendin e saj është ndërtuar një ndërtesë banimi. Dr. Kaleshi me këtë publikim hedh poshtë tezën e deriatëhershme të *Glisha Elezoviqit*, se xhamia më e vjetër në ish-Jugosllavi është ajo "Alaca Xhamia" (Xhamia e Kuqe) e Shkupit e ndërtuar në vitin 1444. Në Manastir Sunkur Beu ndërton edhe një medrese dhe një teqe, kurse në Edrene dhe Vidin ndërton nga një xhami mëhalle (mesxhid) me disa dyqane. Dr. Kaleshi të dhënat i ka mbështetur

[14] *Riza Sadiku*, Hasan Kaleshi Jeta dhe Vepra, 1996 Shkup, fq. 61-62.

[15] Dr. *Hasan Kaleshi*, "Najstari Vakufski Dokumenti na Arapskom Jeziku u Jugoslaviji", 1972 Prishtina, fq. 323

në kopjen e origjinalit të gjetur në sixhilet e kadillëkut të Manastirit, të cilat ruhen në Arkivin shtetëror të Maqedonisë në Shkup[16].

Njëri nga vakëfthemeluesit e parë në ish-territorin e Jugosllavisë ka qenë edhe *Ihsak Beu*, mëkëmbësi i dytë i Shkupit, pas Jigit Beut. Sipas vakëfnames të Ishak Beut, e cila daton prej vitit 1445, ai në Shkup ka ndërtuar një xhami e quajtur "Alaca Camisi" (Xhamia e Kuqe) në vitin 1444, përveç saj ka ndërtuar edhe një medrese, e cila gjatë tërë sundimit në periudhën osmane ka qenë njëra nga më të njohurat në Rumeli. Pranë medresesë ka ekzistuar edhe një bibliotekë shumë e pasur, librat e të cilës kanë qenë thuajse të gjitha në gjuhën arabe. Duhet theksuar se dr. Hasan Kaleshi në komentimin e vakufnames të lartpërmendur, jep shumë sqarime dhe vërejtje serioze në punimet e Glisha Elezoviqit të botuara deri atëherë lidhur me Ishak Beun[17].

Njëra nga vakëfnamet më të rëndësishme të shek. XV, origjinalin e të cilës e zbuloi dr. Hasan Kaleshi, pa dyshim është vakufnamja e *Sinanudin Jusuf Çelebisë*, të quajtur *Ohrizade* nga Ohri, i cili daton prej vitit 1491. Në bazë të dokumentit të sipërpërmendur, dr. Kaleshi vërteton se Sinanudin Jusuf Çelebiu apo Sinan Çelebiu si është i njohur në Ohër, është i njëjti person me Ohrizaden të cilin e përmend Evlia Çelebiu në veprën e vet. Me këtë zbulim autori i shkrimit i heq dilemat se a bëhet fjalë për një apo dy persona. Sinanudin Jusuf Çelebiu përveç xhamisë në Ohër ka ndërtuar edhe një shkollë, një teqe dhe një imaret[18].

Dr. Hasan Kaleshi, kontribut të veçantë trashëgimisë të kulturës osmane në Ballkan i ka dhënë edhe përmes zbulimit të katër vakufnameve të *Ihsak Çelebis nga Manastiri*, deri atëherë të panjohura. Në bazë të dokumenteve të lartcekura, dr. Kaleshi ka vërtetuar se Isaku

[16] Gjerësisht shiko*: Dr. Hasan Kaleshi,* Najstarija vakufnama u Jugosllaviji, Prilozi za Orijentalnu filologiju, sv. X-XI, 1961, Sarajevo, fq. 55-79, Dr. Hasan Kaleshi, Najstari Vakufski Dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, 1972, Prishtina, 65-89.

[17] Dr. *Hasan Kaleshi*, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Prishtina 1972, fq. 89-111.

[18] Gjerësisht shiko: *Dr. Hasan Kaleshi*, Jedna arapsaka vakufnama iz Ohrida, iz 1491 godine, Prilozi za orijentalnu filologiju, nr. XII-XIII 1962/63, Sarajevo 1965, fq. 15-44, me rezyme gjermanisht.

ka qenë kadi në Selanik, kurse i ati i tij është quajtur *Isa Fakih* dhe se ka qenë myderis dhe myfti i Manastirit si dhe ka ndërtuar një xhami në Manastir. Isak Çelebiu në vitin 1508 ka dhënë dorëheqje nga pozita e kadisë në Selanik dhe është vendosur në Manastir. Nga objektet e shumta që ka ndërtuar Ihsak Çelebiu në Manastir ka mbetur vetëm një xhami në qendër të qytetit afër Sahat-Kullës e quajtur *Ishakije,* e cila është xhamia më e madhe dhe më e bukur në Manastir, e ndërtuar në vitin 1506. Ihsak Çelebiu ka ndërtuar dhe themeluar shumë objekte dhe vakëfe jo vetëm në Manastir por edhe në Pazarxhik (Tatar Pazar), Selanik dhe Pllovdiv (Filibe) [19].

Një nga monumentet më të bukura dhe më të njohura kulturo-historike në ish-Jugosllavi është *Kurshumli Hani në Shkup.* Disa qindra vjet ky monument ka tërhequr vëmendjen e shumë hulumtuesve për të zbuluar ndërtuesin e këtij hani. Disa historianë kanë vërtetuar se ndërtesa është bizantine, disa kanë pohuar se ka ndërtuar perandori romak Justiniani, ndërsa historianët serbë janë përpjekur të provojnë se këtë han e ka ndërtuar Car Dushani. Ka pasur edhe të atillë të cilët kanë pohuar se Kurshumli Hani është ndërtuar gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, por nuk kanë pasur prova bindëse për këtë tezë. Dr. Kaleshit i shkon për dore në arkivin e Stambollit të zbulojë vakufnamen origjinale për ndërtuesin e Kurshumli Hanit në Shkup. Në Bazë të dokumentit të lartcekur, dr. Hasan Kaleshi vërteton se Kurshumli Hanin e ka ndërtuar *Muslihudin Abdulgani*, i njohur si *Muzein Hoxha al Madini*. Dokumenti është i vitit 1550. Muslihudin al Madini ka ndërtuar edhe tri xhamia, një në *Shkup*, një në *Trepçë* dhe një xhami dhe shkollë për të mësuar Kuranin në *Jeni Pazar*. Me këtë zbulim Dr. Kaleshi jo vetëm që i heqë të gjitha dilemat lidhur me ndërtimin e Kurshumli Hanit në Shkup (në të cilën sot ndodhet Muzeu Arkeologjik),

[19] Dr. *Hasan Kaleshi*, Najsariji vakufski dokumanti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Prishtina 1972, fq. 145-219

por një tezë e tillë pranohet edhe në qarqet ndërkombëtare shkencore[20].

Në Kosovë ekzistojnë dy xhami që e mbajnë emrin "Xhamia e Sinan pashës", njëra në Prizren e tjetra në Kaçanik. Për ndërtuesit e këtyre dy xhamive edhe pse është shkruar mjaft, por në mungesë të fakteve autentike kanë krijuar shumë dilema dhe paqartësi lidhur me ndërtuesit e këtyre dy xhamive. Në të shumtën e rasteve është thënë se këto dy xhami i ka ndërtuar Koxha Sinan Pasha, ose të kundërtën, atë në Prizren Koxha Sinan Pasha, kurse atë në Kaçanik Sofi Sinan Pasha. Dr. Kaleshi, duke bërë hulumtime të shumta në këtë drejtim, në bazë të dokumenteve autentike (vakufnameve) ka ardhur në përfundim, se ndërtuesi i xhamisë të Sinan Pashës në Prizren është *Sofi Sinan Pasha*, kurse ndërtuesi i xhamisë të Sinan Pashës në Kaçanik është *Koxha Sinan Pasha*, të dy me prejardhje shqiptare nga rajoni i Lumës. Xhamia e *Sofi Sinan Pashës* është ndërtuar në vitin 1615, ekziston edhe sot dhe është një nga monumentet më të bukura të arkitekturës islame-turke në Kosovë. Sofi Sinan Pasha është lindur në katundin Vili të Lumës në Shqipëri. Gjatë karrierës së tij ka pasur poste të larta në hierarkinë e Perandorisë Osmane, ka qenë beglerbeg i *Kajros*, kurse në vitin 1594 beglerbeg i *Budimi*t, ka marrë pjesë në luftërat e Turqisë kundër Hungarisë. Në vitin 1598 është emëruar beglerbeg i *Elajetit të Anadollit*, kurse më vonë ka qenë beglerbeg edhe i *Bosnjës*. Në vitin 1603 në Stamboll i është dhënë grada e *Vezirit*. Në vitin 1604 ka qenë zëvendës i *Vezirit të Madh*, kurse në vitin 1608 emërohet beglerbeg i *Sirisë*[21].

Ndërtuesi i xhamisë së Kaçanikut është *Koxha Sinan Pasha*, ai është lindur në fshatin *Topojan të Lumës në Shqipëri*. Koxha Sinan Pasha ka një karrierë shumë të pasur politike dhe ushtarake në administratën e Perandorisë Osmane. Në vitin 1568 emërohet beglerbeg i

[20] Gjerësisht shiko. *Dr. Hasan Kaleshi*, Koje je graditel i koga e izgredjen Kurshumli an vo Skopje, Glasnik na Istitutot za Nacionalna Istorija, XV-3 Shkup, 1971, fq. 189-2001, (me rezyme).

[21] Gjerësisht shiko: *Dr. Hasan Kaleshi*, Najstariji vakufski dokumenti na arapskom jeziku u Jugoslaviji, 1972 Prishtinë, fq. 257-309.

Egjiptit. Prej këtu ka udhëhequr ofensivat ushtarake turke për shuarjen e kryengritjes të *Jemenit*, të cilin vend përsëri ia ka bashkuar Turqisë. Gjatë kësaj kohe në Jemen, Mekë, Medine, Kajro dhe Aleksandri ka ngritur një numër fondacionesh ekonomiko-shoqërore në dobi të këtyre rajoneve. Për sukseset e arritura në fushat luftarake dhe ekonomike, kur është kthyer në Stamboll është pritur si hero dhe i është dhënë titulli i *Gazisë*, duke e quajtur pushtues të *Jemenit (Fatih-i Yemen)*. Më vonë ka luftuar kundër spanjollëve të cilët i ka mundur në *La Goleta*, me të cilin rast *Tunizinë* ia ka bashkangjitur Turqisë. Në vitin 1580 është bërë *Vezir i Madh*, dhe prej atëherë gjatë tërë jetës së tij, *pesë herë ka qenë Vezir i Madh* dhe *pesë herë kryekomandant (Serdar*) i ushtrisë të Perandorisë Osmane. Koxha Sinan Pasha gjatë karrierës së tij pa ndërprerë ka luftuar edhe kundër hungarezëve. Konsiderohet se *Sinan Pasha* ka qenë personaliteti i fundit midis figurave më të famshme të historisë të Perandorisë Osmane. Kronistët osmanë me gjithë që i vlerësojnë lart meritat e tij, por ia marrin edhe për të madhe se i ka mbrojtur shqiptarët duke u dhënë pozita të larta. *Koxha Sinan Pasha* duke pasur merita dhe pozita të larta në pushtet, krijon pasuri të mëdha si në *Shqipëri, Serbi, Bullgari, Greqi dhe në Anadolli*. Koxha Sinan Pasha në Kaçanik ndërton *një fortifikatë, një xhami* (e cila ekziston edhe sot), *një timaret, një shkollë, dy hane* dhe një hamam[22].

Dr. Hasan Kaleshi në mënyrë argumentuese dhe faktografike jo vetëm që i hoqi të gjitha dilemat lidhur me ndërtuesit e xhamive në Prizren dhe Kaçanik, por përmes dokumenteve të zbuluara ai dha edhe shumë shënime plotësuese për rolin dhe rëndësinë e dy personaliteteve të rëndësishme që kanë luajtur në hierarkinë e Perandorisë Osmane, të rëndësishme jo vetëm për kulturën, trashëgiminë dhe historinë e Perandorisë Osmane, por edhe për historinë e popullit shqiptar. Tezat e dr. Kaleshit lidhur me publikimin e vakëfnameve që kanë

[22] *Dr. Hasan Kaleshi*, Veliki Vezir Kodza Sinan Pasha, njegova zaduzdina i njegova vakufnama, Gjurmime Albanologjike, nr. II, 1965 Prishtinë, fq. 105-144 me rezyme në gjuhën angleze. Për këtë punim recensione janë botuar në : "Revye des etudes Sudeseuropennes" bleni IV, nr. I-II, Bukuresht 1966, fq. 314, Prof. Dr. *Semavi Eyce*, Buletini XXIX, nr. 114, 1965, Ankara.

të bëjnë me ndërtuesit e dy xhamive të lartpërmendura në Kosovë, duket se nuk i ka shkuar për shtati turkologut me famë botërore dr. Franc Babingerit, pasi ai publikimet e tij për këto monumente dhe personalitete që u bë fjalë më lart, ka pasur qëndrime tjera, të cilat dr. Kaleshi i ka hedhur poshtë. Këtë mospajtim e dëshmon dr. Franc Babingeri në mënyrë shumë të kulturuar përmes një shkrese dërguar dr. Hasan Kaleshit më 5 gusht 1965, përmes së cilës e uron për punimin dhe i sugjeron që të rishikojë tezën e publikuar[23].

Kontributi shkencor i dr. Hasan Kaleshit në fushën e trashëgimisë kulturo-historike të Perandorisë Osmane në Ballkan e më gjerë, nuk përfundon vetëm me zbulimin e vakëfnameve të lartpërmendura, por është edhe ma i gjerë, të cilat nuk mund të përfshihen në një punim, andaj sugjeroj institucionet kompetente që punimet e prof. dr. Hasan Kaleshit të kësaj fushe, të përkthehen në gjuhën turqishte ose anglishte, për të mundur punonjësit shkencorë të kësaj disipline, zbulimet e tija t'i inkorporojnë në historinë e trashëgimisë kulturore të Perandorisë Osmane, me të cilin rast, nuk do të pasurohet vetëm kultura osmane, por edhe ajo kombëtare dhe evropiane.

Kontributi shkencor i dr. Hasan Kaleshit, hiç nuk është më i vogël edhe në historinë e popullit shqiptar. Ai në këtë fushë, gjatë viteve '70, në Leksikonin Biografik të Munihut, (Biographisches Lexikon zur Geschichte Sudosteuropas), ka botuar afro 30 artikuj enciklopedikë të personaliteteve kombëtare shqiptare, të cilët kanë vepruar në kuadër të Perandorisë Osmane, nga të cilët për të parën herë në gjuhën shqipe janë botuar 24 artikuj, në veprën Hasan Kaleshi, Jeta dhe Vepra.[24]. Përmes këtyre artikujve dr. Kaleshi ndriçoi një varg personalitetesh kombëtare, për disa nga ata ai shkruan punimet e para, disave ua begaton veprimtarinë kombëtare, kurse disa i ngrit në piedestalin më të lartë letrar dhe shkencor, duke i radhitur në mesin e enciklopedistëve dhe shkrimtarëve më të mëdhenj botërorë, si që është rasti me Sami Frashrin. Dr. Hasan Kaleshi me punën e tij shkencore dhe argu-

23 Riza Sadiku, Hasan Kaleshi Jeta dhe vepra, Shkup 1996, fq. 299.

[24] Riza Sadiku, Hasan Kaleshi, Jeta dhe Vepra, Shkup 1996, 79-197.

mentuese jo vetëm që ndriçoi dhe pasuroi historinë e popullit shqiptar me shumë personalitete kombëtare, por disa nga ata i nxori edhe nga anonimiteti i regjimeve komuniste, duke i afirmuar edhe në çarqet shkencore evropiane, si që ishte rasti me *Faik Konicën, Dervish Himën, dr. Ibrahim Temon, Surija Bej Vlora, Turhan Pashë Përmetin* etj.

Nga fusha e historisë dr. Kaleshi ka botuar edhe një varg punimesh, shumë të rëndësishme për historinë kombëtare, me këtë rast po veçojmë disa nga këto:

Në punimin *"Çfarë të dhënash na japin kronikat osmane mbi luftërat shqiptaro-turke në shek. XV-të "*[25], botim i veçantë kushtuar përvjetorit të Skënderbeut, në të cilin punim janë botuar tri kronika më të vjetra osmane, shumë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar të *Shukurzllahut, Ashikpashazades* dhe të *Hoxha Saduddinit*. Rëndësia e kronikës së parë qëndron në atë, se shqiptarët përmenden për herë të parë, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në betejën e Kosovës, e zhvilluar në vitin 1389. Rëndësia e kronikës së dytë qëndron në atë, se aty për herë të parë përmenden tokat shqiptare, kurse rëndësia e kronikës së tretë qëndron në atë, se në një artikull të veçantë bëhet fjalë për plaçkitjet e tokave shqiptare.

Në një punim tjetër me titull: *"Depërtimi turk në Ballkan dhe islamizimi-faktor të ekzistencës etnike dhe kombëtare të popullit shqiptar"*, botuar në Munih në gjuhën gjermane, në vitin 1975[26], në këtë studim dr. Hasan Kaleshi, për herë të parë na paraqitet me një tezë krejtësisht të re dhe në kundërshtim në atë kohë me historiografinë bashkëkohore shqiptare, e cila në depërtimin e osmanlinjve në Ballkan dhe në islamizimin e shqiptarëve gjen vetëm elemente negative. Dr. Kaleshi tezën në fjalë e arsyeton me sa vijon: Në kohën kur shqiptarët ishin pa shtet, pa kisha të tyre, pa traditë kulturore, pa shkolla, të rre-

25 Simpoziumi për Skënderbeun, i mbajtur prej 9-12 maj 1968, Prishtinë, Botim i veçantë 1969, 171-180

[26] Dr. Hasan Kaleshi, Das Turkische Vordrngen auf dem Balkan und die Islamisierungfaktoren fur die Erhaltung der ethnischen und nationalen Existenc des albanischen Volks, Sudosteuropa unter dem Halbmond, prof. Georg Sradmuler zum 65, Geburstag gewidmet, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, Munih, 1975, fq. 125-139.

thuar nga Bizanti në një anë, nga shteti serb në anën tjetër, nga Venediku në anën bregdetare, në këto rrethana nuk ka pasur fare gjasa të ekzistonte si komb. Me depërtimin turk në Ballkan, me shkatërrimin e Bizantit, shtetit serb si dhe me dezorientimin e kishave të tyre, pengohet asimilimi shqiptar nga elementet e lartpërmendura. Në fillim, ndaj kësaj teze ka pasur shumë reagime dhe mospajtime, por duke i analizuar rrethanat e kohës, është pranuar si realitet. Mjerisht në kohët e fundit ka tendenca dhe punime të veçanta të botuara, ku përpiqen që këtë tezë t'ia përshkruajnë vetes, por faktet flasin ndryshe.

Dr. Hasan Kaleshi, kontribut të veçantë historiografisë shqiptare i dha përmes një punimi voluminoz që ia kushton dr. Ibrahim Temos, i botuar në Minhen dhe Sarajevë, kurse në gjuhën shqipe nga gjermanishtja e ka përkthyer dr. Fejzi Domni dhe botuar në Nju-Jork në vitin 1982. Përmes këtij punimi dr. Kaleshi për herë të parë nxjerrë në dritë të kompletuar veprimtarinë politike, shkencore dhe kombëtare të dr. Ibrahim Temos.

Temo ishte një shqiptar nga Struga, njëri nga themeluesit e Komitetit xhonturk "Bashkim e Përparim", organizator i revolucionit xhonturk, i cili e hoqi Sulltan Hamitin nga froni, udhëheqës i kolonisë shqiptare në Konstancë të Rumanisë, veprimtar i dalluar në lëvizjen kombëtare, bashkëpunëtor i ngushtë i Nikola Naços, pjesëmarrës i Konferencës së Paqes në Paris, si delegat i shqiptarëve të Rumanisë, bashkëpunëtor i revistës "Albania" të Faik Konicës. Kontribut të veçantë human ka dhënë Temoja si mjek i syve në shërimin e shqiptarëve gjatë luftërave ballkanike, sidomos në Luftën e Parë Botërore. Për dashurinë që ka pasur Temoja ndaj kombit, me kërkesë të tij është varrosur i mbështjellur me flamurin kombëtar[27].

Kur bëhet fjalë për veprimtarinë shkencore të dr. Hasan Kaleshit, duhet të vihet në pah, se ai në shkencë jo vetëm që ka qenë i rreptë, por edhe guximtar. Këtë e dëshmon dr. H. Kaleshi në vitin 1976, kur

[27] Gjerësisht shiko, Dr.Hasan Kaleshi, Dr. Ibrahim Temo, frymëzues revolucionar dhe mendimtar nga Struga, Nju Jork 1982, botim i veçantë, editor Idriz Lamaj, përkthimin nga gjermanishtja e ka bërë Dr. Fejzi Domni, punimi i ka 62 faqe, nga të cilat 18 janë shënime bibliografike.

regjimet komuniste si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, Faik Konicën e kishin anatemuar nga të gjitha nivelet e shkollimit, sikur të mos kishte ekzistuar, edhe pse tërë jetën ia kishte kushtuar çështjes kombëtare, duke dhënë kontribute të veçanta jo vetëm në gjuhësi, letërsi, histori, por edhe në shkencë e politikë, mjerisht të gjitha këto kontribute regjimet komuniste i qitën në harresë. Në këtë kohë, kur kolegët e dr. Kaleshit nuk guxonin ta përmendin Faik Konicën, ai shkroi dhe botoi dy artikuj, njërin në Munih e tjetrin në Nju-Jork. Në këtë kontekst, po ashtu duhet vënë në pah, me rastin e shënimit të përvjetorit (100-vjetorit) të lindjes së Faik Konicës, punimin e përgatitur të dr. Kaleshit me titull: *"Faik Konica dhe marrëdhëniet e tij me Austro-Hungarinë"*, në mungesë të autorit e lexon prof. dr. Edvard Liço nga Nju-Jorku, punim i cili për shkak të origjinalitetit dhe nivelit të lartë shkencor, shpërblehet me duartrokitjet më frenetike në sallë, duke i thënë zotëri Liços: ***"Nuk u trokasim Juve që e lexuat, por dr. Hasan Kaleshit që e ka shkruar".***

Faik Konica ishte preokupim i vazhdueshëm për dr. Hasan Kaleshin, ai do të gjurmojë me këmbëngulje për veprimtarinë politike, kombëtare dhe letrare në arkivin e Vjenës, Bukureshtit dhe të SHBA-së. Nga këto hulumtime do të arrijë të mbledhë disa qindra dokumente, me qëllim që të shkruajë një monografi për Konicën, por vdekja e papritur do ta pengojë realizimin saj. Pos artikujve të lartcekur, të botuar për Konicën, dr. Kaleshit për të i mbeti në dorëshkrim edhe një punim prej 50 faqeve, me titull: "*Trajtesa e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare*", punim i cili e pa dritën në librin Jeta dhe Vepra e Hasan Kaleshit[28].

Dr. Kaleshit, përveç punimeve të lartpërmendura i mbetën të papublikuara edhe nja 250 dokumente, në të cilat bëhej fjalë për veprimtarinë politike, kombëtare, korrespondencën, si dhe në cilat metropole evropiane, të Lindjes së Afërme dhe të Egjiptit shpërndahej në kolonitë shqiptare gazeta "Albania" e Faik Konicës. Dorëshkrimet e dokumenteve, kryesisht janë të shkruara me dorë në gjuhën frënge.

[28] Riza Sadiku, Hasan Kaleshi Jeta dhe Vepra, shtypshkronja Grafoprint, (ribotim) Prishtinë, 1996, fq. 197-237.

Dr. Kaleshit, përveç dokumenteve në fjalë i mbetën të pabotuara edhe 245 dokumente të hulumtuara në arkivin e Vjenës në gjuhën gjermane, në të cilat bëhej fjalë për Dervish Himën, si dhe disa dhjetëra dhe qindra kopje dokumentesh, po ashtu të hulumtuara në arkivin e Vjenës, Ankarasë dhe Stambollit, ku flitej për Lidhjen e Prizrenit, kryengritjet shqiptare 1908-1912, Haxhi Zekën, Isa Boletinin, Mehdi Frashërin e tjera personalitete kombëtare[29].

[29] Të gjitha kopjet e dokumenteve të lartë përmendura, autori i këtij artikulli i ka gjetur në tavanin e shtëpisë të familjes së tij në Beograd në vitin 1995, gjatë përgatitjes të monografisë për H. Kaleshin, me rastin e shënimit të 20 vjetorit të vdekjes së tij, në vitin 1996, i cili përvjetor në mënyrë madhështore u shënua në vendlindjen e tije në Kërçovë më 19 korrik 1996. Familja e Dr. Kaleshit, kopjet e dokumenteve të lartë përmendura i ka dhënë pa kompensime materiale, pasi unë si studentë në Prishtinë kam banuar tri vite së bashku në banesën e H. Kaleshit (1973-1976). Këto materiale (dokumente) i kam ruajtur me kujdes të veçantë në kuadër të bibliotekës time personale, me qëllim që me rastin e ndonjë përvjetori do t'i botojmë si kontribut i Dr. H. Kaleshit. Por, mjerisht gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999, me shtëpi isha në Fushë Kosovë, regjimi barbarë serb e kallin shtëpinë, me të cilin rast çdo gjë bëhet shkrumb e hi, shtëpia digjet deri në themel, me gjithë bibliotekën private me më se 2000 libra dhe disa mia kopje të dokumenteve, mikrofilmave dhe fotokopjeve. Me këtë rast dëshiroj të ve në pa, se Dr. Kaleshi ka pasur një bibliotekë shume të pasur, të cilën për fat të mire në vitin 1979 e blen Biblioteke Universitare e Kosovës. Për këtë bibliotekë, për shkak të literaturës së rrallë dhe dokumenteve të ndryshme që ka poseduar, të interesuar për ta ble ka qenë Sarajeva, Beogradi dhe Universiteti i Lajdenit nga Holanda..

Riza Sadiku

HASAN KALESHI'S SCIENTIFIC AND NATIONAL CONTRIBUTION

(Summary)

July 19, 2006 marked the 30th anniversary of the death of Hasan Kaleshi, a reputable Albanian scholar. Hasan Kaleshi died at the age of 54 in Prishtina. He dedicated his entire life to science leaving behind more than 400 books and articles. Due to its originality, his work stirred great interest among distinguished international institutions dealing with oriental studies, history, ethnology, etc.

Despite his contribution to science nothing was done to commemorate him on this anniversary. We hope that such an omission will not occur again in 2007, the 85th anniversary of the birth of Hasan Kaleshi.

ريزا صادق

المساهمة العلمية و القومية للدكتور حسن كاليشي

(خلاصة البحث)

في 19 يوليو من عام 2006 مرت ثلاثون عاما من وفاة الباحث و الدارس الاستاذ الدكتور حسن كاليشى الذي توفى عن عمر 54 عاما بمدينة بريشتنا و الذي ترك خلفه اعمالا حافلة في مجالات متعددة من العلم و المعرفة و تتجاوز اعماله العلمية اكثر من 400 وحدة بيبليغرافية تم نشرها في مجلات علمية أوربية رفيعة المستوى في مجال الاستشراق و الدراسات التركية و التاريخ و اللغة و انتروبولوجيا و مجالات علمية أخرى.

هذه الشخصية العلمية الكبيرة حسب رأيي لم يحل محله حتى الآن أحد في مجال تخصصه في كل الاراضى الالبانية، مع الاسف الشديد لقد مرت مناسبة وفاته الثلاثين دون أن يذكر من أحد مع أن عددا من طلابه يحتلون اليوم مناصب قيادية في مجالات عدة و أنا على يقين الا بتكرر هذا في السنوات القادمة. و بصفة خاصة خلال العام 2007 حينما تمر 85 عاما من ميلاد الدكتور حسن كاليشى.

PORTRETE

Nuridin Ahmeti *- Instituti Albanologjik i Prishtinës*

KONTRIBUTI I DR. HASAN KALESHIT NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

Në plejadën e shquar të shkencëtarëve të mirënjohur të botës shqiptare, pa dyshim, bën pjesë edhe profesori e shkencëtari, tanimë i ndjerë, dr. Hasan Kaleshi.

Hasan Kaleshi u lind më 7 mars 1922 në fshatin Sërbicë të Kërçovës. Mësimet e para i mori nga babai Ahmed Kaleshi, i cili ishte një hoxhë me autoritet i asaj ane. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjashtë klasë në medresenë e madhe "Mbreti Aleksandër" në Shkup[1] dhe dy klasë në shkollën e mesme "Sami Frashëri" në Prishtinë.

Më 1951 diplomoi në Degën e Orientalistikës në Beograd, kurse më 1960 përfundoi disertacionin e doktoraturës me titull ***"Najstariji vakufski dokumenti iz Makedonije na arapskom jeziku"***[2] (Dokumentet më të vjetra të vakëfeve të Maqedonisë në gjuhën arabe) në Fakultetin Filozofik në Beograd.[3]

[1] Shih. Mustafa Memiç, "Velika Medresa i njeni ucenici u revolucijonarnom pokretu", Shkup,1984, fq. 69.

[2] Riza Sadiku, "Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra", Renesanca, Prishtinë, 1996, fq. 13-14.

[3] Në shtator të vitit 1946 regjistrohet në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në *Degën e Orientalistikës* dhe atë të *Romanistikës,* në të dyja degët i jep të gjitha provimet, kurse diplomon Orientalistikën në vitin 1951, me sukses të shkelqyeshëm, me notë mesatare *nëntë (9).* Gjatë studimeve, për shkak të kushteve të vështira ekonomike punon punë të ndryshme fizike. Prej vitit 1947-1950, punon si përkthyes dhe lektor në redaksinë e gjuhës shqipe të Radio Beogradit. Në shkurt të vitit 1952 emërohet profesor i Shkollës së mesme në *Katedrën e Filologjisë Orientale në Beograd,* ndërsa në vitin 1955 asistent. Më *26 shkurt 1960,* në Fakultetin Filozofik në Beograd, në mënyre brilante mbron tezën e doktoratës. Po këtë vitë konkuron për dicent në katedrën e lartëpërmendur, në bazë të referatit pozitiv, të nënshkruar nga dy profesor të rregullt dhe autoritativ të Universitetit te Beogradit, por zgjedhja e tij pezullohet për arsye të pa njohura, deri në vitin 1965, për shkak të kësaj zhagitje demoralizohet dhe e leshon fakultetin (Shih Dr. Riza Sadiku, *"Hasan Kaleshi - Jeta dhe vepra"*, vep. e cit, fq. 14.

Ndonëse kontributi i profesor Hasan Kaleshit shtrihej në fusha të ndryshme e të shumta albanologjike si: gjuhësi[4], letërsi, etnografi, histori, histori e kulturës etj., ne do të ndalemi vetëm në kontributin e profesor Kaleshit dhënë shkencës së historiografisë shqiptare.

Profesor Kaleshi ishte një poliglot i vërtetë. Dihet se ai zotëronte edhe disa gjuhë botërore si: arabishten, turqishten, osmanishten, persishten, italishten, gjermanishten, frëngjishten, anglishten, bullgarishten, serbokroatishten dhe, natyrisht, edhe shqipen[5].

Zotërimi i shumë gjuhëve të huaja ia hapi rrugën profesor Kaleshit për hulumtime në shumë qendra dhe institucione të ndryshme shkencore, si në Tiranë, Stamboll, Ankara, Gëtingen, Vjenë, Grac, Berlin, Hamburg, Munih, Sofje, Athinë, Çikago, Paris, Kajro, Aleksandri, Nju-Jork etj.

Si i tillë, pra poliglot i shquar, ai i kishte parakushtet e duhura për një punë të mirëfilltë shkencore, ndërsa problemeve që i trajtonte nuk u rrekej sipërfaqësisht, por në mënyrë kritike, analitike, gjithnjë duke argumentuar me dokumente. I tillë ishte jo vetëm sa u përket çështjeve të pastudiuara, por edhe ndaj atyre që ishin keqinterpretuar në historinë kombëtare shqiptare[6].

Vendin kryesor në veprimtarinë e tij shkencore në historiografinë shqiptare e zënë studimet që kanë të bëjnë me historinë dhe kulturën e popullit shqiptar, në veçanti ato që trajtojnë rolin e personaliteteve të ndryshme shqiptare në periudhën e Perandorisë Osmane.

[4] Mehdi Polisi, "Kontributi i Hasan Kaleshit në Gjuhësinë Shqiptare", në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2005, fq. 403.

[5] Riza Sadiku, "Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra", Renesanca, Prishtinë, 1996, fq.22.

[6] Riza Sadiku, "Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra", Renesanca, Prishtinë, 1996, fq.18.

Ai është autor i disa punimeve mbi jetën dhe veprimtarinë patriotike, shkencore, kulturore e politike të shumë figurave në zë të historisë sonë kombëtare, si: Sami, Naim e Abdyl Frashërit, Ismail Qemalit, Faik Konicës, Haxhi Zekës, Fan Nolit, Dr. Ibrahim Temos, Dervish Himës, Jahja Bej Dukagjinit, Suzi Prizrenasit, Koçi Beut e Sinan Pashës, Ali Pashë Gucisë, Nexhip Dragës etj[7].

Vlen të ceket se në themelimin e Degës së Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës nga profesor Kaleshi, ku ai i ligjëronte disa lëndë, ndër to edhe osmanishten, të cilën profesori e preferonte më së shumti dhe në anën tjetër studentët kishin vështirësi në nxënien e kësaj lënde. Duk e parë këtë fakt profesori përdorte një metodë të veçantë në përzgjedhjen e teksteve, duke marrë, zakonisht, tekste që lidheshin me historinë shqiptare: për Shqipërinë, për shqiptarët, për Kosovën, Prishtinën, Shkupin për Skënderbeun, Abdyl Frashërin, Elena Gjikën etj. Dhe kjo, siç duket, me qëllim që këto tekste të bënin ndikim te studentët për ta vazhduar rrugën e tyre.

Falë angazhimit të tij të vazhdueshëm, Hasan Kaleshi arriti të hidhte dritë mbi shumë personalitete nga të gjitha trojet shqiptare, disa nga të cilët fare pak njiheshin deri atëherë, ose nuk njiheshin fare.

Profesor Kaleshi ligjëroi edhe në Fakultetin Filozofik në Katedrën e Historisë. Në fillim Dr. Hasan Kaleshi ligjëronte dy lëndë;

1. Gjuhën osmane dhe
2. Shkencat ndihmëse të historisë.

Një mandat dr. Kaleshi ka qenë edhe shef katedre (në Katedrën e Historisë. N.A.) dhe gjatë kësaj kohe angazhohet për organizimin e studimeve pasuniversitare. Për kontributin e madh që dha dr. Hasan Kaleshi në këtë katedër, në shkencë, si dhe për afirmimin e saj brenda dhe jashtë kufijve të vendit si dhe për angazhimin rreth organizimit të punës në katedrën e Historisë, më 10 dhjetor të vitit 1972 u propozua, po nga kjo katedër për Shpërblimin e Dhjetorit.[8]

[7] Mehdi Polisi, "Kontributi i Hasan Kaleshit në Gjuhësinë shqiptare", në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2005, fq. 405.

[8] Riza Sadiku, "Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra", Renesanca, Prishtinë, 1996, fq.16-17.

Ja se çka thoshte profesor Kaleshi për figurat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare: "Figurat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nuk duhet të ndahen si me shpatë në "patriotë" dhe "tradhtarë". Mendimet mos t'i mbështesim në autoritetet politike, por në gjurmimet e vërteta shkencore".[9]

Profesor Kaleshi ishte bashkëpunëtor i ngushtë dhe i rregullt edhe i shumë institucioneve shkencore botërore, ndërsa ne do ta përmendim vetëm Institutin për Evropën Juglindore, me seli në Munih, ku në "Leksikonin për historinë e Evropës Juglindore", profesor Kaleshi botoi 28 artikuj për personalitetet e shquara të Lëvizjes Kombëtare dhe të Kulturës Shqiptare si për Sami, Naim e Abdyl Frashërin, Dervish Himën e Faik Konicën, për Ismail Qemalin e Fan Nolin, për Haxhi Zekën e Hasan Prishtinën etj[10].

Se cili ishte vizioni i tij për shkencat albanologjike në përgjithësi dhe për historiografinë në veçanti, më së miri mund të shihet nga intervista e tij dhënë gazetës "Bota e re" nr. 5-6, prill i vitit 1976, me ç'rast profesor Kaleshi vë në spikamë edhe hartimin e një enciklopedie për kombin shqiptar, duke theksuar mes tjerash:

"Nëse demistifikojmë disa ngjarje tona historike, të cilat janë të mbështjella me legjenda e me mite, nëse i rrekemi punës së studimeve me një objektivitet dhe seriozitet më të madh, pas disa vitesh do të krijohen kushte për t'ia filluar punës në këtë drejtim".[11]

Po në këtë intervistë profesor Kaleshi flet edhe për angazhimin e tij rreth një studimi mbi shqiptarët e shquar nga Kosova e Maqedonia, që nga koha e Rilindjes Shqiptare, sepse, siç thoshte ai, "kam përshtypjen se në historiografinë tonë roli i tyre nënçmohet"[12].

Profesor Hasan Kaleshi preferonte që në shkrimet e tij e në veçanti në ato të karakterit historiografik të kishte edhe bashkautor, çka do të

[9] Riza Sadiku, vep. e cit. fq.1.

[10] Po aty, fq. 20.

[11] "Dr. Hasan Kaleshi - Vepra 1", Logos-A, Shkup 1996, fq. 203; për disa nga punimet e Hasan Kaleshit në historiografinë kosovare shih edhe dr. Daut Bislimi "Bibliografija e punimeve historike të publikuara në Kosovë gjatë viteve 1946-1998" , IAP, Prishtinë 2006, fq. 124, 125, 126.

[12] Mehdi Polisi, punim i cituar, fq. 404.

thotë se ishte i hapur në bashkëpunim me kolegët që merreshin me problemet që i trajtonte ai, si me: Mehmet Mehmedovskin[13] nga Shkupi, Ismet Dërmakun[14] e Ismail Rexhepin nga Prishtina,[15] dr. Hans Jürgenin nga Gjermania,[16] me Ismail Erenin nga Turqia[17] etj.

Studimet e dr. Hasan Kaleshit, të mbështetura mbi bazën e dokumenteve të hulumtuara gjithandej nëpër arkiva të botës dhe ndër posedues privatë dokumentesh, sikundër janë dokumentet nga Arkivi i Vjenës për Lidhjen e Pejës, Vakëfnameja Kukli-Begut, vakëfnameja e Sinan Pashës, 15 fermanët e Manastirit të Deçanit, vakëfnameja e Mehmed pashë Rrotllës etj. Mund të themi lirisht se këto kontribute edhe sot e kësaj dite mbeten të patejkalueshme dhe një pikë referimi e padiskutueshme për historianët që merren me këto çështje.

Në punimin *"Çfar të dhënash na japin kronikat osmane mbi luftërat shqiptare - turke në shek. XV"*[18], ku Dr. Kaleshi jep të dhëna interesante të bazuara në burimet e dorës së parë, në dokumente dhe ku vë në spikamë tri çështje me rëndësi:

1. Pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës e zhvilluar më 1389,
2. Për herë të parë përmend tokat shqiptare, dhe
3. Plaçkitjen e tokave shqiptare.[19]

[13] Hasan Kaleshi i Mehmed Mehmedovski, "Vakufnamata na Hava, čerekoita na Et'hem Čelebi od Skopje", Zbornik na Arkedonskoik Muzej, Skopje 1956, fq. 20-36; "Tri Vakufnami na Kačanikli Mehmed Paše", INI, Shkup, 1958, (Botim i veçantë 95 faqe)

[14] "Dokumente nga Arkivi i Vjenës për Lidhjen e Pejës" në Vjetar, Ak, nr. lV-V, Prishtinë 1971, fq. 149-211.

[15] "Prizrenac Kukli-Beg i njegove zadužbine", OI, u Sarajevu, nr. VIII-IX, 1958/59, Sarajevo 1960, fq. 143-169.

[16] "Vilajet i Prizrenit" Përparimi, nr. 1-2-3, Prishtinë 1967, fq. 23-69, fq. 165-193, fq. 274-310.

[17] "Četernaest turskih fermana manastirna Dečana", Buletini i Muzeut të Kosovës, nr. X, Prishtinë 1970, fq. 305-344; dhe "Prizrenac Mehmed Paša Rotul, njegove zadužbine i vakufname", storina Kosovo, Vl-Vll, Priština 1972/73, fq. 23-65.

[18] Simpozium për Skenderbeun i mbajtur prej 9-12 maj 1968, Prishtinë, botim i vacant, 1969, fq. 171-180. (Shih. Dr. Risa Sadiku, *"Kontributi shkencor dhe kombëtar i Prof. Dr. Hasan Kaleshit"* – punim në dorëshkrim)

[19] Dr. Risa Sadiku, *"Kontributi shkencor dhe kombëtar i Prof. Dr. Hasan Kaleshit"* – punim në dorëshkrim.

Në punimin *"Depërtimi turk në Ballkan dhe islamizimi si faktorë të ekzistencës etnike dhe kombëtare të popullit shqiptarë"*[20] Hasan Kaleshi për herë të parë paraqitet me një tezë të re dhe në kundërshtim me historiografinë shqiptare të kohës e cila me depërtimin e osmanlinjeve në Ballkan dhe në islamin e shqiptarëve gjen vetëm elemente negative. Në këtë punim dr. Hasan Kaleshi tezën e vet e arsyeton: *"Në kohën kur shqiptarët ishin pa shtet, pa kishat e tyre, pa traditë kulturore, pa shkolla, të rrethuar nga Bizanti në një anë, nga shteti serb në anën tjetër, nga Venediku në anën bregdetare, me këto rrethana nuk ka pasur fare gjasa të ekzistonte si komb, me depërtimin turk në Ballkan, me shkatërrimin e Bizantit, Shtetit serb si dhe dezorientimin e kishave të tyre, pengohet asimilimi i shqiptarëve nga elementet e lartpërmendura".*[21]

Se çfarë rëndësie kishin punimet e dr. Hasan Kaleshit shihet më së miri edhe nga interesimi që patën studiuesit e huaj për këto punime, ndër të cilët edhe orientalisti i njohur me famë botërore dr. Franc Babinger, i cili përmes një shkrese dërguar dr. Hasan Kaleshit, më 5 gusht të vitit 1965, e uron për punimet dhe kontributin e tij.....[22]

Dr. Hasan Kaleshi vdiq më 19 korrik 1976, në moshën 54-vjeçare, pikërisht atëherë kur iu desh më së shumti shkencës shqiptare e në veçanti historiografisë shqiptare. Nga veprat e lëna dhe nga shkrimet në lëmin e historiografisë, e në veçanti nga intervista e dhënë për "Botën e re", për të cilën bëmë fjalë më lart, dalin të qarta pikëpamjet e tij për historiografinë shqiptare.

Dr. Hasan Kaleshit përveç punimeve të lartpërmendura i mbeten të papublikuara edhe mbi 250 dokumente, dorëshkrimet e dokumenteve kryesisht janë të shkruara me dorë në gjuhën frënge, përveç dokumenteve në fjalë i mbetën të pabotuara edhe mbi 240 dokumente në

[20] Dr. Hasan Kaleshi, Das turkische Vordrngen auf dem Balkan und die Islamisierung faktoren fur die Erhaltung der ethnischen und nationalen Existenc das albanischen Volks, Sudosteuropa unter dem Halbmond, prof. Georg Sradmuler zum 65, Geburstarg gewidmet, Dr.Rudolf Trofenik, Münih, 1975, fq. 125 - 139.

[21] Dr. Risa Sadiku, *"Kontributi shkencor dhe kombëtar i Prof. Dr. Hasan Kaleshit"* – punim në dorëshkrim.

[22] Riza Sadiku, "Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra", Renesanca, Prishtinë, 1996, fq. 299.

gjuhën gjermane. Si dhe shumë dokumente tjera të hulumtuara në arkivin e Vjenës, Ankarasë dhe Stambollit, ku flitej për personalitetet e ndryshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.[23]

Në përmbyllje mund të themi se profesor Kaleshi, si njohës i të gjitha atyre gjuhëve, autor dhe bashkautor i shumë punimeve nga lëmi i historiografisë, por edhe më gjerë, kishte një kulturë të lakmueshme shkencore. Si i tillë, ai i dha një ndihmesë shumë të çmuar historiografisë shqiptare në përgjithësi.

Është detyrë e atyre që patën fatin ta njohin profesor Kaleshin, e në veçanti të ish-studentëve të tij, që të bëjnë më shumë për personalitetin e tij. Dorën në zemër ka pasur disa përpjekje si nga dr. Riza Sadiku, nga shtëpia botuese "Logos-A" e Shkupit, nga revista "Edukata Islame" në Prishtinë për botimin e një përmbledhjeje të veçantë dhe për përkthimin e punimeve të dr. Kaleshit, por krahasuar me kontributin e tij të gjithmbarshëm ato përpjekje kanë qenë vetëm "një pikë ujë në oqean".

[23] Dr. Risa Sadiku, "*Kontributi shkencor dhe kombëtar i Prof. Dr. Hasan Kaleshit*" – punim në dorëshkrim.

Nuridin Ahmeti

HASAN KALESHI'S CONTRIBUTION TO ALBANIAN HISTORIOGRAPHY

(Summary)

Hasan Kaleshi was among the most reputable Albanian scholars. He was born in the village of Sërbica (Kërçovë) on March 7, 1922. He received his first teachings from his father, who was a distinguished khoja in that region. He completed his primary school education in Kërçova. He attended the "King Alexander" High Madrassa in Shkup and the "Sami Frashëri" Secondary School in Prishtina. In 1951, he graduated from the Department of Oriental Studies in Belgrade. In 1960, he obtained a Ph.D degree at the Faculty of Philosophy in Belgrade (The oldest waqf documents in the Arabic language in Macedonia).

نورالدين أحمد

مساهمة الدكتور حسن كاليشى في التاريخ الالبانى

(خلاصة البحث)

لا شك ان من بين العلماء الالبان الذين تركوا بصماتهم في عالم الفكر و المعرفة يعد الاستاذ الدكتور حسن كاليشى.

ولد حسن كاليشى في 7 مارس 1922 في قرية سرييسا ببلدية كرتشوفا. لقد تلقى التعليم الاولى على يدى أحمد كاليشى و الذي كان شيخا معروفا و يتمتع بسمعة طيبة بين مواطنيه. و اكمل تعليمه الابتدائى في مسقط راسه ثم واصل تعليمه الثانوى بمدرسة "الملك الكساندر" بمدينة شكوبى و المدرسة الثانوية "سامى فراشرى" ببرشتينا.

لقد تخرج سنة 1951 من كلية الاداب قسم الاستشراق بجامعة بلغراد و حصل على الدكتوراه سنة 1960 و كان موضوع الرسالة: "أقدم وثائق عن الاوقاف باللغة العربية في مكدونيا" بكلية الآداب بجامعة بلغراد.

HISTORIOGRAFI

Amr Halid

ZGJEDHJA E OMERIT HALIF - (2)

Kur Ebu Bekri ndjeu se po i afrohej vdekja, ai filloi të konsultohej me sahabët, se cilin do të linin si halif të myslimanëve pas tij. Omer Faruku ishte personi më i afërt për Ebu Bekrin. Ai ishte njeriu i dytë në umet pas Ebu Bekrit. Kur Pejgamberi alejhi selam ishte në xhami dhe sahabët ishin aty, ai pyeti se ku është Ebu Bekri dhe Omeri. Ata shkuan që të dy te Pejgamberi alejhi selam; Ebu Bekri në anën e djathtë dhe Omeri në anën e majtë. Pejgamberi alejhi selam i mori për dore që të dy dhe tha: "Kështu do të ringjallemi në Ditën e Kiametit."

Sahabët rrinin në xhami dhe Pejgamberi alejhi selam ishte në mesin e tyre. Ata pyetnin se kush është njeriu më i mirë pas Pejgamberit alejhi selam. Ata thoshin herë Ebu Bekri e pastaj Omeri, kurse Pejgamberi alejhi selam buzëqeshte në shenjë aprovimi për atë që thoshin. Pejgamberi alejhi selam thotë: "Burri më i mirë është Ebu Bekri dhe burri më i mirë është Omeri." Kur e pyetën Muhamedin alejhi selam se kush është njeriu më i dashur për të, ai tha: "Aishja." I thanë: "Jo prej grave, por prej burrave." Ai tha: "Babai i saj."

Pastaj kush?" Pejgamberi alejhi selam tha: "Omeri."

Vdiq Ebu Bekri dhe Omeri mori halifatin në dorë. Kur u bë halif ai, njerëzit menduan se ai do të ishte i ashpër, ngase e dinin se Omeri

ishte i vrazhdë dhe i ashpër në kohën e Pejgamberit alejhi selam dhe se u bë edhe më i ashpër në kohën e Ebu Bekrit. Po tani, si do të jetë halli kur të jetë halif?

Njerëzit u frikësuan nga Omeri, princi i besimtarëve, e filluan t'i shmangen rrugëve e mos t'i dilnin përballë në javën e parë të halifatit. Me Ebu Bekrin ishte e kundërta; edhe fëmijët i shkonin mbrapa dhe luanin me të në rrugët e Medinës, i ngjiteshin pas rrobave dhe i thoshin "O baba, o baba". Kur Omeri u bë halif, pleqtë dhe të rinjtë e anashkalonin dhe fshiheshin nga ai kur ecte në rrugë. Kur Omeri e ndjeu këtë, ai u ngrit në mesin e njerëzve dhe mbajti një ligjëratë, ku paraqiti kuptimin e thellë të tij ndaj Islamit. Ndër fjalët që Omeri tha në këtë ligjëratë janë edhe këto:

"O ju njerëz! Jam informuar se ju frikësoheni prej meje. Dëgjoni fjalën time. Kur isha me Pejgamberin alejhi selam isha robi dhe shërbëtori i tij dhe Pejgamberi alejhi selam ishte njeriu më i butë dhe xhentil. Mendova ta vendosja ashpërsinë time pranë butësisë së Pejgamberit alejhi selam, të isha shpatë e zgjatur në dorën e tij; nëse dëshironte, më nxirrte nga këllëfi e nëse donte, më linte. Ai veproi si deshi dhe unë isha ashtu tërë kohën pa ndryshuar, derisa e mori Allahu. Ai vdiq i kënaqur me mua. Pas tij erdhi Ebu Bekri. Unë isha shërbëtori dhe krahu i tij. Thashë të bashkoja ashpërsinë time me butësinë e tij. Këtë e bëra qëllimisht. Isha shpatë e zgjatur në dorën e tij; nëse dëshironte, më nxirrte nga këllëfi e nëse dëshironte, më shtinte në këllëf. Isha kështu derisa e mori Allahu e ai ishte i kënaqur me mua. Kurse tani, kur unë jam halifi juaj, dijeni se ajo ashpërsi është dobësuar, por duhet ta dini se këtë ashpërsi timen do ta tregoj sërish kundër të gjithë mizorëve dhe të padrejtëve. Nuk do t'u hap rrugë të padrejtëve mbi të dobëtit. Pasha Allahun, nëse dikush nga të padrejtët cenon dikë nga të drejtët dhe fetarët, do ta vendos faqen e tij në dhe, pastaj do t'ia vë këmbën time mbi faqen e tij derisa të marrë hak. Pastaj do ta vendos faqen time në dhe, që mbi të të shkelin të drejtët, fetarët dhe të dobëtit si mëshirë e butësi ndaj tyre. Ju keni tek unë çështje për të cilat e kam kushtëzuar veten në dobinë tuaj. Së pari, të mos marr prej jush pasuri për vete dhe për familjen time. Së dyti, t'ua shtoj pasurinë dhe riskun.

Së treti, të mos ju dërgoj shpesh në luftëra. E nëse ju dërgoj, unë do të jem në vend të babait të fëmijëve tuaj dhe të familjeve tuaja. Së katërti, ju mund të më urdhëroni në të mirë e të më ndaloni nga e keqja. Më kështilloni, ngase do të ankohem tek Allahu në Ditën e Kiametit!"

Në këtë çast të gjithë ata që ishin në xhami thanë "Allahu Ekber". Kjo ligjëratë vuri baza të rëndësishme.

Pika e fundit në ligjëratën e tij ishte se nëse nuk e urdhëronin në të mirë, nuk e ndalonin nga e keqja dhe nuk e këshillonin, do të ankohej tek Allahu xh.xh..

Për Omerin të ishte halif nuk ishte thjesht post udhëheqës, pasi tek ai ekzistonte frika se të qenët halif dhe përgjegjës i myslimanëve mund të ishte pengesë për të hyrë në xhenet. Këtë parim shumë fisnik e shpirtëror ua urojmë dhe shpresojmë udhëheqësve myslimanë. Le të bashkëpunojmë që të hyjmë në xhenet.

Arritjet e Omerit

Omer Faruku ishte i pari që u quajt "emirul muminin", princi i besimtarëve, prej halifëve të drejtë. Ebu Bekri quhej halifi i Pejgamberit alejhi selam dhe njerëzit nuk dinin si ta quanin Omerin. Ta quanin halifi i halifit të Pejgamberit alejhi selam?

Në këtë kohë erdhi Ahmed bin Kaisi me një delegacion nga Iraku. Ata dëshironin të takonin Omerin. I thanë Amr bin El-Asit që t'u merrte leje nga princi i besimtarëve që ta takonin. Ai ua ktheu: "Kush është princi i besimtarëve?" I thanë: "Princi i besimtarëve! A nuk është Omeri princi ynë?" Tha: "Po, si jo." I thanë: "A nuk jemi ne besimtarë?" Tha: "Po, si jo." Atëherë, Amri hyri tek Omeri dhe i tha: "Selamu alejkum, o princi i besimtarëve!" Omeri tha: "Kush është ai?" Amri i tha: "A nuk jemi besimtarë dhe ti je princi i besimtarëve?"

Që nga ajo ditë u përdor titulli princi i besimtarëve për halifin e myslimanëve. Omeri ishte i pari që u quajt princi i besimtarëve.

Kalendari sipas hixhrit

Gjatë halifatit të Omerit vinin letra e shkresa nga vendet e ndryshme, por ishin pa data. Omeri deshi ta sistematizonte këtë çështje, të dinte se si t'i gjente këto letra kur t'i duheshin. Atëherë ndjeu se kishte nevojë për një kalendar. I thanë të përdorte kalendarin romak ose persian, por ai refuzoi. Ai deshi që ky umet të kishte kalendarin e vet të pavarur dhe të diferencuar nga kalendarët e tjerë. Dikush i tha që të merrej ditëlindja e Pejgamberit alejhi selam si kalendar i myslimanëve, ose Israja dhe Miraxhi. Ai refuzoi dhe zgjodhi hixhretin. Kjo tregon se sa largpamës ishte Omeri. Ai mendonte se kalendari mysliman duhet të fillonte me themelimin e shtetit mysliman.

I pari që patrullonte i vetëm natën

Omeri bin Hatabi ishte qeveritari i parë në histori që ditën kalonte rrugëve të Medinës që të njihej me gjendjen e myslimanëve nga afër. Kur kalonte natën në patrullim dhe dëgjonte për ndonjë problem në atë shtëpi, vendoste një shenjë tek ajo shtëpi. Kështu, një natë, kur po kalonte në rrugë, dëgjoi dialogun mes një bije dhe një nëne që shitnin qumësht.

Omeri më parë e kishte ndaluar që të përzihej qumështi me ujë, ngase kjo ishte mashtrim për konsumatorin. Omeri dëgjoi nënën duke i thënë së bijës: "Përzieje qumështin me ujë", ndërsa e bija i tha nënës së saj: "Omeri, princi i besimtarëve, e ka ndaluar një gjë të tillë!" Nëna i tha: "Por Omeri nuk po na sheh", ndërsa bija e saj me plot besim të sinqertë i tha: "Por Allahu na sheh!"

Omeri e admiroi imanin e vajzës, prandaj vendosi një shenjë para asaj shtëpie. Shkoi te fëmijët e tij dhe u tha: "Kush prej jush po martohet me vajzën e shitëses së qumështit?"

Tek ajo vajzë ai kishte parë besim, sinqeritet dhe devocion. Nëse askush nga djemtë e tij nuk do ta merrte për grua, atëherë ai vetë do të martohej me të. Djali i tij Asimi u martua me të. Princi i besimtarëve e

martoi djalin e tij me bijën e shitëses së qumështit dhe nga pasardhësit e tyre më vonë vjen halifi i pestë i drejtë, Omer bin Abdulazizi.

Omeri mbante konferenca vjetore për valitë, komandantët dhe udhëheqësit myslimanë nga vendet e territoret e ndryshme për të llogaritur dhe përcjellë punën e tyre si dhe për të dëgjuar mendimet e tyre. Ai i mblidhte në Mina, në muajin e haxhit, të gjithë valitë, komandantët si dhe të gjithë ata që ai kishte emëruar me ndonjë përgjegjësi.

Omeri ishte i pari që mbajti një shkop. Ai kishte një shkop të shkurtër me të cilin i edukonte njerëzit. Ai ecte me shkop në dorë dhe kur shihte dikë duke bërë ndonjë gabim, e ndëshkonte.

Një sahab thotë: "Shkopi i vogël i Omerit ishte më madhështor se shpatat tuaja. Shkopi nuk i sillte Omerit madhështi, por duke qenë se ishte në dorën e Omerit, shkopi merrte madhështi."

Planifikimi i qyteteve

Omeri ishte i pari që planifikoi ndërtimin e qyteteve. Në kohën e tij u ndërtua qyteti i Kufës, në qendër të të cilit ai kishte menduar xhaminë. Pastaj ai planifikoi Basrën dhe më vonë edhe Fustatin (në afërsi të Kajros).

Shtrimi i rrugëve

Omeri ishte i pari që rrafshoi rrugët dhe i drejtoi ato. Ai urdhëroi që rrugët të rrafshohen dhe të hiqen pengesat prej tyre. Ai është thënës i fjalëve të famshme: "Nëse një mushkë në Irak pengohet, Allahu do të më marrë në llogari për të."

Kujdesi i tij i kaloi kufijtë e kujdesit për njerëzit deri te kujdesi edhe për kafshët. Thuhet se një ditë e kishte marrë malli të hante peshk. Shërbëtori i tij mori kafshën e tij dhe shkoi në breg të detit, në një udhëtim prej katër ditësh, që të sillte peshk. Kur u kthye, Omeri e pa kafshën e lodhur dhe i tha: "Të shkosh për një ditë dhe të kthehesh për një ditë vetëm për oreksin e Omerit? E ke ndëshkuar dhe munduar kafshën për hir të oreksit të Omerit? Pasha Allahun, nuk e ha këtë

ushqim, që të mos më llogarisë Allahu xh.xh. në Ditën e Gjykimit për lodhjen e kafshës!"

Arritjet e tij në sferën e adhurimeve

Në adhurim, Omeri ishte i pari që i mblodhi njerëzit në xhami për faljen e namazit të teravive. Në fakt, Pejgamberi alejhi selam fali një herë namazin e teravisë me myslimanët dhe njerëzit filluan të shtohen shumë. Kështu u falën për pesë ditë dhe në ditën e gjashtë Pejgamberi alejhi selam nuk doli për faljen e namazit të teravive me qëllim që të mos bëhej obligim për myslimanët. Pastaj njerëzit filluan t'i falin namazet e teravive në shtëpitë e tyre, por kishte prej tyre që e falnin edhe në xhami. Faleshin edhe grupe-grupe, secili grup e falte ndaras nga grupi tjetër, por kur erdhi Omeri, i bashkoi të gjithë në një namaz me një imam dhe kjo nuk është bidat në fenë e Allahut, ngase esenca e faljes së namazit të teravive është siç thamë më parë. Vetë Pejgamberi alejhi selam i fali me xhemat në xhami. Omeri e dinte se Pejgamberi alejhi selam e la faljen e namazit të teravive me xhemat vetëm se frikësohej se do t'u bëhej obligim myslimanëve. Nëse faleshin tani me xhemat, ky namaz nuk do t'u bëhej më farz, prandaj edhe Omeri i bashkoi myslimanët në namaz.

Namazi i xhenazes

Transmetohet se Pejgamberi alejhi selam e ka falur namazin e xhenazes me katër, me pesë dhe gjashtë tekbire, por më shumë me katër tekbire, prandaj Omeri i tuboi myslimanët në këtë formë të faljes së namazit të xhenazes.

Omeri kishte dëshirë ta zgjeronte xhaminë e Pejgamberit alejhi selam, prandaj donte t'ia merrte shtëpinë Abasit, Allahu qoftë i kënaqur me të, por Abasi refuzoi dhe shkoi te gjykatësi, që në atë kohë ishte Ali bin Ebi Talibi. Gjykatësi vendosi se Abasi kishte të drejtë. Atëherë, Abasi tha: "Tani ta jap tokën dhe shtëpinë, o princi i besimtarëve, dhe këtë e bëj vetëm që të lartësohet sovraniteti i myslimanëve."

Omeri ishte i pari që u jepte shpërblime atyre që mësonin Kuranin përmendësh. Ai ishte i pari që e shtyu "Mekamu Ibrahimin", vendin që Ibrahimi alejhi selam e përdorte për ndërtimin e murit të Qabesë. Mekami në atë kohë ishte thuajse i ngjitur me murin e Qabesë dhe kur myslimanët donin të bënin tavafin, largoheshin nga Mekami. Kur e pa këtë Omeri, e shtyu "Mekamu Ibrahimin" një distancë të shkurtër, në mënyrë që haxhilerët ta bënin haxhin më lehtë.

Omeri ishte i pari që kufizoi numrin e këshillit legjislativ, që më parë ishte i hapur.

Marrëdhëniet e tij në sferën e trajtimit të jomyslimanëve

Largimi i çifutëve nga Gadishulli Arabik

Prania e çifutëve në Gadishullin Arabik ishte e dëmshme për myslimanët. Pejgamberi alejhi selam i la çifutët e Hajberit me kusht që myslimanët të merrnin gjysmën e të lashtave të tyre në Hajber. Pejgamberi alejhi selam dërgonte Abdurrahman bin Oufin që të llogariste të lashtat e çifutëve dhe t'i ndante. Edhe Omeri dërgoi gjithashtu Abdurrahman bin Oufin. Një çifut shkoi tek Abdurrahmani dhe i tha: "O Abdurrahman, a do ndonjë llogari, ose përqindje më të mirë? Ti merr një të katërtën, ne të marrim më shumë se gjysmën, kurse pjesën tjetër t'ia japim Omer bin Hatabit."

Abdurrahmani menjëherë hoqi këpucën e tij dhe filloi ta godiste çifutin duke i thënë: "A do të më japësh ryshfet në nderin e Omerit dhe në nderin e Pejgamberit alejhi selam? Pasha Allahun, nuk ke prej meje diçka tjetër vetëm se këtë këpucë në fytyrë!"

Kur lajmi i shkoi Omerit, ai tha: "U bekoftë ajo dorë që goditi me këpucë atë njeri!", dhe dha urdhër të largohen çifutët nga Gadishulli Arabik.

Imponimi i xhizjes ndaj ithtarëve të librit sipas standardit të tyre ekonomik

Në kohën e Omerit i varfri dhe ai me pak të ardhura paguante xhizje të vogël, kurse i pasuri paguante më shumë. Omeri e anuloi xhizjen ndaj ithtarëve të librit që ishin shumë të varfër dhe nuk kishin mundësi ta paguanin. Një ditë, Omeri pa një çifut të vjetër që po lypte në rrugët e Medinës dhe e pyeti përse po lypte. Ai ia ktheu: "Që të paguaj xhizjen!" Omeri tha: "Pasha Allahun, nuk të kemi mëshiruar ty nëse e kemi marrë xhizjen në rininë tënde dhe në pleqërinë tënde." Atëherë ia ktheu atij xhizjen dhe u dha urdhër valive të tij që ithtarëve të varfër të librit t'u kthehen xhizjet e marra.

Të vjetërve dhe të varfërve nga gjiri i ithtarëve të librit Omeri u jepte nga buxheti i shtetit mysliman. Koha e sundimit të Omerit ishte kohë paqeje dhe tolerance me jomyslimanët. Kur ai shkoi në Kuds, i kërkuan që të falej në kishë, por Omeri tha: "Po falem jashtë kishe, pasi kam frikë se kur të vdesë Omeri, myslimanët do ta rrënojnë kishën e do të ndërtojnë në vend të saj xhami. Po falem në rrugë dhe le të mbetet kisha në vend."

Arritjet e tij në sferën e politikës luftarake

Omeri qe i pari që organizoi kampe stërvitore të përhershme. Ai qe i pari që dha urdhër që ushtria të jetë e detyrueshme.

Omeri qe i pari që caktoi se sa kohë ka të drejtë burri të rrijë larg gruas së tij. Sipas këtij urdhri, burri nuk kishte të drejtë të rrinte larg gruas më shumë se katër muaj.

Ai qe i pari që themeloi forcat e rregullta rezerviste, për të cilat ai kishte mbledhur tridhjetë mijë kuaj.

Omeri qe i pari që kishte vendosur pika kontrolli në pozicione të ndryshme. Ai qe i pari që kërkoi nga komandantët e tij raporte të detajuara për jetën e çdo ushtari. Ai i shkroi një letër Sad bin Ebi Vekasit, ku i shkruante: "Më shkruaj në detaje sikur t'ju shihja. Më shkruaj për

gjendjen tënde dhe të ushtarëve të tu, më shkruaj për adhurimet (ibadetet) e tua dhe të ushtarëve."

Ai qe i pari që bëri dosjen e ushtarëve, ku regjistrohej çdo gjë që lidhej me ushtarët, si emrat, pagat etj..

Omeri qe i pari që u caktoi ushtarëve një rrogë fikse.

Ai qe i pari që caktoi mjek, përkthyes, gjykatës dhe udhëzues për të shoqëruar ushtrinë dhe që krijoi departamentin e furnizimit të ushtrisë.

Arritjet e tij në arenën ndërkombëtare

Omeri ishte i pari që regjistronte në dosje çdo gjë.

Ai ishte i pari që themeloi Ministrinë e Furnizimit dhe të Vakëfit Islam.

Omeri qe i pari që ua llogariti të ardhurat dhe pasurinë valive dhe nëpunësve të tij dhe e urdhëroi secilin prej tyre të tregonte sa pasuri kishte.

Omeri qe i pari që themeloi Ministrinë e Financave, që shtypi valutën e dërhemit dhe ia caktoi asaj vlerën në peshë.

Omeri qe i pari që mblodhi zekatin e kuajve dhe që i caktoi taksa popullit. Ai qe i pari që vendosi se jetimët dhe të gjeturit në rrugë (fëmijët pa baba dhe nënë) do të mbaheshin nga buxheti i shtetit.

Omeri qe i pari që vendosi sistemin e kadastrës, që për herë të parë të mateshin sipërfaqet e tokave dhe të shpallej pronari i tyre. Ai qe i pari që shpërndau ushqim në vende të ndryshme dhe që ndërtoi vendpritje për delegacionet dhe për udhëtarët në vendet myslimane.

Omeri qe i pari që u huazonte nga suficiti i shtetit atyre që dëshironin të punonin në tregti dhe qe i pari që dërgoi në mërgim ata që bënin monopol të artikujve ushqimorë.

Omeri qe i pari që caktoi dhe i mbrojti sipërfaqet e gjera në hapësirë dhe i quajti sipërfaqe të mbrojtura nga shteti. Si rezultat i kësaj u rrit numri i deveve dhe i dhive.

Çlirimet në kohën e Omerit

Iraku u çlirua i tëri në kohën e Omerit, ashtu si dhe Shami, Egjipti dhe Azerbajxhani. Omeri çliroi Kudsin dhe hyri në Mesxhidul Aksa.

Gjithë këto arritje u realizuan për dhjetë vjet e gjashtë muaj.

Cilësitë e sundimtarit

Omeri kishte cilësi që askush përveç Pejgamberëve nuk i pati gjatë tërë historisë njerëzore. Njerëzit e dinë se ajo që sundon sot botën është forca dhe fuqia; ai që ka forcën, imponon vullnetin e tij te të tjerët, nënçmon të dobëtin dhe imponon mendimin e vet. Ai që sundon duhet të jetë i fortë, ndërsa i dobëti nuk ka kurrfarë zgjidhjeje në dorë. E vërteta është se personaliteti më adekuat jo vetëm për myslimanët por edhe për mbarë botën është Omer bin Hatabi. Ai ishte personi i vetëm në mesin njerëzor që posedoi fuqinë absolute njerëzore si dhe mëshirën absolute njerëzore. Omeri qe shumë i drejtë, shumë i fuqishëm si dhe shumë i mëshirshëm. Perëndimorët sot thonë se nuk ka mundësi që sot të bashkohen dy antagonizma, fuqia absolute dhe mëshira absolute. Nëse fuqia është në krahun e së drejtës, mirë, por nëse fuqia është në anën tjetër të së drejtës, atëherë fuqia duhet të sundojë e jo drejtësia.

Personaliteti i Omerit ishte i vetmi pas Pejgamberëve që zotëronte fuqi, drejtësi dhe mëshirë në shkallën më të lartë njerëzore.

Fuqi dhe mëshirë

Omeri sundonte një pjesë të madhe të botës. Kufijtë e shtetit islam shtriheshin në Afrikë dhe në Azinë Qendrore deri në Azerbajxhan, duke përfshirë këtu Shamin e Persinë. Me gjithë pushtetin e tij, kur pa në rrugë një lypës çifut që lypte për të paguar xhizjen, Omeri e shikoi atë me mëshirë të madhe dhe i tha: "E kemi marrë xhizjen prej teje sa ke qenë i ri, pastaj të detyrojmë që të lypësh në moshën e vjetër? Jo, pasha Allahun!" Pastaj dha urdhër t'ia kthenin atë që kishte paguar

dhe t'i jepej atij dhe të gjithë ithtarëve të varfër të librit pension nga buxheti i shtetit.

Të drejtojmë me shpatat tona

Një ditë, Omeri i tuboi myslimanët në xhami dhe u tha: "O ju njerëz, çfarë do të bëni nëse dynjaja ma lakon kokën time kështu?" Njerëzit heshtën. Pastaj ai e përsëriti sërish dhe askush nuk foli. Pastaj e përsëriti për herë të tretë dhe atëherë doli një nga të pranishmit dhe tha: "Nëse dynjaja ta lakon kokën ashtu, atëherë do të ta drejtojmë me shpatat tona." Atëherë, Omeri tha: "Elhamdulilah që në umetin e Muhamedit alejhi selam ka njerëz që e drejtojnë Omerin nëse shkon në rrugë të shtrembër!"

Kush është Zoti juaj, cila është feja juaj dhe çfarë thoni për këtë njeri që është dërguar në mesin tuaj?

Pejgamberi alejhi selam ishte ulur një ditë në mesin e sahabëve dhe i pyeti: "Çfarë do t'u thoni dy engjëjve kur të vijnë në varret tuaja dhe t'i hapin ato me dhëmbët e tyre?" Omeri i tha: "O i Dërguari i Allahut, a do ta kem mendjen atëherë?" Pejgamberi alejhi selam i tha se po. E, Omeri ia ktheu: "Atëherë do t'ju mjaftojë atyre o i Dërguari i Allahut (do të di si t'u përgjigjem)."

Pejgamberi alejhi selam buzëqeshi dhe tha: "A e di o Omer se çfarë do t'u thuash dy engjëjve?" Omeri i tha Pejgamberit alejhi selam: "Çfarë do t'u them dy engjëjve?" Pejgamberi alejhi selam ia ktheu: "Kur të vijnë dy engjëjt e do të të pyesin kush është Zoti yt, ti do t'u thuash: "Mirë, po kush është Zoti juaj?" Kur të thonë cila është feja jote, ti do t'u thuash: "Jo, cila është feja juaj?" Do të thonë se çfarë thua për burrin që është dërguar në mesin tuaj, e ti do t'u thuash: "Po ju çfarë thoni për atë burrë që është dërguar në mesin tuaj?"

Që të mos pyetem nga Allahu në Ditën e Kiametit!

Një natë, Omeri ishte duke ecur në rrugët e Medinës dhe dëgjoi një fëmijë që qante. Ai i foli nga jashtë nënës së fëmijës: "Për Allahun, vëre fëmijën të flejë!" Pas pak ai dëgjoi sërish zërin e fëmijës dhe tha: "Për Allahun, vëre fëmijën të flejë!" Pastaj e dëgjoi për herë të tretë zërin e fëmijës dhe i tha: "Vërtet qenke nënë e keqe, vëre fëmijën të flejë!"

Nëna e fëmijës iu përgjigj: "Më lër të lirë, sepse Omeri nuk ka dhënë ushqim. Fëmija nuk po mëson të hajë, e unë po mundohem ta mësoj të hajë."

Atëherë Omeri qau dhe shkoi në xhami. Ishte koha e namazit të sabahut. Ata që ishin në xhami thanë: "Për Allahun, për shkak të të qarit të shumtë, nuk mundëm të kuptonim se çfarë lexoi Omeri."

Pasi përfundoi namazin, Omeri tha: "Mjerë Omeri në Ditën e Kiametit! Sa fëmijë të myslimanëve i ke vrarë, o Omer!"

Pastaj tha: "O ju njerëz, për Allahun, prej sot mos u ngutni që t'i mësoni fëmijët tuaj të hanë. Unë do t'ju furnizoj për të gjithë fëmijët tuaj të lindur dhe të rritur, që mos të pyetem në Ditën e Kiametit."

Sundove dhe ishe i drejtë, i sigurove dhe fjete

Pas humbjeve të shumta të bizantinëve në luftë kundër myslimanëve, pasi Herakliu ndjeu se mbretëria e tij ishte duke u rrënuar, ai dërgoi një lajmëtar tek Omeri që t'i dërgonte një mesazh. Misionari i Herakliut hyri në Medinë dhe filloi të pyeste për Omerin. Një njeri i tregoi se ai person që po flinte nën atë hije ishte Omeri, princi i besimtarëve. Atëherë lajmëtari u habit dhe tha thënien e tij të njohur: "Sundove dhe ishe i drejtë, i sigurove të tjerët dhe fjete i sigurt, o Omer! Ne mbretëruam dhe bëmë padrejtësi, mbetëm natën pa gjumë duke u ruajtur e prapë ndihemi të frikësuar, prandaj na mundët ju o myslimanë."

O Zot, më shto madhështinë!

Omeri ishte duke ecur një ditë dhe pas tij ecnin edhe disa myslimanë. Kur Omeri u ndal, u ndalën edhe ata. U kthye Omeri drejt tyre dhe u tha: "Përse u ndalët?" Thanë: "U frikësuam nga madhështia jote, o Omer!" Omeri u tha: "A ju kam bërë ndonjë të padrejtë?" I thanë se jo. Atëherë ai tha: "O Zot, ma shto madhështinë (hibetin)!"

Një ditë, Omeri shkoi te berberi dhe kur ishte aty u kollit. Berberit nga frika i ra gërshëra nga dora, madje në disa transmetime të tjera thuhet se gati sa nuk e humbi vetëdijen nga frika.

Ëndrra e Pejgamberit alejhi selam

Pejgamberi alejhi selam thotë: "Pashë në ëndërr se në Ditën e Kiametit dikush prej njerëzve e kishte këmishën e tij deri në gjoks, dikush e kishte këmishën deri te kocka më e lartë në gjoksin e tij (afërsisht në qafë), e dikush e kishte edhe më pak se ajo. E pashë Omerin se e kishte këmishën të gjatë dhe e tërhiqte zvarrë. A e dini se ç'është ajo këmishë?" Thanë: "Jo, o i Dërguari i Allahut." Ai tha: "Ajo është simbol i fesë."

Sikur ta kisha në dorë, do të të zgjidhja ty në vend të Omer bin Hatabit!

Siç ishte traditë e tij, Omer bin Hatabi natën patrullonte rrugëve të Medinës. Ai pa një zjarr diku larg dhe shkoi drejt e atje tek ata njerëz. Aty pa një grua dhe fëmijët e saj që qanin. Gruaja kishte vënë një enë në zjarr dhe vlonte ujë në të, kurse fëmijët qanin. Omeri u kollit, u afrua dhe tha: "O pronarët e dritës, a mund të afrohem?" Gruaja i tha se po. Omeri e pyeti: "Çfarë keni, përse qajnë fëmijët tuaj?" Tha: "Pasha Allahun, nuk kemi ushqim dhe jemi në udhëtim." Omeri tha: "Po çfarë ka në atë enë në zjarr?" Gruaja ia ktheu: "Mundohem t'i mashtroj e t'i vë në gjumë." Omeri i tha: "Përse ka ndodhur kjo?" Gruaja i tha: "Sikur Omeri ta dinte, kjo nuk do të na ndodhte!" Omeri i tha: "Më prit këtu, oj grua!"

Omeri mori me vete shërbëtorin e tij që quhej Jarfe dhe u nis drejt shtëpisë së financave të myslimanëve. Jarfeja tregon se Omeri vrapon te aq shpejt, saqë nuk mund ta arrinte. Omeri arriti para tij dhe mori një thes me miell, e vuri mbi shpinën e tij, mori edhe ushqime të tjera dhe pak elb. Shërbëtori i tha: "Ma jep mua, o princi i besimtarëve!" Omeri i tha: "E kush e mban këtë në Ditën e Kiametit? Largohu prej meje, o Jarfe, se do ta mbaj vetë, ngase nuk dua që Zoti të më llogarisë në Ditën e Kiametit."

Omeri nisi të përgatiste ushqimin dhe ndihmonte në ndezjen e zjarrit duke i fryrë atij, derisa zjarri i preku mjekrën. Omeri i ushqeu fëmijët dhe i tha nënës së tyre: "Nesër në mëngjes eja në shtëpinë e princit të besimtarëve, ndoshta më gjen atje", kurse gruaja i thoshte: "Pasha Allahun, ti je më i mirë se Omer bin Hatabi. Sikur të ishte në dorën time, do të të zgjidhja ty në vend të Omerit!"

Druajtja e sundimtarit

Omeri ishte ulur një ditë pas një muri dhe po qante. Një sahab e pa tek qante dhe kapte mjekrën e tij dhe thoshte: "O Omer biri i Hatabit, princi i besimtarëve, bravo bravo!"

Ky sahab pastaj tregon se Omeri nisi të qante edhe më shumë, prandaj ai iu afrua dhe u përpoq t'ia zbuste gjendjen duke e pyetur: "Ç'të bëri të qaje, o princi i besimtarëve?"

Omeri ia ktheu: "Po qaj ngase kam dëgjuar Pejgamberin alejhi selam kur tha: ""Nuk ka ndonjë njeri që obligohet me ndonjë çështje të myslimanëve e nuk mundohet dhe lodhet për ta, vetëm se ai person nuk do jetë me ta në xhenet." I tha: "Përse po qan atëherë, o princi i besimtarëve?" Tha: "Kam frikë se myslimanët do të hyjnë në xhenet dhe Omeri do të hyjë në zjarr, ngase nuk jam përpjekur e lodhur sa duhet për ta."

Kur i robëruat njerëzit, ndërsa nënat e tyre i kanë lindur të lirë?

Pasi myslimanët çliruan Egjiptin, Omer bin Hatabi e emëroi Amr bin El-Asin mëkëmbës të Egjiptit. Në Egjipt po mbaheshin garat e vrapimit të kuajve dhe i biri i Amr bin El-Asit po garonte me një egjiptian. Garën e fitoi egjiptiani, prandaj i biri i Amrit e goditi me kamxhik në kokë egjiptianin dhe i tha: "Më munde mua, djalin e më të ndershmëve?!" Egjiptiani shkoi në Medinë që t'i ankohet princit të besimtarëve për rrahjen, ngase e njihte drejtësinë e Omerit dhe e dinte se në sundimin e tij nuk i bëhet askujt e padrejtë. Kur Omeri u njoftua për këtë, i dërgoi mesazh Amr bin El-Asit që të vinte në këmbë me gjithë të birin në Medinë. Omeri ia dha kamxhikun egjiptianit dhe i tha: "Merre dhe rrihe birin e më të ndershmëve." Egjiptiani e goditi birin e Amrit dhe mori hakun, pastaj Omeri i tha: "Drejtoja tani kamxhikun kokës së babait të tij1" Egjiptiani i tha: "Unë rraha atë që më rrahu." Omeri i tha: "Ai të ka rrahur me pushtetin e babait të vet." Pastaj iu kthye Amrit dhe i tha: "O Amr, kur i keni skllavëruar njerëzit, ndërsa nënat e tyre i kanë lindur të lirë?!"

Jo në zjarr, por në xhenet

Omeri ishte ulur e tek ai erdhi një arab me dy vajza dhe me gruan e tij. Arabi i tha princit të besimtarëve:

"O Omer, mirësi, u shpërblefsh me xhenet! Vishi vajzat e mia dhe nënën e tyre. Të përbej në Allahun ta bësh këtë!" Omeri deshi të komentonte më shumë këtë rast dhe e pyeti arabin sërish, duke i thënë se ç'bëhej nëse nuk vepronte ashtu. Arabi i tha: "Atëherë po largohem, o baba i Hafsës." Pastaj arabi e pa dhe shtoi: "Pasha Allahun, atëherë do të përgjigjesh para Allahut atë ditë kur dhuratat janë mbulesë, atë ditë që do të tërhiqesh ose në zjarr, ose në xhenet."

Omeri hyri në shtëpinë e tij duke qarë dhe tha: "Pasha Allahun, do t'ju jap tërë atë që kam në shtëpi."

Doli nga aty, sepse nuk gjeti asgjë që mund t'ua jepte, prandaj hoqi këmishën e vet, ua dha dhe u tha: "Pasha Allahun, nuk kam gjë tjetër përveç kësaj këmishe. Ndoshta në ahiret do të jetë dhuratë e xhenetit e të dërgohem në xhenet e jo në zjarr."

Një ditë, Omeri shkoi te gruaja e tij dhe me vete kishte disa parfume. Ai kërkoi prej bashkëshortes së tij që t'i ndante në disa shishe të vogla që t'ua shpërndante myslimanëve të varfër. Duke e ndarë parfumin në shishe të vogla, disa pika ranë në rrobat e saj. Kur Omeri shkoi sërish tek ajo, nuhati erën e parfumit dhe menjëherë i tha: "Ç'është kjo?" Ajo ia ktheu: "Më ranë disa pika në rroba teksa e hidhja parfumin në shishe të vogla. Ç'të bëj?"

Omeri i mori rrobat e saj dhe lau e fërkoi fort. Pastaj i nuhaste erën derisa era e parfumit nuk u ndie më. Pastaj Omeri tha: "Ky parfum ishte me paratë e zekatit të myslimanëve!"

Nuk i respekton ato vetëm se fisniku

Njëri nga myslimanët një ditë u hidhërua sepse gruaja e tij kishte ngritur zërin ndaj tij. Deshi të ankohej te princi i besimtarëve, Omeri, por kur u afrua te dera e shtëpisë së Omerit dëgjoi se zëri i gruas së Omerit ishte më i lartë se zëri i Omerit. Atij i erdhi keq të trokiste në derë dhe u kthye. Kur donte të kthehej, del Omeri nga dera, e sheh dhe i thotë: "Ndoshta erdhe për ndonjë nevojë." Ai ia ktheu se po. Omeri e pyeti se përse po largohej, atëherë dhe ky burrë i tregoi: "Erdha të ankohem se gruaja ime po e ngre zërin ndaj meje, por dëgjova se zëri i gruas tënde ishte më i lartë se zëri yt, prandaj u ktheva."

Omeri tha: "Më ka duruar dhe ka pastruar rrobat e mia. Më ka përgatitur shtratin e fjetjes dhe më ka rritur fëmijët. I bëri të gjitha këto dhe më duroi, e përse mos ta duroj atë kur ngre zërin?"

A është gjykimi ndryshe?

Në Medinë jetonte një çifut që kishte një stallë kuajsh. Omeri një ditë deshi të blinte një kalë. Ai kërkoi nga çifuti një kalë dhe ai i dha një kalë me të meta. Omeri e mori ta provonte, por kalit iu thye këmba. Çifuti kërkoi nga Omeri çmimin e kalit, por Omeri i tregoi se nuk e kishte blerë ende. Çifuti këmbëngulte të merrte paratë. Shkuan te kadiu Shurej, i cili i tha Omerit: "O princi i besimtarëve, ose merre atë që ke blerë, ose ktheje ashtu siç e ke marrë!" Omeri buzëqeshi dhe tha: "Si është ndryshe gjykimi?"

Pastaj shtoi: "Po e marr! Falënderimi i takon Allahut për drejtësinë në umetin e Muhamedit alejhi selam!"

Ibni Mesudi ka thënë: "Pasha Allahun, ende ishim të nënçmuar derisa Omeri u bë mysliman! Pasha Allahun, nuk mund të faleshim para Qabesë prej mosbesimtarëve kurejshë derisa Omeri u bë mysliman! Pasha Allahun, sikur shoh mes syve të Omerit një engjëll që e forcon dhe e drejton. Besoj se edhe shejtanët ishin prangosur në kohën e Omerit."

Morali dhe vdekja e Omerit

Modestia dhe përulësia e tij

Një ditë, Omeri ishte duke ecur me disa sahabë. Një grua plakë e ndali dhe i tha: "Eja, o Omer!" Omeri iu afrua dhe plaka i tha: "A të kujtohet kur të thërrisnin Omejr kur përlaheshe me djelmoshat e Mekës, kur u rrite filluan të të thërrasin Omer, kurse tani të thërrasin princi i besimtarëve? O Omer, ki frikë Allahun se do të të ndëshkoj..." Sahabët i thanë plakës: "Si i flet kështu princit të besimtarëve?" Omeri u tha: "A e dini se kush është kjo? Kjo është ajo gruaja së cilës ia dëgjoi Allahu xh.xh. në shtatë qiej ankesën e saj." Omeri e kishte fjalën për ajetin: ***"Vërtet Allahu dëgjoi fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua tek Allahu; Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë."*** *(El-Muxhadele, 1)*

Kjo grua plakë ishte Hule bint Thalebe. Pastaj, Omeri tha: "Pasha Allahun, sikur të ndalej një vit e të më qortonte, nuk do të lëvizja nga vendi im!"

Një ditë, Omeri i tuboi njerëzit, u ngjit në mimber dhe u tha: "O ju njerëz, i kam ruajtur delet e tezes në Mekë. Merrja pagesë për këtë disa hurma. Nëse nuk e dini ku i kam ruajtur, atëherë dijeni."

Ali bin Ebu Talibi i tha: "O princi i besimtarëve, të shoh se nuk bën tjetër vetëm se po e nënçmon veten."

Omeri tha: "Këtë desha ta bëja ngase disi m'u duk vetja se u rrita kur mendova se jam princ i besimtarëve, prandaj desha ta edukoja veten."

Omeri ishte duke u ligjëruar një ditë njerëzve dhe u tha: "Mos e shtoni mehrin e grave më shumë se 40 eukije." Një grua u ngrit dhe tha më sa zë që kishte: "Ti nuk e ke këtë të drejtë!" Omeri i tha: "Përse?" Gruaja tha: "A nuk ke dëgjuar thënien e Allahut kur tha: ***"Në qoftë se dëshironi të ndërroni*** *(ta merrni)* ***një grua në vend të një gruaje*** *(të lëshuar)*, ***e asaj*** *(të lëshuarës)* ***i keni pas dhënë shumë të madhe, mos merrni prej saj asnjë send. A do ta merrni atë pa të drejtë e në mënyrë mizore?"*** *(En-Nisa, 20)*

Omeri e shikoi atë gruan dhe tha: "Po, gruaja ia qëlloi e Omeri gaboi."

Një ditë Omeri ishte duke ecur pranë shtëpisë së Abasit, xhaxhait të Pejgamberit alejhi selam. Ai pa se streha e shtëpisë së tij pikonte e pikat e shiut binin mbi udhëtarët që kalonin atypari. Omeri mori ta ndreqte strehën dhe e drejtoi pranë murit. Abasi zbriti tek ai dhe i tha: "A e di se ç'ke bërë?! A e di se kush e ka vendosur? Pejgamberi alejhi selam është ai që e ka vendosur aty. E nëse ti do të ndreqësh e ta drejtosh siç do, vepro..." Omeri ia ktheu: "Të përbej në Allahun, o Abas, hip mbi shpinën time dhe drejtoje siç ka qenë!" Abasi refuzoi. Omeri tha: "Jo, pasha Allahun, asnjëherë nuk e largoj një gjë që Pejgamberi alejhi selam e ka vënë me duart e tij!"

Le të meditojnë e ta përfillin mirë këtë thënie të Omerit ata që kanë humbur traditën e Pejgamberit alejhi selam dhe e kanë ndryshuar atë.

Jarfeja, shërbëtori i Omerit, tregon se një ditë e kishte parë rrobën e Omerit dhe kishte vërejtur se ajo kishte më shumë se njëzet e një arna, katër prej tyre në krah. Një ditë, Omeri u vonua për në namazin e xhumasë, pastaj doli para njerëzve dhe hipi në mimber. Ai vazhdoi t'u kërkonte falje njerëzve për një kohë të gjatë, duke u thënë: "Pasha Allahun, nuk jam vonuar për diçka tjetër vetëm se nuk kam rroba të tjera. Desha ta laja e të vija me rroba të pastra në xhami. Më falni që u vonova!"

Kur erdhën disa pëlhura nga Jemeni, çdo mysliman mori nga një pëlhurë, e cila u mjaftonte për një palë rroba ose më pak. Kur Omeri ua ndau banorëve të Medinës, ai mori për vete një pëlhurë, por ajo nuk i mjaftoi, ngase Omeri ishte i gjatë. Kur doli para njerëzve në ditën e xhuma, në fjalën e tij ai i nxiste besimtarët t'i bindeshin Allahut xh.xh. dhe të respektonin udhëheqësit myslimanë. Njëri nga të pranishmit në xhami i tha: "As nuk të dëgjojmë e as nuk të bindemi sot derisa të na tregosh se nga i more këto rroba!" Omeri tha: "Allahu të shpërbleftë për interesimin tënd për myslimanët." Pastaj thirri djalin e tij, Abdullah bin Omerin, që t'i përgjigjej asaj pyetjeje. Abdullahu u përgjigj se ai i kishte dhënë të atit dhuratë pjesën e tij të pëlhurës, pasi babai i tij ishte i gjatë dhe pëlhura e tij nuk i dilte për një palë rroba. Atëherë burri në xhami tha: "Tani të dëgjojmë dhe të bindemi!"

Një ditë, Omeri ishte duke ecur në rrugë dhe një djalosh kishte hipur mbi gomar. Atij i erdhi keq për Omerin si princ i besimtarëve dhe i tha: "Hip, o princi i besimtarëve, kurse unë do të eci." Omeri ia ktheu: "Jo, pasha Allahun, por do të hipim që të dy!" Djaloshi i tha të hipte para, kurse ai pas tij, por Omeri i tha: "Jo, ti hip përpara në vend të butë, e unë do të hipi mbrapa në vend të vrazhdë."

Omeri kërkoi dorën e një gruaje me të cilën deshi të martohej. Kjo grua ishte Umu Iban bint Umar. Kësaj gruaje i kërkuan martesë dy sahabë, Omeri dhe Talha bin Ubejdullahu. Ajo zgjodhi Talha bin Ubejdullahun. Kur e pyetën përse, tha: "Omeri e ka lëshuar këtë dynja dhe ka zgjedhur ahiretin. Sa herë që e shikoja, sikur e shihja se po shikon tek Allahu me dy sytë e tij. Nuk mund ta kaloj jetën me të..."

Një ditë, Shifa, bija e Abdullahut, ishte duke ecur dhe pa një grup njerëzish që ecnin të mekur e të lodhur dhe flisnin ngadalë e më zë të ulët. Ajo pyeti: "Si është puna e tyre?" I thanë: "Ata janë njerëz të devotshëm e të përvuajtur." Shifaa tha: "Kur Omeri fliste, e dëgjonin të gjithë; kur ecte, shpejtonte; kur hante, ngopej, e kur godiste, të dhembte. E Omeri ishte vërtetë i përvuajtur dhe i devotshëm!"

Përvuajtja dhe fisnikëria e Omerit, Allahu qoftë i kënaqur me të

Pasi myslimanët çliruan Persinë, për ta u hapën shumë depo plot thesare. Myslimanët i mblodhën këto thesare dhe u nisën për në Medinë nga Persia dhe Iraku. I vendosën në xhaminë e Pejgamberit alejhi selam pa asnjë roje dhe mbi to vendosën vetëm një mbulesë. Më vonë erdhi Omeri dhe ngriti mbulesën që mbulonte thesarin. Aty kishte edhe unaza të vogla e copëza të vogla diamanti si dhe gjëra të tjera të vogla e të çmuara, të cilat mund të vidheshin fare lehtë. Omeri atëherë tha: "Populli që e ka bërë këtë është i sinqertë e besnik!" Aliu i tha: "Je vetë besnik, prandaj edhe ata janë treguar besnikë. E sikur të anoje ti, edhe ata do të anonin."

- Omer bin Hatabi caktoi që ithtarëve të librit t'u ndahej një buxhet dhe për këtë ai emëroi një të krishterë që t'ua ndante pensionet. Ky nëpunës i krishterë i dha Omerit një palë rroba dhuratë dhe Omeri e pyeti: "A është prej pasurisë tënde? I krishteri i tha: "Është prej pasurisë sime, përveç një peri me të cilin kam plotësuar një qepje." Omeri i tha: "Ma trego ku është", dhe filloi ta shkulte, derisa e hoqi fare dhe tha: "O Allah, pastroje këtë rrobë nga çdo gjë që nuk i lejohet Omer bin Hatabit!"
- Omeri kishte caktuar një vend të mbrojtur për kullosë, që aty të mbaheshin vetëm devetë dhe kafshët e myslimanëve. Ai hyri një ditë aty dhe pa disa deve të majme e disa të dobëta. Ai pyeti se të kujt ishin devetë e majme. I thanë se ishin të Abdullah bin Omer bin Hatabit. Atëherë, Omeri u hidhërua shumë, ngase ata që punonin në atë vend ishin interesuar më shumë për devetë e djalit të

tij sepse ai ishte biri i princit të besimtarëve dhe kjo ishte në dëm të deveve të tjera. Omeri e ndëshkoi me shkop dhe Abdullahu i tha: "Çfarë të keqe kam bërë unë?!" Omeri i tha: "I kanë shikuar për shkak të pozitës tënde." Omeri e pyeti se cila ishte vlera e tyre para se të hynin në këtë vendkullosë dhe pastaj ia dha çmimin e kërkuar, ndërsa fitimin e tyre e futi në kasën e myslimanëve. Pastaj Omeri i mblodhi punëtorët e asaj kullose dhe i ndëshkoi me shkop dhe u tha: "Ju e keni bërë këtë duke pasur parasysh vendin e tij te princi i besimtarëve. Pasha Allahun, nuk hyn në gojën e djalit të princit të besimtarëve ajo që nuk është hallall."

- Kur Omeri ndante dhuratat, ai kishte parasysh njerëzit e respektuar dhe me merita dhe nderonte edhe bijtë e tyre. Një ditë, Omeri pa një djalë të ri, babai i të cilit kishte marrë pjesë në luftën e Uhudit. Omeri i dha atij katër mijë dërhemë, kurse djalit të vet tre mijë dërhemë. Kur e pyetën njerëzit pse po e bën këtë dallim në ndarjen e dhuratave, u tha: "Babai i tij ka qëndruar më shumë në luftën e Uhudit."
- Omeri goditi një ditë dikë me shkopin e tij dhe më vonë pa se ai njeri nuk kishte gabuar. Omeri i tha: "Të përbej në Allahun, merre hakun tënd sot!" Ai i tha: "Jo sot." Ditën tjetër e gjeti Omerin te dera e shtëpisë së tij, ku kishte qenë duke pritur tërë natën. Kur ky njeri doli nga dera e tij, Omeri i tha: "A ka ardhur koha që ta marrësh hakun tënd prej meje?", dhe i dha shkopin e tij, por ai i tha: "Jo, ende nuk është koha!" Omeri i tha: "Të lutem, merre hakun tënd. Unë nuk kam fjetur fare tërë natën duke të pritur të marrësh hakun. Ose merre hakun, ose më fal!" Ai burri i tha: "Ta kam falur rrahjen!"
- Omeri derdhte lot shumë dhe qante shumë. Në sytë e tij kishte dy viza të zeza nga të qarët. Një natë ai po ecte mes shtëpive që të njihej me hallet e myslimanëve. Papritmas dëgjoi një nga myslimanët që lexonte në shtëpinë e tij suren Tur, e kur erdhi te Fjala e Allahut: ***"Vërtet ndëshkimi i Allahut do të ndodhë, e atë nuk ka kush që do ta ndalë",*** *(Tur 7-8),* u ndal dhe këmbët nuk e mbanin më. U ul dhe ia nisi vajit. Nuk mund të ecte, prandaj e morën dhe

e dërguan në shtëpi. Thuhet se njerëzit shkonin dhe e vizitonin një muaj me radhë dhe nuk e dinin se ç'kishte.

- Omeri në shumicën e rasteve e lexonte suren Jusuf në namazin e sabahut. Kur arrinte tek ajeti: ***"Ai*** *(Jakubi)* ***tha: "Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj All-llahut, e unë di për All-llahun atë që ju nuk e dini"*** *(Jusuf, 86),* qante me dënesë. E qara e tij dëgjohej nga ata që ishin në rreshtin e katërt dhe të pestë.
- Omeri pyeste shumë për devotshmërinë. Një ditë thirri Ebij bin Kabin dhe i tha: "Më fol për devotshmërinë." I tha: "O princi i besimtarëve. Zëre se je duke ecur në ara me plot ferra. Çfarë do të bësh?" Tha: "Përvjel mangët dhe mundohem." I tha: "Ajo është devotshmëria. Përvil mangët për bindjen (taatin) ndaj Allahut dhe mundohu të mos e kundërshtosh Allahun e mos t'ia thyesh urdhrat."
- Kur Omeri e shihte Musa El-Eshariun, i cili kishte zë të mirë kur lexonte Kuran, i thoshte: "Eja ma shto mallin për Allahun" dhe kërkonte që t'i lexonte Kuran.
- Një ditë e pyeti Ebij bin Kabin se si del shpirti dhe ai i tha: "A e sheh degën e lisit se sa degë ka? Sikur ta fusim në gojën e njeriut e të mundohemi ta nxjerrim nga aty, çdo degë kapet te damarët e njeriut derisa ta nxjerrim me forcë. Ashtu del edhe shpirti."

Omeri arriti bindje aq të fortë, saqë tha: "Pasha Allahun, sikur të çahet qielli dhe ta shoh xhenetin me sy, nuk do të më shtohet më shumë bindja!" Pejgamberi alejhi selam i pati treguar Hudhejfe bin Jemames emrat e hipokritëve dhe disa sekrete të tjera. Omeri shkoi tek ai dhe këmbënguli që t'i tregonte se a mos kishte përmendur Pejgamberi alejhi selam në mesin e hipokritëve, kurse Hudhejfeja nuk i përgjigjej. Omeri i tha: "Të përbej në Allahun që të më tregosh a më ka përmendur Pejgamberi alejhi selam në mesin e hipokritëve!" Hudhejfeja heshti e nuk foli, por Omeri kësaj radhe i tha: "Pasha Allahun, nuk të lëshoj derisa të më tregosh!" Hudhejfeja i tha: "Jo, o princi i besimtarëve!", dhe u betua se nuk do t'i tregonte asnjë njeriu pas Omerit.

Interesimi i Omerit për çështjet e myslimanëve

Imam Muslimi transmeton një hadith të Pejgamberit alejhi selam, i cili thotë: "Nuk ka ndonjë njeri që obligohet me ndonjë çështje të myslimanëve e nuk mundohet dhe lodhet për ta, vetëm se ai person nuk do jetë me ta në xhenet."

Omer bin Hatabi e kishte vënë këtë hadith para syve dhe përherë e përmendte, deri në atë shkallë saqë nuk gjente kohë të pushonte e pastaj thoshte: "Kur të fle?! Nëse fle natën, humb hakun e Allahut, e nëse fle ditën, humb hakun e robërve të Tij!"

Interesimi i tij për myslimanët dhe jetën e tyre arriti në atë shkallë, saqë për çdo natë dilte në rrugët e Medinës që të ndiqte gjendjen e myslimanëve. Një natë, kur po ecte, gjeti një burrë që rrinte para një tende, kurse brenda ishte një grua që klithte. Omeri i tha: "Ç'ke?" Ai burri i tha: "Ajo është gruaja ime dhe nuk di si ta ndihmoj." Omeri i tha të qetësohej dhe shkoi shpejt te gruaja e vet, Umu Kulthumi, bija e Ali bin Ebi Talibit, dhe i tha: "A ke dëshirë të fitosh sevabe që të hysh në xhenet?" Ajo tha: "Si është çështja?" Omeri i tha: "Një grua po lind, eja të shkojmë e të marrim sevabin bashkë. Shpejtuan drejt asaj gruas. Umu Kulthumi hyri në tendë që ta ndihmonte atë grua, ndërsa Omeri u ndal që të qetësonte burrin e gruas. Pas pak ata dëgjuan të qarën e fëmijës. Umu Kulthumi i tha Omerit: "Përgëzoje shokun tënd me djalë, o princi i besimtarëve!" Në këtë rast ai burri u step nga habia që ishte Omeri, princi i besimtarëve, ai që e kishte ndihmuar, kurse Omeri i tha: "Qetësohu, unë jam vëllai yt."

- Një natë Talha bin Ubejdullahu doli dhe pa princin e besimtarëve duke ecur dhe iu vu mbrapa. E pa se trokiti në një derë, hyri aty e pastaj pas pak doli prej aty. Thotë Talha: "Hyra pastaj edhe unë në atë shtëpi dhe gjeta një grua plakë, të verbër e të paralizuar. I thashë: "Kush qe ai që erdhi më parë?" Tha: "Pasha Allahun nuk e di! Është një burrë që vjen një herë në javë prej dhjetë vjetësh, pastron shtëpinë dhe më sjell atë që kam nevojë. Kur e pyes, më thotë: "Jam rob nga robërit e Zotit dhe më thotë t'i lutem Allahut për të."

- Kur Omer bin Hatabi lexonte në namaz suren El-Ahzab dhe arrinte tek ajetet 32-34, e ngrinte zërin. Kur e pyetën, tha: "Ngase e kujtoj me plot vetëdije zbritjen e këtyre ajeteve."
- Një ditë, Omeri ishte duke ecur në Medinë dhe pa një djalosh që ecte si i llastuar dhe jo si burrë. Omeri e pyeti: "A mos je i sëmurë?!" Tha: "Jo." Atëherë ia flakëroi një shkop në trup dhe i tha: "Ec me fuqi, si burrë!"
- Një ditë, Omeri pa se një plak i verbër ishte vonuar për në namazin e sabahut. Pyeti për të dhe mësoi se nuk kishte kush ta sillte në namazin e sabahut, prandaj tha: "Pasha Allahun, nuk dua që dikush të mungojë në namazin e sabahut." Atëherë ia caktoi një njeri me pagesë nga buxheti i shtetit që të shkonte e ta marrte çdo ditë për në namaz, kurse burrit të verbër i tha të mos harronte të bënte nijet për punë të mirë sa herë që të vinte në xhami.
- Kur vinte koha që postierët e fronteve të muxhahidëve të vinin në Medinë, Omer bin Hatabi dilte jashtë qytetit të Medinës dhe i priste. Një ditë ishte duke pritur, kur ja erdhi një postier. Omeri e pyeti për lajmet e muxhahidëve, por postieri nuk e njihte se kush ishte Omeri, prandaj i tha: "Pa prit pak sa të shkoj te princi i besimtarëve dhe t'i tregoj." Omeri këmbëngulte që postieri t'i tregonte se a kishin fituar myslimanët në frontet e luftës, duke i thënë: "Për Allahun, më trego, a kanë fituar myslimanët?" Postieri i thoshte: "Më ka thënë princi i besimtarëve që askujt të mos i tregoj derisa ta takoj atë." Ai i thoshte: "Më trego të lutem", e kur postieri i tregonte se myslimanët kishin fituar, Omeri nga gëzimi binte në sexhde dhe thoshte: "Allahume Lekel-Hamd!", do të thotë: "O Zot, për Ty është falënderimi!"
- Omeri dilte ditën në rrugët e Medinës mbi devenë e tij. Ai kishte me vete pak rrush të thatë dhe pak hurma dhe kush e ndalte në rrugë për ndonjë kërkesë, ai i jepte nga ajo që kishte. E kur tregu i Medinës mbyllej, ai mblidhte gjërat që gjente në rrugë dhe në ditën e xhuma i çonte me devenë e tij te xhamia dhe i shpërndante. Një

ditë ai u tha myslimanëve: “O ju njerëz, më keni lodhur! Deri kur do t’ua mbaj gjërat? Për Allahun, kini kujdes e mos i humbni gjërat tuaja!”

- Një ditë, Omeri shkoi në ahurin e deveve të sadakasë, kërkoi një letër dhe laps e nisi të regjistronte devetë dhe t’i maste sa peshonin. Ali bin Ebu Talibi i tha Uthman bin Afanit: “A ke dëgjuar për ajetin e Allahut xh.xh.: ***“Ai është njeriu më i mirë që mund ta marrësh me qira*** *(për të punuar),* ***i forti dhe i besueshmi.”*** *(El-Kisas, 26)?* Ja, ky është i forti dhe i besueshmi!”

Viti i hirit

Viti i hirit ishte viti i 18-të pas hixhretit. Ai vit qe viti i një urie të madhe që zgjati disa muaj. Ky vit u quajt “viti i hirit” ngase ngjyra e pluhurit u bë ngjyrë hiri. Ky vit ndikoi edhe te princi i besimtarëve, sa që edhe ngjyra e trupit të tij ndryshoi, u bë e zezë. Njerëzit në atë kohë luteshin me gjithë shpirt prej vështirësive që solli thatësia dhe kishin frikë se do ta gjente ndonjë e keqe princin e besimtarëve. Omeri i fliste barkut të tij: “Pasha Allahun, o bark, do të vdesësh për bukë e vaj derisa të jetojnë njerëzit (derisa të tjerët të kenë ushqim të mjaftueshëm).”

Një ditë, Omeri pa në dorën e birit të tij një shalqi dhe i tha: “Bravo, bravo o djali i princit të besimtarëve! Ti po ha fruta, kurse umeti i Muhamedit është këputur nga uria.”

Një ditë, disa myslimanë therën një kafshë dhe i dërguan një pjatë me mish e ushqim, por ai tha: “Sa vali i keq do të isha nëse unë do të haja ushqimin e mirë, kurse umetit do t’i jepja atë që mbetej dhe eshtrat!”

Omeri i dërgoi mesazh valiut të tij në Egjipt, Amr bin El-Asit, duke i kërkuar atij ndihmë e furnizim. Amri i nisi nga Egjipti njëzet karvanë me furnizime dhe veshmbathje.

Në vitin e hirit edhe jeta e Omerit ndryshoi. Ai i mblidhte njerëzit në xhami prej akshami deri në jaci dhe u shtronte darka. Në këto darka merrnin pjesë me qindra e nganjëherë edhe mijëra njerëz. Omeri

merrte borxh për të shtruar këto darka dhe për të ushqyer njerëzit e uritur të umetit islam. Vetë Omeri i mbikëqyrte këto darka dhe kalonte në mesin e njerëzve. Kur shihte se ndonjë sofër kishte nevojë më shumë për ushqim, ai i thërriste shërbëtorit të tij, Jarfes: “Sill këtu ushqim e mish. Le të ngopen njerëzit.”

Omeri shpesh thoshte: “O Allah, mos e përça umetin e Muhamedit alejhi selam sa të jem unë gjallë!”

Vinte namazi i sabahut e ai ende nuk kishte ngrënë. Kur ia dërgonin ushqimin, thoshte: “Dërgojani këtë ushqim asaj shtëpie. Më duket se askush nuk u ka dërguar ushqim.”

Në moshën 63-vjeçare, gjatë haxhit që Omeri bëri, njerëzit e dëgjuan duke thënë: “O Zot, jam i moshuar. Trupi më është dobësuar, ndërsa shteti i myslimanëve është shtrirë. Më merr te Ti duke mos lëshuar pe në hakun e myslimanëve!”

Omeri u kthye nga haxhi në Medinë e Allahu iu përgjigj duasë së tij. Pas pesëmbëdhjetë ditësh, më 23 të dhul-hixhes, ai vdiq. Para se të vdiste, ai pa në ëndërr se një këndes e kishte çokitur me dy çukitje. Pastaj ai mblodhi njerëzit dhe u tha se kishte parë një ëndërr, e cila ishte e vërtetë. Omeri tregoi: Pashë një këndes që më çukiti dy herë dhe shoh se kjo është vdekja ime, ose rënia ime shehid, dhe shoh se vrasësi im është joarab.” Pastaj bëri këtë dua: “O Zot, më bëj dëshmor në rrugën Tënde dhe më bëj të vdes në qytetin e Pejgamberit Tënd!”

Hafsa, bija e tij dhe bashkëshorte e Pejgamberit alejhi selam, i tha: “Nga të vjen kjo?”

Ngase Medina është fortifikata e Islamit dhe në të nuk kishte luftë ku të bije dëshmor. Omeri tha: “Nëse do Allahu, bëhet!”

Omeri e shpeshtonte këtë dua: “O Zot, më bëj dëshmor në rrugën Tënde dhe më bëj të vdes në qytetin e Pejgamberit Tënd!”

Ai bënte edhe këtë dua: “O Allah, Ty të ankohem ndaj fuqisë së të pafeve dhe dobësisë së të besueshmeve!”

E pyetën për cilësitë e atij që mund të ishte vrasësi dhe Omeri tha: “Kur është në mesin e njerëzve, ai nuk është prijësi i tyre, por paraqitet si të ishte prijësi i tyre. E kur ai është prijësi i tyre, ata nuk e ndiejnë se ai është prijësi i tyre.”

Më trego për fitnen

Disa ditë para se të vdiste, ai i kërkoi sërish Hudhejfe bin El-Jemanit t'i tregonte se mos e kishte përmendur Pejgamberi alejhi selam në mesin e emrave të hipokritëve duke i thënë: "Të betohem, a më ka përmendur Pejgamberi alejhi selam në mesin e emrave të hipokritëve?" Hudhejfeja tha: "Të kam thënë, o princi i besimtarëve, se Pejgamberi alejhi selam nuk të ka përmendur në mesin e tyre." Atëherë ai tha: "El-hamdulilah!" Pastaj e shikoi Hudhejfen dhe i tha: "Më trego për fitnen (problemet e myslimanëve)."

Hudhejfeja tha: "Fitnen e njeriut në shtëpinë e tij dhe fitnen e njeriut në pasurinë dhe fëmijët e tij i mbulon namazi, zekati dhe sadakaja." Omer Faruku i tha: "Nuk po të pyes për këtë, por po të pyes për fitnen që do të përshkojë umetin." Hudhejfeja tha: "Çfarë lidhjeje ke ti me këtë fitne? Mes teje dhe fitnes është një derë e mbyllur, e cila nuk çilet sa të jesh ti gjallë." Omeri tha: "O Hudhejfe, a hapet dera apo thyhet?" Hudhejfeja tha: "Jo, thyhet!" Omeri ia ktheu: "Atëherë, pra, nuk po kthehet në vendin e saj!" Hudhejfeja tha: "Ashtu është, o princi i besimtarëve!"

Omeri u ngrit dhe nisi të qajë. E pyetën njerëzit Hudhejfen për fitnet dhe derën dhe ai tha: "Dera është Omeri dhe kur të vdesë Omeri, do të hapet dera e fitneve."

Omeri dha urdhër që të nxirrej nga Medina çdo rob i rritur, që të mbeteshin në Medinë vetëm myslimanët. Ky urdhër nuk u pëlqeu disa sahabëve, në mesin e të cilëve edhe Abbasit, xhaxhait të Pejgamberit alejhi selam, dhe Mugire bin Shu'bes, i cili kishte një rob që quhej Fejruz, nofka e të cilit ishte Ebu Lulu El-Mexhusi. Mugireja kërkoi leje nga Omeri që ta mbante në Medinë këtë rob, pasi ai njihte shumë mjeshtëri dhe myslimanët kishin nevojë për të. Omeri ia dha lejen.

Ebu Luluja shkoi një ditë tek Omeri që t'i ankohej se zotëria i tij, Mugireja, nuk po e paguante sa duhet për punën që ai po ia kryente. Kur e pyeti Omeri se sa pagë merrte, ai i tregoi dhe Omeri i tha: "Ki frikë Allahun dhe sillu mirë me zotërinë tënd."

Omeri kishte vendosur t'i fliste Mugires për këtë dhe i foli. Ebu Luluja filloi të ankohet te njerëzit se Omeri mbante drejtësi me të gjithë njerëzit, vetëm se me të jo. Ai thoshte: "Omeri ma hëngri mëlçinë."

Ai ishte njëra palë e komplotit, në të cilin kishte edhe palë të tjera; dy mexhusë të tjerë dhe një çifut. Kur u bënë bashkë, ata të katër arritën një marrëveshje për ta vrarë Omerin. Pranë tyre kaloi Abdurrahman bin Ebu Bekri dhe ata u drodhën. Thika e mprehur në të dyja anët u ra nga dora, por për fat të keq Abdurrahmani nuk e vuri re.

Ebu Luluja vazhdonte të ecte në mesin e njerëzve në Medinë dhe të thoshte se ku ishte drejtësia e Omerit.

Takimi i dytë

Një ditë, Omeri ishte me disa sahabë. Omeri e pa Ebu Lulunë dhe i tha: "Kam dëgjuar se ti bën mulli guri të mirë." Ebu Luluja e shikoi Omerin dhe i tha: "Do të ta mbaroj një mulli guri që tërë njerëzit do të flasin për të." Sahabët u gëzuan për këtë, kurse Omeri u tha: "A u gëzuat për këtë?" Ata i thanë se po. Omeri u tha: "Ai më kërcënon se do të më vrasë." Sahabët i thanë: "Atëherë ta vrasim ne!" Omeri ua ktheu: "A doni ta vrisni njeriun vetëm me mendim, pa fakte? Pasha Allahun, nuk e takoj Zotin dhe në fyt timin të kem përgjegjësinë e gjakut të njeriut pa ndonjë fakt." I thanë që ta çonin në mërgim, por Omeri u tha: "A t'i bëj padrejtësi njeriut e ta nxjerr nga vendi vetëm se unë mendoj se do të më vrasë? Nëse Allahu ka caktuar se vdekja ime do të vijë nga dora e këtij, atëherë ky është caktim i Allahut."

Në Medinën e Pejgamberit, në xhaminë e tij dhe në vendin ku prehet trupi i tij fisnik, në kohën e namazit të sabahut ndodhi tragjedia. Allahu xh.xh. i ishte përgjigjur lutjes së Omerit, që t'ia merrte shpirtin në qytetin e Pejgamberit alejhi selam dhe që ai të ishte shehid. Omeri jo vetëm që ra dëshmor në Medinë, por edhe në xhaminë e Pejgamberit alejhi selam dhe në mihrabin e tij, pranë vendit ku prehet trupi fisnik i Pejgamberit alejhi selam, teksa po falte namazin e sabahut me xhemat. Një nga tabiinët, Amr bin Mejmuni, e ilustron këtë rast duke

thënë: “Isha në këmbë në rreshtin e dytë dhe mes meje e princit të besimtarëve ishte vetëm Abdullah bin Abasi. Drita në xhami ishte e zbehtë. Omeri dha tekbir në fillim të namazit dhe para se të lexonte Fatihanë, doli mexhusi dhe e goditi me thikë gjashtë herë. Omeri bërtiti: “Më vrau qeni!” Atëherë sahabët u munduan ta kapnin, por ai filloi të godiste në të majtë e në të djathtë. Abdurrahman bin Oufi i hodhi përsipër rrobën e tij dhe kur Ebu Luluja e kuptoi se do ta kapnin, atëherë qëlloi veten dhe vdiq. Princi i besimtarëve i tha Abdurrahman bin Oufit që t’ua falte namazin myslimanëve dhe Abdurrahmani e fali namazin shkurt, me suren El-Keuther dhe El-Asr.

Erdhi Abdullah bin Omeri dhe e vendosi kokën e babait të tij në prehër. Omeri i tha: “Biri im, ma vendos faqen në dhe, se ndoshta më mëshiron Allahu.” Pastaj tha: “Mjerë unë e mjerë nëna ime, nëse nuk më mëshiron Zoti im! O djali i Omerit, kur të vdes, m’i mbyll sytë dhe mos harxho shumë qefin. Kur të shkoj te Zoti im e nëse Ai është i kënaqur me mua, m’i ndërron këto rroba me më të mira. E nëse shkoj te Zoti im e Ai është i hidhëruar me mua, m’i heq këto rroba.”

Pastaj atij i ra të fikët. Atëherë njerëzit e transportuan teksa atij ende po i rridhte gjak. Kur deshën t’ia kthejnë vetëdijen, Ibni Abasi i tha: “Namazi, o princi i besimtarëve!”, e Omerit i erdhi vetëdija. Ai pyeti: A u falën njerëzit?” I thanë se po. Omeri tha: “Dua të marr abdest që të falem.” E ngritën që të merrte abdest, kurse plaga i rridhte gjak. Pastaj erdhi mjeku dhe kërkoi një enë me qumësht. Ia dha qumështin Omerit që ta pinte, por qumështi filloi t’i dilte nga plaga. Atëherë mjeku i tha: “O princi i besimtarëve, jep këshillat e tua, se exheli erdhi.” Omeri e shikoi mjekun dhe pa se rroba e tij po prekte tokën, prandaj i tha: “Ngrije petkun tënd, është më pastër për petkun tënd dhe më afër me Zotin!”

Omeri dërgoi Ibni Abasin që ta dinte se kush e kishte vrarë. Kur Ibni Abasi erdhi dhe i tregoi se vrasësi ishte shërbëtori i Mugire bin Shu’bes, i cili quhej Ebu Lulu, atëherë Omeri tha: “Përse? Unë atij i kam bërë mirë.” Pastaj tha: “Falënderimi qoftë për Allahun xh.xh., që vrasjen time e bëri nga dora e atij që nuk i ka rënë në sexhde Allahut, që në Ditën e Kiametit të mos më konfrontojë me të.”

Pas disa çastesh, Omeri shtoi: “A është marrë vesh me dikë nga myslimanët për këtë?” Doli Ibni Abasi dhe pyeti: “O paria e myslimanëve, a mos ka kush gisht në komplotin e Ebu Lulusë kundër princit të besimtarëve?”

Myslimanët shtuan vajin e tyre dhe thanë: “Pasha Allahun, do të kishim më shumë dëshirë t’ia shtonim jetën Omerit nga jeta jonë!” Kurse gratë myslimane thanë: “Për ne më mirë do ishte të na vdisnin djemtë tanë sesa të vdesë princi i besimtarëve.”

Umu Kulthumi bërtiti: “O Omer, ti mbyte fitnet dhe ngjalle traditën, sunetin!”

Medinasit e kuptuan tani se sa e madhe ishte tragjedia. Ata e kuptuan se dera e fitneve ishte thyer.

Këtu dua të theksoj një gjë të rëndësishme. Ebu Lulu mexhusiu nuk gjeti vend tjetër për ta vrarë Omerin përveç xhamisë, sepse Omeri nuk jetonte për veten e tij, por përherë ishte në mesin e njerëzve duke u kujdesur për hallet e tyre. Ai u detyrua ta vriste në xhami dhe në namazin e sabahut, atëherë kur drita ishte e zbehtë, kur njerëzit faleshin dhe e kishte të lehtë të shkonte tek ai.

Omeri i thirri Ibni Abasit: “O Ibni Abas, ti dhe babai yt kishit dëshirë t’i shtonim mosbesimtarët në Medinë. A e sheh se ç’më ndodhi?” Ibni Abasi tha: “Po të duash, do të bëjmë këtë e këtë kundër tyre.” Omeri i tha: “Mos e dhëntë Allahu ta bëjmë atë kundër tyre, pasi kanë hyrë në vendin tonë, kanë ngrënë bukën tonë dhe flasin tani gjuhën tonë. Nëse Ebu Luluja është ende gjallë, mos e keqtrajtoni. E nëse ka vdekur, mos ia prishni kufomën, ngase unë marr hak prej tij Ditën e Kiametit.”

Pastaj pranë Omerit u afrua një djalë i ri dhe i tha: “Të përgëzoj me xhenet, o princi i besimtarëve! Ti e bëre hixhretin haptazi dhe e ndihmove Islamin. Me ty myslimanët falën namaz te Qabeja kur ti u bëre mysliman, pasi më parë nuk mundeshin. Pejgamberi alejhi selam vdiq dhe ishte i kënaqur me ty, po ashtu edhe Ebu Bekri ishte i kënaqur me ty. Gëzohu me xhenet, o princi i besimtarëve!”

Omeri qau dhe tha: “Pasha Allahun, nuk kam frikë nga diçka tjetër vetëm se i frikësohem punës sime. Ia kam frikën tmerrit në varr (pyetjes) dhe ia kam frikën llogarisë së Allahut.”

Pastaj hyri Abdullah bin Abasi, ia fërkoi gjoksin dhe i tha: “Qetësohu, o princi i besimtarëve! Sundove me Librin e Allahut, ndave me të drejtë.” Omeri buzëqeshi dhe tha: “A dëshmon për këtë në Ditën e Kiametit?” Ibni Abasi qau, kurse Omeri i ra në krah duke i thënë: “A e dëshmon këtë në Ditën e Kiametit? A dëshmon se kam sunduar sipas Librit të Allahut dhe kam ndarë me të drejtë? Ibni Abasi tha: “Dëshmoj, o princi i besimtarëve!”

Në këtë rast edhe Ali bin Ebi Talibi tha: “Edhe unë dëshmoj, o princi i besimtarëve!”

Pastaj tha: “Po halli i borxheve? Kam frikë ta takoj Allahun kur kam borxhe.” Ia llogaritën borxhin dhe doli 86 mijë dërhemë. Omeri i tha djalit të tij: “Shko pas vdekjes sime e jo para vdekjes sime në shtëpinë e financave të shtetit mysliman, në mënyrë që të mos i ngushtosh ata. Shiko se a kam ndonjë sasi malli aty. Nëse nuk gjen, atëherë shko te Beni Adijët. Kërko prej tyre që të ma lajnë borxhin. E nëse nuk gjen edhe aty, atëherë shko te kurejshët dhe kërko prej tyre që ta lajnë borxhin.”

Njerëzit filluan të mbledhin para me qëllim që t’i lanin borxhet Omerit, që ai të mos shkonte tek Allahu duke qenë në borxh. Shuma e të hollave u mblodh pas vdekjes së Omerit dhe pas një jave iu pagua Uthman bin Afanit, halifit të tretë të myslimanëve.

Fqinjësia me Pejgamberin alejhi selam

Në çastet e fundit të jetës së tij Omeri kërkoi nga Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit alejhi selam, leje që ta varrosin pranë Pejgamberit alejhi selam dhe Ebu Bekrit. Omeri i tha djalit të tij: “Thuaji se Omeri po e kërkon lejen dhe jo princi i besimtarëve, ngase nuk jam më princi i besimtarëve. Thuaj se Omeri nuk ka pasur ndonjë dëshirë më të madhe sesa të varroset pranë dy shokëve të tij. Thuaj se po të kërkon leje. E nëse të jep leje, eja shpejt e më trego.”

Kur Ibni Omeri shkoi tek Aishja, nëna e besimtarëve, e gjeti duke qarë, ngase e dinte se vdekja e Omerit do të thoshte hapje e derës së fitneve. Djali i Omerit i tha: “Omer bin Hatabi të kërkon leje të varroset pranë dy shokëve të tij.” Aishja tha: “E dëshiroj këtë vend për vete, por kur është fjala për Omer bin Hatabin, unë e preferoj atë vend për Omerin para vetes.”

Çfarë bamirësie e çfarë çiltërsie shpirtërore! Ajo u varros në El-Bekia dhe vendin ku dëshironte të varrosej vetë ia la Omerit.

Ibni Omeri erdhi shpejt te babai i tij që t’i jepte lajmin e gëzuar. Omeri e pyeti: “Çfarë bëre, o djali i Omerit? Ai i tha: “Të përgëzoj, o princi i besimtarëve! T’u dha leja!” Omeri tha: “Elhamdulilah!” E pastaj shtoi: “O djali i Omerit, kur të vdes, më mbartni deri te dera e Aishes, e pyeteni sërish ngase ndoshta më ka dhënë leje sa kam qenë gjallë e i ka ardhur keq prej meje.”

Omeri vdiq ditën e mërkurë, më 23 të dhul-hixhes në të 23-tin vit pas hixhretit. E qau Medina dhe i tërë umeti. Omerin, Allahu qoftë i kënaqur me të, e varrosën pranë dy shokëve më të dashur të tij.

Para vdekjes së tij, Omeri zgjodhi gjashtë veta nga mesi i të cilëve duhej zgjedhur halifi i myslimanëve. Ata njerëz ishin: Uthman bin Afani, Ali bin Ebi Talibi, Talha bin Ubejdullahu, Zubejr bin Avami, Sead bin Ebij Vekasi dhe Abdurrahman bin Oufi. Kur e këshilluan që mes tyre të jetë edhe i biri, Adullah bin Omer Hatabi, ai tha: “Është mjaft për familjen e Omerit që njëri prej tyre të llogaritet tek Allahu xh.xh. në Ditën e Kiametit!”

Hasan El-Basriu thotë: “Sikur e shoh Islamin se vjen në Ditën e Kiametit. Shfleton fytyrat e njerëzve dhe thotë: “O Zot, ky më ka ndihmuar e ky më ka poshtëruar, derisa arrin tek Omer bin Hatabi. E merr atë për dore dhe thotë: “O Zot, isha garib, i panjohur, derisa ky burrë u bë mysliman!”

Përktheu nga arabishtja:
Tahir Kukaj

- vijon -

Amr Khaled

THE NOMINATION OF CALIPH UMAR - (2)

(Summary)

Before he passed away, Abu Bakr consulted the senior Sahabah (Companions) and elected Umar as the second Caliph. Umar is the most respectful personality in Muslim Ummah after Abu Bakr. He is also one of the Companions of Prophet Muhammad, who was given the reward of Heaven in the world.

The Sahabah used to discuss the best of the people during the time of the Prophet. The Prophet told them that Abu Bakr was the best. Second to him was Umar ibn Al-Khattab.

"Who is the most beloved person to you?" He said, "Aisha." They asked, "Among the men?" He said, "Her father." (Abu Bakr) They said, "Who then?" He said, "Then 'Umar bin Al-Khattab."

عمر خالد

انتخاب عمر بن الخطاب خليفة للمسلمين – (2)

(خلاصة البحث)

عندما احسن أبو بكر الصديق بان الموت أوشك بدأ يتشاور مع الصحابة عمن سيكون خليفة للسملمين بعد رحيلة و كان عمر الفاروق هو اقرب الناس اليه اذ كان هو الرجل الثانى في الامة بعد ابى بكر الصديق. و عندما كان النبي (صلعم) في المسجد و الصحابة حوله، هو سأل عن أبى بكر و عمر رضى الله عنهما و هما ذهبا إليه و كان أبو بكر على اليمين و عمر على يساره و امسك الرسول (صلعم) بيديهما و قال: "هكذا سوف نبعث يوم القيامة".

و كان الصحابة يجلسون بالمسجد و كان الرسول (صلعم) يجلس بينهم و هم يسألون من هو أحسن شخص بعد النبى (صلعم) و هم كانوا يجيبون مرة أبو بكر ثم عمر و كان الرسول (صلعم) يبتسم كعلامة استحسان عن الذي يقولونه و كان الرسول (صلعم) يقول: "أحسن رجل هو أبو بكر و أحسن رجل هو عمر". و عندما سئل النبى (صلعم) من هو أحب شخص إليه اجاب: "عائشة" و قالوا له: لا تقصد من النساء بل من الرجال، هو اجاب: "أبوها". ثم قالوا من؟ اجاب: "عمر".

KUMTESA

Dr. Feti Mehdiu

NDIKIMI I LIBRAVE TË SHENJTË NË DIALOGUN NDËRMJET QYTETËRIMEVE EURO-AZIATIKE*

Vetëm All-llahu e di çdo send në hollësi

Porse në Evropë ka njerëz, ca me përcaktime shkencore ca tjerë me orientime politike e ndonjë tjetër edhe me përcaktime fetare, të cilët mendojnë se dinë, që thonë Evropa është djep i krishterimit; identiteti i saj është krishterimi dhe duhet të mbetet larg nga terri aziatik.

Kur thonë kështu, në radhë të parë, mendojnë për fetë. Sipas bindjes së tyre feja hebraike dhe ajo islame janë fe aziatike, kurse ajo krishtere është evropiane.

Vetëm All-llahu - nuk ka dyshim - i di të gjitha gjërat në hollësi, porse me sa ka arritur të dëshmohet sipas hulumtimeve nga fushat e antropologjisë, arkeologjisë, historisë, etj., është dëshmuar shumë qartë se All-llahu a.xh. e kishte zgjedhur kontinentin e Azisë - më saktë rajonin ndërmjet meridianëve 20-70 dhe paraleleve 10-45 që aty të fillojë jeta, të fillojë historia e njerëzimit.

Historia e njerëzimit fillon me njeriun e parë për të cilin librat e shenjta thonë se ka jetuar në rajonin e Arabisë Saudite të sotme. Në

këtë hapësirë është ngritur objekti i parë në botë për të adhuruar Krijuesin e gjithësisë.[1]

Njeriu i parë ka qenë edhe pejgamberi i parë - Ademi (Adam).

Edhe pejgamberët tjerë që përmenden në librat e shenjtë: Në Tevrat, Ingjil dhe në Kur'an, të gjithë i përkasin hapësirës gjeografike ndërmjet meridianëve e paraleleve të përmendura që në atlaset gjeografike emërtohet Azi Jugperëndimore.

Këto fakte përjashtojnë mundësinë dhe hedhin poshtë deklaratat e individëve të caktuar të cilët e shpallin Evropën djep të krishterimit. Në këtë grackë kanë rënë edhe autoritete kishtare, të cilët duhet, më mirë se të gjithë tjerët, t'i dinë rrugët historike të librave të shenjtë. Kjo i ndodhi Papa Benediktit 16, i cili në solemnitetin e inaugurimit të tij për papë u dërgoi mesazhin strukturave politike evropiane që Turqinë të mos e afrojnë në Bashkimin Evropian.[2]

Fakte historike flasin se edhe tre Librat e shenjtë, për të cilët do të flasim, kanë zënë fill në Azi dhe fillimisht kanë qenë në shërbim të popujve dhe shoqërive aziatike. Kjo është një kapital i fortë i kulturës dhe qytetërimit të popujve aziatikë. Më pastaj përmes Evropës, u përhapën edhe në anët tjera të botës.

Në historinë e feve janë të njohur 4 (katër) libra të shenjtë që përmenden edhe me emër, dhe 4 (katër) pejgamberë, të cilët, gjithashtu opinioni i njeh me emër, porse unë, për këtë rast, kamë bërë objekt shqyrtimi e studimi vetëm tre libra të shenjtë me tre pejgamberë, bartës të tyre.

Katër librat e shenjtë dhe katër pejgamberët e mëdhenj, historikisht do të radhiteshin si vijon:

Zeburi - Psalme... me Davudin a.s. (Davidi)
Tevrati, Tora - Telmudi, me Musain a.s. (Mojsi, Moshe)
Ingjili, Dhjata e re, Ungjilli, me Isa a.s. (Krisht, Mesihi)
Kur'ani, Koran, me Muhammedin a.s.

---

* Referat i lexuar në Simpoziumin ndërkombëtarë në Stamboll, shtator 2005, në temën bosht: **"Asya Toplumlarının Feraseti".**

[1] *Al-Kur anu-l-kerim*, 3:96.

[2] *Lajm* (Ekskluzive), Prishtinë, 26 mars, 2005.

Në vazhdim do të flasim për rolin që kanë luajtur këta libra dhe ndikimin që kanë pasur në dialogun me shumë qytetërime e kultura të botës së sotme. Do të bëjmë fjalë për kontributin që i kanë dhënë librat e shenjtë dialogut kaq shumë të preferuar në kohët e fundit. Dëshmia më e mirë për kultivimin e dialogut në këto libra të shenjtë është fakti se me mijëra vjet ithtarët e tyre japin dhe marrin ide, sipas bindjes së tyre dhe bashkëjetojnë në tërë botën.

Libra të shenjtë dhe pejgamberë ka pasur edhe më shumë,[3] kurse këta tre: **Tevratin, Ingjilin dhe Kur' anin**, i kemi marrë në shqyrtim nga arsyeja se në mbështetje të këtyre tre librave janë themeluar, janë zhvilluar dhe po gjallërojnë fe, qytetërime e kultura të caktuara, të cilat kronologjikisht duhet vështruar sipas kësaj radhe.

1.*Tevrati* - me bartësin, pejgamberin Musa, a.s. nga shekulli i 12 para erës re, nga koha e Ramzesit të tretë., në thelb përmban predikimin monoteist që rrjedh historikisht [4] nga koha e Ibrahimit (Abraham) dhe përshkon tërë Dhjatën e Vjetër. Në këtë Libër të shenjtë e ka mbështetjen feja hebraike. Talmudi, po ashtu libër fetar për hebrenjtë përmban komentet për librin kryesor Tora.

2.*Ingjili*, Ungjilli, me pejgamberin Isa në shekullin e parë të erës gregoriane- deri kah viti 30 i erës miradije, njihet me emrin Biblija, kurse te sllavofonët njihet me emrin Novi zavet, Sveto Pismo, Biblija, ndërsa te shqiptarët njihet, përveç me emrin Bibël, edhe si Besëlidhja e Re, Dhjata e Re, Shkrimi i shenjtë. Ky libër paraqet bazën mbi të cilën është ndërtuar krishterimi, gjegjësisht feja e krishterë së cilës i përkasin shumica e popujve të Ballkanit: grekët, rumunët, bullgarët, serbët, kroatët, malazeztë, sllovenët dhe një pjesë e popullit shqiptar.

[3] *Al-Kur anu-l-kerimu*, 2:286.

[4] Cf. *Al-Kur anu-l-kerimu*, 6:76-78; Feti Mehdiu, *Dualizmi në kulturë dhe qytetërim ardhmëri e popullit shqiptarë*, P e r l a , nr.1/2000, Tiranë, pp.44; Feti Mehdiu, *Religiolinguistika islame në këngët popullore shqiptare*, E d u k a t a I s l a m e , nr. 74/2004, Prishtinë; Mark Tirtja, *Elemente të kulteve ilire te shqiptarët*, S t u d i m e Ilire, II, Prishtinë, 9978, pp.286-288. Poashtu....

3.*Kur ani*, me bartësin pejgamberin Muhammed a.s., i cili u lind në vitin 570 dhe ndërroi jetë në vitin 632 të erës gregoriane. Nga popujt e Evropës Juglindore, më saktë nga Ballkani, Kur'anin dhe fenë islame, e cila mbështetet në Kur'an e kultivojnë dhe e praktikojnë: Shqiptarët dhe boshnjakët, si edhe një pjesë e popullit turk që jetojnë në Rumeli: Bullgari, Greqi, Maqedoni, Kosovë, Serbi, Rumani, Kroaci dhe Slloveni.

Mbi këto burime hyjnore bota sot ka këto fe:

Fenë Hebraike - **Jehudijje**

Fenë Krishtere- **mesihije, apo Nasranij**

Fenë Islame - **islam (Islamijje)**

Për sa i përket Zeburit dhe pejgamberit Davud (David) a.s. ky paraqet një libër të shenjtë që përmban lëvdata për Krijuesin e gjithësisë që, ka gjasa të jenë inkorporuar në të gjithë librat e shenjtë, por nuk ka norma e platformë të ndonjërës nga fetë që Krijuesi i Gjithësisë ia ka shpallur njerëzimit.

Të tre këta libra të shenjtë, në esencë, historikisht kanë burim të përbashkët. Janë libra të shpallur dhe myslimanët obligohen dhe i besojnë të gjithë këto.

Mirëpo aktualisht, secili prej tyre, sot ka marrë karakteristika të veçanta dhe secili përfaqëson fe, kulturë e qytetërim me dallime ndërmjet vete.

E përbashkëta e të tre këtyre librave -në teori- është monoteizmi, besimi në një Zot, kurse të veçanta janë adhurimet ndaj Atij Zoti që e pranojnë për krijues të gjithësisë.

Objekt i qasjes tonë, me këtë rast, është të hulumtojmë elementet e kulturës dhe të qytetërimit që nga këta libra të shenjtë kanë kaluar edhe në kulturën e popujve të Evropës, apo të Azisë perëndimore, siç e quajnë disa. Për këtë qëllim kemi marrë në shqyrtim fushën e arkitekturës, folklorin, etnologjinë, traditën popullore etj., fusha të cilat janë dëshmia më e fortë se tre librat e shenjtë që vijnë nga Azia kanë ushtruar ndikim në qytetërime të ndryshme dhe kanë kultivuar dialog ndërmjet vete që është reflektuar në fusha të ndryshme të jetës te popujt përtej kufijve të Azisë.

Në hapësirën ballkanike kjo reflektohet në forma e lëmi të ndryshme.

Një shembull mund të jetë ylli pesëcepësh që ka prejardhje hebraike. Po ashtu edhe ylli me gjashtë cepa, i njohur te popujt e Ballkanit si Ylli Davidit, është bërë pjesë dekorative në arkitekturë. E gjejmë të gdhendur në gur, në dru, në beton në gips në punët e dorës të femrave me grep e me gjilpërë,etj., nëpër kroje publike, rrethoja të oborreve individuale apo të objekteve shoqërore, madje edhe në objektet e kultit islam.

Vlen të përmendim se në një xhami të Prishtinës e hasim edhe kryqin e thyer-svastika, si dekorim mural, që besoj se është rast unik.

Kulti i diellit, hënës, yjeve gjithashtu është i pranishëm edhe te fiset ilire, njëlloj siç ka qenë edhe te paraardhësit e Ibrahimit a.s.[5]

Numri 12, i cili në Kur'an na paraqitet në suret Bekare dhe A raf,[6] kur shpërthyen 12 burime, që ka shtrirje te populli hebraik, është gjithashtu i pranishëm edhe te populli shqiptar, i cili pranon 12 bajraqe, betohet me 12 pleq, kompleti i lugëve për një sofër është 12, numri i atyre që shkonin të çojë çejzin, tre ditë para se të merret nusja ishte po ashtu 12, etj.

Numri shtatë, i cili në Kur'an përmendet shpesh, për shembull për shtatë qiej, te popujt e Ballkanit, përveç shtatë kat qiell, shënon edhe shtatë pash tokë. Përdoret edhe "për të shtatat", kur shënojnë ditën e shtatë pas vdekjes së dikujt, zakonisht natën e shtatë, që e organizojnë edhe në mjedise islame. Në një këngë popullore e kemi numrin shtatë përballë numrit shtatëdhjetë e shtatë:

Shtat bidate ju m' i keni lyp

Shtatëdhjetë e shtatë baba do t'jua jap...

Te popujt e Ballkanit ndikimi i librave të shenjtë është reflektuar edhe në etnologji dhe në folklorin popullor.[7]

Ndërkaq në letërsinë evropiane, përveç tjerash, njëra nga kryeveprat e poezisë - Komedia Hyjnore e Dante Aligerit është e nxitur drejt-

[5] Ibid.

[6] *Al-Kur anu-l-kerim*, 2:60, 7:16o.

[7] Shih fusnotën 4, Edukata Islame, nr. 74.

përdrejt nga një temë që trajtohet në Kur'an dhe është konstruktuar, kryesisht në bazë të literaturës ndihmëse, e cila trajton temën e Isra dhe Miraxhit të Muhammedit a.s. Studiuesi italian Miguel Asin Palacios[8] e ka përpunuar në hollësi këtë temë duke e krahasuar veprën e Aligerit me burimet islame Kur'anin dhe hadithin. Njëkohësisht është shërbyer edhe me veprën e Al-Maarrit, Gazaliut, Ibn Arabiut.

Te Komedia Hyjnore e Dantes, rrethi i pestë i ferrit, në të cilin vuajnë dënimin.... është emërtuar Gena. Ky emërtim është vetëm një transformim i termit xhehenem që përdoret në Kur'an.[9]

Kjo është realizuar me anë të feve botërore që kanë mbështetjen në njërin nga Librat e shenjtë që u përmendën dhe kontakti i dy qytetërimeve, krishterë dhe islam, siç pohon M.A.Palacios, shpejt dhe pa kurrfarë pengesash përmes rrugëve normale dhe transparente.[10]

Këta tre Libra të shenjtë, Tevrati, Ingjili dhe Kur'ani janë të padiskutueshëm në tërë botën.

Pranimi i pakontestueshëm dhe i padiskutueshëm ka të bëjë me parimin global si tre Libra të shpallur nga Krijuesi i gjithësisë, të pranuar nga të tria fetë që ekzistojnë sot. Të tre këta libra që zunë fill në truallin e Azisë: Sinaj, Jerusalim, Mekke-Medine, kanë bërë jetë të përbashkët edhe ndër popujt e Ballkanit gjatë historisë, duke filluar prej shekullit të dytë të erës luftërat gregorijane[11] dhe bashkëjetojnë edhe sot.

Faktet historike flasin se këta tre libra të shenjtë janë të pranishëm në Ballkan, dy të parët që nga fillimi i erës gregoriane, kurse i treti prej shekullit 14. pas ardhjes së ushtrisë Osmane në këto anë.[12]

[8] Miguel Asin Palacios, Eskatologjia myslimane në Komedinë hyjnore (La eskatologia musulmana en la Divina Comedia), Shkodër, 2003.

[9] Ibid. p.229

[10] Ibid. P.277

[11] Krishterimi prej shekullit të parë kurse ebreizmi prej shekullit të dytë janë dy fetë e pranishme në këto hapsira që nënkupton praninë e dy librave të shenjt: Tevratit dhe Ingjilit.

[12] Osmanët nga viti 1371 e këndej fillojnë të vendosin sundimin e tyre në hapësirën e Ballkanit, fillimisht në Maqedoninë e sotme, në Kosovë, Shqipëri e gjetiu.

Ballkani ka qenë dhe ka mbet ura më e rëndësishme tokësore për lidhjen e Azisë me Evropën. Për këtë qëllim u ka shërbyer edhe Librave të shenjtë.

Përkundra faktit se Ebreizmi është i pranishëm në Ballkan qysh në shekullin e dytë të erës gregoriane.[13] komenti i librit të shenjtë të tyre Talmudi në vitin 1990 është përkthyer nga gjuha hebraike dhe armene dhe është botuar në Beograd, ndërsa Ingjili dhe Kur'ani janë përkthyer më herët se Talmudi.[14]

Kjo bashkëjetesë e këtyre tre librave të shenjtë dhe ky respekt i ithtarëve të tyre është meritë, në radhe të parë, e librave të përmendur të cilët në thelb kanë përbashkësinë, me ndryshime, jo me kërkesa ekstreme.

Vetëm në këto baza librat e shenjtë kanë ndikuar te popujt e Azisë, të Evropës e më gjerë, që të respektojnë njëri-tjetrin dhe të këmbejnë pasurinë kulturore e fetare.

Do të përmendi vetëm disa ilustrime nga Kur'ani ku shihet se si i obligon Kur'ani ithtarët e vet që të kenë respekt ndaj Tevratit dhe Ingjilit: ***"… Ai këtë ua ka premtuar me siguri në Tevratë dhe në Inxhil edhe në Kur'an - pra, kush i plotëson premtimet e veta më mirë se All-llahu?..."***[15]

Është meritë e Librave të shenjtë - burimisht - që deri në ditët e sotme kanë bashkëjetuar ithtarët e feve që mbështeten në këta libra.

Hebrenjtë në shekullin e dytë të erës gregoriane, kishin ndërtuar sinagogën në Shtip[16] dhe më vonë i gjejmë të vendosur në Durrës,[17]

[13] **Enciklopedija živih religija**, drugo, dopunjeno izdanje, Nolit, Beograd(1992); Feti Mehdiu, Hyrje në filologji orientale, Prishtinë, 2004; Simon Dubnov, **Kratkaistorija jevrejskog naroda**, Beograd, 1962. 27.glava – Prva jevrejska naselja u Evropi.

[14] **Talmud**, preveo sa hebrejskog i aramejskog jezika Eugen Veber, Beograd, 1990. (BIGZ); Feti Mehdiu, Srpskohrvatski prevodi Kur ana, Studia Humanistica, III, Pristina, 1978, i Zbornik Filozofskog Fakulteta, XIV, Pristina, 1980.

[15] *Al-Kur anu-l-kerim*, 9:111.

[16] Shih: *Enciklopedija živih religija*…; Feti Mehdiu, *Hyrje në filologji orientale*, Prishtinë, 2004.

[17] Shih: Bogumil Hrabak, Jevreji u Albaniji od kraja 13. do kraja 17 veka i njihove veze sa Dubrovnikom, Zbornik – l, 1971, Beograd.

Dubrovnik,[18] Split, Sarajevë, Shkup,[19] Mostar, Manastir, Prishtinë,[20] etj. Në kohët e fundit më së shumti jetojnë në Zagreb, Beograd dhe në Sarajevë. Sipas të dhënave nga viti 1971, në territorin e Jugosllavisë, do të thotë në Maqedoni, Kosovë, Serbi, Vojvodinë, Kroaci, Bosnjë dhe Slloveni kishte 6486 hebrenj. Nga ky numër rreth 70% jetonin në: Beograd - 1602; në Zagreb - 1330; në Sarajevë - 1090, kurse në Shkup kishte 54 dhe në Prishtinë 11 hebrenj.[21]

Organizatori i këtij takimi shkencor të rëndësishëm për rajonin Azi -Evropë dhe më gjerë, ka mundësi t'u sugjerojë vendeve të përfshira në këtë organ shkencor që të kenë parasyshë këtë model për qeverisjen e vendeve të tyre pa dhunë, pa dredhi e pa gjakderdhje.

Librat e shenjtë, si burime të kulturës njerëzore, duhet ruajtur që të mos bastardhohen nga grupacione ekstreme, prej të cilëve pastaj mund të dalin forca destruktive që e shkatërrojnë botën, siç ndodhi me adhuruesin e organizatës së fshehtë të kishës Sataniste - Karl Marksin[22], i cili pasi kishte hequr dorë nga Zoti iu dorëzua shenjtreshës Xhoana dhe u angazhua për të organizuar sistem shoqëror pa Zot.

Forcat konstruktive intelektuale, fetare, politike, shkencore, pa dallim përkatësie fetare, politike e racore kanë obligim t'u kthehen esencialisht librave të shenjtë. T'ua bëjnë me dije interpretuesve të librave të shenjtë se ata që shtrembërojnë interpretimin për levërdi individuale a klanore, e shpiejnë popullin në shkatërrim. Duhet t'i vënë në dijeni qarqet udhëheqëse se këta dinë të dallojnë thelbin e Librit të shenjtë nga interpretimet destruktive të ndonjë autoriteti fetar, i cili me Librin e shenjtë në dorë shprehet në kundërshtim me parimet, të cilat i proklamojnë librat e shenjtë dhe t'ia përkujtojnë se Zoti i ka krijuar njerë-

[18] Zbornik - l, 1971, Beograd, në tërësi trajton temën: Studije i gradja o jevrejima Dubrovnika.

[19] Në Shkup deri në vitet e tridhjeta të shekullit 20. punonte edhe një shkollë serbo-hebreje, krahas atyre serbo-muslimane për mashkuj dhe serbo-muslimane për femra.

[20] Shih: Arzu Terzi, Zejet në qyteti e Prishtinës, Edukata Islame, nr.73/2004, Prishtinë.

[21] Jevrejski kalendar za godinu 5731 (1970/71). Savez jevrejskih opština Jugoslavije, Beograd.

[22] Richard Wurbrond, Was Karl Marx A Satanist? Glendale, California: Diane Books Publishing, co.,1976.

zit të lirë dhe se në këtë botë, Azi, Evropë e gjetiu, ka vend për të gjith ata që dëshirojnë të jetojnë në hisen e vet, jo në shpinë të tjerëve. Ka vend për tërë ata që nuk kanë në shpirt dhunën dhe satanën, por shpalljen e Zotit.

E ardhmja u takon njerëzve të mirë të Zotit, thuhet në Librat e shenjtë: **أَنَّ الأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ** (El-Enbija, 105)

Feti Mehdiu

THE INFLUENCE OF THE HOLY BOOKS IN THE DIALOGUE BETWEEN EURO-ASIAN CIVILIZATIONS

(Summary)

Only Allah knows everything

In Europe there are people who say that Europe has a Christian identity and that it should keep a distance from Asia.

When they say so, they are talking primarily about religion. According to them, Islam and Judaism are Asiatic religions, whereas Christianity is European.

There is no doubt that only Allah knows everything. Yet, thanks to thorough research in the fields of anthropology, archeology, history, etc., it has been confirmed that Allah chose Asia as the cradle of civilization.

فتى مهديو

أثر الكتب المقدسة في حوار الحضارات أورو–اسيوية

(خلاصة البحث)

الله هو وحده الذي يعرف كل شيء.

يوجد في أوربا اناس لهم خلفية علمية و آخرون لديهم خلفية سياسية و ربما هناك اناس لديهم دراية دينية و الذين يؤكدون بان أوربا هي مهد المسيحية و هو يتها مسمية و عليها ان تبقى بعيدة عن الظلام الاسيوى.

و هم عندما يقولون ذلك يقصدون الاديان و حسب اعتقادهم فان الدين اليهودى و الدين الاسلامى هما ديانتان آسيويتان و الديانة المسيحية هي أوربية.

الله جل و اعلى هو وحده يعرف كل شيء و لكن حسب معرفتنا و حسب الدلائل التي تقدمها لنا العلوم مثل انترو بولوجى و علم الآثار و التاريخ تؤكد با الله سبحانه و تعالى اختار قارة آسيا و بصورة أكثر دقة منطقة الشرق الاوسط لتبدأ الحياة فيها و يبدأ التاريخ فيها أيضا.

XHAMITË – VATRA TË DITURISË

XHAMIA ZEJTUNIE …
VATËR E SHKENCËS DHE DITURISË

Janë të shumtë variantet për xhaminë Zejtunie, xhaminë e dytë që njohu Tunizi pas arritjes së myslimanëve në atë vend. Lidhur me të, historiani i njohur es-Serraxh në librin e tij "Rrobat e mëndafshit", thotë: "Xhamia Zejtunie është mesxhid kur ta shohësh atë të merr sytë drita e tij, do ta kuptosh se ajo është xhamia unike në tërë rruzullin tokësor. Ajo gjendet në një kodër nga e cila shihet i tërë qyteti i vjetër. Gjendet në mes të tregjeve të vjetra, të cilat e rrethojnë nga çdo anë. Para tij është një rrafshinë e gjerë që lidhet me disa korridore, të cilat paraqesin lidhjet kryesore të qytetit. Xhamia Zejtunie gjendet në mes portave të rrumbullakëta të qytetit. Ai nuk është shumë larg nga porta e detit, largësia nuk mund të jetë më shumë se treqind metra. Mund të thuhet se njëjta largësi është edhe nga porta e re, porta e ujdhesës, porta Alevit dhe porta e dritës, pak më larg është distanca që e ndan xhaminë Zejtunie nga portat tjera prej të cilave formohet zinxhiri i portave tradicionale për mbrojtjen e qytetit, e cila mund të jetë në një largësi prej një kilometri apo pak më shumë, sa i përket portës së gjelbër, portës së mjaltit dhe portës Sa'dun. Mirëpo, hapja e qytetit arab ndaj njëri-tjetrit dhe lidhjet e korridoreve mes vete e bëjnë këtë distancë të pa rëndësishme, pasi t'i kuptojnë banorët e tij fshehtësitë e korridoreve të tij të ngushta.

Thuhet se themelues i xhamisë Zejtunie është Abdullah ibnu Hixhab, vali i Hishamit të ibnu Abdul Melikut në Afrikë. Thuhet po ashtu se themelues është Hasan ibnu En-n'man, çlirues i Tunizit. Nëse është themeluesi i pari, viti i ndërtimit duhet të jetë më 79 sipas hixhretit (699) dhe ky mund të jetë varianti më i saktë te historianët, sepse nuk është e logjikshme që një qytet si Tunizi të mbetet pa xhami në mes viteve 79 sipas hixhretit deri më 116, koha e ardhjes së ibnu Hixhabit.

Xhamia Zejtunie

Xhamia Zejtunie konsiderohet universiteti i parë i shkencave islame, i cili kishte hapur dyert për nxënësit që kërkoni njohuri islame dhe hulumtuesit të fshehtësive të fesë së re, ku erdhën një numër i madh i atyre që kërkonin dituri dhe njohuri islame. Andaj xhamia Zejtunie në Tunizi, xhamia e al-Az-harit në Kajro, xhamia e Emevive në Damask dhe xhamia e el-Kurevijine në Marok, konsiderohen kështjellat më të mëdha të gjuhës arabe dhe sheriatit islam në shekujt e fund-

it. Xhamia Zejtunie për shekuj të tërë ishte pioniere e shkencës në vendet e Magrebit Arab. Llogaritej se numri i referencave shkencore në kulmin e zhvillimit të saj arrinte në 200 mijë ekzemplarë. Por, për fat të keq spanjollët shkatërruan shumicën e këtyre librave në vitin 970 sipas hixhretit (1563), deri në atë masë sa që librat më të vlefshme dhe perlat e atij thesari ishin hedhur rrugëve, nëpër të cilat po shkelnin kuajt me patkonjtë e tyre. Ndërkohë që një numër të konsideruar të dorëshkrimeve agresorët kishin marrë me vete në Spanjë dhe disa i kishin dërguar në bibliotekën e papës në Romë. Shumë dorëshkrime edhe sot e kësaj dite që janë me origjinë nga xhamia Zejtunie ruhen në vende të ndryshme të botës. Kështu shohim valiu e Tunizit Ebul Abbas Ahmed Baj, në kohën e sundimit të shtetit të Husenijve bëri rindërtimin e bibliotekës së Xhamisë Zejtunie, të cilës ia ktheu famën e mëparshme derisa biblioteka u bë e njohur me emrin Biblioteka el-Ahmedije.

Xhamia Zejtunie është përmendur në shumë vepra të historianëve, në mesin e tyre, historiani njohur el-Bekri në "el-Mealik ve el-Memalik" Po ashtu këtë xhami e përmend edhe ibnu Halduni në veprën e tij "al-'Iber", es-Seraxh në veprën e tij "el-Hilel es-sundusije fi tarihil bilad et-tunisije", Hasan Husni Abdul Vehhab në veprën e tij "Hulasatu tarihi Tunis", Ahmed bin ebi ed-dijaf në veprën: "it-Tixhahu ehli ezzeman bi ahbari muluki Tunis ve ahdu el-eman", ibnu ebi Dinar në librin e tij "al-Munis ti tarih Ifrikija ve Tunis". E tërë kjo tregon për rëndësinë e madhe që ka pasur xhamia Zejtunie gjatë historisë.

Xhamia Zejtunie ka një arkitekturë të veçantë dhe për shekuj me radhë ishte objekt interesimi i halifëve dhe princave, të cilët sunduan Tunizinë. Të gjithë pushtetarët punuan që arkitektura e saj të jetë e ngjashme me xhaminë e Ukbetu ibni Nafi në Kajrevan dhe pjesa më e madhe e buxhetit i është kushtuar kësaj xhamie deri në ditët tona. Ajoi dallohet me sallën e faljes në formë të katrorit që përmban 15 fonderi dhe 7 pllaka guri të gjëra. Sipërfaqja e sallës së faljes është 1344 m2 dhe është e mbuluar me kupola të rrafshëta. Para sallës së faljes gjendet pllakëza pa hajat dhe ajo është i rrethuar me mure të përforcuara nga dy këndet me dy kulla. Ndërtimi i kësaj xhamie u bë kryesisht prej guri, por në disa vende janë përdorur edhe tullat. Xhamia Zejtu-

nie përmban hatmen më të bukur të Kur'anit, që është shkruar në Tunizi. Hatmeja e Kur'anit është përfunduar dhe i është dhuruar xhamisë në kohën e Shejh Taxhuddin el-Bekrit, në fund të shekullit dymbëdhjetë sipas hixhretit. Në xhami gjendet po ashtu një orë për matjen e kohëve të namazeve sipas stinëve. Në kohën e saj ka qenë mjeti më preciz dhe ora më e saktë për matjen e kohës. Mirëpo, orët bashkëkohore e tejkaluan atë në saktësi dhe precizitet, për këtë tash ajo është jashtë përdorimit.

Kupola e mihrabit dallohet me ornamente në tërë hapësirën e dukshme të tri kateve me zbukurime tejet precize, të cilat konsiderohen unike në arkitekturën islame në shekujt e saj të parë

Ashtu siç kishte variante të ndryshme për ndërtuesin e kësaj xhamie, ka variante të ndryshme edhe për emërtimin e saj. Disa thonë se çliruesit e parë të Tunizisë gjetën në vendin e xhamisë një pemë fiku të vetme dhe pushuan nën hijen e saj dhe thanë: "Vërtetë sa pushimi i bukur qenka nën këtë pemë të gjelbër dhe për atë e quajtën xhaminë që e ndërtuan në atë vend, xhamia Zejtunie". Përveç kësaj duhet përmendur kontributin fetar që ka dhënë xhamia Zejtunie si një vatër e arsimit dhe njohurisë. Nga bankat e saj dolën dijetarë të njohur dhe unik si dhe reformator që patën ndikim të madh.

Kjo xhami luajti një rol të rëndësishëm në periudha të ndryshme kohore të rilindjes shoqërore dhe kulturore nëpër të cilat kaloi Tunizi. Por, Universiteti i Zejtunies nuk mjaftoi vetëm me këtë, ajo u bë vatër e diturisë nga e cila shndriti drita e saj në të gjitha anët e botës. Përveç kësaj ajo ishte një bazë shumë e fuqishme e çlirimit kombëtar sepse nga kjo vatër e dijes shumë të rinj u pajisën dhe frymëzuan me ndjenjat fetare dhe kombëtare për çlirimin e vendeve të tyre nga kolonializmi dhe fuqizimin e ndjenjës së identitetit islam dhe kombëtar.

Nga universiteti i Zejtunies u diplomua historiani dhe themeluesi i sociologjisë Abdurrahaman bin Halduni, autori i "Mukadimes", pastaj fekihu, komentatori dhe muhadithi Muhamed bin Arefe, Tahir bin Ashur, autor i librit "Tefsiru et-Tahriri ve et-Tenviri", Muahmed el-Hidr Hasan, Shejh i Universitetit të al-Az-harit, reformatori dhe prijësi Abdul Aziz eth-Thealibi, autor i lbrit "Tunis Esh-shehidetu", Ebul

Kasim Esh-shabi, autor i divanit "Agani al-Hajat", Tahir el-Hadad , autor i librit" Imretetun fi Esh-sheriati ve el-Muxhtama", i cili pati një jehonë të madhe për shkak se bënte thirrje për emancipimin e gruas.

Tash kanë kaluar më shumë se 1300 vjet nga themelimi i xhamisë së Zejtunies, që të takohet emri i saj me një pemë, të cilën Allahu e bekoi në librin e tij të shenjtë. Kjo xhami e ruajti në vazhdimësi shkëlqimin e saj që të mbetet dëshmitar i të gjitha ngjarjeve, nëpër të cilat kaloi Tunizi, duke qenë në një pozitë të rëndësishme dhe në zemër të qytetit me plotë jetë.

Përktheu nga arabishtja:
Fuad Morina
Marrë nga gazeta "Asharqulaësat", 9.11.2007

THE ZITOUNA MOSQUE… A CENTER OF KNOWLEDGE

(Summary)

The Zitouna Mosque is the second oldest in Tunisia. According to historians it is unique. It is a masjid, which captivates one's eyes. It is situated on top of a hill with a view over the entire old town. The mosque is surrounded by souks. The mosque is in the midst of the city gates.

المنجى السعويدان

جامع الزيتونة المعمور... منارة للعلم و المعرفة على مر العصور

(خلاصة البحث)

تتكاثر الروايات و تتواتر حول جامع الزيتونة، ثانى المساجد التي عرفتها تونس بعد الفتح الاسلامى. يقول عنه السراج في كتابت "الحلل السندسية": "جامع الزيتونة مسجد اذا بدا لك تبلج نوره اللامع ايقنت أنه الجامع المفرد و المفرد الجامع... و جامع الزيتونة جامع بهيج يرتفع على ربوة تكاد تطل على كامل المدينة العتيقة، و هو في موقع الوسط بين الاسواق العديدة التي تحيط به من كل جانب.

INTERVISTË E HUAZUAR

Intervistë me Karen Armstrong, botuar në revistën "ISLAMICA"

FEJA NUK ËSHTË SHKAK I PËRÇARJEVE NË BOTË

Karen Armstrong për shtatë vjet ka shërbyer si murgeshë katolike para se të regjistrohej në Oksford. Sot, ajo radhitet në mesin e teologëve më të famshëm të botës, njëherësh është autore e disa bestsellerëve mbi religjionet e mëdha dhe themeluesit e tyre. Ajo është njëra nga anëtarët udhëheqës të Grupit për Afrimin e Qytetërimeve, iniciativë kjo e marrë nga ish-Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Anan, që ka si synim luftimin e ekstremizmit dhe nxitjen e dialogut mes Perëndimit dhe Botës Islame. Në këtë intervistën dhënë gazetarit gjerman, Andrea Bistrich, ajo flet rreth politikës, fesë, ekstremizmit si dhe tema të ngjashme.

ANDREA BISTRICH: 9/11 është bërë simbol i armiqësive të mëdha e të pakapërcyeshme mes Islamit dhe Perëndimit. Pas atyre sulmeve shumë amerikanë pyesnin: "Përse të na urrejnë"? Ekspertë të shumtë në tryeza të shumta diskutimesh kanë debatuar nëse dhuna është pjesë e trashëguar e Islamit. A është ashtu?

KAREN ARMSTRONG: Jo, natyrisht. Në Bibël shprehet më tepër dhunë sesa në Kur'an; ideja se Islami ia imponon vetes shpatën është një trillim i Perëndimit, i shpikur gjatë kohës së Kryqëzatave, ku në të vërtetë ishin të krishterët perëndimorë ata që luftonin brutalisht

në luftërat e shenjta kundër Islamit. Kur'ani ndalon luftën agresive dhe lejon luftën vetëm për qëllime vetëmbrojtjeje; në momentin kur armiku kërkon paqe, Kur'ani insiston në myslimanët që t'i ulin armët dhe të pranojnë çfarëdo kushte t'iu afrohen, çofshin ato edhe në disfavor të tyre. Më vonë, ligji Islam ua ndaloi myslimanëve që assesi të mos sulmojnë një vend në të cilin myslimanët tjerë janë të lejuar ta praktikojnë fenë e tyre lirshëm; vrasja e civilëve u ndalua, sikurse edhe shkatërrimi i pronave dhe përdorimi i zjarrit në luftë.

Sensi i polarizimit është theksuar edhe më nga debatet e fundit - pikturat daneze të pejgamberit Muhamed, vlerësimet e Papës rreth Islamit, apo mendimi se mbulesa vështirëson integrimin. Gjithë këto gjëra kanë prishur marrëdhëniet mes Islamit dhe Perëndimit. Profesori i Harvardit, Samuel Huntington solli një teori rreth "përplasjes së qytetërimeve" diçka që po e përjetojmë sot. A ekziston në të vërtetë një papajtueshmëri e tillë fondamentale mes Perëndimit të Krishterë dhe Botës Islame?

Përçarjet në botën tonë nuk janë rezultat i fesë apo kulturës, ato kanë baza politike. Në botë ekziston një jo-balancim i pushtetit, ku të pafuqishmit kanë filluar të sfidojnë hegjemoninë e Fuqive të Mëdha, duke deklaruar pavarësi nga to shpesh përmes një gjuhe fetare. Shumë nga ajo çfarë ne e quajmë 'fundamentalizëm' shpesh mund të duket si një formë fetare e nacionalizmit, një mbrojtje e identitetit. Ideali i vjetër nacionalist evropian i shekullit të XIX ka humbur shkëlqimin e tij duke qenë gjithnjë i huaj për Lindjen e Mesme. Në botën myslimane njerëzit kanë filluar ta riidentifikojnë veten sipas fesë së tyre, duke synuar kthimin në rrënjët e tyre pas përçarjeve të shumta kolonialiste.

Çfarë e ka bërë fundamentalizmin, siç shihet, aq dominues sot?

Devocioni militant të cilin e quajmë 'fundamentalizëm' ka shpërthyer në secilën prej feve të mëdha botërore gjatë shekullit njëzet. Ekziston fundamentalizëm budist, krishterë, çifut, sikh, hindu, konfuçian, sikurse që ekziston edhe fundamentalizëm islamik. Nga tri fetë monoteiste Judaizëm, Krishterim dhe Islam, Islami është i fundit që zhvilloi një forcë fundamentaliste dhe atë gjatë viteve të 1960-ta.

Fundamentalizmi paraqet një revoltë kundër shoqërisë moderne shekullare, e cila ndan fenë nga politika. Kudo që është themeluar një qeveri me ideologji perëndimore-shekullare, një lëvizje protestuese religjioze kontra-kulturaliste do jetë ngritur përkrah saj për ta kundërshtuar atë fuqishëm. Qëllimi i fundamentalistëve është afrimi i Zotitfesë prej margjinave në të cilat e ka dërguar kultura moderne drejt qendrës. I tërë fundamentalizmi është i bazuar në një frikë të thellë asgjësimi: çofshin ata çifutë, krishterë apo myslimanë, fundamentalistët janë të bindur se shoqëria shekullare apo liberale synon zhdukjen e tyre. Kjo nuk është paranojë: fundamentalizmi çifut mori dy hapa të mëdhenj përpara - një pas Holokaustit nazist dhe dy pas luftës së Jom Kippurit, më 1973. Në disa pjesë të Lindjes së Mesme, shekullarizmi u formua aq shpejt dhe agresivisht sa që qe përjetuar si një goditje vdekjeprurëse.

A mund t'i identifikoni arsyet politike që kanë shkaktuar rritjen e ndarjes mes shoqërisë myslimane dhe asaj perëndimore?

Në Lindjen e Mesme, modernizimi është penguar nga konflikti arabo-izraelit, konflikt ky që është bërë simbol i fundamentalistëve të krishterë, çifutë dhe myslimanë, dhe është zemra e përgjakur e problemit. E vetmja shpresë për paqe, do të ishte gjetja e një solucioni politik që lë të kënaqur të gjithë. Ekziston gjithashtu edhe problemi i naftës, e cila i ka bërë disa nga këto shtete cak të lakmisë perëndimore. Perëndimi, për ta ruajtur pozitën e tij strategjike dhe furnizimin e lirë me naftë, shpesh është detyruar të përkrahë liderë si shahët e Iranit, Sauditët dhe fillimisht Sadam Hysenin, të cilët kanë krijuar regjime diktatoriale që shtypin çfarëdo opozite normale.

Bota moderne është dëshmuar të jetë shumë e dhunshme. Vetëm brenda viteve 1914-1945, shtatëdhjetë milionë njerëz në Evropë kanë gjetur vdekjen, si rezultat i luftës. Nuk duhet të befasohemi përse religjioni modern është bërë i dhunshëm gjithashtu; shpesh duke imituar dhunën e predikuar nga politikanët shekullarë. Dhuna dhe terrori, që ne shohim në tokat myslimane, kanë lulëzuar në ato rajone ku lufta,

zhvendosja dhe konflikti kanë lënë trauma dhe madje janë bërë kronike: Lindja e Mesme, Palestina, Afganistani, Pakistani, Kashmiri.

Për sa i përket konfliktit arabo-izraelit, ju keni thënë se për myslimanët është bërë "një simbol i impotencës së tyre në botën moderne". Çfarë në të vërtetë nënkupton kjo?

Konflikti arabo-izraelit ka filluar nga të dy anët, si një konflikt krejtësisht shekullar rreth një pjesë toke. Sionizmi ka filluar si kryengritje kundër judaizmit religjioz, madje në fillim rabinët ortodoksë patën shpallur Sionizmin si shekullarizëm blasfemues i tokës së Izraelit, njëri nga simbolet më të shenjta të Judaizmit. Ngjashëm ideologjia e PLO-së ishte shekullare, dihet se shumë nga palestinezët janë të krishterë. Për fat të keq konflikti u lejua të acarohet; në të dy anët konflikti u bë i shenjtë, andaj edhe shumë më i vështirë për t'u zgjidhur.

Në shumicën e lëvizjeve fundamentaliste, disa çështje kanë tematikë simbolike duke prezantuar gjithçka që është gabim me modernizmin. Sa i përket Judaizmit, shteti shekullar i Izraelit ka inspiruar secilën lëvizje fundamentaliste, ngase si i tillë përfaqëson aq grafikisht depërtimin e karakterit shekullar në jetën fetare çifute. Disa fundamentalistë çifutë e shohin me plot pasion shtetin e Izraelit, madje edhe e konsiderojnë atë si të shenjtë; involvimi në politikën izraelite konsiderohet si akt i shenjtë i tikkun-it, restaurimit të botës; vendbanimi në territoret e okupuara është gjithashtu një akt i tikkun-it, që do të nxisë ardhjen e Mesisë, siç besojnë disa. Megjithatë, çifutët ultra-ortodoksë shpesh janë deklaruar kundër shtetit të Izraelit: disa e shohin atë si diçka e ligë, urrejtëse (çifutët duhet të presin që Mesia të themelojë një shtet fetar në Tokën e Shenjtë) kurse disa të tjerë mbajnë qëndrim krejt neutral, duke iu shmangur sa më shumë që munden. Për shumë çifutë, Izraeli simbolizon feniksin e ngritur nga hiri i Auschwitz-it.

Por për shumë myslimanë, problemi i palestinezëve paraqet problemin e botës moderne. Fakti se më 1948, 750 000 palestinezë kanë mundur t'i humbin shtëpitë e tyre me aprovimin e dukshëm të botës, simbolizon impotencën e Islamit në botën moderne karshi Perëndimit. Kur'ani mëson se po qe se myslimanët jetojnë me drejtësi e modesti, shoqëritë e tyre do të përparojnë, sepse një jetë e tillë do të ishte në

ujdi me ligjet themelore të universit. Islami gjithmonë ka qenë fe e suksesit, triumfet kanë pasuar njëri-tjetrin, por sot myslimanët nuk janë në gjendje të lëvizin përpara Perëndimit shekullar, dhe problemi i palestinezëve konkretizon këtë impotencë. Jerusalemi gjithashtu është vendi i tretë për nga shenjtëria në botën islame, dhe kur myslimanët shohin faltoren e tyre të shenjtë të rrethuar nga forca izraelite, duke e ndier se qyteti i tyre i shenjtë gradualisht po u rrëshqet nga duart, kjo simbolizon se identiteti i tyre është në rrezik. Sidoqoftë, ia vlen të përmendet se palestinezët kanë adoptuar një ideologji me ngjyrë religjioze relativisht vonë - shumë vonë në krahasim me vendet, si Egjipti apo Pakistani, ku fundamentalizmi islamik simbolizon një forcë jo të dobët. Lëvizja e tyre rezistuese kishte karakter shekullar deri në Intifadën e parë, më 1987. Gjithashtu është shumë me rëndësi të theksohet se Hamasi, për shembull, ndryshon shumë nga lëvizjet tjera si Al-Kaida, e cila ka ambicie globale. Hamasi është një lëvizje rezistuese; nuk ka për qëllim sulmimin e amerikanëve apo anglezëve, cak i saj janë forcat okupuese. Prapë kjo simbolizon një shembull të "fundamentalizmit" si një formë fetare e nacionalizmit.

Konflikti arabo-izrael është bërë shumë i rëndësishëm edhe për fundamentalistët e krishterë në Shtetet e Bashkuara. E Djathta e Krishterë beson se përderisa çifutët nuk janë në tokën e tyre, Krishti nuk mund të kthehet në Ardhjen e Dytë. Por, edhe pse ata duken sionistë të pasionuar, ideologjia e tyre është edhe anti-semitike, sepse në ditët e fundit, ata besojnë se, Antikrishti do t'i masakrojë çifutët në Tokën e Shenjtë, nëse nuk e pranojnë Baptizmin.

A mendoni se Perëndimi mban ca përgjegjësi për atë që po ndodh në Palestinë?

Njerëzit e Perëndimit janë përgjegjës për çdonjërin që është duke vuajtur në botë. Ne jemi në mesin e shteteve më të pasura dhe më të fuqishme, andaj nuk bën moralisht dhe fetarisht të rrimë duarkryq dhe të shikojmë varfërinë, grabitjet apo padrejtësitë që po ndodhin qoftë në Palestinë, Kashmir, Çeçeni apo Afrikë. Për më tepër, njerëzit e Perëndimit mbajnë një përgjegjësi të posaçme për situatën arabo-

izraelite. Sipas Deklaratës së Balforit (1917), Britania aprovon vendbanimin e çifutëve në Palestinë duke injoruar aspiratat dhe telashet e palestinezëve autoktonë. Edhe sot Shtetet e Bashkuara mbështetin Izraelin ekonomikisht e politikisht dhe shkojnë drejt injorimit të problemit të palestinezëve. Kjo paraqet rrezik, sepse palestinezët nuk do të ndalen, dhe përderisa nuk gjendet një zgjidhje e cila do t'iu premtonte siguri izraelitëve dhe t'iu ofrojë pavarësi politike e siguri palestinezëve të shpronësuar, nuk ka shpresë për paqe botërore.

Veç kësaj, ju keni theksuar rëndësinë e një "vizioni të trefishtë"- mundësia për ta shikuar konfliktin nga perspektiva e komunitetit islamik, krishterë dhe çifut. A mund ta shpjegoni këtë pikëpamje?

Tri fetë Ibrahimite - Judaizmi, Krishterimi dhe Islami - mund dhe duhet të shikohen si një traditë fetare, e cila ka marrë tri drejtime të ndryshme. Gjithnjë jam përpjekur t'i shoh në këtë mënyrë; asnjërën nuk e konsideroj superiore ndaj tjetrës. Çifutët, krishterët dhe myslimanët adhurojnë të njëjtin Zot dhe ndajnë vlera të njëjta morale. Në librin, *Një histori e Zotit*, jam përpjekur të paraqes se si gjatë historisë së tyre, çifutët, krishterët, dhe myslimanët kanë bërë pyetje të njëjta rreth Zotit dhe kanë arritur në konkludime të njëjta - kështu që ekzistojnë versione çifute dhe myslimane të inkarnimit për shembull, dhe shumë pikëpamje të njëjta rreth profecisë. Në librin tjetër, *Beteja për Zot,* jam përpjekur të paraqes ngjashmërinë e lëvizjeve fundamentaliste në të tri fetë.

Çifutët, megjithatë, gjithnjë e kanë pasur të vështirë të pranojnë besimet e vona të krishterimit dhe islamit; krishterimi gjithnjë ka pasur një relacion të parehatshëm me judaizmin, besimin mëmë, dhe e ka shikuar islamin si imitues blasfemik të shpalljes. Kur'ani, megjithatë, mban një qëndrim pozitiv ndaj judaizmit dhe krishterimit dhe vazhdimisht pohon se Muhamedi nuk ka ardhur për t'i anuluar besimet e 'Ithtarëve të Librit': nuk mund të konsiderohesh mysliman përderisa nuk e nderon pejgamberin Ibrahim, Davud, Nuh, Musë dhe Isë – të cilët konsiderohen pejgamberë nga myslimanët - sikurse që besojnë dhe shumë shkrues të Testamentit të Ri. Gospeli i Lukës thërret Isën pej-

gamber prej fillimit deri në fund; ideja se Isa është hyjnor është një zhvillim i mëvonshëm, shpesh i keqkuptuar nga të krishterët.

Islami dhe Perëndimi

Duke diskutuar idetë perëndimore të drejtësisë dhe demokracisë në Lindjen e Mesme, korrespondenti i jashtëm anglez i gazetës "The Independent", Robert Fisk, thotë: "Vazhdimisht themi se arabët...do të kishin dashur të kenë pak nga demokracia jonë e ndritur, do të donin liri nga policët sekretë dhe liri nga diktatorët, të cilët ne me të madhe i vëmë atje. Por, ata do të donin liri nga ne gjithashtu. Ata duan drejtësi, e cila disa herë është më e rëndësishme sesa 'demokracia'. A duhet Perëndimi ta kuptojë se myslimanët mund të drejtojnë një shtet modern, ndoshta jo me të njëjtën demokraci të cilën ne duam ta shohim?

Siç e kanë qartësuar edhe intelektualët myslimanë, Islami plotësisht pajtohet me demokracinë, por për fat të keq demokracia ka fituar një emër të keq në shumë shtete myslimane. Duket që Perëndimi njëzëri ka pohuar: ne besojmë në liri dhe demokraci, por ju duhet të qeveriseni nga diktatorë si shahët apo Sadam Hyseni. Duket se ka ekzistuar një standard i dyfishtë. Robert Fisk ka të drejtë: kur isha në Pakistan së fundi dhe citova z. Bushin – "Ata e urrejnë lirinë tonë" – e gjithë audienca shpërtheu në gaz.

Demokracia nuk mund të imponohet me ushtri, tanke e zor. Fryma moderne përmban dy përbërës esencialë; nëse këta nuk ekzistojnë, pavarësisht sa avionë luftarakë, kompjuterë apo rrokaqiej ke, shteti yt nuk është me të vërtetë "modern".

I pari nga ta është pavarësia. Modernizimi i Evropës nga shekulli i XVI deri në shekullin e XX është theksuar me deklarimin e pavarësisë në të gjithë frontet: fetar, intelektual, politik, ekonomik. Njerëzit kërkonin liri për të menduar, shpikur dhe krijuar sipas zgjedhjes së tyre.

Përbërësi i dytë ka të bëjë me shpikjet dhe zbulimet. Gjatë modernizimit tonë në Perëndim vazhdimisht kemi krijuar diçka të re; një proces me shumë dinamizëm dhe eksitim, edhe pse shpesh di të jetë edhe traumatik.

Por në botën myslimane, modernizmi nuk arriti me pavarësi por me nënshtrim kolonizues; dhe akoma myslimanët nuk janë të lirë, për shkak se fuqitë e Perëndimit shpesh kontrollojnë politikën e tyre prapa skenave për të siguruar furnizimin me naftë etj. Në vend të pavarësisë ka ekzistuar një varësi e sëmurë dhe humbje lirie. Përderisa njerëzit nuk ndihen të lirë, çfarëdo "demokracie" do të jetë sipërfaqësore dhe me të meta. Dhe modernizmi nuk erdhi me shpikje e zbulime te myslimanët: ngase ne ishim shumë para, ata vetëm se mund të na kopjonin. Kështu që në vend të shpikjeve pati imitim.

Nisur nga jeta jonë, ne e dimë se është vështirë madje e pamundur të jesh kreativ kur ndjehesh në rrezik. Myslimanët shpesh ndihen në mbrojtje dhe kjo e bën të vështirë për t'u modernizuar dhe demokratizuar në mënyrë kreative - posaçërisht kur në rrugë ka trupa, tanke dhe forca okupuese.

A shihni ndonjë pikë të përbashkët mes Perëndimit dhe Islamit?

Kjo është e mundur vetëm nëse çështjet politike janë të zgjidhura. Ka mjaft pajtueshmëri mes idealeve të Islamit dhe idealeve moderne perëndimore, dhe shumë myslimanë me kohë e kanë kuptuar këtë. Në fillim të shekullit njëzet, pothuajse secili intelektual mysliman ishte në dashuri me Perëndimin dhe dëshironte që vendi i tij të duket mu sikur Britania dhe Franca. Disa madje thanë se Perëndimi ishte më "islamik" sesa vendet e pa-modernizuara myslimane, sepse ekonomia e tyre moderne u afrohej mësimeve thelbësore të Kur'anit, i cili predikon për rëndësinë e drejtësisë sociale dhe barazinë. Në këtë kohë, myslimanët e shikonin Perëndimin modern e demokratik si shumë të përafërt. Më 1906, klerikët myslimanë bënin fushatë krah intelektualëve shekullarë në Iran për një qeveri përfaqësuese dhe qeverisje konstitucionale. Kur ia arritën qëllimit, Ajatollahi i madh tha se kushtetuta e re ishte gjëja më e mirë për ardhjen e Mesisë shiit, sepse do të kufizonte tiranizimin e shahut dhe se ky projekt është në favor të çdo myslimani. Fatkeqësisht, anglezët më pas zbuluan naftën në Iran dhe kurrë nuk lejuan që parlamenti i ri të funksionojë lirshëm. Myslimanët u çmagjepsën nga Perëndimi, si rezultat i politikës së jashtme perëndimore:

Suezi, Izrael-Palestinë, përkrahja perëndimore e regjimeve të korruptuara, dhe kështu me radhë.

Çfarë mendoni se mund ta lidhë këtë boshllëk nga një pikëpamje praktike? Çfarë do t'i këshillonit liderët, politikanët dhe qeveritë tona?

Korrigjim të politikës së jashtme. Një zgjidhje konfliktit Izrael-Palestinë, e cila do iu garantonte siguri izraelitëve dhe drejtësi e autonomi palestinezëve. Jo më përkrahje regjimeve të korruptuara e diktatoriale. Një zgjidhje e drejtë tmerrit të shtrirë në Irak, e cila ka qenë një "ndihmë e hatashme" për grupet si Al-Kaida, duke luajtur mu në duart e tyre. Jo më situata si Ebu Garibi apo Gjiri i Guantanamos. Ndihmë financiare Afganistanit dhe Palestinës. Një zgjidhje Kashmirit. Jo me solucione afatshkurtër për naftë me çmim të lirë. Në Irak dhe Liban verën e kaluar pamë se ushtritë tona të mëdha nuk janë më të pathyeshme nga guerilët dhe sulmet e tyre. Diplomacia është esenciale. Por, mëdyshja e Perëndimit tani është aq e ngulitur sa që mund të jetë tepër vonë.

ANDREA BISTRICH, është gazetar me bazë në Munih, Gjermani.

Përktheu dhe përshtati:
Jeton Mehmeti
Kuala Lumpur
Marrë nga revista "Islamica" nr. 20

Interview with Karen Armstrong, published in the Islamica Magazine

DIVISIONS IN OUR WORLD ARE NOT THE RESULT OF RELIGION

(Summary)

Karen Armstrong was a Catholic nun for seven years before leaving her order and going to Oxford. Today, she is amongst the most renowned theologians and has written numerous bestsellers on the great religions and their founders. She is one of the 18 leading group members of the Alliance of Civilizations, an initiative of the former UN General Secretary, Kofi Anan, whose purpose is to fight extremism and further dialogue between the western and Islamic worlds. She talks here to the German journalist, Andrea Bistrich, about politics, religion, extremism and commonalities.

"الدين ليس سببا للصراعات في العالم"

(مقابلة اجريت مع كارن ارمسترونغ في مجلة "اسلاميكا")

(خلاصة البحث)

كارن ارمسترونغ خدمت لمدة سبع سنوات كراهبة كاثوليكية قبل أن تدخل في جامعة اكسفورد. اليوم هي تعتبر من أشهر علماء الاديان في العالم و لديها كتب مشهورة عن الديانات الكبرى. و هو عضو نشيط في مجموعة تقارب الحضارات و قد قام بتأسيسها العام السابق للامم المتحدة كوفي آنان و هدفها تقارب الاديان و مقاومة العنصرية و بصفة خاصة بين الغرب و العالم الاسلامي. و في هذه المقابلة التي اجرت معها الصحفى الالمانى آندريا بستريش هي تتحدث عن السياسة و الدين و التطرف و مواضيع أخرى.

ESE

Tajib Salih *(Sudan)*

KOHA E SHPËRNGULJES NË VERI - (2)

Ai është një tregim i gjatë, por unë nuk do ta tregoj të tërin. Disa detaje ndoshta nuk të interesojnë shumë, e disa… Me rëndësi është, ashtu siç po sheh se unë jam i lindur në Hartum[1]. Jam rritur jetim. Babai im kishte vdekur disa muaj para se të lindesha unë. Por, na kishte lënë pasuri të mjaftueshme. Ai merrej me tregtinë e deveve. Unë nuk kisha vëllezër. Andaj, jeta nuk ishte e vështirë për mua dhe për nënën time. Kur kthehem për disa vite mbrapa, më kujtohet ajo me buzët e saj të holla, kurse në fytyrën e saj kishte diçka sikur një maskë. Nuk e di. Maskë e dendur, sikur fytyra e saj të ishte një faqe e detit. A më kupton? Ajo nuk kishte vetëm një ngjyrë, por shumë ngjyra. Ato paraqiteshin, zhdukeshin dhe përziheshin. Ne nuk kishim të afërm. Ishim unë dhe ajo të afërm të njëri-tjetrit. Ajo më dukej si të ishte njeri i huaj me të cilin rastësisht më kishin bashkuar rrethanat. Ndoshta unë isha njeri i çuditshëm, apo ndoshta nëna ime ishte e çuditshme. Nuk e di. Nuk bisedonim shpesh. Mund të habitesh nëse them se unë ndjeja një lloj ngrohtësie, ndihesha disi i lirë, sepse nuk kishte një krijesë baba apo nënë që të më lidhte për një vend apo mjedis të caktuar. Lexoja dhe flija, dilja dhe hyja, luaja jashtë shtëpisë, sorollatesha rrugëve duke mos pasur askush të më urdhëronte apo të më ndalonte. Por, unë prej kohës së fëmijërisë, ndieja se unë isha diçka ndryshe… Kam për qëllim se unë nuk isha sikur fëmijët tjerë të moshës sime. Nuk ndikohesha prej askujt. Nuk qaja nëse dikush më rrihte. Nuk gëzohesha kur mësuesi më lavdëronte në klasë. Nuk ndieja dhembje prej gjërave prej të cilave ndiejnë dhembje të tjerët. Isha sikur një top kauçuku që e gjuan në ujë e nuk laget, e gjuan në tokë e ai kërcen. Ishte kjo periudha jonë e parë në shkollë. Më kujtohet tash se njerëzit nuk donin të shkonin në shkolla. Qeveria dërgonte nëpunësit e saj të shëtisnin nëpër fshatra dhe lagje, për të kërkuar prej njerëzve që t'i dërgonin fëmijët në shkolla, kurse ata i fshihnin për të mos i dërguar. Njerëzit ishin të bindur se okupatorët me ushtritë e tyre kishin sjellë vetëm gjëra të këqija dhe asnjë të mirë. Isha duke luajtur me disa shokë jashtë shtëpisë. Rastësisht pashë një njeri hipur në kalë, veshur me uniformë që u ndal para nesh. Të gjithë fëmijët tjerë ikën dhe mbeta unë vetëm duke shikuar kalin dhe njeriun që ishte hipur mbi të. Më pyeti si quhesha, unë i tregova. Më pyeti - sa vjet i ke? Iu përgjigja -Nuk e di. Pastaj më tha: "A dëshiron të regjistrohesh në shkollë"? -Ia ktheva -Çka është shkolla"? -Mu përgjigj: "Ndërtesë e bukur prej guri, në mes një kopshti të madh në brigjet e lumit Nil. Bie zilja hyn në klasë me shokë. Mëson shkrim-leximin dhe matematikën". Iu drejtova njeriut: "A do të vesh çallmë siç ke veshur ti"? -duke dhënë shenjë për kapelën që mbante ai në kokë. Njeriu qeshi dhe më tha: "Kjo nuk është çallmë. Kjo është kapelë". Zbriti prej kalit dhe ma vendosi mua në kokë, ajo ma mbuloi tërë fytyrën time. Pastaj njeriu më tha: "Kur të rritesh dhe ta kryesh shkollën dhe do të bëhesh nëpunës në qeveri do ta vendosësh një kapelë si kjo." Atëherë iu drejtova njeriut dhe i thash: "Dua të shkoj në shkollë." Njeriu më hipi edhe mua pas tij në kalë dhe më dërgoi në një vend ashtu siç ma kishte përshkruar, një ndërtesë prej gurësh në breg të lumit Nil, që ishte e rrethuar me lule dhe me drunj. Hymë te një njeri me mjekër që kishte të veshur një xhybe, i cili u çua në këmbë ma ledhatoi kokën dhe më tha: "Ku është babai yt?" I thashë se baba im më ka vdekur. Atëherë ma ktheu: "Kush është kujdestari yt?" Iu drejtova atij: "Unë dëshiroj të regjistrohem në shkollë."

[1] Kryeqytet i Sudanit.

Njeriu më shikoi me simpati dhe e regjistroi emrin tim në regjistër. Pastaj më pyetën sa vjet i ke? Iu përgjigja nuk e di. Rastësisht ra zilja. Ika prej tyre dhe hyra në njërën prej klasave, erdhën dy burra më nxirrën prej saj dhe më dërguan në një klasë tjetër, më ulën në një bankë me disa nxënës tjerë. Në drekë, u ktheva te nëna ime, e cila më pyeti se ku isha. Ia rrëfeva asaj tregimin tim. Për një çast më shikoi me një shikim të çuditshëm, sikur ajo donte të më shtrëngonte në kraharorin e saj. Pashë se si fytyra e saj u qetësua për një çast, sytë e saj shndrisnin, buzët e saj po liroheshin sikur ajo donte të buzëqeshte apo të thoshte diçka. Por, ajo nuk tha asgjë. Kjo ishte një kthesë e madhe në jetën time. Ky ishte vendimi im i parë që kisha marrë me vullnetin tim të plotë.

Unë nuk kërkoj prej teje të besosh për këtë që po e them. Ti mund ta pranosh apo të dyshosh. Ti je i lirë. Këto janë ndodhi, që kanë ndodhur para një kohe të gjatë. Si po e sheh edhe vetë se ato tash nuk kanë kurrfarë vlere. Këtë po ta them ty, sepse ato më kujtojnë mua shumë ngjarje, sepse ndoshta të përkujtojnë njëra-tjetrën.

Me rëndësi është se unë me tërë qenien time u përqendrova në jetën e re. Shumë shpejt zbulova në mendjen time një fuqi marramendëse për të kuptuar dhe mbajtur në mend. E lexoj librin dhe i tëri vendoset në memorien time. Posa ta përqendroj mendjen time në ndonjë çështje të matematikës, të cilën e zgjidhi pa asnjë problem, sikur ajo të vendosë një grusht kripe në ujë. Shkrimin e mësova brenda dy javëve. Pastaj u hyra gjërave tjera pa asnjë pengesë. Mendja ime sikur të ishte një thikë e prehtë, çdo send e pret me ftohësi dhe efektivitet. Nuk më habiste çudia e mësuesve apo simpatia e shokëve apo zilia e tyre. Mësuesit më shikonin mua si një lloj mrekullie, kurse shokët e mi kërkonin shoqërimin tim. Por, unë isha i zënë me atë instrument të çuditshëm që më ishte dhënë mua.. Isha i ftohtë si një fushë akulli. Nuk kishte në botë ndonjë forcë që do të më zmbrapste mua. Ciklin e parë e mbarova për dy vjet. Në shkollën e mesme zbulova edhe enigma tjera, prej tyre gjuha anglishte. Mendja ime nisi të kafshojë dhe të prej sikur omët e plugut. Fjalët dhe fjalitë më dukeshin si të ishin ekuacione të matematikës, kurse aritmetika dhe gjeometria sikur të ishin

vargje poezie. Botën e gjerë e shoh në mësimet e gjeografisë, sikur ajo të ishte një copë shahu. Shkolla e mesme ishte instanca më e lartë e shkollimit që mund të arrinte njeriu në atë kohë. Pas tre vjetëve, drejtori i shkollës, i cili ishte anglez më tha: “Ky vend nuk ka më çka të ofrojë njohuri të reja për kokën tënde. Udhëto në Egjipt, Liban apo Angli. Nuk kemi më çka të ofrojmë më tepër.” Ia ktheva menjëherë: “Dëshiroj të shkoj në Kajro!” Më lehtësoi procedurën rreth udhëtimit. Më kishte siguruar udhëtimin dhe regjistrimin falas në një kolegj në Kajro, si dhe një bursë shkollore prej qeverisë. Kjo është e vërtetë që më ka ndodhur gjatë jetës sime. Disa njerëz si të ishin të porositur më dilnin në ndihmë në çdo periudhë, ndaj të cilëve nuk kisha asnjë ndjenjë për ndonjë të mirë. Unë pranoja ndihmat e tyre sikur ata këtë ta kishin obligim ndaj meje.

Kur drejtori i shkollës më njoftoi se çdo gjë ishte në rregull për udhëtimin tim për në Kajro, shkova te nëna ime dhe i tregova asaj. Më shikoi edhe një herë me atë shikimin e saj të çuditshëm. Buzët e saj për një moment u veniten sikur ajo dëshironte të buzëqeshte, pastaj i mbylli ato dhe fytyra e saj u kthye në gjendjen e saj të zakonshme e maskuar e dendur, apo më mirë të them një grup maskash. Pastaj u largua për pak kohë dhe erdhi me një kuletë, të cilën e vendosi në dorën time dhe më tha: “Po të ishte gjallë babai yt, do ta zgjidhte rrugën që ti ke zgjedhur për vete. Vepro si të duash. Udhëto, apo rri. Bën si ta merr mendja se është më së miri për ty. Kjo është jeta dhe e ardhmja e jote. Ti je i lirë të veprosh sipas vullnetit tënd. Në këtë kuletë ke diçka që do të ndihmoj ty.” Kjo ishte lamtumira e jonë. Nuk kishte lot, as puthje e as zhurmë. Dy krijesa kishin kaluar një pjesë të rrugëtimit bashkërisht, pastaj secili kishte zgjedhur rrugën e vet. Këto ishin fjalët e fundit, që ajo më kishte thënë mua, sepse unë më nuk e kisha parë asnjëherë. Pasi kishin kaluar disa vite dhe isha përballur me shumë sfida, më ishin kujtuar ato momente dhe kisha qajtur. Por, tash nuk ndiej diçka të veçantë. I mblodha rrobat e mija në një çantë të vogël dhe i hipa trenit. Askush nuk më përshëndeti me dorë dhe unë nuk derdha lot që u largova prej dikujt. Treni nxitoi nëpër shkretëtirë dhe mendova për vendin tim që lashë pas. Më dukej si një kodër në të ci-

lin kisha vendosur tendën time atje dhe në mëngjes i kisha nxjerrë shtyllat, kisha përgatitur devën time dhe kisha vazhduar rrugëtimin tim. Mendova për Kajron kur ne ishim në Vadi Halfa, mendja ime paramendoi atë një tjetër kodër, më të madhe, në të cilën do të flejë një natë apo dy net e pastaj do ta vazhdoj rrugëtimin deri te një cak tjetër.

Më kujtohet se unë në tren isha ulur para një njeriu me rrobe të zeza, që në qafë mbante një kryq të madh me ngjyrë të verdhë. Njeriu, duke buzëqeshur m'u drejtua në gjuhën anglishte, të cilit iu përgjigja menjëherë. Më kujtohet se habia u shfaq në fytyrën e tij dhe u zgjeruan bebëzat e syve të tij posa dëgjoi zërin tim. Më hodhi një shikim me vëmendje dhe më tha: "Sa vjet i ke?" I thashë pesëmbëdhjetë vjet. Në realitet unë isha në moshën dymbëdhjetë vjeçare, por u frikësova se mos do të më nënçmojë. Atëherë, ai ma ktheu: "Për ku je nisur?" Iu përgjigja: "Po shkoj të regjistrohem në një kolegj në Kajro". Më tha: "Vetëm"? I thashë po. Më shikoi edhe një herë me një shikim të gjatë dhe para se ai të fliste i thashë: "Unë dëshiroj të udhëtoj vetëm. Përse të frikësohem"? Atëherë më tha një fjali, të cilës nuk ia kam vënë veshin shumë, kurse fytyrën e tij e shndriti një buzëqeshje e madhe dhe shtoi: "Ti po e flet anglishten me një gjuhë shumë të rrjedhshme".

Arrita në Kajro dhe e gjeta zotëri Robinson dhe gruan e tij në pritjen time. Ata i kishte lajmëruar zotëri Stekvol për kohën e arritjes sime. Njeriu më përshëndeti dhe më tha: "Si je ti zotëri Seid?" Ia ktheva: "Unë jam mirë zotëri Robinson." Pastaj më prezantoi gruan e tij. Rastësisht ndjeva se krahët e një gruaje më përqafojnë dhe buzët e saj puqen mbi faqet e mia. Në atë moment, kur unë isha në trotuarin e hekurudhës, në mesin e asaj tollovie të zërave dhe ndjenjave, dy duart e gruas kishin përthekuar qafen time, goja e saj ishte puqur mbi faqen time, aroma e trupit të saj, aromë evropiane e çuditshme, kënaqte hundën time, kraharori i saj prekte kraharorin tim. Ndjeva, dhe unë isha djalosh dymbëdhjetë vjetësh me një epsh misterioz, të cilin nuk e kisha njohur më parë në jetën time. Ndjeva se sikur Kajroja, ajo bjeshkë e madhe tek e cila më barti deveja ime, ishte një grua evropiane, plotësisht sikur zonja Robinson, krahët e saj më përqafojnë, kurse aroma dhe era e trupit të saj mbulojnë hundën time. Në mendjen time ngjyra

e syve të saj ishte sikur ngjyra e Kajros, ngjyrë hiri, e gjelbër, gjatë natës kthehet në dritë.

Zonja, Robinson më thoshte mua: "Ti zotëri Seid nuk je njeri buzagaz". Është e vërtetë se unë nuk qeshesha. Zonja Robinson qeshte dhe më thoshte: "A nuk mund ta harrosh mendjen tënde asnjëherë?" Ditën kur më dënuan mua Oveld Billi me burgim prej shtatë vjetësh, nuk gjeta tjetër kraharor përveç kraharorit të saj ta mbështesë kokën time. Ajo e përkëdheli kokën time dhe më tha: "Mos qaj djali im i dashur." Ata dy nuk kishin fëmijë. Zotëri Robinson e fliste bukur gjuhën arabe dhe kishte njohuri për mendimin islam dhe arkitekturën islame. Në shoqërinë e tij vizitova xhamitë e Kajros, muzetë dhe monumentet e saj të shumta. Pjesa më e dashur e Kajros për mua ishte pjesa e el-Az-harit. Kur lodheshim duke ecur, pastaj çlodheshim në ndonjë kafe aty pranë xhamisë së el-Az-harit, pinim lëngje të hurmave, kurse zotëri Robinsoni lexonte poezitë el-Mearrit. Në atë kohë isha i angazhuar me vetveten dhe nuk kisha kohë të mendoj për respektin dhe dashurinë që ata kishin treguar ndaj meje.

Zonja Robinson ishte me trup të plotë, ngjyrë bronzi, në harmoni me Kajron, sikur ajo të ishte një panoramë e zgjedhur me shije që të jetë në harmoni me ngjyrën e mureve në një dhomë. Shikoja qimet e sqetullave të saj dhe tmerrohesha. Ndoshta ajo e dinte se unë e dashuroja atë, por ajo ishte e këndshme, ndoshta gruaja më e këndshme që kam njohur ndonjëherë. Ajo qeshte me gëzim dhe më donte mua ashtu siç e do nëna fëmijën e saj.

Ata po qëndronin në trotuar kur erdhi anija nga Aleksandria për në Londër. E pashë nga larg duke më përshëndetur me mindilin e saj dhe fshirë lotët. Afër saj qëndronte burri i saj, që kishte vënë duart në bel. Nga ajo distancë mund të shihja çiltërinë e syve të tij të kaltër. Megjithatë, unë nuk isha i pikëlluar, i tërë koncentrimi im ishte përqendruar si të arrijë në Londër, në një bjeshke tjetër më të madhe se Kajroja. Nuk e dija se sa net do të mbetem atje. Isha në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare. Mendonte kush më shihte se isha në moshën njëzetvjeçare, vital, sikur të ishte një tupan i fryrë. Pas vete kisha tregimin e një suksesi të rrallë në shkollë. E tërë arma ime ishte kjo thikë e mprehtë në

kokën time, kurse në kraharorin tim një ndjenjë e ngurtë e ftohtë, më dukej sikur kraharori im të ishte i murosur me gurë. Kur zhurma e mori bregdetin dhe valët u ngritën nën anije dhe u soll horizonti i kaltër përreth nesh, ndjeva disa emocione të valëve në det. Unë e njoh këtë gjigant të gjelbër të pafund sikur ai të kalonte mes brinjëve të mi. Gjatë tërë rrugëtimit më përshkoi ajo ndjenjë sikur unë nuk jam në një vend të caktuar. Para meje dhe pas meje, mbaron çdo send apo asgjë dhe faqja e detit kur mbaron vegimi tjetër vazhdimisht ndryshon, sikur maska në fytyrën e nënës sime. Këtu dukej sikur të ishte një shkretëtirë e gjelbër e gjatë, që vazhdimisht më thërret mua. Ky zë i çuditshëm më çoi në luginën e Dofrit, në Londër dhe në tragjedi. Vazhdova të njëjtën rrugë në kthim dhe gjatë rrugës pyetja veten gjatë udhëtimit a ka qenë e mundur shmangia e asaj që ndodhi? Harku është i ngrehur andaj nuk ka mundësi pa u nisur shigjeta. Shikoj në të majtë e në të djathtë dhe gjelbërimin e errët, fshatrat saksone të ndërtuara pranë kodrave. Kulmet e shtëpive kanë ngjyrë të kuqe janë të kërrusura sikur shpina e lopëve dhe një mjegull e dendur ka mbuluar luginat. Sa me bollëk është uji këtu si dhe gjelbërimi dhe të gjitha ato ngjyra. Aroma e atij vendi është e çuditshme, sikurse aroma e trupit të zonjës Robinson. Zërat kanë një melodi të bukur në veshët e mi ashtu sikur zhurma e krahëve të shpezëve. Kjo botë është e sistemuar, shtëpitë, arat dhe drunjtë janë të mbjellë me plan. Lumenjtë, po ashtu nuk bëjnë leqe, por, ata rrjedhin nëpër kanale artificiale. Treni ndalet për pak minuta në stacion. Njerëzit dalin me nxitim dhe hynë me nxitim, pastaj niset treni. Nuk ka zhurmë. Për pak mu kujtua jeta në Kajro. Nuk ka ndodhur diçka që nuk është e paraparë. Njohuritë e mia shtohen. Më kanë ndodhur disa ndodhi të vogla. Një shoqe e imja ra në dashuri në mua pastaj më braktisi, duke më thënë: “Ti nuk je njeri. Ti je një vegël mekanike.” Sorollatesha rrugëve të Kajros dhe vizitova Operën, hyra në teatër dhe kalova Nilin një herë duke notuar. Nuk ndodhi asgjë përveç se daulli u fry edhe më tepër. Shigjeta do të niset në drejtim të horizonteve të reja të panjohura. Shikoj tymin e trenit që ka filluar të shpërndahet nga erërat e forta në dendësinë e mjegullave të përhapura nëpër lugina. Në ndërkohë më kishte kotur gjumi. Kisha parë ëndërr

se unë po falesha vetëm në xhaminë e kalasë në Kajro. Xhama po ndriçohej me mijëra qirinj, graniti i kuq po shndriste, kurse unë vetëm po falesha. U zgjova dhe në hundën time ndjeva aromën e temjanit. Në ndërkohë që treni po i afrohej Londrës, Kajroja ishte qytet i gëzimit po ashtu edhe zonja Robinson. Ajo insistonte ta thirrja me emrin e saj të parë Elizabet, por unë e thirrja me emrin e burrit të saj. Prej saj mësova ta dua muzikën e Bahut, poezinë e Ketsit dhe dëgjova për herë të parë për Mark Tvenin. Por, megjithatë, unë nuk kënaqesha me asgjë, për ç’gjë zonja Robinson qeshte dhe më thoshte: ”A nuk mund ta harrosh mendjen tënde përgjithmonë”? -A ke mundur t’i shmangesh ndonjë sendi që ka ndodhur? Në atë kohë isha duke u kthyer dhe mu kujtua se çka më kishte thënë prifti, kur unë isha në udhëtim e sipër për në Kajro: “Të gjithë ne, biri im, më në fund do të udhëtojmë vetëm.” Me dorën e vet e prekte kryqin në gjoksin e tij. Fytyrën e tij e përshkoi një buzëqeshje e madhe dhe shtoi: “Ti po flet gjuhën angleze shumë rrjedhshëm.” Por, gjuhën të cilën po e dëgjoj tash nuk është sikur ajo që kam mësuar në shkollë. Këto janë zëra të gjallë që kanë një tingull tjetër. Mendja ime ishte sikur një thikë e mprehtë. Por, gjuha nuk është gjuha ime. Atë e kisha mësuar gjatë praktikumit të saj. Treni më kishte sjellë në stacionin e Viktorisë dhe në botën e Xhin Morisit.

Çdo send kishte ndodhur para se të takohem me të, ishte një çudi. Çdo send që kam bërë pas mbytjes së saj ishte kërkim-falje jo për mbytjen e saj, por për një gënjeshtër në jetën time. Isha në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare kur e takova atë në një ceremoni në Çelsi. Një derë dhe një korridor i gjatë të çonte në sallë. Hapa derën, prita pak në sytë e mi u paraqit një dritë e dobët, sikur të ishte vegim që shndrit në shkretëtirë. Isha i dehur, në gotën time më kishte mbetur një e treta e pijes. Aty rreth meje kisha dy vajza me të cilat bëja punë të pamoralshme dhe ato qeshnin. Ajo ishte nisur në drejtim tonin me hapa të shpejtë, duke përqendruar peshën e trupit të saj në këmbën e djathtë. Më shikonte mua dhe ajo vinte kah unë. Qëndroi para meje dhe më shikoi me mburrje, ftohësi dhe diçka tjetër. Hapa gojën të flas, por ajo

shkoi. Iu drejtova një shoqeje që ishte pranë meje me fjalët: “Kush është kjo grua?”

Londra posa kishte dalë nga lufta dhe nga periudha Viktoriane. Kisha mësuar kafenetë e Çelsit, klubet e Hambstidit dhe shoqatat e Blumbzberit. Lexoja poezi, flisja për fe dhe filozofi, e kritikoja artin dhe flisja për aspektin shpirtëror të Lindjes. Bëja çdo gjë derisa e çoja femrën në krevatin tim. Pastaj shkoja në një gjah tjetër. Në zemrën time nuk kishte asnjë grimë dëfrimi, ashtu siç pohonte zonja Robinson. Kisha sjellë në shtratin tim vajzat nga mesi i ushtrisë së shpëtimit, të shoqatës Kriker, të shoqërisë Fabijane. Kur tubohet partia Liberale, Laburiste, Konservatore apo edhe Partia Komuniste, përgatis devenë time dhe shkoj. Herën e dytë më pati thënë mua Xhin Moris: “Ti je i shëmtuar. Asnjë herë në jetën time nuk kam parë fytyrë të shëmtuar si fytyra jote.” Sapo e hapa gojën të flas, por ajo shkoi. Në atë moment, dhe unë isha i dehur, u betova se ajo do ta paguajë çmimin e këtij ofendimi ndonjë ditë. U zgjova dhe An Hamend ishte pranë meje në shtrat. Çka është ajo që e ka tërhequr An Hamend tek unë? Babai i saj është në armatën e inxhinierisë, kurse nëna prej familjeve të pasura të Liverpulit. Ishte gjah i lehtë. E takova atë, kur ajo ishte nën moshën njëzetvjeçare, duke studiuar gjuhët orientale në Oksford. Ishte e gjallë, fytyra e saj tregonte se ishte e zgjuar, sytë e saj tregonin se ajo kishte dëshirë për vëzhgim. Më pa mua si një agim të venitur, si një agim të rrejshëm. Ishte antipod i imi. Dëshironte klimën ekuatoriale, diellin me rreze të forta dhe horizontet e purpurta. Në sytë e saj isha simbol i tërë kësaj dashurie. Unë isha nga jugu që e donte veriun dhe të ftohtit. An Hamend kishte kaluar femërinë e saj në një shkollë të motrave të nderit. Halla e saj ishte bashkëshortja e anëtarit në parlament. Në shtratin tim e kisha kthyer në një prostitutë. Dhoma e fjetjes sime ishte si një varr që kishte pamjen e një kopshti. Perdet kishin ngjyrë vjollce ishin të zgjedhura me kujdes. Tepihu prej mëndafshi, një krevat i madh, jastëkët ishin me pendla të shpezëve. Dritat elektrike të vogla, të kuqe, të katërta, violete të vendosura në një kënd të caktuar. Nëpër mure kishte pasqyra të mëdha, kur unë përqafoja një grua, dukej sikur po përqafoj një harem të tërë. Në dhomë kishte lloj-

lloj parfumesh, kurse në banjë parfume të orientit. Dhoma e fjetjes sime i përngjante sallës së operacionit në spital. Ekziston një kënetë e qetë në thellësinë e çdo gruaje. Unë dija si ta lëvizja atë. Një ditë e kishin gjetur të vdekur.

Kishte bërë vetëvrasje me gaz, pranë saj kishin gjetur një fletë të vogël me emrin tim. Në të nuk kishte më tepër se ky tekst: “Zotëri Seid, Zoti të mallkoftë”. Mendja ime ishte si një thikë e mprehtë. Treni më kishte sjellë në stacionin e Viktorisë dhe në botën e Xhin Morisit.

Në sallën e madhe të gjyqit në Londër qëndrova ulur për javë të tëra duke dëgjuar avokatët, të cilët flisnin për mua, kurse mua më dukej se ata po flisnin për një njeri, i cili nuk më intereson mua fare. Prokurori i përgjithshëm, Sir Arthur Hunkenz, kokë gjeniale, të cilin e njoh shumë mirë. Më ka ligjëruar mua jurisprudencën në Oksford. Atë e kisha parë më parë në këtë gjyq dhe në këtë sallë, duke i shtrydhur të akuzuarit ashtu siç shtrydhet limoni. Shumë të rralla ishin rastet kur ndonjë i akuzuar mund të shpëtonte prej tij. Kam parë të akuzuar, duke qarë dhe u binte të fikët pasi që përfundonte marrjen në pyetje të tyre. Por, ai kësaj radhe kishte para vetes një kufomë.

“A je ti shkaktar i vetëvrasjes së An Hamend ”?

“Nuk e di.”

“E të Shila Grenod ?”

“Nuk e di.”

“E të Izabela Simor ?”

“Nuk e di.”

“A je ti që ke mbytur Xhin Morisin”?

“Po.”

“A e ke mbytur qëllimisht”?

“Po,”

Më dukej sikur zëri i tij po vinte nga një botë tjetër. Njeriu vazhdoi të vizatojë me mjeshtri pamjen e tmerrshme të një njeriu ujk, që shkaktoi vetëvrasjen e dy vajzave, shkatërroi jetën e një gruaje të martuar dhe e mbyti gruan e vet. Një njeri egoist që i tërë qëllimi i jetës së tij ishte në kërkimin e kënaqësisë. Një herë m’u kujtua kur unë isha i molisur, isha ulur duke dëgjuar profesorin tim Maksol Fisterkin, i ci-

li mundohej të më shpëtonte nga varja, të ngritëm dhe të bërtas në gjyq: “Personi me emrin Mustafa Seid nuk ekziston. Ai është iluzion dhe gënjeshtër. Unë kërkoj prej jush të gjykoni për ekzekutimin e gënjeshtrës.” Por, unë isha i vdekur sikur një masë hiri. Profesori Maksol Fosterkin vazhdoi ta përshkruajë pamjen e një mendje gjeniale, të cilën rrethanat ia kishin imponuar vrasjen, në një rast xhelozie dhe çmendurie. U shpjegoi atyre se si unë isha caktuar ligjërues i ekonomisë në Universitetin e Londrës, në moshën njëzetekatërvjeçare. U tha atyre se An Hamend dhe Shila Grinod ishin dy vajza që e kërkonin vdekjen me çfarëdo mënyre dhe se ato dyja do të bënin vetëvrasje u takuan me Mustafa Seidin apo nuk u takuan me të. “Mustafa Seidi, të nderuar gjyqtarë, është njeri i ndershëm, mendja e të cilit e ka kuptuar civilizimin perëndimor, por ai ka shkatërruar zemrën e tij. Ato dy vajza nuk i vrau Mustafa Seidi, ato i vrau mikrobi i një sëmundje të pashërueshme që i ka goditur para një mijë vjetëve.”.. Më shkoi mendja të ngrihem dhe t’i them atyre: “Ky është falsifikim dhe trillim. Ato i kam mbytur unë. Unë jam shkretëtirë e etshme. Unë nuk jam Othello. Unë jam gënjeshtër. Përse nuk gjykoni me varjen time dhe ta mbytni gënjeshtrën!” Mirëpo, profesor Fosterkin e ktheu gjykimin në konflikt mes dy botëve. Unë isha njëra prej viktimave të tij. Treni më barti në stacionin e Viktorisë dhe në botën e Xhin Morisit.

Unë vazhdova ta ndjek atë për tre vjet me radhë. Për çdo ditë harku i shigjetës ishte më i tensionuar. Një ditë m’u drejtua me këto fjalë: “Ti je një ka i çartur që nuk ndalet nga të ndjekurit. Unë jam e lodhur nga të ndjekurit tënd. Më kurorëzo!” E kurorëzova. Dhoma ime e fjetjes u kthye në një shesh lufte. Shtrati im u kthye në një copë ferri. E kapi atë dhe më duket sikur unë ta kap një re, sikur unë të përqafoj një meteor, sikur unë hipi një kalë të racës prusiane. Në buzët e saj paraqitet ajo buzëqeshje e hidhur. Tërë natën e kaloj pa gjumë. Vazhdoj luftën me hark, shpatë, shtizë dhe shigjetë. Në mëngjes e shoh atë buzëqeshjen e saj të rëndomtë, në të njëjtën gjendje si më parë. Atëherë kuptoj se unë përsëri e kam humbur luftën. Sikur unë të isha Shehrejari rob, të cilin e blen për një dinar, Shehrezadeja, të cilin e ka takuar rastësisht një lypëse në rrënojat e një qyteti që e kishte mbytur kolera.

Jetoja me teoritë e Kenz dhe Toni gjatë ditës, kurse natën vazhdoja luftën me hark, shpatë, shtizë dhe shigjetë. Pashë ushtarët duke u kthyer të tmerruar nga lufta e hendeqeve dhe sëmundjeve. I pashë ata duke mbjellë farën e luftës së ardhshme në marrëveshjen e Versajit. Pashë Luid Gjorgjin duke vënë bazat e shtetit të prosperitetit të përgjithshëm. Qyteti u kthye në një grua të çuditshme, e cila kishte simbole dhe thirrje të paqarta. Infektimi i kishte goditur ato një mijë vjet më parë, mirëpo unë nuk i ndërmora masat adekuate derisa sëmundja e bëri të veten dhe i mbyti. Këngëtarët përsëritnin këngët e dashurisë së vërtetë në teatrot e Lister Skverit. Por, zemra nuk më gëzohej fare. Kush ka menduar se Shila Grenod do të bëjë vetëvrasje? Punonte shërbëtore në restorantin Soho. E thjeshtë me një buzëqeshje të natyrshme, gojëmbël. Familja e saj janë fshatar nga periferia e Hilit. E mashtrova atë me dhurata, biseda të ëmbla dhe me shikimin që e sheh sendin dhe nuk e gabon. Bota ime e re e tërhoqi atë. Atë e mahniti aroma e drurit sandall dhe temjanit. Qëndroi për një kohë duke qeshur me imagjinatën e saj para pasqyrës. U lodh derisa e vendoi fildishin, si një nyje rreth qafës së saj të bukur. Hyri në dhomën e fjetjes sime e pastër virgjëreshë, kurse doli prej saj dhe ajo barte mikrobin e sëmundjes në gjakun e saj. Vdiq pa e folur asnjë fjalë. Munucioni im i tregimeve nuk mbaron. Për çdo rast kam tregimin e duhur.

“A nuk është e vërtetë se në periudhën mes tetorit 1922 dhe shkurtit 1923, vetëm gjatë kësaj periudhe ke bashkëjetuar së paku me pesë gra në të njëjtën kohë?”

“Gjithsesi.”

“Dhe secilën prej tyre e mashtroje se do ta marrësh për grua?”

“Gjithsesi.”

“Dhe me secilën prej tyre kishe shpikur emër të ndryshëm?”

“Gjithsesi.”

”Ti ishe Hasan, Çarls, Emin, Mustafë, dhe Riçard?”

“Gjithsesi.”

“Dhe megjithatë, ke shkruar dhe ke ligjëruar në ekonominë e mbështetur në dashuri dhe jo në numra? A nuk është e vërtetë se ti u bëre i njohur me thirrjen tënde njerëzore në ekonomi?”

"Gjithsesi".

Tridhjetë vjet kishte që shelgjeja zbardhej, gjelbërohej dhe zverdhohej në kopshte, si dhe qyqja i këndonte pranverës për çdo vit. Tridhjetë vjet dhe salla e Albertit mbushte përplot me tifozët e Betovenit dhe Bahut, dhe shtypshkronjat nxjerrin me mija libra në fushën e artit dhe të menduarit. Dramat e Bernard Shout shfaqen në Rojal Kort dhe Himarket. Idith Stol thurte poezi dhe teatri Princi i Velsit ishte përplot të rinj. Deti me baticat dhe zbaticat e tij në Port Mouth dhe Brat Toun si dhe në zonën e liqeve zbukurohej vit pas viti. Ujdhesa dukej si një melodi e këndshme, Seidi është i pikëlluar, në ndryshimin vegues me ndërrimin e stinëve. Tridhjetë vjet dhe unë jam pjesë e tërë kësaj. Jetoj në të dhe nuk e ndjej bukurinë e vërtetë dhe nuk më intereson asgjë tjetër përveç asaj që ma mbush shtratin tim për çdo natë.

Po. Në verë. Thanë se një verë e tillë nuk kishin përjetuar përveç para njëqind vjetëve. Dola prej shtëpisë sime ditën e shtunë të marrë ajër të pastër dhe ndjeja se unë jam në prag të një gjahu të madh. Arrita në Hajd Park në këndin e fjalimeve. Ishte përplot njerëz. Qëndrova në një distancë të dëgjoj një folës nga ujdhesat e Indisë Perëndimore, që po fliste për problemin e njerëzve me ngjyrë. Rastësisht, shikimi im u përqendrua në një grua që po zgjate qafen e saj për ta parë folësin (oratorin), fustani i së cilës po ngrihej mbi gjunjët e saj, duke i shpaluar dy këmbë të kthyera prej bronzi. Thash vetmevete: Po ky është gjahu im dhe shkova tek ai. Ashtu siç shkon barka te ujëvara. Qëndrova parapa saj. U mbështeta për të derisa ndjeva se ngrohtësia e saj depërtoi tek unë. Nuhata aromën e trupit të saj, ajo aromë me të cilën më kishte pritur zonja Robinson në trotuarin e stacionit të trenit të Kajros. U afrova pranë saj derisa ajo hetoi prezencën time. Rastësisht u kthye kah unë dhe buzëqeshi me një buzëqeshje, që nuk e kuptoja domethënien e saj, por unë vendosa që të mos e lëshoj këtë rast. Unë qesha po ashtu që të mos kthehet habia në fytyrën e saj në armiqësi dhe ajo buzëqeshi. Qëndrova pranë saj afër një çerek ore, qeshja kur atë e dispononte fjalimi i folësit, qeshja me zë të lartë që edhe ajo të qeshte, derisa erdhi momenti, ku ndjeva se unë dhe ajo ishim bërë si një kalë dhe pelë që vrapojnë në harmoni pranë njëri- tjetrit. Këtu

doli zëri nga fyti im, sikur të mos ishte zëri im: "Çka mendon për një pije, larg nga kjo tollovi dhe vapë?" E solli kokën e saj me habi. Kësaj radhe buzëqeshi me një buzëqeshje të gjerë të padjallëzuar që së paku ta kthejë habinë në dëshirë për vëzhgim. Gjatë kësaj shikova fytyrën e saj dhe vërejta se çdo shenj prej shenjave të saj më shtonte bindjen se ky ishte gjahu im. Nga përvoja ime e kumarxhiut hetova se ky ishte momenti vendimtar. Çdo send në këtë moment është i mundur. Buzëqeshja ime së shpejti u kthye në gëzim dhe për pak çdo gjë më doli prej dorësh kur ajo më tha: "Po, përse jo?" Ecëm së bashku, ndieja atë pranë meje bëj flakadan të bronztë nën rrezet përcëlluese të korrikut. Ndieja atë si një qytet fshehtësish dhe komoditeti. Ajo që më gëzoi ishte se ajo qeshte me lehtësi. Kjo zonjë, soji i tyre është i shumtë në Evropë. Gra që nuk dinë për frikë, ia mësyjnë jetës me gazmend dhe dashurisë për të vëzhguar. Unë jam shkretëtirë e etshme, labirint për shfryrjen e epsheve të çmendura. Kur ne ishim duke pirë çaj më pyeti për vendin tim. I tregova asaj në mënyrë të falsifikuar për shkretëtira me ranë të art dhe për xhungla në të cilat bërtasin shtazët që nuk ekzistojnë. I thashë se rrugët e kryeqytetit tim janë përlot elefantë dhe luaj, kurse në mesditë zvarriten krokodilët. Më dëgjonte me vëmendje, mes besueshmërisë dhe gënjeshtrës. Qeshte, i mbyllte sytë dhe i skuqeshin faqet e saj. Nga njëherë më dëgjonte në heshtje, në sytë e saj dukej keqardhja e krishterë. Erdhi momenti kur unë hetova se sipas mendimit të saj, unë isha kthyer në një krijesë primitive lakuriq, që me një dorë mban shigjetën dhe në tjetrën shtizën me të cilat gjuan elefantët dhe luajt në xhungël. Kjo është mirë. Kështu pra dëshira për vëzhgim ishte kthyer në një gazmend dhe ishte kthyer gazmendi në simpati. Kur ta lëvizi kënetën e qetë në thellësi do të kthehet simpatia në dëshirë në melodi në telat e shtrënguar ashtu siç dëshiroj unë. Më pyeti mua: "Çfarë nënshtetësie ke ti? A je ti afrikan apo aziatik"?

Ia ktheva: "Unë jam si Othello, arabo-afrikan".

Ma hodhi një shikim në fytyrë dhe më tha: "Po. Hunda jote është si hunda e arabëve në fotografi. Mirëpo, flokët tua nuk janë të zeza e të buta si flokët e arabëve".

"Po. Unë jam ky. Fytyra ime është arabe sikur shkretëtira e Saharas së madhe, kurse koka ime është afrikane që ka kaluar një fëmijëri të ligë."

Qeshi dhe më tha: "Ti po i përshkruan gjërat me një mënyrë të çuditshme".

Biseda na çoi te familja ime dhe i thash, pa e gënjyer kësaj radhe. Unë jam jetim dhe nuk kam prind. Pastaj iu ktheva gënjeshtrave duke ia përshkruar se si e kisha humbur babain tim, derisa vërejta se si rridhnin lotët prej syve të saj. I thashë se unë isha në moshën gjashtëvjeçare, kur babai im u fundos me tridhjetë persona të tjerë në një barkë që kalonte lumin Nil nga një breg në bregun tjetër. Këtu ndodhi diçka që ishte më i mirë se elegjia Elegjisë në këto rast nuk i dihet përfundimi i sigurt. Shkëlqyen sytë e saj dhe bërtiti sikur të ishte e dehur:

"Nili?"?

"Po , Nili".

"Ju pra banoni në brigjet e Nilit"?

"Po, shtëpia jonë është në breg të Nilit, sa që kur unë zgjohesha natën në shtratin tim, nxjerri dorën time në dritare dhe luaj me ujin e Nilit derisa të më marrë gjumi përsëri".

Shpendi, z. Mustafa ka rënë në kurth. Nili, ai zot gjarpër, fitoi edhe një viktimë të re. Qyteti u kthye në një grua. Nuk shkon më tepër se një ditë apo javë, derisa ta vendos tendën time dhe të vendos shtyllat në maje të kodrës. Ti o zonjë ndoshta nuk e di, por ti je si" karnarfon" kur hyri në varrin e Tot Ang Hamonit, mund të godet ndonjë sëmundje e pashërueshme nuk e di se nga të ka ardhur, do të marrë ty tash apo më vonë. Municioni im prej barsoletave nuk ka të mbaruar. Personi si unë e di si të veproj në raste të këtilla. Ndjeva se unë jam ai që po udhëheqja bisedën, si një artist i shkathët, andaj i thashë asaj: "Kaluan dy orë pa hetuar fare. Nuk kam ndjerë këtë lloj gëzimi qe një kohë të gjatë, ka mbetur edhe shumëçka të them unë ty dhe ti mua, çka mendon të shëtisim pak dhe ta vazhdojmë bisedën"?

Për një moment heshti, por nuk u shqetësova, sepse unë e ndjeva atë ngrohtësi djallëzore nën vellon e ndarjes, kur e ndjej këtë e kuptoj se unë i kam në dorë punët. Jo. Ajo nuk mund të thotë jo. Ajo tha:

"Ky është një takim i çuditshëm. Një njeri jabanxhi, të cilin nuk e njoh më fton mua. Kjo është e palejueshme. Por …" Heshti e pastaj vazhdoi: "Po. Përse jo? Pamja e jote tregon se ti nuk je prej atyre që hanë mish njeriu."

I thashë asaj dhe një valë gëzimi lëvizte nga brendia ime, thellësia e zemrës sime: "Do të bindesh se unë jam një krokodil i vjetër që i kanë rënë dhëmbët. Nuk do të mundem të ha edhe nëse dëshiroj ta bëj këtë." Paracaktova se unë isha më i vjetër se ajo së paku për pesëmbëdhjetë vjet. Ajo ishte grua në të dyzetat. Çfarëdo që t'i ketë ndodhur asaj, koha ka pasur sjellje të butë ndaj trupit të saj. Rrudhat e imëta në ballin e saj dhe skajet e gojës së saj nuk tregojnë se ajo është plakur, por është pjekur.

Vetëm atëherë e pyeta për emrin e saj dhe ajo më tha: "Izabela Simor." E përsërita dy herë dhe unë e shqiptoja me gojën plotë, sikur unë të haja një dardhë.

"Ti si quhesh?"

"Unë.. quhem Emin. Emin Hasan."

"Do të thërras Hasan."

Me mish të pjekur dhe me venë i çelen fijet e fytyrës së saj dhe shpërtheu vrulli i dashurisë që ndjente ndaj tërë botës dhe ndaj meje. Mua nuk më interesonte dashuria e saj ndaj botës as ajo re e pikëllimit që paraqitej herë pas here në fytyrën e saj aq sa më interesonte gjuha e saj e kuqe kur ajo qeshte, si dhe fshehtësitë e saj në thellësi të gojës së saj. E imagjinova atë lakuriq dhe shkova më larg duke më thënë: "Jeta është përplot dhembje, por ne duhet të jemi optimistë dhe ta ballafaqojmë jetën me guxim."

Po, unë e di se arritja e urtësisë është afër, ajo del nga goja e njerëzve të rëndomtë, ajo është e tërë shpresa e shpëtimit. Pema rritet ngadalë. Gjyshi yt jetoi dhe do të vdesë në mënyrë të rëndomtë. Këtu qëndron fshehtësia. Ashtu është zonjë, guximi dhe optimizmi. Mirëpo, derisa të vijnë në pushtet të vegjlit dhe të ikin ushtritë dhe të jetë i sigurt qengji pranë ujkut dhe të luajë fëmija top me krokodilin në lumë. Derisa të vijë koha e gëzimit dhe dashurisë, unë do të shprehem për veten time në këtë mënyrë të shtrembëruar. Kur të arrij në maje të

malit duke gulçuar dhe të vendos flamurin pastaj të marrë frymë dhe të pushoj – kjo zonja ime do të jetë gëzimi im më i madh sesa dashuria dhe lumturia. Për këtë unë nuk dua që ty të bëj ndonjë të keqe, vetëm në atë masë sa deti donë të jetë i dëmshëm kur përplasen anijet në gurët e tij, apo aq sa është e dëmshme reja kur e ndan drurin në dy pjesë. Mendimi im fundit ishte përqendruar në kokën time, me disa qime në krahun e saj të djathtë, aty pranë kyçit të dorës dhe vërejta se qimet e krahëve të saj ishin më të dendura se tek femrat tjera, kjo më çoi te qimet tjera. Patjetër ato janë të buta dhe të dendura sikur bimët e dendura pranë vijës së ujit. Sikur kaloi mendimi prej meje tek ajo, u drejtua në uljen e saj dhe tha: ”Çka ke më dukesh i pikëlluar”?

“A dukem i pikëlluar” Në të kundërtën, unë jam shumë i lumtur”.

Shikimi i saj i dashamirës u kthye në sytë e saj, e zgjati dorën, të cilën e kapa me dorën time dhe më tha: “A e di se nëna ime është spanjolle?”

“Kjo pra shpjegon çdo gjë. Shpjegon takimin tonë të rastit, mirëkuptimin tonë spontan, sikur na të njiheshim para disa shekujve. Patjetër se gjyshi im duhet të ketë qenë ushtar në ushtrinë e Tarik bin Zijadit, ai me siguri do të jetë takuar me gjyshen tënde, duke vjelë rrush në njërën prej kopshteve të Ishbilisë. Me siguri, ai do të ketë rënë në dashuri me të në shikimin e parë, po ashtu edhe ajo e ka dashur atë. Ka jetuar me të një kohë, pastaj e ka braktisur, ka shkuar në Afrikë dhe ti je prej pinjollëve të tij në Spanjë”.

“ Çfarë shejtani je ti”!

Për një çast imagjinova takimin e ushtarëve arabë në Spanjë. Të ngjashëm me takimin tim në këtë rast. Ulur para Izabela Simor. Një etje e çmendur është përhapur në fushat e historisë në veri. Unë nuk kërkoj lavdi, sepse njeriu sikur unë nuk kërkon lavdi.

E solla çelësin e shtëpisë pas një muaji djegie të dëshirës, ajo ishte pranë meje. Andaluzia është e begatshme, pastaj e çova nëpër një korridor të shkurtër në dhomën e fjetjes e dogji atë aroma e drusandalit të djegur, duke ia mbushur mushkëritë e saj me një parfum, të cilin nuk e dinte se ai do të ishte vrasës për të. Ato ditë isha në kulm, më kaplonte nganjëherë një qetësi tragjike. E tërë temperatura ishte e përqendruar në zemër, kurse tensioni në nerva, kthehej në qetësi kirurgjike kur ai priste barkun e të sëmurit. E dija se rruga e shkurtër nëpër të cilën shkuam së bashku te dhoma e fjetjes, për atë ishte një rrugë e shndritshme. Ajo simbolizonte rrugën e tolerancës dhe dashurisë, kurse për mua ishte hapi i fundit për ta arritur në kulmin e egoizmit. U ndala në skaj të shtratit, sikur unë po e rezymeja atë moment në mendjen time. I hodha një shikim objektiv perdeve me ngjyrë vjollce dhe pasqyrave të mëdha, dritave të shumta në të gjitha anët e dhomës, pastaj skulpturës së bronzit që ishte para meje. Ne ishim në kulmin e tragjedisë, bërtita me një zë të ulët: “Jo. Jo.” Kjo nuk të sjellë dobi tash. Ka humbur momenti i rrezikshëm kur ke pasur mundësi të marrësh hapin e parë. Unë të kam mashtruar. Atëherë ke pasur mundësi të thuash “:Jo.” Por, tash të ka marrë vala e ndodhive ashtu siç e merr çdo njeri. Dhe nuk ke mundësi të ndërmarrësh asnjë send. Sikur secili njeri ta dinte se kur nuk duhet ndërmarrë hapin e parë, do të kishin ndryshuar shumë gjëra. A është dielli i keq kur kthen zemrat e miliona njerëzve në shkretëtirë, rëna e së cilës lufton dhe dridhet në të fyti i bilbilit? U ndala dhe unë e fshija me shuplakën e dorës sime qafën e saj dhe e puthja në vendet e ndjeshme. Me çdo prekje, me çdo puthje, ndjeja se organet e trupit të saj çliroheshin. Fytyra e saj rrezatonte, sytë e saj shkëlqenin me një shkëlqim të shpejtë. Shikimet e saj u zgjaten sikur ajo më shihte mua si një hije e jo një realitet. E dëgjova duke më thënë me një zë lutës të dorëzuar: “Të dua ty.” Iu përgjigj zërit të saj me një thirrje e ulët nga thellësia e vetëdijes sime që më thërriste të qëndroj. Mirëpo, kulmi ishte një hap larg dhe pastaj mora frymë dhe pushova. Kur ne ishim në kulmin e dhembjes nëpër kokën time kaluan një mori kujtimesh të largëta, të vjetra sikur mjegulla që ngrihet nga një liqe i njelmët në mes të shkretëtirës. Ajo ia plasi një vaji pikëllues të zjarrtë, kurse unë iu dorëzova një gjumi të shqetësuar me temperaturë.

- vijon -

Tayeb Salih (Sudan)

SEASON OF MIGRATION TO THE NORTH (2)

(Summary)

It is a long story, but I will not tell it all. Some details may not be of great interest to you, whereas others… I was born in Khartoum. I grew as an orphan. My father died before I was born. Yet, he left us considerable wealth. He was a camel trader. I had no brothers. Thus, life was not that difficult for me and my mother. When I recall the past, I can recall her face - her thin lips. On her face she had something like a mask. I don't know. Her face resembled the surface of the sea. Do you understand? It had many colors. We had no relatives. She was like a stranger to me, we were like two people who were brought together by chance.

الطيب صالح

موسم الهجرة إلى الشمال (2)

(خلاصة البحث)

إنها قصة طويلة. لكنني لن أقول لك كل شيئ. و بعض التفاصيل لن تهمك كثيرا، و بعضها... المهم انني كما ترى ولدت في الخرطوم. نشأت يتيما، فقد مات أبي قبل أن أولد ببضعة أشهر، لكنه ترك لنا ما يستر الحال. كان يعمل في تجارة الجمال. لم يكن لي إخوة، فلم تكن الحياة عسيرة عَليَّ و على أمي، حين أرجع الآن بذاكرتي، أراها بوضوح، شفتاها الرقيقتان في حزم و على وجهها شئ مثل القناع. لا ادري. قناع كثيف، كأن وجهها صفحة بحر، هل تفهم، ليس له لون واحد بل الوان متعددة، تظهر و تغيب و تتمازج. لم يكن لنا أهل. كنا، أنا و هي، أهلا بعضنا لبعض.

BIBLIOGRAFI

Ramadan Shkodra

BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE TË MR. QEMAJL MORINËS 1971-2007

I
Hyrje

Lexues të nderuar!

Në këtë numër të revistës "Edukata Islame" sjellim para jush, Bibliografinë Kronologjike të punimeve të profesorit, gjurmuesi, studiuesit e analistit tonë të njohur mr. Qemajl Morina. Në këtë bibliografi kronologjike janë përfshirë punimet e prof. Morinës që për 36 vjet (1971-2007) janë botuar në shtypin e Kosovës si dhe shtypin që botohet në qendrat tjera shqiptare, atë të Tiranës e Shkupit etj.

Lexuesit tanë, tashmë janë të njohur me kontributet e Qemajl Morinës që nga vitet e 70 të shekullit të kaluar, kohë kjo kur Morina, si i ri - student në studime posdiplomike në Universitetin e Kajros nis punën e tij hulumtuese në arkivat e kryeqendrës së Egjiptit, ku hulumton dokumente të rëndësishme për shqiptarët e Egjiptit, ndërsa në shtypin e kohës respektivisht në të përditshëm "Rilindja" atë kohë botoi një sërë shkrimesh ku duhet veçuar ato për Mehmet Ali pashën, Lidhjen Shqiptare të Prizreni si dhe për koloninë shqiptare të Egjiptit etj.

Për këto 36 vjet të veprimtarisë shkencore të prof. Morinës, kontributi i tij është shumëdimensional dhe prek fusha nga më të ndryshmet, duke filluar nga puna e tij kërkimore në fushën e historisë për të vazhduar më vonë në fund të viteve të 80 të shekullit të shkuar me kontributin e prof. Morinës në shtypin e Bashkësisë Islame, ku sjell një frymë, filozofi, qasje e elan të ri, që nga angazhimi i tij në revistën "Dituria Islame" fillimisht si bashkëpunëtorë e më vonë si kryeredaktor i saj, për të vazhduar më vonë edhe në "Takvim" e "Edukata Islame", ku ka dhënë një kontribut të madh me tema të fushave të ndryshme, duken nisur nga gjurmimet, punimet profesione nga gjuha e letërsia arabe, por ajo që e bën më të njohur prof. Morinën e gjejmë në shtypin islam si opinionist dhe analist të fuqishëm ku me kohë ngrit çështje për diskutim dhe jep premisat se si duhet reflektuar.

Pos kësaj prof. Morinën viteve të fundit e gjejmë edhe si opinionist edhe në shtypin e përditshëm të Prishtinës, ku me analizat e komentet e tij ka bërë emër sidomos në opinionet e shprehura për islamin dhe për botën islame. Në këtë fushë, prof. Morina në punën e tij karakterizohet, për largpamësi, objektivitet, qasje reale dhe njohje substanciale të problemeve, me çka ka sjell një këndvështrim ndryshe nga opinionistët kosovarë, dhe njëherësh e ka bërë këtë një njeri të respektuar e me kredibiliet.

Mirëpo kontributi i prof. Morinës është edhe më i madh, ngase atë e gjejmë edhe autor e bashkautor të disa veprave të rëndësishme si dhe recensues e redaktor të një numri edhe më të madh.

Nga veprat e prof. Qemalj Morinës vlen që të cekët monografia "Hoxhë Kadri Prishtina mendimtar islam" botuar më 2002 ii dhe librin "Lidhja shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian" botuar më 2006, me të cilat i ka ven në dispozicion historiografisë shqiptare të dhënë deri tash të panjohura si për Hoxhë Kadiun ashtu për trajtimin dhe jehonën LSHP-it nga shtypi egjiptian.

Me këtë bibliografi lexuesit i paraqesim kontributin e prof. Morinës në mënyrë kronologjike.

Bibliografia ka 556 zëra bibliografik, të renditur në mënyrë kronologjike.

Renditja e zërave bibliografik është bërë ashtu siç janë botuar nëpër vite. Me qëllim të lehtësimit, brenda një viti kemi renditur kontributet e profesorit, fillimisht të një organi psh., në fillim janë dhënë të gjitha temat e botuara në revistën Edukata Islame, për të vazhduar me ato të Diturisë Islame e kështu me radhe.

Shpresojmë që kjo bibliografi do tu shërbej studiuesve për një njohje më të mirë me veprimtarinë dhe kontributin e tij në shumë sfera të kulturës sonë.

II
Biografi

Mr. Qemajl Morina, u lind më 03.01.1951, fshatin Hodonoc, të Kamenicës Kosovës.

Shkollën fillore e kreu në Hodonovc dhe Roganë, ndërsa Medresenë e Mesme "Alauddin" në Prishtinë 1970.

Në vitin 1970 u regjistrua në Fakultetin Filologjik, Dega e gjuhës dhe letërsisë arabe në Universitetin Islamik të Omdurmanit në Sudan, ku diplomim më 1976

Studimet pasuniversitare i regjistroi në Fakultetin e Filologjisë, degën e gjuhësisë në Universitetin e Kajros më 1976 dhe më 12 tetor 1979 mbrojti temën e magjistraturës me titull: "Studime kontrastive midis gjuhës arabe dhe gjuhës shqipe në lëmin e fonologjisë".

Ka bërë hulumtime në Londër respektivisht në Institutin për Studime Orientale gjatë periudhës (qershor-dhjetor 1978).

Ka përfaqësuar Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Fakultetin e Studimeve Islame në shumë vende të botës, si në Evropë, SHBA dhe vendet e Lindjes së Mesme.

Detyrat e ushtruara:

- Sekretar i ekipit medicinal në Bengazi të Libisë tetor 1980-tetor 1989;
- Udhëheqës i shtypit dhe veprimtarisë botuese pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë 1990-2007;

- Kryeredaktor i revistës mujore "Dituria Islame" tetor 1990-tetor 1996;
- Prodekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë prej vitit 1992;
- Kryeredaktor i revistës shkencore, kulturore islame "Edukata Islame" që botohet nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë;
- Ligjërues i gjuhës arabe pranë Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë;

Jeton në Hajvali është i martuar, baba i katër fëmijëve.

III
Bibliografi kronologjike
e Mr. Qemajl Morinës 1971-2007

1971

1. Poezi kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s. (Ditës së Mevludit), *Edukata Islame*[1] *nr. 1 fq. 32-34.*

1977

2. Letër prej Kajros: "Vizitë shkencore e frytshme dhe interesante", (Dr. Ali Dida mbajti ligjërata në Universitetin e Kajros), *Bota e Re*[2]*, qershor 1977, (fq. 10).*

[1] Edukata Islame, (në vazhdimi të tekstit E.I.), revistë tremujore, fillimisht është botuar nga Shoqata e Ulemeva të Kosovës, ndërsa nga viti 2001, botohet nga Kryesia e BI të Kosovës.

[2] Bota e Re, gazetë e studentëve të Universitetit të Prishtinës e viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar.

1979

3. Ç'thonë egjiptianët për Mehmet Ali Pashën?
   Rilindja[3] *3 mars 1979, fq. 25.*

4. Ushtria shqiptare e Misirit,
   Rilindja 05. maj 1979, fq.26.

5. E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët,
   Rilindja 19 maj 1979. fq.25.

6. Kreta vend strehimi për kryengritësit shqiptarë,
   Rilindja 26 maj 1979, fq. 26.

7. Një fole e shuar e kulturës shqiptare në Egjipt,
   Rilindja 9 qershor 1979, fq.25.

8. Jehona e Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian të kohës,
   Rilindja 30 qershor 1979, fq. 24

9. Ç'u tha Garibaldi të deleguarve shqiptarë?,
   Rilindja 14 korrik 1979, fq.20.

1981

10. Qëndrimi i shtypit arab ndaj Lidhjes së Prizrenit,
    (Konferenca Shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,
    (Referate dhe kumtesa të mbajtura në Seksionin e Historisë) (I), Prishtinë, 6-9 qershor 1978), Prishtinë, 1981, fq. 529-535.

1990

11. Bajram Kurbani-ngjarje kulminante,
    Dituria Islame[4] *nr. 15-16 korrik 1990 fq. 3-5.*

12. Një fole e shuar e kulturës shqiptare në Egjipt,
    D.I. nr.15-16, korrik 1990, fq. 24.

[3] Gazetë e vetme përditshme në gjuhën shqipe në Kosovë. Është botuar në Prishtinë prej vitit 1945 deri në fillim të vitit 1990, atëherë kur është ndaluar botimi i saj nga okupatori serb.

[4] Dituria Islame (në vazhdim vetëm D.I.), e përmuajshme organ i Kryesisë së BI të Kosovës.

13. Kush është prof. Rozhe Garodi?
    (përkthim nga arabishtja),
    D.I. nr. 17, gusht 1990, fq. 7-9.

14. Në Kosovë ndjeva afërsi njerëzore,
    (Intervistë me Ahmed Hajdush, prof. i kritikës letrare në Universitetitin Tizi-Uzu të Algjerisë),
    D.I. nr.17, gusht 1990, fq. 22.

15. Në Hamburg falen pesë kohët e namazit,
    (Intervistë me Zulhajrat Fejzullahun, imam dhe koordinator i xhamive shqiptare në Gjermani),
    D.I. nr. 17, gusht 1990, fq. 23-24.

16. Si e pranova Islamizmin?
    (përkthim),
    D.I. nr. 18, shtator 1990, 30-31.

17. Milicët rrahën dhe maltretuan hoxhën e Shipashnicës,
    D.I. nr.18, shtator 1990, fq. 43.

18. Vdekja e Isakut të vogël në Panoni,
    (Reportazh),
    D.I. nr. 18, shtator 1990, fq. 48.

19. Disa të dhëna arkivore mbi shqiptarët në Arkivin Kombëtar të Egjiptit në Kajro,
    D.I. nr. 18, shtator 1990, fq. 49.

20. Islami dhe paqja,
    D.I. nr. 19, nëntor 1990, fq. 4.

21. Riorganizimi që obligon,
    D.I. nr. 19, nëntor 1990, fq.4-5.

22. A do të ngritët minareje në Panoni?!
    (Intervistë me Fadil Muratin, imam i xhamisë në Novi Sad),
    D.I. nr. 20, dhjetor 1990, fq. 7-8.

23. Ajeti dhe kuptimi i tij,
    D.I. nr. 20, dhjetor 1990, fq. 38.

1991

24. Edhe Zoti është me durimtarët,
D.I. nr. 21, janar 1991, fq. 13-14.

25. Që njeriu të mos e humb vetveten!,
D.I. nr. 22-23, shkurt-mars 1991, fq. 7.

26. Domethënia e Isras dhe Mi'raxhit,
D.I. nr. 22-23, shkurt-mars 1991, fq. 22-23.

27. Edhe në Shqipëri arritën erërat e ndryshimeve,
D.I. nr. 22-23, shkurt-mars 1991, fq. 54-55.

28. Mirë se na erdhe muaj i bekuar!,
D.I. nr. ekskluziv për Ramazanin, prill 1991, fq. 3.

29. Agjërimi pastrim i shpirtit,
D.I. nr. ekskluziv për Ramazanin, prill 1991, fq. 7.

30. Ramazani-muaji i agjërimit,
D.I. nr. ekskluziv për Ramazanin, prill 1991, fq. 14.

31. Agjërimi i Ramazanit në vendet islame,
D.I. nr. ekskluziv për Ramazanin, prill 1991, fq. 29-34.

32. Kopshti i diturisë
(përgatitur dhe përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 24, prill 1991, fq. 28-29.

33. Nëse nuk i kthehemi Islamit do të kthehemi në refugjatë?!
(Intervistë e huazuar me dijetarin e madh islam Muhamed el-Gazalin (përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 24, prill 1991, fq. 33-36.

34. Mendime të dijetarëve eminentë botëror për Muhammedin a.s.,
D.I. nr. 25, maj 1991, fq. 24.

35. Kopshti i diturisë
(përgatitur dhe përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 25, maj 1991, fq. 26-27.

36. Haxhi kongres i përgjithshëm islam,
D.I. nr. 26, qershor 1991, fq. 3.

37. Shqipëria i kthehet fesë,
D.I. nr. 26, qershor 1991, fq. 8-10.

38. Çështja shqiptare në shtypin arab (I),
D.I. nr. 26, qershor 1991, fq. 20-23.

39. Islami jeton në zemrat e popullit shqiptar
(Si u festua dita e Bajramit në Tiranë?),
D.I. nr. 26, qershor 1991, fq. 57-59.

40. Kuptimet e hixhretit,
D.I. nr. 27, korrik, 1991, fq. 3.

41. Abdurrahman Taxhuddin, Hixhreti,
(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 27, korrik, 1991, fq. 15-17.

42. E vramë frikën mos ta vrasim shpresën,
(Intervistë me Valdete Sala, drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë),
D.I. nr. 27, korrik 1991, fq.21-23.

43. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Aktivitetet e Lidhjes Shqiptare), (II),
D.I. nr. 27, korrik 1991, fq. 39-42.

44. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Turqia lufton Lidhjen Shqiptare), (III),
D.I. nr. 28, shtator 1991, fq. 43-46.

45. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Lidhja e Prizrenit mbron tokat shqiptare), (IV),
D.I. nr. 29, shtator 1991, fq. 36-38.

46. Kur rrente mbreti, rrente mileti,
(Bisedë me Hafëz efq. Hajrudin Delli-myfti i Vlorës),
D.I. nr. 29, shtator 1991, fq. 46.

47. Nëse shkon në xhami do të varrim në minare!,
D.I. nr. 29, shtator 1991, fq. 47.

48. Kthimi në pikën e fillimit,
D.I. nr. 30-31, tetor-nëntor 1991, fq. 3.

49. Salah Ahmed Et-tenuhi, Misioni i Muhamedit a.s. feja e të gjithë pejgamberëve

(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 3-31, shtator-tetor 1991, fq. 15.

50. Sami Dijab, Sikur të kish bashkëjetuar me ty o Pejgamber i Zotit!,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 30-31, shtator-tetor 1991, fq.40-41.

51. Mustafa Ed-divani, Momentete e fundit të jetës së Pejgamberit a.s.,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr.30-31, shtator-tetor 1991, fq. 40-41.

52. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Lidhja Shqiptare mbron Hot e Grudë), (V),
D.I. nr. 30-31, tetor 1991, fq. 61-66.

53. Islami fe e natyrshme,
D.I. nr. 32, dhjetor 1991, fq. 3.

54. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Mbrojtja e Ulqinit), (VI),
D.I. nr. 32, dhjetor 1991, fq. 43-49.

55. Shqipëria po i kthehet fesë,
(botim special),
Hëna e Re[5] qershor 1991, (fq..4-5).

56. Erdhi e vërteta u zhduk gënjeshtra
(reportazh),
H.R. qershor 1991, (fq. 20-21).

[5] Hëna e Re (në vazhdim H.R.) e përmuajshme, organ i Bashkësisë Islame të Maqedonisë

1992

56. Husejn Munis, Frytet e XIV shekujve nën hijen misionit të Muhamedit a.s. (përkthim),
Takvimi[6] 1412/13, Kalendari 1992, (fq. 41-55).

57. Feja domosdoshmëri e jetës dhe e mëkëmbjes së shoqërisë,
D.I. nr. 33, janar 1992, (fq. 3).

58. H. Chapman, Shqipëria kërkon identitetin e saj islam
(Përkthyer nga anglishtja),
D.I. nr. 33, janar 1992, fq. 25.

59. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Dorëzimi i Ulqinit), (VII),
D.I. nr. 33, janar 1992, fq. 40-44.

60. Si ta respektojmë fjalën e shkruar?!
D.I. nr. 34, shkurt, 1992, fq. 3.

61. Patjetër duhet hapur derën e ixhtihadit në Islam!,
(Bisedë e përkthyer nga arabishtja me mendimtarin islam Fuad Sizkin),
D.I. nr. 34, shkurt 1992, fq. 23-24.

62. Çështja shqiptare në shtypin arab (Lidhje Shqiptare mbron viset jugore), (VIII),
D.I. nr. 34, shkurt 1992, fq. 32-34.

63. Si duhet të jetë Ramazani ndër ne?,
D.I. nr. 35, mars 1992, fq. 4.

64. Izuddin Belik, Ramazani muaji i Kur'anit
(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 35, mars 1992, fq. 8-10.

65. Ebul Hasen Ali En-nedevi, Agjërimi në fetë tjera,
(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 35, mars 1992, fq. 13-14.

66. Çështja shqiptare në shtypin arab
(Konferenca e Berlinit),
D.I. nr. 35, mars 1992, fq. 35-36.

[6] Takvimi, Publikim vjetor, organ i Kryesisë së BI të Kosovës

67. Porosia e Ramazanit,
D.I. nr.36, prill 1992, fq. 3.

68. Çka pas Ramazanit?!,
D.I. nr. 36, prill 1992, fq. 9-10.

69. Qëndruam të fortë kundër stuhisë komuniste
(Intervistë me H. Sherif Ahmetin, doajenin e publicistikës islame në Kosovë),
D.I. nr. 36, prill 1992, fq. 11-14).

70. Ta respektojmë të kaluarën tonë!,
D.I. nr. 37, maj 1992, fq. 3.

71. Xhamia në shërbim të popullit,
(Intervistë me Mulla Jakup ef. Muhamedin, imam në xhaminë e Minhenit në Gjermani),
D.I. nr. 37, maj 1992, fq.17-18.

72. Vetëm me punë mund të kalohen vështirësitë
(Reportazh nga një vizitë në disa qendra islame shqiptare në Evropë),
D.I. nr. 37, maj 1992, fq. 31-34.

73. Islami e inspiroi ta dojë gjuhën dhe kombin,
D.I. nr. 38, qershor 1992, fq. 33.

74. Muhamed Muhamedejn, Islami është ilaç për të gjitha sëmundjet e shekullit të pasindustrializmit,
(Intervistë e përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 39, korrik 1992, fq. 28-29.

75. Terrori serb mbi myslimanët nuk ka të ndalur,
D.I. nr. 40, gusht 1992, fq. 2.

76. Abdullah Muhamed, Ndalimi i ofendimit të njerëzve dhe sjellja e mirë ndaj tyre,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 40, gusht 1992, fq.7.

77. Pa fe nuk ka atdhe,
(Intervistë me hafiz Ibrahim Jaldyn, imam në njërën prej xhamive kryesore të komunitetit turk në Bruksel),
D.I. nr. 40, gusht, 1992, fq.10-11.

78. Bota Islame dhe lufta në Bosnjë,
D.I. nr. 41, shtator 1992, fq. 2.

79. Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut,
D.I. nr. 41, shtator 1992, fq. 5.

80. Domethënia e fjalës së dëshmisë,
(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 41, shtator 1992, fq. 6.

81. Osmanlinjtë nuk ia imponuan gjuhën as fenë e tyre popujve të Ballkanit,
(Intervistë e huazuar me shefin e katedrës së historisë në Fakultetin teologjik të Universitetit të Marmarasë, Ali bin Maksud),
D.I. nr. 41, shtator 1992, fq. 24-25.

82. Nismë e mbarë që duhet të bëhet traditë!,
D.I. nr. 42, tetor 1992, fq. 3.

83. Tetëdhjetë vjetori i pavarësisë,
D.I. nr. 43, nëntor 1992, fq. 3.

84. Gjenocidi serb mbi myslimanët e Bosnjës-dhunimi i vajzave dhe grave myslimane,
D.I. nr, 43, nëntor, 1992, fq. 32.

85. Nuk kursehen as krerët fetarë,
D.I. nr. 44, dhjetor 1992, fq. 3.

86. Turpi i Evropës!,
D.I. nr. 44, dhjetor 1992, fq. 6-7.

87. Pse u bëra mysliman?
(Intervistë e huazuar me ish-priftin e konvertuar në Islam Ibrahim Halil Filips",
D.I. nr. 44, dhjetor 1992, fq. 25-27.

88. Nimat Fauad, El-Az'hari dhe mendimi islam: Xhami dhe Universitet,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 44, dhjetor 1992, fq. 3.

1993

89. Abdurrahaman En-Nexhar, Feja në peshojën e jetës
(përkthim),
Takvimi 1413/14, Kalendari 1993, fq. 8-18.

90. Mbrojtja e shtëpisë është obligim,
D.I. nr. 45, janar 1993, fq. 3.

91. Mirësia dhe mëkati,
D.I. nr. 45. janar 1993, fq. 7.

92. Hasen Doh, Rruga e Kur'anit (I),
(fejton i përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 45, janar 1993, fq. 8-13.

93. Rëndësia e informimit në islam,
D.I. nr, 46, shkurt 1993, fq. 4.

94. Hasen Doh, Si u tubua Kur'ani?(II),
(fejton i përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 46, shkurt 1993, fq. 15-18.

95. Lamtumirë muaj i mëshirës!,
D.I. nr. 47, mars 1993, fq. 3.

96. Hasen Doh, Ç'është fshehtësia e këtyre shkronjave?!, (III),
(fejton i përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 47, mars 1993, (fq.11-14).

97. Njeriu nuk ka arsye të jetë kryelartë…!,
(Intervistë e huazuar),
D.I. nr. 47, mars 1993, fq. 15-19.

98. Fjala e hyrjes,
D.I. nr. 48, prill 1993, fq. 3.

99. Hasen Doh, Shkaqet e zbritjes së ajeteve të Kur'anit, (IV),
(fejton i përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 48, prill 1993, fq. 9-12.

100. Rrugë të mbarë mysafirë të Mëshiruesit!,
D.I. nr. 49, maj 1993, fq. 3.

101. Hasen Doh, Fjala e Allahut dhe fjala e Pejgamberit, (V),
(fejton i përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 49, prill 1993, fq. 9-12.

102. Numri i 50-jubilar,
D.I. nr. 50, maj 1993, fq. 3.

103. Fshehtësia e madhështisë,
D.I. nr. 51, gusht-shtator 1993, fq. 3.

104. Ta ruajmë identitetin tonë,
D.I. nr. 51, gusht-shtator 1993, fq. 4.

105. Bosnja-viktimë e indolencës së perëndimit,
D.I. nr. 51, gusht-shtator 1993, fq. 19-25.

106. T'i kthehemi mësimeve të Kur'anit,
D.I. nr. 52, tetor 1993, fq. 3.

107. Abdul Halim Mahmud, Besimi dhe rilindja islame,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr. 52, tetor 1993, fq. 4.

108. Beogradi gjatë periudhës islame,
(përkthyer nga arabishtja),
D.I. nr.52, tetor 1993, fq. 36.

109. Refugjatët shqiptarë dhe kishat,
D.I. nr. 53, nëntor-dhjetor 1993, fq. 3.

110. Çdo ajet i Kur'anit më inspiron
(Intervistë e huazuar me myslimanin e parë që fitoi çmimit
Nobel për fizikë, dr. Abdus-selam me origjinë nga Pakistani)
D.I. nr. 53, nëntor -dhjetor 1993, fq. 18-20.

1994

111. Integrimi i myslimanëve-imperativ kuranor,
D.I. nr. 54, janar 1994, fq. 3.

112. Muhamed Muteveli Esh-sha'ravi, Mëshirë për mbarë njerëzimin (I), (përkthim),
D.I. nr. 54, janar 1994, fq. 8-11.

113. Kush po i frikësohet Islamizmit?,
D.I. nr 55, shkurt 1994, fq. 4.

114. Muhamed Muteveli Esh-sha'ravi, Mrekullia e Kur'anit (II), (përkthim),
D.I. nr. 55, janar 1994, fq. 9-14.

115. Disa rregulla të agjërimit,
(përgatitur),
D.I. nr. 55, shkurt 1994, fq. 26-27.

116. Trembëdhjetë shekuj lashtësi,
(përgatitur),
D.I. nr. 55, shkurt 1994, fq. 35.

117. Duke e pritur bajramin!,
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 3.

118. Masakra në xhami,
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 4.

119. Muhamed Mutvelei Esh-sha'ravi, Nata e Kadrit (III),
(përkthim),
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 9-14.

120. Palestina-pikësynim i kahershëm i hebrenjve,
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 25-27.

121. Çka piqet nuk hiqet
(reagim ndaj Bujkut"),
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 31.

122. A duhet të agjërojnë fëmijët?,
D.I. nr. 56, mars 1994, fq. 32.

123. Bosna-Endulus i ri,
D.I. nr. 57, prill 1994, fq. 3.

124. Kujt po i pengon Islamizmi?,
D.I. nr. 57, prill 1994, fq. 4.

125. Muhamed Muteveli Esha-sha'ravi, Kur'ani dhe shkenca (IV), (përkthim),
D.I. nr. 57, prill 1994, fq. 5-11.

126. Muhamed Muteveli Esh-sha'ravi, Për madhështinë e Kur'anit dëshmuan edhe jobesimtarët (V),
D.I. nr. 58, maj 1994, fq. 7-13.

127. Hixhreti-refuzim i realitetit të hidhur,
D.I. nr. 59, qershor-korrik 1994, fq. 3.

128. Në Bosnjë po përsëritet inkuizicioni i Endulusit,
(Intervistë me haxhi Ismet ef. Spahiqin, zëvendës i reis-uelemas në Bosnjë e Hercegovinë gjatë qëndrimit në Haxh),
D.I. nr. 59, qershor-korrik 1994, fq. 20-26.

129. Si ta festojmë ditëlindjen e Pejgamberit a.s.?,
D.I. nr. 60, gusht 1994, fq. 3.

130. Turqia kërkon identitetin e saj,
D.I. nr. 60, gusht 1994, fq. 4.

131. Diplomacia në dritën e mesazheve të Pejgamberit a.s.,
D.I. nr. 60, gusht 1994, fq. 5-12.

132. Idriz Hajrullahu (alias Mulla Idriz Gjilani bash vaiz),
Lindja e Pejgamberi
(përkthim),
D.I. nr. 60, gusht 1994, fq. 13-14.

133. Vizitë që hap shtigjet e bashkëpunimit
(reportazh nga vizita në Turqi),
D.I. nr. 60, gusht 1994, fq.37.

134. Perëndimi dhe bota islame,
D.I. nr. 61, shtator 1994, fq. 3.

135. Kur'ani ashtu si e sheh një shkencëtar i perëndimit
(Intervistë e huazuar),
D.I. nr. 61, shtator 1994, fq. 5-7.

136. Shqiptarët duhet t'i kthehen vlerave të tyre shpirtërore!,
(Intervistë me Muhamed Uruçin në Stamboll),
D.I. nr. 61, shtator 1994, fq. 11-14.

137. Ndërmjet Mekes dhe Ulqinit
(reagim),
D.I. nr. 61, shtator 1994, fq. 34.

138. Kushtetuta e re-obligim për synime të reja,
D.I. nr. 62, tetor 1994, fq. 3.

139. Shqiptarët ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit,
D.I. nr. 62, tetor 1994, f. 4-5.

140. Përse Mojra bëhet Bushra?
(përkthim),
D.I. nr. 62, tetor 1994, fq. 21.

141. Allahu është me optimistët
(përkthim),
D.I. nr. 62, tetor 1994, fq. 22.

142. Edhe një kryqëzatë e re kundër myslimanëve,
D.I. nr.63, nëntor-dhjetor 1994, fq. 3.

143. Feja në faqet e shtypit tonë,
D.I. nr. 63, nëntor-dhjetor 1994, fq. 4-5.

144. Shqiptarët e paguan shtrenjtë përkatësinë e tyre islame,
(Intervistë me Nexhmdein Shenoxhak, arsimtar në Imam hatib-lisesi në Brusë),
D.I. nr. 63, nëntor-dhjetor 1994, (fq. 18-22).

145. Muhamed Abdullah Anan, Xhamitë në rolin e universitetit dhe roli i tyre në themelimin e civilizimit islam,
(përkthim),
D.I. nr. 63, nëntor-dhjetor 1994, fq. 30-32.

1995

146. Feja nuk është gëzof që mund të ndërrohet për ditë,
(Feja, shqiptarët dhe Evropa),
Drita Gjilan 1995.

147. Feja Islame dhe shqiptarët,
Takvimi 1415/16 - Kalendari 1995, fq. 63-78.

148. Feja shqiptarët dhe Evropa,
D.I. nr. 57, 1995, fq. 17-27.

149. Të zgjohet ndërgjegjja e njerëzimit,
D.I. nr. 64, janar 1995, fq. 3.

150. Granada-plagë e pashëruar në zemrat e myslimanëve
(përgatitur),
D.I. nr. 64, janar 1995, fq. 28-31.

151. Lufta në Bosnjë-vazhdimësi e luftërave të kryqëzatave,
D.I. nr. 65, shkurt 1995, fq. 4-6.

152. Qëndrimi i një ushtari mysliman më mësoi më shumë se dhjetë vjet studime në Sorbonë!,
(Intervistë e huazuar me Rozhe Garodin, filozof francez që pranoi Islamin),
D.I. nr. 65, shkurt 1995, fq. 21-23.

153. Eksodi dhe përgjegjësia,
D.I. nr. 66, mars 1995, fq. 3.

154. Dialogu ndërmjet civilizimeve,
D.I. nr. 66, mars 1995, (fq. 4-5).

155. Idriz Hajrullahu, (alias Mulla Idriz Gjilan, Bash vaiz),
Vëllazëria islame,
(përkthim nga boshnjakishtja),
D.I. nr. 66, mars 1995, (fq. 30-32).

156. Sihariqi" i "Bujkut" me rastin e Kurban-Bajramit,
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 3.

157. Ringjallja e fesë në Shqipëri,
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 4-5.

158. Kudo mund të ndodhin përçarje, vetëm në Shqipëri jo!,
(Intervistë me Hafiz Sabri Koçin, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë),
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 14-18.

159. Ta shtojmë dashurinë mes nesh!,
(Intervistë me Pater Zef Pëllumbin, kryetar i Kuvendi Françeskan në Shqipëri),
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, (fq. 21-23).

160. Xhihadi islam-fundamentalizëm apo luftë për mbrojtjen e identitetit,
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 24-25.

161. Bashkimi Kombëtar është për integrimin e shqiptarëve në Evropë (1),
(Intervistë me Abdi Baleten, deputet i Parlamentit të Shqipërisë),
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 26-31.

162. Me bashkëpunim të ndërsjellë mund të tejkalohen mosmarrëveshjet,
D.I. nr. 67-68, prill-maj 1995, fq. 43.

163. Me censurë nuk shkohet përpara!,
D.I. nr. 69, qershor 1995, fq. 30.

164. Shqipëria ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, (2),
(vazhdim i intervistës me Abdi Baleten),
D.I. nr. 69, qershor 1995, fq. 12-17.

165. Shkodra ka traditë për tolerancë fetare,
(Intervistë me myftiun e Shkodrës, z. Faik Hoxhen),
D.I. nr. 69, qershor 1995, fq. 22-24.

166. Rinia po i kthehet fesë me zemër e me shpirt të hapur,
(Intervistë me myftiun e Kavajës, Muhamed Hoxhen),
D.I. nr. 69, qershor 1995, fq. 2-47.

167. Intelektualët dhe vlerat tona shpirtërore,
D.I. nr. 70, korrik 1995, fq. 3.

168. Evropa po vdes në Bosnjë,
D.I. nr. 70, korrik 1995, fq. 4-5.

169. Kujt po i pengojnë librezat e bashkësisë Islame?,
D.I. nr. 71, gusht 1995, fq. 30.

170. F. El-Tabehan, Roli i edukimit fetar në formimin e personalitetit,
(përkthim),
D.I. nr. 71, gusht 1995, fq. 6-9.

171. Vendosmëria e një populli,
D.I. nr. 72, shtator 1995, fq. 30.

172. Komploti i madh,
D.I. nr.72, shtator 1995, fq. 4-6.

173. Kultura islame pjesë e identitetit tonë kombëtar,
(Intervistë me kryetarin e Shoqatës së intelektualëve shqiptarë myslimanë në Tiranë, prof. Dr. Shyqri Bylykun),
D.I. nr. 72, shtator 1995, (fq. 2 -51).

174. Zëri i arsyes nga Perëndimi,
D.I. nr. 73, tetor 1995, fq. 3.

175. Ardhmëria e njerëzimit në islamizëm,
(Intervistë e huazuar me mendimtarin islam Dr. Rushdi Fekkar),
D.I. nr. 73, tetor 1995, fq. 12-15.

176. Shkodra me xhami të re
(reportazh),
D.I. nr. 73, tetor 1995, fq. 52.

177. Kush po mbjell farën e përçarjes fetare?!,
D.I. nr. 74, nëntor 1995, fq. 3.

178. Myslimanët në Evropë gjatë Mesjetës
(recension),
D.I. nr. 74, nëntor 1995, fq. 46-49.

179. A dëshirojmë të kemi shtyp islam?!,
D.I. nr.75, dhjetor 1995, fq. 3.

180. Përgjegjësia e Bashkësisë Islame ndaj mërgimtarëve tanë,
D.I. nr. 65, dhjetor 1995, fq.4-5.

181. Mbi të gjitha kemi një Zot!,
(Intervistë me z. Nik Prelën-Ipeshkëv në Ipeshkvin Shkup-Prizren),
D.I. nr. 75, dhjetor 1995, fq. 15-19.

182. Abdullah Anan, El-Hamijado-gjuha e fshehtë e maurëve
(përkthim nga arabishtja),
D.I. nr. 75, dhjetor 1995, fq. 33-37.

183. E vërteta dhe paragjykimet për Islamin në botë dhe ndër shqiptarët,.(kumtesë)
(Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (simpozium ndërkombëtar),
Prishtinë 1995, fq. 29-39.

184. Kur ngatërrohen faktet
(reagim ndaj në shkrimi të Beqir Musliut),
Shkëndija[7] nr. 3. viti XXV, mars 1995, fq.12.

185. Toleranca fetare gur themeltar kombëtar,
(Intervistë me rastin e një takimi ndërfetar në Veronë të Italisë),
Bujku[8] 19 maj 1995, fq. 4.

1996

186. Turqia po i kthehet identitetit të saj,
D.I. nr. 76, janar 1996, fq. 4-5.

187. Sherif El-Idrisi mësues i Evropës në gjeografi,
D.I. nr. 76, janar 1996, fq. 31-33.

188. Nostalgjikët e ateizmit,
D.I. nr.77, shkurt 1996, fq. 3.

189. Këshilla e Fitër-Bajramit,
(përgatitur),
D.I. nr. 77, shkurt 1996, fq. 6-8.

190. Shtypi islam, problemet me të cilat ballafaqohet, islamizmi objekt sulmi në shtypin tonë
D.I. nr. 77, shkurt 1996, fq. 37-40.

[7] Shkëndija,revistë pedagogjike arsimore dhe shoqërore, Prishtinë.

[8] Bujku gazetë e përditshme për fshat është botuar në Prishtinë. Pas ndalimit të Rilindjes e ka zëvendësuar atë si gazetë e përditshme gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

191. Kujt i pengon Unioni Demokratik Islam?!,
D.I. nr. 78, mars 1996, fq. 3.

192. Terrorizmi" dhe "Fundamentalizmi,
D.I. nr. 78, mars 1996, fq. 4-6.

193. Gressy Morrison, Shkenca të çon në besim (1),
(përkthim),
D.I. nr. 78, mars 1996, fq. 10-13.

194. Gjenocid, indolenca dhe vetëflijimi,
D.I. nr. 78, mars 1996, fq. 26-30.

195. Njeriu i mirë nuk vdes (Nik Prela: 1918-1996),
D.I. nr.78, mars 1996, fq. 50.

196. Feja dhe intelektualët,
D.I. nr. 79, prill 1996, fq. 4-5).

197. Gressy Morrison, Shkenca të çon në besim (2),
(përkthim),
D.I. nr.79, prill 1996, fq. 17-18.

198. Këshilla e Kurban-Bajramit,
D.I. nr. 79, prill 1996, fq. 25-27.

199. Abdul Fethi Hixhazi, Kosova nëpër shekuj (përkthim),
D.I. nr. 79, prill 1996, fq. 2-51.

200. Kush është i sëmurë?!,
D.I. nr. 80, maj 1996, fq. 3.

201. Kush përfiton nga përçarja e Bashkësisë islame?,
D.I. nr. 80, maj 1996, fq. 28.

202. Medreseja e "Isa Beut"-qendra më e vjetër e arsimit në Ballkan",
(Intervistë me z. Bahri Aliun, drejtorin e Medresesë së Mesme "Isa Beu" në Shkup),
D.I. nr. 80, maj 1996, fq. 29-31.

203. Gressy Morrison, Shkenca të çon në besim (3),
(përkthim),
D.I. nr. 80, maj 1996, fq. 45.

204. Drita e "Diturisë Islame",
D.I. nr. 81-82, qershor-korrik 1996, fq. 3.

205. Ardhmëria e lëvizjeve islame,
D.I. nr. 81-82, qershor-korrik 1996, fq. 4 -8).

206. Gresssy Morrison, Shkenca të çon në besim (4),
(përkthim),
D.I. nr. 81-82, qershor-korrik 1996, fq. 17.

207. Ta ndryshojmë botëkuptimin e njerëzve tanë ndaj fesë,
(Intervistë me H. Sulejman ef. Rexhepin - reisul-ulema i Bashkësisë Islame të Maqedonisë),
D.I. nr. 81-82, qershor-korrik 1996, fq.30-32.

208. Uzurpatori i vakëfit,
D.I. nr. 83, gusht 1996, fq. 3.

209. Kush kë po e terrorizon?!,
D.I. nr. 83, gusht 1996, fq. 4-7.

210. Gressy Morrison, Shkenca të çon në besim (5),
(përkthim),
D.I. nr. 83, gusht 1996, fq. 18-19.

211. Kultura e shkrimit fetar te ne në fazën fillestare,
(Intervistë me z. Ismail Bardhin, kryetar i Këshillit Botues të Shtëpisë Botues e "Logos-a", Shkup),
D.I. nr. 83, gusht 1996, fq. 29-31.

212. Në vend të përshëndetjes,
D.I. nr. 84, shtator 1996, fq. 3.

213. Islamizimi i Evropës dhe evropianizimi i myslimanëve,
D.I. nr. 84, shtator 1996, fq. 4-7.

214. "Islami-besim dhe fuqi",
(Intervistë e huazuar me Roxher Hardin, komentator i BBC-së për çështje islame),
D.I. nr. 84, shtator 1996, fq. 12-16.

215. Gressy Morrison, Shkenca të çon në besim (6),
(përkthim),
D.I. nr. 84, shtator 1996, fq. 28-30.

216. Kudsi-amanet i mbarë myslimanëve,
D.I. nr. 85, tetor-nëntor 1996, fq. 8-11.

217. Qëndrimi i një ushtari mysliman më mësoi më shumë se dhjetë vjet studime në Sorbonë,
(Intervistë e huazuar),
Thirrja Islame[9] nr. 8, mars 1996, (fq. 15-16.)

1997

218. E vërteta dhe paragjykimet për islamin në botë dhe ndër shqiptarët,
(Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët), Shkodër 1997.

219. Dialogu ndërfetar islamo-krishter ndërmjet teorisë dhe realitetit,
D.I. nr. 61-62/1997, fq. 19-30.

220. Idetë islame të Hoxhë Kadri Prishtinës në revistën "Udha e s'vërtetës" (1),
D.I. nr. 87, janar 1997, fq. 21-26.

221. Idetë islame të Hoxhë Kadr Prishtinës në revistën "Udha e s'vërtetës" (2),
D.I. nr. 88, shkurt 1997, fq. 18-20.

222. Çeçenia - dyqind vjet luftë për liri,
D.I nr. 89, mars 1997, fq. 12-16.

223. Idetë Islame të Hoxhë Kadri Prishtinës në revistën "Udhe e s'vërtetës" (3),
D.I. nr. 89, mars 1997, fq. 20-22.

224. Kur Kur'ani ribotohet për biznes?!
(reagim),
D.I. nr. 89, mars 1997, fq. 45.

225. Idetë islame të Hoxhë Kadri Prishtinës në revistën "Udhe e s'vërtetës", (4),
D.I. nr. 90, prill 1997, fq. 19-20.

226. Idetë Islae të Hoxhë Kadr Prishtinës në revistën "Udhe e s'vëretës" (5),
D.I. nr. 90-91, maj-qershor 1997, fq. 17-18.

[9] Revistë e Komunitetit Mysliman të Amerikës dhe Kanadasë, botohet në Nju-Jork.

227. Kë pengoi vizita e z. Michaell Mekllellen në disa kështilla të Bashkësisë Islame?! (reagim),
D.I. nr. 90-91, maj-qershor 1997, fq. 38-39.

228. Idetë islame të Hoxhë Kadri Prishtinës në revistën "Udhe e s'vërtetës", (6),
D.I. nr. 93, korrik 1997, fq. 23-25.

229. Nga e kaluar mbeti vetëm gjuha gjermane
(Intervistë me Hubert Fisher (alias Mahmud Fisher), nga Bazeli i Zvicrës),
D.I. nr. 94-95 gusht-shtator 1997, fq. 20-22.

230. Idetë islame të Hoxhë Kadri Prishtinës në revistën "Udhe e s'vërtetës" (7),
D.I. nr. 94-95, gusht-shtator 1997, fq. 25-31.

231. Me besim në Zotin dhe në vetveten
(Intervistë me hirësinë e tij Leka Zogu i Parë, mbret i shqiptarëve),
D.I. nr. 96, tetor 1997, fq.12-15.

232. Islami dhe Perëndimi,
D.I. nr. 96, tetor 1997, fq. 40-42.

233. Shqiptarët popull i vogël, por trim!,
D.I. nr. 98, dhjetor 1997, fq. 24-26.

1998

234. Mbi fenë, atdheun dhe kombin,
Takvimi 1418/19-Kalendari 1998, fq. 25-48.

235. Islami fe e arsye,
Takvimi 1418/19-Kalendari 1998, fq. 152-154.

236. Kryqëzata serbe në Kosovë!,
E.I. nr. 63-64/1998, fq. 27-30.

237. Kur vdes alimi me rastin e vdekjes së Mulla Sherif Ahmetit (1920-1998),
E.I. Nr. 63-64/1998, fq. 135-141.

238. Shqiptarët e Turqisë një mbështetje e fuqishme e kauzës kombëtare,
(Intervistë me Nijazi Sulçen-poet dhe shkrimtar nga Peja që jeton dhe vepron në Ankara të Turqisë),
D.I. nr. 99, janar 1998, fq. 42-45.

239. Islami është pasuria jonë më e madhe!,
(nga seminari islamik evropian në Vaimar të Gjermanisë)!,
D.I. nr. 99, janar 1998, fq. 48-49.

240. Taha Toros, Sami Frashri-enciklopedist dhe leksikograf (01.06.1850-01.06.1905), (përkthim nga anglishtja),
D.I. nr. 100, shkurt 1998, fq. 2-99.

241. Besnike dhe konsekuente e traditës islame!,
D.I. nr.100, shkurt 1998, fq. 6.

242. Kush po e prish përpjesëtimin fetar?,
D.I. nr. 100, shkurt 1998, fq. 42-45.

243. Rilindja e islamit do të vijë nga Perëndimi!,
(Intervistë me dr. Murad Hofman, ish-ambasador i Gjermanisë, i cili para dy decenieve pranoi Islamin),
D.I. nr. 100, shkurt, 1998, fq. 75-79.

244. Drenica-Kurban i lirisë,
D.I. nr. 101, mars 1998, fq. 4-5.

245. Kosova ndërmjet luftës dhe bisedimeve,
D.I. nr. 102-103, maj-qershor 1998, fq. 4-5.

246. Çështja e Kosovës në shtypin amerikan,
D.I. nr.102-103, maj-qershor 1998, fq. 67.

247. Bashkim e jo përçarje,
D.I. nr. 104, korrik-shtator 1998, fq. 3.

248. Kosova ndërmjet terrorizmit serb dhe indiferencës së Perëndimit
D.I. nr. 104, korrik-shtator 1998, fq. 4-6).

249. Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve,
(recension),
D.I. nr. 104, korrik-shtator 1998, fq. 79-81.

250. A ka feja ndikim në konfliktin kosovar?!
D.I. nr.105-106, tetor-nëntor 1998, fq. 4-6.

251. Kosova në qendër të vëmendjes
(Reportazh nga pjesëmarrja në Konferencën e Hartumit në Sudan),
D.I. nr. 105-106, tetor-nëntor 1998, fq. 66-67.

252. Na mban shpresa në ndihmën e Allahut xh.sh.,
D.I. nr. 107, dhjetor 1998, fq. 3.

253. Si të manifestohet agjërimi në sjelljet dhe veprimet tona?!
D.I. nr. 107, dhjetor 1998, fq. 4-8.

254. Feja, shqiptarët dhe Evropa,
Ftesa[10] nr. 7-8, janar 1998 - Ramazan-1418, fq. 4-7.

255. Bashkim e jo përçarje,
Bujku 16 tetor 1998, (fq.9).

1999

256. Toleranca islame dhe fanatizmi i krishterë,
Takvimi 1419/20-Kalendari 1999, fq. 28-48.

257. A është Kosova pjesë e Evropës?!,
D.I. nr.108-109, janar-shkurt 1999, fq. 3.

258. Masakra që tmerroi botën,
D.I. nr. 108-109, janar-shkurt 1999, fq. 5-8.

259. Kthimi në Kosovën e lirë,
D.I. nr. 110, mars-gusht 1999, fq. 3.

260. Beteja e fundit serbe në Kosovë,
D.I. nr. 110, mars-gusht 1999, fq. 4-6.

261. Kosova: Thirrja e ndërgjegjes?!,
D.I. nr. 110, mars-gusht 1999, fq. 39.

262. Si ta kthejmë Kosovën në oazë të paqes?![11]
D.I. nr. 110, mars-gusht 1999, fq. 40-44.

[10] Revistë islame botohet në Tetovë, organ i Rinisë Islame.

[11] Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Vjenës për paqe në Kosovë prej 16-18 mars 1999.

263. Rrënuesit e xhamive,
D.I. nr. 111-112, shtator-tetor 1999, fq. 3.

264. Roli i Kishës Serbe në ngjarjet në Kosovë,
D.I. nr.1 11-112, fq. 4-7.

2000

265. Lamtumirë shekulli njëzet!
Takvimi 1420/21-Kalendari 2000, fq. 6-10.

266. Si t'i emërtojmë fëmijët tanë?!,
Takvimi 142/21-Kalendari 2000, fq. 135-149.

267. Marshi për tërësinë e Kosovës,
D.I. nr.115-116, janar-shkurt 2000, (fq.3).

268. Kosova ndërmjet realitetit shqiptar dhe mitit serb,
D.I. nr, 115-116, janar-shkurt 2000, fq. 4-10.

269. Roli i fesë në mileniumin e ardhshëm[12],
D.I. nr. 115-116, janar-shkurt 2000, fq. 49-56.

270. Takimi i parë i prisave fetarë të Kosovës,
D.I. nr.115-116, fq.56.

271. Xhamitë e djegura e kishat e paprekura,
D.I. nr. 117-118, mars-prill 2000, fq. 3.

272. Dimensionet e gjenocidit serb në Kosovë,
D.I. nr. 117-118, mars-prill 2000, fq. 4-7.

273. T'i kthehemi të së ardhmes, pa e harruar të kaluarën,
D.I. nr. 119-120, maj-qershor 2000, fq. 4-7.

274. Për një Kosovë të pavarur dhe demokratike,
D.I. nr. 121-122, korrik-gusht 2000, fq. 3.

275. Etnocidi serb në Kosovë dhe nevoja e ringjalljes shpirtërore,
D.I. nr. 121-122, korrik-gusht 2000, fq. 4-7.

[12] Nga punimet e Konferencës Botërore Fetë për Paqe, mbajtur në Aman prej 25-29 nëntor 1999.

276. Kontribut për paqen, stabilitetin dhe tolerancën për gjithë njerëzimin,
(Nga Konferenca e Këshillit Euro-Islamik në Sarajevë),
D.I. nr.121-122, korrik-gusht 2000, fq. 59-60.

277. Intifada e Kudsit,
D.I. nr.123-124, shtator-tetor 2000, fq. 4-7.

278. Nëse nuk i përmbahemi parimeve islame, Allahu do të na përbuzë,
(Intervistë me dijetarin e madh islam-Shuajb el-Arnautin nga Amani),
D.I. nr.123-124, shtator-tetor 2000, fq.25-29.

279. Islami dhe brenga e njeriu modern[13],
D.I. nr. 123-124, shator-tetor 200, fq. 66-67.

280. Sfidat me të cilat ballafaqohet Bashkësia Islame në periudhën e pasluftës[14],
D.I. nr. 125, nëntor 2000, fq. 30-33.

281. Islami luajti rol me rëndësi në historinë e Kosovës, (1),
(Intervistë me Dr. Andrash Ridelmajer, ekspert i historisë së artit islam në Universitetin e Harvardit në SHBA),
D.I. nr. 125, nëntor 2000, fq. 41-44.

282. Shekulli XXI do të jetë shekulli ynë!,
D.I. nr.126, dhjetor 2000, fq. 3.

283. Islami luajti rol me rëndësi në historinë e Kosovës, (2),
(Intervistë me dr. Ridelmajer),
D.I. nr. 126, dhjetor 2000, (fq.38-40).

284. Zbulohet një varrezë masive në fshatin Llapllasellë të Prishtinës,
Koha Ditore[15] 3 mars 2000.

285. U zbulua edhe një varrezë masive në fshatin Llapllasellë të Prishtinës,
Kosova Sot[16] 3 mars 200.

[13] Recension i librit me të njëjtin emër organizuar në Shtëpinë e Kulturës në Tetovë, më 13 shtator 2000.
[14] Referat i paraqitur në seminarin e katërt me Imam organizuar nga Kryesia e BIK-ut,
[15] Gazetë e përditshme botohet në Prishtinë
[16] Gazetë e përditshme botohet në Prishtinë

2001

286. Shqiptarët urë lidhëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit,
Takvimi 1421/22-Kalendari 2001, fq.3-29.

287. Tridhjetë vjet të revistës "Edukata Islame",
E.I. nr.65/ 2001, fq. 5-7.

288. Kosova po shkon drejt pavarësisë
(Intervistë me Dr. Muhamed Mufakun),
E.I. nr. 65/2001, fq. 115-120.

289. Kosova para një sprove të madhe,
D.I. nr.127-128, janar-shkurt 2001, fq. 3.

290. Çështja shqiptare dhe ndërkombëtarët,
D.I. nr.131, maj 2001, fq. 3.

291. Ne nuk rrënojmë, por ndërtojmë!,
D.I. nr. 132, qershor 2001, fq. 3.

292. A do të ndryshohet harta e Ballkanit?!,
D.I. nr. 132, qershor 2001, fq. 4-5.

293. Nga Gazimestani në Hagë,
D.I. nr.133, korrik 2001, fq. 3.

294. Maqedonia ndërmjet luftës dhe paqes,
D.I. nr. 133, korrik 2001, fq. 4-7.

295. Marrëveshja që kthen dinjitetin e shqiptarëve,
D.I. nr.134-135, gusht-shtator 2001, fq. 3.

296. Kosova lindore ndërmjet aspiratave të shqiptarëve dhe vullnetit të ndërkombëtarëve,
D.I. nr. 134-135, gusht-shtator 2001, fq. 4-6.

297. Çamëria-plagë e pashëruar e popullit shqiptar,
D.I. nr.136, tetor 2001, fq. 7-9.

298. Mirë se vjen muaj i bekuar!,
D.I. nr. 137, nëntor 2001, fq. 30.

299. Shqiptarët në Malin e Zi,
D.I. nr. 137, nëntor 2001, fq. 33-34.

300. Gërshetimi i kulturave dhe civilizimeve[17],
D.I. nr. 137, nëntor 2001, fq. 62-64.

301. Pamfletet,
D.I. nr. 138, dhjetor 2001, fq. 3.

302. Diaspora shqiptare,
D.I. nr. 138, dhjetor 2001, fq. 4-6.

303. Kur keqpërdoret emri i studentëve
(Reagim),
D.I. nr. 138, dhjetor 2001, fq. 58-59.

304. Shqiptarët dhe çështja fetare,
Studime Orientale,[18] nr. 1, Prishtinë 2001, (fq. 119-124).

305. Konflikti midis Krishterimit dhe Islamit kurrë nuk do të ndodhë!
(Intervistë),
Zëri[19] nr. 1790, 22 shtator 2001, fq. 31-33.

2002

306. Hoxhë Kadri Prishtina mendimtar islam,
Prishtinë, 2002, (fq. 3-103).

307. Prej sulmit mbi Amerikën e deri te bombardimi i Afganistanit,
Takvimi 1422/23-Kalendari 2002, fq. 19-32.

308. Shebmuj sakrificash,
(Aburrhaman Rafet el-Basha: Fragmente nga jeta e sahateve),
(botim i parë, Prishtinë 1996, botimi i dytë 2002, (fq.7-13).

309. Identiteti islam i shqiptarëve,
Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar, Prishtinë 2003.

310. Roli i fesë në edukimin e rinisë,
E.I. nr.66/ 2002, fq. 6-9.

[17] Kumtesë e lexuar në seminarin e pestë me imam organizuar nga Kryesia e BIK-ut.
[18] Organ i shoqatës së orientalistëve të Kosovës, botohet në Prishtinë.
[19] Zëri, magazinë e përjavshme e ilustruar shqiptare, Prishtinë.

311. Kamil Esh-sherif, Islami shoqëri e drejtësisë dhe e prosperitetit,
(përkthim),
E.I. nr. 66/2002, fq. 41-65.

312. Kultura islame në Spanjë ishte burimi i dritës për Evropën mesjetare,
(intervistë e huazuar),
E.I. nr. 66/2001, fq. 87-97.

313. Arsimimi kosovar në udhëkryq,
E.I. nr. 67/2002, fq. 3-7.

314. Rrita dhe zhvillimi i revistës "Edukata Islame" 1971-2001,
E.I. nr. 67/2001, fq. 21-25.

315. Historiku i gjuhës arabe deri në zbritjen e Kur'anit,
E.I. nr.67/2002, fq. 141-150.

316. Për mësimin e fesë në shkolla, (editorial),
E.I. nr. 68-69/2002, fq. 3-10.

317. Historiku i hartimit të fjalorëve të gjuhës arabe,
E.I. nr. 68-69/2002, fq. 131-141.

318. Essejid Ali Ismail, Udhëtimi drejt martizimit
(Tregim i shkurtër) përkthim nga arabishtja,
E.I. nr. 68-69/2002, fq. 187-190.

319. "Ne kishim një herë një atdhe" dhe "Brezi i nderit", nga poeti Muhamed Salih Junus,
E.I. nr. 68-69/2002, fq. 191-195.

320. Parimet njerëzore të haxhit,
D.I. nr. 139, janar 2002, fq. 48-50.

321. Pavarësia e Kosovës-alternativë e vetme,
D.I. nr. 140, shkurt 2002, fq. 4-5.

322. Shqipëria piemont i çështjes shqiptare,
D.I. nr. 141, mars 2002, fq. 4-6.

323. Palestina,
D.I. nr. 142, prill 2002, fq. 3.

324. Bashkimi kombëtar ndërmjet dëshirës dhe realitetit,
D.I. nr.142, prill 2002, fq. 4-5.

325. Rezoluta,
D.I. nr. 143, maj 2002, fq. 3.

326. Terrori shtetëror izraelit në Palestinë,
D.I. nr. 143, maj 2002, fq. 4-7.

327. Kthimi,
D.I. nr. 144-145, qershor-korrik 2002, fq. 3.

328. Perëndimi dhe Lindja-bashkëjetesë apo konflikt?!,
D.I. nr. 144-145, qershor-korrik 2002, fq. 4-6.

329. 11 shtatori 2001,
D.I. nr.146-147, gusht-shtator 2002, fq. 3.

330. A e rrezikon Islami Perëndimin?!,
D.I. nr. 146-147, gusht-shtator 2002, fq. 4-6.

331. Islami në botën bashkëkohore-Fuqia shpirtërore e Islamit (I),
D.I. nr. 148, tetor 2002, fq. 39-41.

332. Kosova 2002,
D.I. nr. 149, nëntor 2002, fq. 3.

333. Islami në botën bashkëkohore-Fitorja e islamistëve në Turqi (II),
D.I. nr. 149, nëntor - dhjetor 2002, fq. 4-5.

334. Pavarësia e Shqipërisë dhe princi i saj i ri
(me rastin e 90 vjetorit të pavarësisë), (përkthim), marrë nga "el-Hilali",
D.I. nr. 149, nëntor-dhjetor 2002, fq. 37-39).

335. Konferenca "Marrëdhëniet ndëretnike dhe toleranca e religjioneve" (Tiranë, 11-12 dhjetor-dhjetor 2002),
D.I. nr. 149, nëntor 2002, fq. 63.

336. Ushtria shqiptare e Misirit,
Vjetar[20] nr. XXV-XXVI, 2002, fq.. 409-414.

337. Revista "Edukata Islame" me fizionomi të re,
Kosova sot 8 maj 2002, fq. 18.

338. Revista "Edukata Islame" me fizionomi të re,
Zëri 8 maj 2002, fq. 16).

[20] Vjetari, publikim vjetor që e boton Arkivi i Kosovës, Prishtinë.

2003

339. Roli i familjes në shoqërinë islame,
Takvimi 1423/24-Kalendari 2003, fq.123-144.

340. Statistikat e popullatës myslimane nëpër botë,
Takvimi 1423/24-Kalendari 2003, fq. 259-272.

341. Identiteti fetar i shqiptarëve,
E.I. nr. 70/2003, fq. 5-10.

342. Dr. Hasan Kaleshi, Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi, (përkthim),
E.I. nr. 70/2003, fq. 55-71.

343. Baza doktrinore e tolerancës islame[21],
E.I. nr. 70/2003, fq. 123-134.

344. A po i kthehen shqiptarët fesë?,
E.I. nr. 71/2003, fq. 5-10.

345. Zhvillimi i shkrimit arab,
E.I. nr. 71/2003, fq. 119-128.

346. Qytetërimi islam në Ballkan,
E.I. nr.72/2003, fq. 5-9.

347. Kaligrafia arabe,
E.I. nr. 72/2003, fq.131-142.

348. Kronikë e gjallë e ngjarjeve të një dekade,
E.I. nr. 72/2003, fq. 265-267.

349. Jubile që obligon,
D.I. nr.150, janar 2003, fq. 3.

350. Islami në botën bashkëkohore-Lëvizjet islame alternativë e regjimeve autoritare, (III),
D.I. nr. 150, janar 2003, fq.56-58.

[21] Kumtesë e paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare me temën: "Marrëdhëniet ndëretnike dhe toleranca e religjioneve" mbajtur në Tiranë më 11-12 dhjetor 2002, organizuar nga Instituti i Shqipërisë për Studime Ballanike dhe Fondacioni Fridrich Ebert (Fridrich Ebert.

351. Shqipëria në fillim të shekullit njëzet (II),
(sipas të dhënave nga revista " el-Hilal" e Kajros, (përkthim),
D.I. nr. 150, janar 2003, fq. 89-93.

352. Fakulteti Islam nevojë e kamotshme,
D.I. nr. 150, janar 2003, fq. 120.

353. Sindromi i islamofobisë perëndimore (IV),
D.I. nr. 151-152, shkurt-mars 2003, 4-6.

354. Vrasja e Salih Tivarit është sfida më e rëndë që i është bërë Bashkësisë tonë,
(Intervistë me Ervin Hatibin, kryeredaktor i gazetës "Drita Islame", Tiranë),
D.I. nr. 151-152, shkurt-mars 2003, fq. 41-42.

355. Mësimbesimi, e drejtë e patjetërsueshme,
D.I. nr. 153, prill 2003, fq. 3.

356. Islami në botën bashkëkohore-Rënia e Bagdadit - (V),
D.I. nr. 153, prill 2003, fq. 4-6.

357. Roli i imamit në ruajtjen e unitetit në xhematin e vet[22],
D.I. nr. 153, prill 2003, fq. 45-46.

358. Konferenca,
D.I. nr.154, maj 2003, fq. 3.

359. Për një avancim të shtypit islam,
D.I. nr.154, maj 2003, fq. 4-5.

360. Shtypi islam në hapësirat ku jetojnë shqiptarët për shkak të rrethanave të njohura, relativisht është i ri
(intervistë),
D.I. nr. 154, maj 2003, fq. 54-55.

361. Bashkësia Islame e Kosovës katër vjet pas luftës,
D.I. nr. 155, qershor 2003, fq. 3.

362. Aktualiteti i mesazheve të Lidhjes së Prizrenit,
D.I. nr. 155, qershor 2003, fq. 4-5.

[22] Kumtesë e lexuar në Seminarin e VI-të me imamët e Kosovës të mbajtur më 21 tetor 2002 në Prishtinë

363. Dhuna,
D.I. nr. 156-157, korrik-gusht 2003, fq. 3.

364. Strategjia kishtare serbe për Kosovën "Memorandumi" për kthimin e okupimit serb në Kosovë,
D.I. nr. 156-157 - korrik-gusht 2003, fq. 4-6.

365. Zgjedhjet,
D.I. nr.158, shtator 2003, fq. 3.

366. Përkujtimi i dytë i sulmeve të 11 shtatorit,
D.I. nr. 158, shtator 2003, fq. 4-6.

367. Dialogu,
D.I. nr. 159, tetor 2003, fq. 3.

368. Rrezik për Islamin… e jo nga Islami,
D.I. nr. 159, tetor 2003, fq. 4-6.

369. Standardet,
D.I. nr.160-161, nëntor-dhjetor 2003, fq. 3.

370. Ikja nga identiteti (në shënjestër),
D.I. nr. 160-161, nëntor-dhjetor 2003, fq. 4-5.

371. Mehmet Ali Pasha në dritën e dokumenteve arkivore egjiptiane,
Vjetar nr. XXIX-XXX, 2003, fq. 242-248.

2004

372. Parathënie e bitimit shqip, 2004, (fq.11-14).
Thomas W. Arnold: Historia e përhapjes së Islamit. Prishtinë, 2004.

373. Roli i xhamisë në fenë islame,
(Xhemush Biçku, Xhamitë dhe imamët e Dardanës, me rrethinë 1532-2004), Prishtinë, 2004, (fq.7-9).

374. Muhamedi (a. s.),
E.I. nr. 73/2004, fq. 5-9.

375. Ndikimi i faktorit fetar në emrat vetjakë tek shqiptarët,
E.I. nr.73/2004, fq.79-88.

376. Arsimimi,
E.I. nr. 74/2004, fq. 5-14.

377. Angazhimi i BI të Kosovës në zhvillimin e arsimit universitar islam në kuadër të FSI-së të Prishtinës,
E.I. nr. 74/2004, fq. 143-152.

378. Do të preferoja që njerëzit të më quajnë arabolog,
E.I. nr. 74/2004, fq. 239-243.

379. Kultura në shërbim të afrimit të Lindjes dhe Perëndimit,
E.I. nr.75/2004. fq. 5-12.

380. Boshnjakët ndërmjet kombit dhe Islamit,
(Recension),
E.I. nr. 75/2004, fq. 243-250.

381. Roli i Kishës Ortodokse serbe në luftërat e fundit në ish-Jugosllavinë,
(recension),
E.I. nr. 75/2004, fq. 251-268.

382. Haxhi-mesazh i paqes,
D.I. nr.162, janar 2004, fq. 3.

383. Shamia,
D.I. nr. 163, shkurt 2004, fq. 3.

384. Shamia obligim e jo simbol fetar,
D.I. nr. 163, shkurt 2004, fq. 5-7.

385. Protestat,
D.I. nr. 164, mars 2004, fq. 3.

386. Nga po shkon Kosova?,
D.I. nr. 164, mars 2004, fq. 5-7.

387. Mevludi
D.I. nr.165, prill 2004, fq. 3.

388. Çka duhet të mësojmë nga protestat e marsit?,
D.I. nr. 165, prill 2004, fq. 5-6.

389. Administratorët,
D.I. nr.166, maj 2004, fq. 3.

390. Ferri prapa grilave në burgun Ebu Graib,
D.I. nr.166, maj 2004, fq. 4-6.

391. Njëqindvjetori,
D.I. nr. 167, qershor 2004, fq. 3.

392. Projekti amerikan për Lindjen e Mesme të Madhe,
D.I. nr. 167, qershor 2004, fq. 4-5.

393. Hoxha që ringjalli Islamin në Shqipëri (Haxhi Hafiz Sabri Koçi (1921-2004),
D.I. nr. 167, qershor 2004, fq. 62-63.

394. Paragjykimet,
D.I. nr. 168-169, korrik-gusht 2004, fq. 3.

395. Feja si faktor për të ardhmen e Kosovës,
D.I. nr.168-169, korrik-gusht 2004, fq. 4-6.

396. Zgjedhjet 2004,
D.I. nr. 170-171, shtator-tetor 2004, fq. 3.

397. Prej Bagdadit në Gauantenamo,
D.I. nr. 170-171, shator-tetor 2004, fq. 4-6.

398. "Kosova-konflikt etnik, e jo fetar" (pjesë nga dialogu i zhvilluar në Radion Evropa e Lirë-Pragë rreth gjendjes në Kosovë me At Sava Janjiq të udhëhequr nga Omer Karabeg),
D.I. nr. 170-171, shtator-tetor 2004, (fq. 42-45).

399. Pengjet,
D.I. nr. 172, nëntor 2004, fq. 3.

400. Integrimet fetare në Evropë
D.I. nr. 172, nëntor 2004, fq. 4-8.

401. Qeverisja,
D.I. nr. 173, dhjetor 2004, fq. 3.

402. Turqia, Evropa dhe Islami,
D.I. nr. 173, dhjetor 2004, fq. 4-6.

403. Si të përgatitet ligjërimi fetar[23]?
D.I. nr. 173, dhjetor 2004, fq. 43-45.

[23] Kumtesë e lexuar në Seminarin e 9-të të Imamëve të BIK-ut më 9 tetor 2004.

404. Kur ndërron jetë intelektuali
(me rastin e vdekjes së Idriz Vuçitërnës),
D.I. nr. 173. dhjetor 2004, fq. 60.

405. Ndikimi i faktorit islam në emrat vetjakë të shqiptarëve,
Univers[24]*, nr. 5, 2004, fq. 31-40.*

406. Koncepti islam i Sami Frashrit në veprën e tij
"Përhapja e Islamit",
Studime[25]*, nr. 11 2004, fq. 243-254.*

407. Rreth Kishës së Deçanit dhe rrugës për Evropë,
(reagim),
Koha Ditore nr. 2600, 11 shtator 2004, fq. 31.

408. Dorëshkrim për gjuhësinë arabe në Bibliotekën e Shqipërisë,
(Orientalistikë),
Koha Ditore nr. 2628, 9 tetor 2004, fq. 34).

409. Për vehabitët thuhen gjera që nuk kanë të bëjnë me realitetin
(Intervistë),
Java[26] *nr. 036, 13 fror 2003, fq. 7.*

410. Strehimi në " Shtëpitë e Zotit",
(Bisedë),
20 minutat[27] *nr. 2. 30 dhjetor 2004, fq. 16.*

411. Ikja nga identiteti
(Vështrim),
Epoka e Re nr. 1142, 17 janar 2004. fq. 15.

412. Pse ka mbetur të festohet Kurban Bajrami?
(Intervistë),
Epoka e Re nr. 1154, 31 janar 2004, fq.7.

413. Islami dhe letërsia kombëtare,
Bota Sot[28]*, nr. më 28 tetor 2004, fq. 19.*

[24] Revistë shkencore kulturore, e boton Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam në Tiranë.
[25] Revistë shkencore vjetore boton Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
[26] Gazetë e përjavshme që botohet në Prishtinë
[27] Gazetë e përditshme që është botuar në Prishtinë
[28] Gazetë e përditshme që botohet në Prishtinë

2005

414. Nevoja e ripërtëritjes së mendimit fetar,
Takvimi 1425/26-Kalendari 2005, fq.7-24.

415. Roli dhe misioni i informimit në Islam,
(Shtypi islam dje, sot dhe nesër (përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore, (Prishtinë, 23-24 maj 2003), fq. 257-270, Prishtinë, 2005.

416. Kultura dhe akultrimit,
E.I. nr. 76/2005, fq. 5-13.

417. Gjendja e monumenteve islame të Kosovës në vitet e pesëdhjeta të shekullit njëzet,
(Përgatitur nga Dr. H. Kaleshi, (përkthim),
E.I. nr 76/2005, fq. 75-88.

418. Egjipti në kohën e Mehmet Ali Pashës,
E.I. nr. 76/2005, fq. 223-236.

419. Orientalistët e rinj,
E.I. nr. 77/2005, fq. 5-10.

420. Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe
(recension),
E.I. nr. 77/2005, fq. 277-282.

421. Myderrizi që u bë kurban për lirinë e vendit të vet,
(recension),
E.I. nr. 77/2005, fq. 289-292.

422. Aspekti edukativ në veprën e Muhamed Abduhus,
E.I. nr. 78/2005, fq. 5-12.

423. Orientalizmi në fazën fillestare të tij,
E.I. nr, 78/2005, fq. 79-98.

424. Feja dhe Evropa,
D.I. nr. 174175, janar-shkurt 2005, fq. 3-6.

425. Tribunali,
D.I. nr.176-177, mars 2005, fq. 3.

426. Islami dhe Evropa,
D.I. nr. 176-177, mars 2005, fq. 4-7.

427. Halid Muhamed haliç, Shkëndijë nga njerëzia e Muhamedi a.s. (përkthim),
D.I. nr. 176-177, mars 2005, fq. 29-30.

428. Trashëgimia,
D.I. nr. 178, maj 2005 fq. 3.

429. Përdhosja e Kur'anit indinjon të gjithë myslimanët,
D.I. nr. 178, fq. 5-6.

430. Srebrenica,
D.I. nr. 179 qershor 2005, fq. 3.

431. Evropa dhe dialogu ndërkulturor me vendet e Mesdheut,
D.I. nr. 179, qershor 2005, fq. 4-8.

432. Myslimanët dhe laicizmi,
D.I. nr. 180-181, korrik-gusht 2005, fq. 4-5.

433. Sindromi i përçarës në Bashkësinë Islame të Maqedonisë,
D.I. nr. 182, shtator 2005, fq. 4-5.

434. Haxhi shtyllë e islamit,
D.I. nr. 183-184, tetor-nëntor 2005, fq. 3.

435. Ligjërata e Presidentit të Shqipërisë që shqetësoi shpirtrat e shqiptarëve,
D.I. nr. 183-184, tetor-nëntor 2005, fq. 4-5.

436. Myderriz mulla Mehmet Dobrosini-imami që ishte në shërbim të popullit (1907-1969),
D.I. nr. 183-184, tetor -nëntor 2005, fq. 42-43.

437. Egjipti në kohën e Mehmet Ali Pashës,
Vjetar nr.XXXIII-XXXIV, 2005 fq. 105-116

438. Përpjekje për unifikimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe, (Terminologjia Islame, (Tryezë shkencore -Prishtinë, 10 nëntor 2005),
Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës & Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, 2006, (përmbledhje kumtesash), (fq. 91-95).

439. Çfarë gjendet në "Komedinë Hyjnore" nga "el-Mi'raxh?",
Zëri[29] nr. 1601, 19 mars 2005, fq. 20.

440. Mundësi e mirë e njohjes së portretit të Kadaresë në botën arabe,
Zëri nr.1631, 23 prill 2005, fq.27.

441. Masakra e Srebrenicës dhe kërcënimet për reprezimin e saj
Zëri, nr. 1701, 15 korrik 2005, fq. 10.

442. Myslimanët ndërmjet fesë dhe politikës,
Zëri, nr. 1708, 23 korrik 2005, fq. 12.

443. T'i lemë të qetë të vdekurit tanë,
Zëri nr. 1720, 6 gusht 2005, fq. 12.

444. Poeti mërgimit që jetoi në Kajro e vdiq në Bejrut
(Me rastin e 70 vjetorit të vdekjes),
Zëri nr. 1720, 6 gusht 2005, fq. 31.

445. Medlin Olbrajt: Në Kosovë Amerikën e duan dhe e respektojnë shumë,
Zëri nr.1759, 21 shtator 2005, fq.14.

446. Jerusalemi-vendi ku toka takohet me qiellin,
(Letër nga Jerusalemi),
Zëri nr. 1767, 30 shtator 2005, fq.14.

447. Ekstremizmi islam dhe reflektimi i tij në Kosovë,
Zëri nr. 1721, 8 gusht 2005, fq. 10.

448. Myslimanët dhe laicizmi-Moskuptimet nga mosnjohjet,
Zëri nr.1776, 11 tetor 2005, fq. 16.

449. Anëtarësimi i Turqisë në BE - fitore për Turqinë dhe Evropën,
Zëri nr. 1778, 13 tetor 2005, fq. 12.

450. Përkatësia ndaj atdheut dhe përkatësia ndaj fesë,
Zëri nr. 1794, 1 nëntor 2005, fq. 16.

451. Asgjë e re në Kishën Ortodokse Serbe!,
Zëri nr.1799, 6 nëntor 2005, fq. 11.

[29] Gazetë e përditshme që botohet në Prishtinë.

452. Monumentet ortodokse serbe në Kosovë do t'i mbrojnë vetë kosovarët,
Zëri nr. 1802, 12 nëntor 2005, fq. 12.

453. A mund të imponohet faktori fetar në bisedimet për Kosovën?,
Zëri nr. 1817, 30 nëntor 2005, fq. 14.

454. A po cenohet toleranca ndërfetare te shqiptarët?!,
Zëri nr. 1832, 17 dhjetor 2005, (fq..12).

455. Myslimanët ndërmjet fesë dhe politikës,
Koha ditore nr. 2915, 28 korrik 2005, fq. 11.

456. Haxhi 2005, (intervistë), nr. 8, shkurt 2005,
Mendimi Islam[30] fq. 51-54.

457. Ndikimi i librit "el-Mi'raxh" në "Komedinë hyjnore",
"Kosova sot" nr. 1964, 20 mars 2005, fq. 33.

458. Pse fushatë për përçarjen e Islamit?!,
"Kosova sot" nr. 1976, 1 prill 2005, fq.10.

459. Myslimanët ndërmjet fesë dhe politikës,
"Kosova sot" nr. 2088, 22 korrik 2005, fq. 22.

460. Shqiptarët kryeministra dhe artistë të famshëm,
"Kosova sot" nr. 2006, 30 prill 2005, fq. 34.

461. Kjo ide s'është e re,
Java 27 tetor 2005, fq. 29.

462. Një jubile që nuk duhet anashkaluar,
Epoka e Re nr.1491, 5 mars 2005, fq. 19.

463. Fushatë për përçarjen e Islamit,
Epoka e Re nr.1514, 1 prill 2005, fq. 7.

464. Ismail Kadare ndërmjet letërsisë dhe politikës,
Epoka e Re nr.1533, 23 prill 2005, fq. 19.

465. Kryeministra të mëdhenj dhe artistë të famshëm,
Epoka e Re nr. 1539, 30 prill 2005, fq. 20.

466. Egjipti në kohën e Mehmet Ali Pashës (I),
Epoka e Re nr.1551, 14 maj 2005, fq.13.

[30] Mendimi Islam, revistë e përmuajshme botohet në Prizren.

467. Egjipti në kohën e Mehmet Ali Pashës (II),
Epoka e Re nr.1552, 16 maj 2005, fq. 23.

468. Mehmet Ali Pasha, themelues i Egjiptit modern, (200 vjetori i ardhjes në pushtet).
Epoka e Re nr.1719, 6 dhjetor 2005, fq.14.

469. Çfarë trajtimi institucional po i bëhet fesë në Kosovë?
(Intervistë),
Zëri nr. 1936, 16 korrik 2005, fq. 12-13.

2006

470. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian,
Prishtinë 2006, fq.3-192.

471. Parathënie me rastin e botimit në gjuhën shqipe,
(Abdullah Nasih Ulvan, Salahudin el-Ejubi hero i betejës së Hittinit), Prishtinë, 2006, (fq.9-13).

472. Angazhimi i BI të Kosovës në zhvillimin e arsimit universitar islam në kuadër të FSI-së të Prishtinës,
(Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Fetare Islame) (punimet e tryezës së rrumbullakët).
Shkup, 2006.

473. Përpjekje për unifikimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe,
(Terminologjia Islame) (Tryezë shkencore-Prishtinë, 10 nëntor 2005).
Prishtinë, 2006

474. Aspekti fetar në pavarësimin e Kosovës,
(Kosova shtet i pavarur dhe sovran),
(Tryezë shkencore, 20 dhjetor 2006)
Prishtinë, 2006.

475. Ibnu Halduni themelues i sociologjisë moderne,
E.I. nr. 79/2006, fq. 5-11.

476. Han Kristian Andersen, Një tregim danez për ditëlindjen e profetit Muhamed,
(përkthim),
E.I. nr. 79/2006, fq. 279-290.

477. Dritë e pashuar për Hz. Muhamedin a.s.
(recension),
E.I. nr. 79/2007, fq. 337-342.

478. Islami evropian,
E.I. nr. 80/2006, fq. 5-9.

479. Ndikimi i gjuhës asiriane në gjuhën arabe,
E.I. nr. 80/2006, fq. 115-124.

480. Roli edukimit fetar në shoqërinë bashkëkohore,
E.I. nr. 80/2006, fq..191-198.

481. Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarët,
E.I. nr.81/2006, fq. 5-8.

482. Të dhëna për Shqipërinë në prag të pavarësisë në revistën "El-Hilal" të Kajros,
E.I., nr. 81/2006, fq. 263-279.

483. Karikaturat ofenduese dhe reagimet ndaj tyre,
D.I. nr. 186-187, janar-shkurt 2006, fq. 4-5.

484. Lufta në Liban dhe reflektimi i saj në Lindjen e Mesme,
D.I. nr. 192-193, korrik-gusht 2006, fq. 4-5.

485. Klithma dhe vaji i palestinezes Huda
(Nga skena palestineze),
D.I. nr. 192-193, korrik-gusht 2006, fq. 6.

486. Qëllimi i simpoziumit është të hedhë dritë mbi një periudhë të gjatë kohore prej gjashtë shekuj të historisë sonë kombëtare dhe fetare" (bisedë),
D.I. nr.192-193, korrik-gusht 2006, fq. 46.

487. Sa larg e sa afër është Medvegja nga Prishtina?!
(Reportazh),
D.I. nr. 192-193, korrik-gusht 2006, fq. 54-55.

488. Frika nga transversalja e gjelbër në Ballkan, trillim apo realitet?!,
D.I. nr. 194, shtator 2006, fq. 4-5.

489. Si duhet të kuptohet ligjërata e Papa Benediktit të XVI-të?,
D.I. nr.195-196, tetor-nëntor 2006, fq. 4-5.

490. Vitet e thyerjeve të mëdha,
D.I. nr.197, dhjetor 2006, fq. 5.

491. Roli i Bashkësisë Islame në periudhën e pas statusit të Kosovës (sfida dhe përgjegjësi)[31],
D.I. nr. 197, dhjetor 2006, fq. 9-10.

492. Feja si faktor për të ardhmen e Kosovës,
(Kosova shtet i pavarur dhe sovran, (Tryezë shkencore, 20 dhjetor 2006), Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës,
(përmbledhje kumtesash), Prishtinë 2006, (fq. 153-161).

493. Çka simbolizon festa e Kurban-Bajramit?,
Zëri nr. 1850, 11 janar 2006, fq.12.

494. Mark Sopi-përfaqësues i denjë i çështjes së Kosovës në planin ndërkombëtar,
(In memoriam),
Zëri nr. 13 janar 2006, (fq.11).

495. Vdekja e politikanit të moderuar dhe simbolit të pavarësisë,
(In memoriam),
Zëri nr.1861, 23 janar 2006, fq. 8.

496. Kompromisi ndërmjet lirisë së të shprehurit dhe respektimit të fesë,
Zëri nr. 1886, 21 shkurt 2006, fq. 14.

497. Si do të reagonte profeti i islamit ndaj karikaturave?,
Zëri nr. 1891, 27 shkurt 2006, fq. 11.

498. Të shikohet edhe ana tjetër e medaljes,
Zëri nr.1892, 28 shkurt 2006, fq. 14.

499. Pas karikaturave, simpoziumi për profetin e islamit,
Zëri nr.1900, 9 mars 2006, fq.13.

500. Princi Carls aktivist për afrimin e religjioneve,
Zëri nr. 1918, 30 mars 2006, fq. 14.

501. A duhet të festohet ditëlindja e Profetit?!,
Zëri nr.1931, 14 prill 2006, fq. 14.

[31] Kumtesë e lexuar në Seminarin e XI-të të imamëve të Kosovës, mbajtur më 9 shtator 2006.

502. Cila është trashëgimia kulturore e Kosovës?,
Zëri nr. 1961, 20 maj 2006, fq. 14.

503. Pse arabët frikohen nga globalizmi?!
(Letër nga Amani),
Zëri nr. 1972, 2 qershor 2006, fq. 12.

504. Abu Musa'ab al-Zarkavi-martir apo vrasës?!,
Zëri nr.1981, 13 qershor 2006, fq.15.

505. Dom Lush Gjergji ithtar i dialogut ndërfetar dhe aktivist për pajtimin e gjaqeve në Kosovë,
Zëri nr. 1990, 23 qershor 2006, fq. 22.

506. Intervenimi ushtarak ndërkombëtar në Kosovë, ndryshe nga krejt të tjerët,
Zëri nr. 2034, 14 gusht 2006, fq. 12.

507. Përse arabët janë kundër demokracisë së Perëndimit?,
Zëri nr. 2048, 28 gusht 2006, fq. 10.

508. Islami evropian dhe dilemat rreth tij,
Zëri nr.2060, 13 shtator 2006, fq. 16.

509. Ikja nga filozofia për të gjetur prehje në Poezi, Omer el-Hajami - poet dhe filozof,
Zëri nr. 2063, 16 shtator 2006, fq. 28.

510. Opusi letrar i novelistit egjiptian Nexhip Mahfudhi (11.12.1911-30.08.2006), Shprehës i metaforave të fuqishme mbi një periudhë prej gjysmë shekulli,
Zëri nr. 2075, 30 shtator 2006, fq. 27.

511. Kosova është vend me tolerancë shumë të madhe ndërfetare,
Zëri, nr. 2088, 16 tetor 2006, fq. 12.

512. Islami evropian dhe dilemat rreth tij,
Iliria Post[32] *21-23 tetor 2006, fq. 22.*

[32] Gazetë e përditshme që është botuar në Prishtinë.

2007

513. Myslimanët ndërmjet së kaluarës dhe së sotmes,
Takvimi 1427/28-Kalendari 2007, fq. 65-74.

514. Parathënie,
(Akademik, Ekrem Murtezai, Fajlori i terminologjisë fetare),
Prishtinë, 2007, (fq.9-10).

515. Bibliografi me vlerë,
(Rexhep Shahini, Libri islam në shqip 333 tituj),
Prishtinë, 1428h-2007, (fq.10).

516. Përkujtim i Salahudin el-Ejubiut (1138-1193),
E.I. nr. 82/2007, fq. 5-9.

517. Mehmet Mujezinoviq, Dorëshkrimet e xhamisë së Mehmet Pashës në Prizren,
E.I. nr 82/2007, fq. 145-170.

518. Origjina e fundamentalizmave,
E.I. nr. 83/2007, fq. 5-9.

519. Ahmet Rami-shqiptari që mori ofiqin poeti i Kajros,
E.I. nr. 83/2007, fq. 225-236.

520. Islamofobia!,
E.I. nr. 84/2007, fq. 5-12.

521. Gjuha dhe feja,
E.I. nr. 84/2007, fq. 83-92.

522. Tajib Salih, Koha e shpërnguljes në veri, (përkthim),
E.I. nr. 84/2007 fq. 199 -211.

523. Islami dhe brenga e njeriut modern, (recension),
E.I. nr. 84/2007, fq. 225-227.

524. Varja e Sadamit apo varja e Irakut?!,
D.I. nr. 198, janar 2007, fq. 4-5.

525. Monumentet e harruara islame të Medvegjës
(Reportazh),
D.I. nr. 198, janar 2007, fq. 44-46.

526. Si trajtohet çështja fetare në pakon e Ahtisarit?!,
D.I. nr. 199, shkurt 2007, fq. 5-6.

527. Feja si faktor për të ardhmen e Kosovës,
D.I. nr. 200, mars 2007, fq. 4-7.

528. Në përkujtim të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit,
D.I. nr. 202, maj 2007, fq. 4.

529. Sa larg e sa afër është Amerika!
(Reportazh),
D.I. nr. 202, maj 2007, fq. 46-47.

530. Kosova dhe politika globale,
D.I. nr. 203, qershor 2007, fq. 4-5.

531. Sa mund të jetë e rrezikshme loja me flamuj?!,
D.I. nr. 204-205, korrik-gusht 2007, fq. 4.

532. Shamia në mes sheriatit dhe ligjit,
D.I. nr. 206, shtator 2007, fq. 4-5.

533. Misionarët dhe misionarzimi në Kosovë,
D.I. nr.207, tetor 2007, fq. 5-6.

534. Çka duhet të mësojmë prej zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007?!,
D.I. nr. 208-209, nëntor-dhjetor 2007, fq. 4-6.

535. Çka duhet të mësojmë nga Islamabadi?,
Zëri nr. 2267, 19 maj 2007, fq. 11.

536. Prijësit fetarë duhet të ofrojnë mesazhe të paqes,
Zëri nr. 2275, 29 maj 2007, fq. 14.

537. Nismëtarja e revolucionit metrik në poezinë arabe, (Nazik el-Melaike),
Zëri nr. 2309, 7 korrik, 2007, fq. 26.

538. Shqiptari që mori ofiqin "Poeti i Kajros", (I),
Zëri nr.2317, 17 korrik 2007, fq. 27.

539. Lidhjet e Ahmet Ramit me Teqenë shqiptare të Kajros, (II),
Zëri nr. 2318, 18 korrik 2007, fq. 27.

540. Tekstet për këngët e Um Kulthumit, këngëtares së njohur me përmasa në tërë botën arabe, (III),
Zëri nr. 2319, 19 korrik 2007, fq. 28.

541. A po e ndryshon Turqia Kursin e saj politik?!,
Zëri nr. 2325, 26 korrik 2007, fq. 16.

542. A po thyhen tabutë në letërsinë moderne të Arabisë Saudite?!,
Zëri nr. 2339, 11 gusht 2007, fq. 30.

543. A lejon Islami marrjen peng?,
Zëri nr. 2347, 21 gusht 2007, fq. 12.

544. Islami në Evropën e ndryshuar dhe përvoja shqiptare,
Zëri nr. 2364, 10 shtator 2007, fq.19.

545. Fetfa kundër xhihadit,
Zëri nr.2386, 5 tetor 2007, fq. 14.

546. Indiferentizmi fetar,
Zëri nr. 2390, 10 tetor 2007, fq.16.

547. A e rrezikon Islami çështjen shqiptare?!,
Zëri nr. 2396, 18 tetor 2007, fq. 15.

548. Ku qëndrojnë shkaqet e "hidhërimit islamik"?!,
Zëri nr. 2406, 30 tetor 2007, fq. 17.

549. Shqipëria nuk dëshiron të lëshojë pe në pavarësinë e saj,
Zëri nr. 2433, 1 dhjetor 2007, fq. 28.

550. Kur një prijës fetar dërgon mesazhe urrejtjeje?!,
Zëri nr. 2437, 6 dhjetor 2007. fq. 18.

551. Kurban-Bajrami - simbol i sakrificës,
Zëri nr.2448, 19 dhjetor 2007, fq. 18.

552. "Dimër i nxehtë për Kosovën!",
Zëri nr.2449, 21 dhjetor 2007, fq. 16.

553. Kosova dhe bota islame,
Zëri nr.2453, 26 dhjetor 2007, fq. 16.

554. A është shamia ferexhe?! (reagim),
Express[33] *nr. 932, 28 shtator 2007, fq.5.*

555. Shamia në mes sheriatit dhe ligjit,
Express nr. 938, 4 tetor 2007, fq. 5.

556. Si trajtohet çështja fetare në pakon e Ahtisarit?!,
Infopress[34] *nr.195, 3 mars 2007, fq. 5.*

[33] Gazetë e përditshme që botohet në Prishtinë.
[34] Gazetë e përditshme që botohet në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Shoqëria e Hixhretit dhe ne **5**

Orhan Bislimaj
Besëtytnia dhe rreziku i saj në besimin islam **13**

Prim. Dr. Ali Iljazi
Kur'ani Famëmadh dhe "ateizmi shkencor" **45**

Muhammed Asad
Parimet e shtetit dhe të qeverisë në Islam
- Qeverisje me mirëkuptim dhe këshill - **63**

Abdullah Nasih Ulvan
Islami - ligj i jetës **87**

Dr. Mahmud Halil
Marrëdhëniet ndërkombëtare në kushtetutën e shtetit islam **115**

Osman Nuri Haxhiq
Organizimi dhe rregullimi i brendshëm i halifatit - shtetit islam **-125**

Nazim Agaj
Sistemi arsimor-shkollor në territorin e Kosovës
sipas sallnameve 1885/1900 ..... **139**

Mr. Qemajl Morina
Glosari i nocioneve fetare **177**

Zymer Ramadani
Sâl-namet – Vjetarët **213**

Dr. Riza Sadiku
Kontributi shkencor dhe kombëtar i prof. dr. Hasan Kaleshit **229**

Nuridin Ahmeti
Kontributi i dr. Hasan Kaleshit në historiografinë shqiptare **249**

Amr Halid
Zgjedhja e Omerit halif - (2) **257**

Dr. Feti Mehdiu
Ndikimi i librave të shenjtë në dialogun ndërmjet
qytetërimeve euro-aziatike **291**

Xhamia Zejtunie … vatër e shkencës dhe diturisë **301**

Intervistë me Karen Armstrong, botuar në revistën "ISLAMICA"
Feja nuk është shkak i përçarjeve në botë **307**

Tajib Salih
Koha e shpërnguljes në veri - (2) **317**

Ramadan Shkodra
Bibliografi e punimeve të Mr. Qemajl Morinës 1971-2007 ..... **337**

Përmbajtja **387**